

---

---

# Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti X (XXIV) - Nr. 34 (187) ISSN: 2305-655X

---

SHKENCA ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



NUMRI  
ISSUE

34

2022



**Botues:**  
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

# Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI I (XXIV) 2022, NR. 34 (187)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,  
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

[www.zaninalte.al](http://www.zaninalte.al)

Tiranë, 2022

## Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

*Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012*

VITI X (XXIV), janar - qershor 2022 nr. 34 (187)

**Nën kujdesin e:** H. Bujar Spahiu

**Drejtor:** Dorian Demetja

**Kryeredaktor:** Dr. Genti Kruja

**Bordi editorial:** Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Universiteti Bedër  
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër  
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër  
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër  
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë  
PHD. Cand. Elton Karaj, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë  
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut  
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

**Redaktor:** Andrin Rasha

**Në anglisht:** Rudina Çinari, Universiteti Bedër

## Zani i Naltë

---

**Bordi shkencor:** Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri  
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë  
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë  
Prof. Dr. Sadije Bushati  
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër  
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë  
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza – Perriu, Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan  
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup  
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup  
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës  
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër  
Dr. Agron Tufa, Zvicër  
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike  
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA  
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër  
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër  
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës  
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër  
PhD. Cand. Ali Zaimi, Universiteti Bedër  
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër  
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA  
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtime dhe Studime Islame, Prishtinë  
Msc. Agron Hoxha, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë  
Msc. Lorela Shehu, Florida State University, SHBA  
H. Resul Rexhepi, Prishtinë  
Xhemal Balla, Tiranë

**Fushat:** Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

**Realizimi**

**grafik:** Ejup Lila

**Fotoja në kopertinë:** Pamje nga Berati, foto AQSH

**Adresa:** Komuniteti Mysliman i Shqipërisë  
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

**e-mail:** info@zaninalte.al

**Web:** www.zaninalte.al



## Përmbajtja

### Studime Islame

1. Marrëdhëniet sociale nga perspektiva e Sunetit  
**Prof. Dr. Faredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup.....7**
2. Xhamia - Vendi më meritohet për adhurimin e Allahut të Lartësuar  
**Resul Rexhepi, Prishtinë.....13**

### Kur'ani dhe Shkenca

3. Mrekullia e Kur'anit Famëlartë në dritën e njohurive të reja shkencore  
**Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi, Gjakovë.....31**

### Studime

4. Vakëfi midis së shkuarës dhe së ardhmes  
**Edison Hoti, Drejtorja e Vakf-Investimeve, KMSH.....40**
5. Bediuzzaman Said Nursi, Mrekullia e kohës (I)  
**Dorian Demetja, Drejtorja e Kulturës, KMSH.....49**
6. Gjumi si argument  
**Blerim Lazimi.....78**

### Psikologji Islame

7. “Prodhimi i fëmijëve” - Perspektiva biologjike, ekonomike, psikologjike, sociale dhe islame  
**Skënder Mustafi & Jusuf Zimeri.....87**

### **Sociologji Islame**

8. Sfidat me të cilat përballen familjet myslimane në shoqërinë bashkëkohore  
**Msc. Ledian Cikalleshi, Myfti i Korçës.....103**

### **Përkthime**

9. Vdekja e bardhë: Ibn ‘Arabiu rreth sprovave e virtyteve të urisë dhe agjërimit  
**Atif Khalil, Universiteti i Lethbridge, Kanada.....112**

### **Reçencë**

10. Recencë romanit “Baladë muhaxhire” me autor Nimon Muçaj  
Drejt një kuptimi  
**Ma. sc. Refik Gërbeshi.....127**

### **Personalitet**

11. Vexhi Buharaja (1920-1987) - “Mësues i Popullit”.....135

### **Retrospektivë**

12. Pse duhet të jemi fetar (II).....139
13. Abstracts in English.....144
14. Rregullat e shkrimit.....154





## Marrëdhëniet sociale nga perspektiva e Sunetit

**Prof. Dr. Faredin Ebibi**  
**Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup**

### Hyrje

**I**nteresimi për çështje sociale dhe studimi i fenomeneve shoqërore, siç është sociologjia, është shkencë më vete e cila zanafillën dhe burimet e veta i ka që me zhvillimin e vazhdueshëm të jetës shoqërore.

Ndërtimi i familjes mbi baza edukative të shëndosha, të kuptuarit e problemeve me të cilat çiftet bashkëshortore ballafaqohen në fazën e formimit, problemet e edukimit pas ardhjes së fëmijëve në këtë botë, studimi i dukurive të

sjelljeve, i manifestimeve fetare, i kulturave të besimeve dhe të ideve, të klasave sociale dhe etnike, siç kërkon vetëdije, përkushtim dhe njohuri se si duhen menaxhuar proceset, po ashtu kërkon njohje të segmenteve delikate.

Shumica e studimeve sociale konfirmojnë faktin se njeriu, nga vetë natyra, është shoqëror dhe instinktivisht tenton të integrohet me anëtarët e llojit të tij. Nevoja vetë kushtëzon që ai të merret me njerëzit dhe të bashkëpunojë me ta, për arritjen e interesave e synimeve të tij si dhe për t'i përmbushur nevojat e

veta nga ata dhe anasjelltas.

Sociologjia si shkencë merret me studimin e marrëdhënieve shoqërore në nivel të individëve, të grupeve apo të institucioneve vetëm nga këndvështrimi ose nga aspekti i arritjes ose ngopjes së interesave të kësaj bote.

Sa i përket ligjit (shariatit) islam, ai bën dallim, sepse bën lidhjen e marrëdhënieve shoqërore të kësaj bote me shpërblimin ose ndëshkimin e botës së përtejme, duke vendosur një sërë kontrollesh dhe kornizash që kontribuojnë në ndërtimin e duhur të këtyre raporteve. Respektimi i këtyre kontrolleve i forcon radhët e besimtarëve dhe e mbron shoqërinë nga përçarja dhe copëtimi. Ky tekst përpiket t'i hedhë një vështrim rëndësishëm së marrëdhënieve ose të raporteve të mira shoqërore në Islam dhe pasojat si rezultat i mos përmbushjes së detyrave.

### **Rëndësia e ndërtimit të marrëdhënieve shoqërore në Islam**

Me nocionin marrëdhënie shoqërore nënkuptohet lidhja me efektet reciproke, që lind si rezultat i bashkimit të njerëzve, këmbimit të ndjenjave dhe fërkimeve të tyre me njëri-tjetrin, si dhe nga ndërveprimi i tyre në rrafshin shoqëror.

Krijuesi i gjithësisë e ka bërë të qartë faktin se marrëdhëniet mes njerëzve peshohen në bazë të njohjes dhe integritetit, dhe se ekuilibri i

preferencës është devotshmëria dhe puna e mirë. **“O njerëz, Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri-tjetrin. Më fisniku nga ju te Allahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij; Allahu, me të vërtetë, është shumë i dijshëm dhe mirë i informuar.”**<sup>1</sup>

Sipas Ibni Haldunit njeriu, nga vetë natyra, është i urbanizuar - i qytetëruar që do të thotë se individi nuk mund ta jetojë jetën larg njerëzve, nga motivi se ekzistenca e tij ka kuptim dhe është e plotë vetëm me anëtarët e llojit të vet, për shkak të paaftësisë, përkatësisht për shkak të pamundësisë për t'i rezistuar jetës i vetëm, pasi ai ka nevojë për ndihmën e faktorëve të tjerë.

### **Marrëdhëniet shoqërore mes myslimanëve në Kur'anin e Shenjtë**

Ekzistojnë shumë dëshmi që konfirmojnë shenjtërinë e sistemit shoqëror, tekste hyjnore që kërkojnë nga shoqëria myslimane të zbatojë plotësisht legjislacionin e dy shpalljeve: **“O ju që kini besuar, bëni në paqe të gjithë ju.”**<sup>2</sup>

Sipas këtij teksti, besimtarët janë të urdhëruar t'i besojnë të Dërguarit të Allahut xh.sh. dhe t'i marrin veçoritë e Islamit e ligjet e tij, t'iu përmbahen dhe të zbatohet

1. Kur'an, 49 : 13.

2. Kur'an, 2 : 208.

plotësisht si sistem në të gjitha porët e jetës në shoqëri, në mënyrë që shoqëria islame të jetë plotësisht e shenjtë dhe paqësore.

Islami i ka ndërtuar marrëdhëniet mes besimtarëve mbi bazën e një themeli të fortë të vëllazërisë: “**Vërtet, besimtarët janë vëllezër.**”<sup>3</sup>

Sipas Raziut, njerëzit mund të bashkohen si vëllezër nga aspekti i prejardhjes dhe nga aspekti i miqësisë.

### **Marrëdhëniet shoqërore mes myslimanëve në Sunet**

Sipas sunetit, zbatimi praktik i asaj që kishte praktikuar i Dërguari i Allahut (a.s.) nga ana e shoqërisë myslimane, paraqet një garanci dhe mbrojtje nga devijimi, regresi dhe shpërbërja. “*Në mesin tuaj kam lënë dy çështje që nuk do të humbni përderisa mbaheni fort pas tyre: Libri i Allahut (Kur’anin) dhe Sunetin e Profetit të Tij.*”<sup>4</sup>

Ndoshta arsyeja e mirësisë për të cilën ka folur i Dërguari i Zotit për gjeneratat e para të shoqërisë myslimane: “*Njerëzit më të mirë janë brezi që më ka pasuar mua, pastaj ata që i pasuan ata, pastaj ata që i kanë pasuar ata.*”<sup>5</sup>, me çka Zoti i Madhëruar

3. Kur’an, 49 : 10.

4. Muslim, *el-Musnedu-s-abibu-l-mubtesar bi naksi-l-adli ani-l-adli ila resulilabi [sal-lallabu alejbi uese-l-em]*, Daru ihjai-t-urathi-l-arabi, Bejrut, 2, 886.

5. Buhari, *Sabihu-l-Buhari*, Daru tauku-n-exhat, botimi i parë, 1422,171 ,3 .

i dalloi të mëparshmit: “**Allahu është i kënaqur me muslimanët e parë...**”<sup>6</sup>, shpërblimi për atë që kanë vepruar janë “**në Xhenetit e kënaqësisë...**”<sup>7</sup>, “**Shumë nga të hershmit e më pak nga të mëvonshmit...**”<sup>8</sup>, “**... janë në shtretër të qëndisur...**”<sup>9</sup>, “**si shpërblim për atë çka kanë punuar.**”<sup>10</sup>

Ka shumë udhëzime dhe hadithe të Profetit (a.s.) që e nxisin myslimanin të ndërtojë marrëdhënie pozitive, t’i forcojë radhët e veta, të jetë aktiv, larg individualizmit dhe larg mos shoqërimit me të tjerët.

I Dërguari i Allahut (a.s.) është shprehur: “*Shembulli i besimtarëve në dashurinë e tyre, në mëshirë dhe dhembshuri është si një trup.*”<sup>11</sup>, “*Besimtari miqësohet dhe nuk ka dobi nga ai që nuk miqëson dhe që nuk miqësohet.*”<sup>12</sup>

### **Shumëllojshmëria e marrëdhënieve shoqërore në Islam**

Kur’ani dhe Suneti për

6. Kur’an, 9 : 100.

7. Kur’an, 10 : 9.

8. Kur’an, 56 : 13-14.

9. Kur’an, 56 : 15.

10. Kur’an, 56 : 24.

11. Muslim, *el-Musnedu-s-abibu-l-mubtesar bi naksi-l-adli ani-l-adli ila resulilabi [sal-lallabu alejbi uese-l-em]*, Daru ihjai-t-urathi-l-arabi, Bejrut, 4, 1999.

12. Ahmed, *Musnedu imam Ahmed*, Muesesetu-r-isale, botimi i parë, 1421 / 2001, Bejrut, 37, 492.

muslimanin janë dy burime të shenjta, në bazë të të cilëve realizohet ekzaminimi i vlerave arsimore dhe shoqërore. Udhëzimet e Profetit (a.s.) në mënyrë të vazhdueshme rekomandojnë ndërveprim të ndryshme, në kontekst të forcimit të lidhjeve mes shtresave shoqërore, të bazuara në baza doktrinare, legjislativë dhe etike, në përputhje me kërkesat e instinktit njerëzor.

### Marrëdhëniet me prindërit

Sistemit të familjes Islami i ka kushtuar rëndësi të madhe. Në kuadër të këtij segmenti studiuesi i famshëm i hadithit, imam Buhari në veprën e tij “Kitabu-l-edeb”, transmeton një mori hadithesh të cilët trajtojnë këtë marrëdhënie, të cilët përfaqësojnë një njësi objektive të integruar, që arrin në njëmbëdhjetë hadithe, të ndarë në tetë kapituj. Abdullah b. Mesudi (r.a.) i kishte parashtruar disa pyetje të Dërguarit të Allahut (a.s.): “Cila është vepra më e dashur tek Allahu? *“Namasxi në kohë të vet”*, - ishte përgjigjur ai. Pastaj cila është, kishte pyetur: *“Nderimi i prindërve”*. Po pastaj: *“Xhibadi për në rrugë të Allahut.”*, - ishte përgjigjur ai.<sup>13</sup>

Në raport me ndërtimin e marrëdhënieve ky hadith konsiderohet si bazë. Falja e namazit paraqet një lidhje të ngushtë me Zotin e Madhëruar, nderimi i

13. Buhari, *Sabihu-l-Buhari*, Daru tauku-n-exhat, botimi i parë, 1422,292, 1 .

prindërve paraqet marrëdhënie me muslimanët, sepse ai që i nderon prindërit, i nderon edhe të tjerët. Ai që nuk i nderon prindërit e tij, të tjerët nuk i nderon aspak. Kushdo që e braktis xhihadin ndaj jobesimtarëve me potencial armiqësor të theksuar, ndaj atyre që i shkelin normat fetare, morale e kombëtare, do të ishte edhe më mospërfillës. Në hadithin e radhës, respekti ndaj nënës është theksuar në mënyrë të veçantë. Ebu Hurejre ka treguar se një njeri kishte ardhur tek i Dërguari i Zotit dhe e kishte pyetur se cili nga prindërit duhej respektuar më tepër? *“Nëna jote.”*, - i ishte përgjigjur, pastaj kush e kishte pyetur, *“Sërisht nëna jote”*, pastaj kush, pyeti njeriu? *“Nëna jote.”*, e pastaj kush, tha ai? *“Babai yt.”*, - ia ktheu i Dërguari i Allahut (a.s.).<sup>14</sup>

Ky hadith rekomandon mirësinë dhe respektin ndaj prindërve, prek edhe mekanizmat e asaj mirësie e atij respekti. Njeriu nuk duhet t'i ofendojë prindërit, pra do të thotë se ai nuk duhet të bëhet shkak që ata të fyejnë ose shajnë prindërit e tij. Sipas asaj që Mugire b. Shu'be ka transmetuar i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë: *“Allahu jua ka ndaluar që të jeni mos bindës ndaj nënave, duke mos i përmbushur obligimet, duke i tejkaluar kompetencat. Ju ka ndaluar fëmijëvrastjen*

14. Muslim, *el-Musnedu-s-abibu-l-mubtesar bi naksi-l-adli ani-l-adli ila resulilabi [sal-lallahu alejhi nese-l-em]*, Daru ihjai-t-urathi-l-arabi, Bejrut, 4, 1974.

*e bijave femra, i urren thasbethemet duke parashtruar shumë pyetje dhe duke e shpenzuar (pa vend) pasurinë.”<sup>15</sup>*

### Marrëdhëniet me të afërmit

Hadithet e Profetit që konfirmojnë domosdoshmërinë e lidhjeve farefisnore, rrjedhimisht të mirën në këtë botë dhe për shpërblimin në botën e përtejme, Buhariu i ka përmendur në kapitullin në të cilin trajtohen virtytet e lidhjeve farefisnore.

Nga Ebu Ejub el-Ensariu është transmetuar se një njeri e kishte pyetur të Dërguarin e Allahut (a.s.): “O i Dërguar i Allahut më trego një vepër e cila do të më fuste në Xhenet: “*Të adhurosh Allahun pa i përshkruar rival Atij, të falësh namazin, të japësh zekatin dhe të mos i ndërpresësh marrëdhëniet me të afërmit.*” - ia ktheu Profeti (a.s.).<sup>16</sup>

### Marrëdhëniet me shoqërinë

Islami ka caktuar se besimtarët janë vëllezër. Në kontekst të kësaj në Kur'an është theksuar: “**Besimtarët pa dyshim janë vëllezër.**”<sup>17</sup>

Një marrëdhënie e këtillë te myslimanët u realizua pas

shpërnguljes së Muhamedit (a.s.) në Medinë. Bazuar në këtë vëllazëri, sahabiu me përkatësi medinase (ensari) i ndante pasurinë vëllait të tij emigrant. Kishte raste kur ndonjëri kishte ofruar divorcin e njëres nga bashkëshortet e tij me qëllim, që vëllai i tij emigrant të martohej me të. E gjithë kjo vërteton lidhjet e marrëdhënieve shoqërore dhe nevojën që një mysliman të jetojë si pjesë e një kombi.

Myslimani duhet të jetë i vetëdijshëm për dispozitat e fesë së tij. Për nga natyra myslimani është shoqëror, sepse është bartës i mesazhit hyjnor në jetë, nga motivi se të dërguarit duhet të kishin kontakt me njerëzit, të përziheshin me ta, t'i udhëzonin, të jepnin e të merrnin, me qëllim të përvetësimit të mesazhit në fushën e ndërveprimit social.

Islami e ka ndaluar mendjemadhësinë, talljen, akuzimin dhe fajësimin e të tjerëve. Ai rekomandon modestinë, dhembshurinë, butësinë dhe nxit bashkëpunimin në dhembshuri, në bujari dhe në bamirësi ndaj fqinjit, të varfrit, nda gruas së ve dhe ndaj nevojtarit. Urdhëron mirësjellje ndaj jetimit njëkohësisht urdhëron mirësi ndaj çdokujt që është i vobektë.

### Realizimi i të drejtave shoqërore

Sipas një hadithit, të cilin e ka transmetuar Ebu Hurejre, i Dërguari

15. Buhari, *Sahibu-l-Buhari*, Daru tauku-n-exhat, botimi i parë, 1422,4 ,8 .

16. Ahmed, *Musnedu imam Ahmed*, Muesesetu-r-isale, botimi i parë, 1421 / 2001, Bejrut, 38, 571.

17. Kur'an, 49 : 10.

i Allahut (a.s.) është shprehur: “*Shtatë* (kategoria njerëzish) *do të jenë të hijesuar nga Zoti në hijen e Tij ditën kur nuk do të ketë hije pos hijes së Tij: imami (prijësi) i drejtë, një i ri që është rritur në adhurimin e Zotit të tij, një njeri zemra e të cilit është e lidhur ngushtë me xhamitë dhe dy burra që e duan njëri-tjetrin për hir të Zotit, mblidhen për Të dhe ndahen për Atë. Dhe, një burrë që e kërkon një grua që ka pozitë dhe që është e bukur por ai shprehet: Unë i frikësohem Zotit, dhe njeriu që dhuron sadaka në mënyrë të fshehur, saqë dora e tij e majtë nuk e di se çfarë ka dhuruar dora e tij e djathtë, dhe një burrë që e kujton Zotin veçmas dhe i vërshejnë sytë lot.”<sup>18</sup>*

Siç vërehet nga hadithit veprimet e këtyre shtatë lloj grupeve ndryshojnë në formë dhe grupimin e tyre. Një kuptim është lufta kundër vetvetes dhe kundërshtimi i tekave. Një gjë e tillë kërkon stërvitje dhe

18. Buhari, *Sahibu-l-Buhari*, Daru tauku-n-exhat, botimi i parë, 1422,133,1 .

përkushtim intensiv, kërkon durim të vazhdueshëm për t’u përmbajtur nga ajo që kërkon epshi i individit. Zemra është gati të digjet nga nxehtësia e zjarrit të epshit kur trazohet nëse kjo nuk shuhet me arritjen e qëllimit, prandaj shpërblimi për durimin është i madh.

Shumica e këtyre veprave që e meritojnë atë pozitë të lartë, janë veprime që lidhen me shoqërinë dhe me rregullimin e marrëdhënieve me të tjerët.

Në përmbyllje të këtij artikulli mund të thuhet fakti se Feja Islame i ka organizuar mirë të gjitha marrëdhëniet mes njerëzve, të aktiviteteve dhe të akteve të adhurimit.

Natyra hyjnore e sistemit shoqëror në Islam, bazohet në besimin se marrëdhëniet shoqërore i lidh me shpërblimin dhe ndëshkimin e Krijuesit të gjithësisë.

## XHAMIA

### Vendi më meritë për adhurimin e Allahut të Lartësuar

Resul Rexhepi  
Prishtinë

فِي بُيُوتٍ أُذِنَ لِلَّهِ أَنْ تُرْفَعَ وَيُذْكَرَ فِيهَا اسْمُهُ يُسَبِّحُ لَهُ فِيهَا بِالْغُدُوِّ وَالْآصَالِ

“Ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet Emri i Tij, Atë e madhërojnë në to (në xhami) mëngjes e mbrëmje.”

Kur'an: En-Nur, 36

#### Hyrje

**N**ë Islam, xhamitë kanë një vend veçanërisht të spikatur. Vetë emri, i cili në burimet dhe traditën islame, përdoret si sinonim i një xhamie, “*Bejtullah*”, që do të thotë “*Shtëpi e Allahut*”, flet shumë për rolin dhe rëndësinë e xhamisë në jetën e besimtarëve myslimanë. Myslimani është i lidhur ngushtë me xhaminë

që nga fëmijëria e tij e hershme, kur shkon në xhami, në mejtep, për mësimë e udhëzime fetare dhe për të marrë njohuritë e para të fesë, moralit dhe mirësjelljes. Kjo lidhje do të duhej të ngelte e përhershme, edhe kur ai të rritet si personalitet, sepse Islami i rekomandon pasuesve të tij që të shkojnë në xhami vazhdimisht çdo ditë gjatë gjithë jetës së tyre për të kryer ibadete (adhurime) në xhemat, pasi namazet e falura në

xhemat janë shumë më të vlefshme nga ato të kryera individualisht.

Gjithashtu, tubimet më të mëdha myslimane, siç është falja e namazeve të Xhumasë dhe Bajrameve, kryhen në xhami, madje, edhe disa ngjarje shumë të rëndësishme në jetën e myslimanëve, janë të lidhura ngushtë me xhaminë; aty lexohet Kur'an, bëhet mevlud, tregohet vazi-nasihah (ligjëratë, këshillë), shënohen netët e mira dhe festat tjera islame, etj. Dhe kur një mysliman vdes, ai përsëri është i lidhur me xhaminë, sepse, kryesisht, në haremin e xhamisë ose para xhamisë, bëhet falja e namazit të xhenazes, e cila është kalimi me dinjitet i njeriut nga kjo botë. Me një fjalë, myslimani e organizon jetën e tij në mënyrë të tillë që të jetë në kontakt të ngushtë me xhaminë.

Prandaj, me të drejtë është vlerësuar se xhamitë janë faltoret më të mëdha myslimane po njëkohësisht edhe mësonjëtoret e para dhe më të vjetra islame dhe qendrat më të rëndësishme kulturo-arsimore.<sup>1</sup>

Ky punim synon të kujtojë lexuesit e nderuar për rëndësinë dhe rolin e xhamive dhe xhematëve në jetën e myslimanëve, elementeve që përbëjnë xhaminë, qëndrimin tonë ndaj tyre, etj.

1. Akad. Jashar Rexhepagiqi, Faltore, institucione dhe qendra islame në Kosovë (xhami, teqe, kutubhane, vakëfe), tek "Edukata Islame" nr. 65, viti 2001, f. 77 e tutje.

## Prejardhja e emrit "xhami"

Fjala "xhami" e ka prejardhjen nga gjuha arabe "جَمْعَ *xheme'a*", që do të thotë: "të mbledhësh, tubosh, afrosh, lidhësh, vendosësh së bashku", etj. Nga këtu, për më shumë se 600 vjet edhe shqiptarët e kanë përvetësuar kështu, pra që vendin ku i bëhet ibadet Allahut, e quajnë *xhami*.<sup>2</sup>

Nga e njëjta rrënjë buron edhe termi *xhema'at* (ar. *جماعة Xhema'atun*), që do të thotë: "bashkësi, grup, tubim, grumbullim", etj. Xhamitë pra, janë vendet ku tubohen myslimanët për të kryer lutje të përbashkëta - namaz, mësim, edukim dhe manifestime të tjera fetare.<sup>3</sup>

2. Nerkez Smailagić, *Leksikon Islama*, "Svetlost", Sarajevo, 1990, f. 137. John L. Esposito, *Fjalor i Oksfordit për Islam*, "Logos-A", Shkup, 2017.

3. Është interesant fakti se myslimanët i quajtën universitetet e tyre me të njëjtin emër "el-xhami'atu", emër ky që përdoret edhe sot. Në arabishten e sotme moderne thuhet: "جامعة الأزهر - Xhami'atu-l-Ez'her - Universiteti El-Ez'her" (në Kajro), etj. Kjo, në fakt, tregon se universitetet e para, si vende të arsimit universal, kulturës dhe edukimit, u krijuan në xhami ose në kuadër të tyre. Është fakt historik i padiskutueshëm, sa që mjafton të kujtohet Universiteti i famshëm "El-Ez'her", i cili u ndërtua në mijëvjeçarin e parë (që nga viti 972), dhe u ndërtua në xhaminë me të njëjtin emër në Kajro. Para tij, Universiteti i "Ez-Zejtun" u themelua në Tunizi dhe, gjithashtu, u themelua në xhami. Kjo, në fakt, flet për shkallën e lartë të kujdesit me të cilën brezat e parë të myslimanëve u përpoqën të mbanin edukimin dhe arsimimin në lidhje të ngushtë me xhaminë.



Sinonim i nocionit *xhami* është termi “مسجد - *mesxhid*”, që rrjedh nga folja “*se xbe de*” e që do të thotë “*përkulje me modesti*” dhe shpreh “*vendin ku bëhet sexhde*”.

Është interesante se termi *mesxhid* në tekstin kur'anor dhe në hadithet e Profetit (a.s.) përdoret si emër për xhami: *Mesxhidi-haram*, ose *Mesxhidi-Aksa* ose *Mesxhidun'Nebeuj*, etj., kështu që xhamia, në thelb, është *vendi ku bëhet sexhdeja*. Sexhdeja, prandaj, është shprehje e bindjes më të lartë dhe përlësisë më të madhe ndaj Allahut të Madhërishëm dhe është pjesë përbërëse e namazit, e dispozitës themelore dhe më të rëndësishme islame. Institucioni që ndërtohet për të kryer namazin me xhemat në të, e i cili është i paimagjinueshëm pa sexhde, u emërua *mesxhid*, domethënë vendi i sexhdes. Prandaj, sexhdeja nuk është vetëm një akt i thjeshtë fizik në kuptimin e përkuljes dhe vënies së fytyrës në tokë, por është një reflektim i bindjes më sublime ndaj Zotit. Në mesxhide/xhami, që nga fillimi i Islamit, kryhet edhe edukimi fetar, veçanërisht i fëmijëve dhe brezave të rinj, dhe në këtë aspekt ato mbesin të pazëvendësueshme. Myslimanët e përdorin dhe kanë edhe një emër tjetër për xhaminë - “*musal-la*”, e fjala është për vendet informale dhe hapësirat e hapura që përdoren rëndom për faljen e namazeve të bajrameve.<sup>4</sup>

4. John L. Esposito, *Fjalor i Oksfordit për*

Në viset tona ballkanike e më gjerë në vendet ku jetojnë myslimanë me origjinë turke, ekziston një ndryshim midis termave *xhami* dhe *mesxhid*. Kështu, “*xhamia*” është një ndërtesë që ka karakter fetar dhe që ka minare dhe ku kryhen ritet e zakonshme islame (namazet ditore në xhemat, namazet e xhumasë, namazet e Bajrameve, mësimi mbi fenë, vazi, ligjëratat...), që do të thotë se ka një imam të përherëshëm në xhami. “*Mesxhidi*”, ndërkaq, është një ndërtesë fetare që nuk ka minare, megjithëse roli i saj në thelb është i njëjtë si ai i xhamisë me ndryshimin që në (disa) mesxhide namazet e Xhumasë dhe ato të Bajrameve nuk kryhen, sepse mesxhidet kanë hapësira më të vogla dhe nxënë më pakë xhematë.

Pjesa tjetër e botës islame ka përvetësuar emrin “*mesxhid*”, ndërkaq, vendet që njihen si më të shenjta e myslimanëve, kanë vazhduar të përmenden me emrin e tyre të përveçëm, si: “*Mesxhid'ul-Haram*”, “*Mesxhid'ul-Aksa*” dhe “*Mesxhid'un-Nebeuj*”.

Siç bëhet e ditur në Kur'anin Famëlartë, faltarja e parë e ndërtuar për njerëzit në faqen e dheut është Qabeja, gjegjësisht pjesa e cila e rrethon Qabenë, e njohur si “*Mesxhid'ul-Haram*”, pra, “*Xhamia e shenjtë*”<sup>5</sup>. Profeti (a.s.) na ka treguar se pas kësaj në Mekë, është

*Islamin*, “Logos-A”, Shkup, 2017.

5. Kur'an, Al 'Imran: 96.

ndërtuar “Mesxhid’ul-Aksa” në Jeruzalem, e cila daton që nga koha e Sulejmanit (a.s.). Qëllimi kryesor i xhamisë është që të shërbejë si një vend formal për adhurimin ndaj Zotit (xh.sh.) në namazet ditore dhe atë të ditës së xhuma. Është konstatim i përgjithshëm se tri xhamitë e sipërpërmendura gëzojnë status të veçantë. Qabeja në Mekë u bë qendra e ibadeteve të Haxhit dhe drejtimi nga i cili duhet të kthehemi me fytyrë gjatë namazit. Në xhaminë e Medinës është i varrosur Profeti (a.s.). Ndërkaq, “El-Aksaja” e Jeruzalemit është identifikuar si vendi nga i cili Profeti u ngjiti për të bërë Mi’raxhin.

Profeti (a.s.) kishte shpallur se toka i qe bërë mesxhid dhe e pastër, kështu që për të dhe ithtarët e tij, kudo që t’i arrijë koha e namazit, mund të falen. Megjithatë, për sa kohë që ai qëndroi në Mekën e tij të dashur, falej në “*Daru’l Erkam - Shtëpinë e Erkamit*”, e cila gjendej në zonën e Haremit, pikërisht në kodrinën Safa. Pas emigrimit në Medine dhe deri sa u ndërtua xhamia e tij, ai dhe besimtarët faleshin ku mundeshin, mjaftonte të ishte vend i gjerë dhe i pastër. Megjithatë, nga të dhënat historike shihet qartë se myslimanët që nga periudha e parë kanë përcaktuar vende të veçanta si mesxhide. Vetë, i Dërguari i Allahut (a.s.) akoma pa e përfunduar udhëtimin e hixhretit-emigrimit, gjatë rrugës për në Medinë, kur

arriti në Kuba, vërejti se myslimanët që kishin emigruar para tij, kishin rregulluar një vend për të falur namaz, madje ata kishin edhe një imam, Salimin. Profeti (a.s.), i cili i fali edhe vetë namazet në këtë vend sa qëndroi në Kuba, duke e zgjeruar këtë vendfalje të namazit, ndërtoi mesxhidin e njohur si “*Mesxhid’ul-Kuba*”.<sup>6</sup> Më pas, Profeti (a.s.) vazhdoi rrugën për në Medine dhe sapo pushuan nga udhëtimi, filluan ndërtimin e mesxhidit në Medinë, i cili edhe sot njihet si “*Mesxhid’un-Nebeuij*”.<sup>7</sup>

### Kur’ani për xhamitë

Xhamia përmendet në shumë ajete kur’anore. Më lartë e përmendëm se emri kur’anor i një xhamie është *mesxhid*, që do të thotë: *vendi ku bëhet sexhde*. Ky emër kur’anor për xhaminë është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse i referohet rolit themelor të xhamisë, i cili është tubimi i myslimanëve për të falur namazin në xhami. Namazi

6. “Xhamisë së Kubasë”, vetë i Dashuri i Allahut i kishte dhënë trajtim të veçantë. Ai konstatonte se “*Një namaz në këtë xhami është i barasvlershëm me një Umrë*” që mund ta bënte besimtari. Profeti (a.s.) shpeshherë nga Medina e vizitonte “Xhaminë e Kubasë”, herë hipur mbi deve e nga një herë edhe në këmbë. Abdullah bin Mes’udi thoshte se jo rrallëherë ai e shoqëronte Profetin.

7. Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, pjesa 2, “Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë”, Stamboll, 2017.

është dispozitë themelore islame, që kryhet çdo ditë gjatë gjithë jetës, kështu që ky shoqërim për sexhden, në të vërtetë është një kujtesë e asaj që është thelbësore për vetë Islamin. Sipas Kur'anit, gjithçka që është krijuar ekziston dhe u krijua për hir të njeriut, kurse ai (njeriu) u krijua për hir të Allahut, për të njohur Allahun dhe për ta madhëruar Atë, duke u përpjekur të arrijë kënaqësinë e Tij në të gjitha segmentet e ekzistencës njerëzore në këtë botë.

Për ta bërë më të lehtë gjetjen e ajeteve kur'anore që flasin për *mesxhidin*, përkatësisht xhaminë, përdorëm “*El-Mu'xhem el-mufehres li elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerim*”, të përgatitur nga Muhamed Fuad 'Abdulgabi. Sipas tij, termi “*mesxhid*”, në njëjës, në Kur'anin Famëlartë përmendet 22 herë. Në shumës, termi “*mesxhid*” (pra, *mesaxhid*) përmendet 6 herë.<sup>8</sup>

Por, në këtë kontekst, duhet theksuar se Kur'ani e përmend me theks të veçantë *sexhden*, sepse xhamitë, siç u tha, ndërtohen për t'i bërë sexhde Allahut (xh.sh.), gjë të cilën Allahu e do aq shumë, në të kundërtën, nuk do të kishte fare nevojë për xhamitë. Muhamedi (a.s.) ka thënë:

عن أبي هريرة أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: “أقرب ما يكون العبد من ربه وهو ساجد” أخرجه مسلم

Transmetohet nga Ebu Hurejreja

8. Shih: Muhammed Fuad 'Abdulgabi, *El-Mu'xhem el-mufehres li elfadhi 'l-Kur'ani 'l-kerim*, “Daru-l-hadith”, Kajro, 1994, f. 438.

se Profeti me një rast ka thënë: “... Njeriu është më i afërt me Allahun kur është në sexhde...”<sup>9</sup> Në lidhje me këtë, kemi një detaj shumë interesant në ajetin e fundit të sures “El-Alek”, në të cilin Allahu (xh.sh.) ka thënë:

...**Bjer në sexhde dhe afroju Allahut!**” Kjo tregon qartë se kur njeriu është në sexhde, atëherë ai është në praninë dhe mbrojtjen e Allahut. Pra, njeriu kurrë nuk është më afër Allahut sesa kur bën sexhde, sepse mes tij dhe Krijuesit nuk ka asnjë pengesë dhe sepse ai, kur është në sexhde, është në komunikim të drejtpërdrejtë me Allahun (xh.sh.). Prandaj, në Kur'anin Famëlartë lavdërohen ata të cilët bien në sexhde. Në Suren “Et-Teube”, në një kontekst që përmend besimtarët për të cilët Allahu i Madhërishëm ka përgatitur Xhenetin, thuhet:

النَّابِئُونَ الْعَابِدُونَ الْحَامِدُونَ السَّائِحُونَ  
الرَّاكِعُونَ السَّاجِدُونَ الْأَمْرُونَ بِالْمَعْرُوفِ  
وَالنَّاهُونَ عَنِ الْمُنْكَرِ وَالْحَافِظُونَ لِحُدُودِ اللَّهِ  
وَبَشِّرِ الْمُؤْمِنِينَ

“(Besimtarët të cilëve Allahu u ka blerë jetën janë) **ata të cilët pendohen, ata që e lusin Atë** (i bëjnë ibadet), **ata që e lavdërojnë Atë, ata të cilët agjërojnë** (ose që luftojnë për Çështjen e Tij), **ata që përkulën** (ruku në namaz), **ata që bien në sexhde, ata që i urdhërojnë të tjerët për mirësi dhe ndalojnë nga e keqja dhe ata të cilët kanë kujdes meritore**

9. Transmeton Muslimi.

ndaj dispozitave të Allahut. Pra, përgëzoji besimtarët.”<sup>10</sup>

Kur’ani Famëlartë, gjithashtu, i kërcënon ata që nuk bëjnë sexhde ndaj Allahut, kështu që theksohet se njerëz të tillë do të thirren për të bërë sexhde në Ditën e Gjykimit, por ata nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë atë, sepse tashmë është shumë vonë për ta!

حَاشِعَةً أَبْصَارُهُمْ تَرْهُفُهُمْ ذِلَّةً وَقَدْ كَانُوا يُدْعَوْنَ إِلَى السُّجُودِ وَهُمْ سَالِمُونَ

“Sytë e tyre (atyre që nuk bëjnë sexhde) do të tmerrohen, turpi do t’i mbulojë; ata gjithnjë u ftuan që të bien në sexhde (të falin namazin) kur qenë shëndosh e mirë (në këtë dynja por ata nuk e bënë këtë)!”<sup>11</sup>

Në tri ajete të Kur’anit, të cilët do t’i përmendim në vijim, nocioni XHAMITË (ar. *el-mesaxhid*) përmendet krahas emrit të Zotit - Allah:

وَأَنَّ الْمَسَاجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا مَعَ اللَّهِ أَحَدًا

“Dhe vërtet që xhamitë janë për Allahun, kështu që mos lutni askënd tjetër me Allahun.”<sup>12</sup>

إِنَّمَا يَعْمُرُ مَسَاجِدَ اللَّهِ مَنْ آمَنَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَأَقَامَ الصَّلَاةَ وَآتَى الزَّكَاةَ وَلَمْ يَحْشَ إِلَّا لِلَّهِ فَعَسَىٰ أُولَٰئِكَ أَنْ يَكُونُوا مِنَ الْمُهْتَدِينَ

“Xhamitë e Allahut i mirëmbajnë vetëm ata që

besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që kryejnë namazin, japin zekatin dhe që nuk i frikësohen përveç se Allahut. Të tillët, është për të shpresuar, se janë të drejtëudhëzuar.”<sup>13</sup>

وَمَنْ أَظْلَمُ مِمَّن مَنَّ اللَّهُ فِي خَرَابِهَا يُذَكَّرَ فِيهَا اسْمُهُ وَسَعَىٰ فِي خَرَابِهَا

“A ka më dëmtues (tiran) se sa ai që ndalon të përmendet emri i Tij në xhamitë e Allahut, madje dhe që angazhohen në shkatërrimin e tyre...”<sup>14</sup>

Nga këto ajete mund të nxirren disa mesazhe të rëndësishme:

1. Xhamive u atribuohen nderime të veçanta, sepse Allahu i Madhërishëm i lidh ato me Emrin e Tij të Lartësuar dhe thotë: “*mesaxhidullah*” – “*xhamitë e Allahut*”;

2. Xhamitë ndërtohen dhe mirëmbahen nga ata që besojnë në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, që do të thotë se atje ku ka xhami, ka edhe myslimanë;

3. Kur’ani, jo vetëm që dënon prishjen e xhamive dhe kërcënon ata që e bëjnë këtë me një ndëshkim të tmerrshëm, por paralajmëron se edhe ndalimi i përmendjes së Emrit të Allahut në xhami, është një veprim i dhunshëm, një krim dhe një mëkat i rëndë.<sup>15</sup>

13. Kur’an, Et-Teube: 18.

14. Kur’an, El- Bekare: 114.

15. Safvet Halilovic, *Sira - životopis posljednjeg Allahovog Poslanika*, El-Kalem,

## Profeti (a.s.) për xhamitë dhe për rëndësinë e faljes së namazit me xhemat

Profeti ynë (a.s.) xhamisë i ka kushtuar rëndësi të veçantë, saqë ai, - siç figuron në “Siren” (Jetëshkrimin) e tij, - në një rast kishte thënë se xhamitë/mesxhidet “janë vendet më të pëlqyera të Allahut (xh.sh.)”, gjë që ndikoi tek ai edhe më shumë për të ndërtuar të tilla mesxhide, siç është ajo e Medinës, e cila edhe sot krenare qëndron edhe për të konfirmuar vullnetin e pashoq të Resulullahut për ndërtimin e *Shtëpive të Zotit*.

Veçanërisht mbresëlënëse janë hadithet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), në të cilët ai flet për xhamitë dhe rolin e tyre në jetën e besimtarit. Këto hadithe shprehin rëndësinë e ndërtimit të xhamive, mirëmbajtjen e tyre dhe faljen e namazeve të përbashkëta në to. Ne do t'i përmendim disa prej tyre:

مَنْ بَنَى لِلَّهِ مَسْجِدًا بَنَى اللَّهُ لَهُ بَيْتًا فِي الْجَنَّةِ.

“Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, Allahu do t'i ndërtojë atij një shtëpi në Xhenet.”<sup>16</sup>

Në një version tjetër të këtij hadithi, i Dërguari i Allahut (a.s.) ka thënë:

مَنْ بَنَى لِلَّهِ مَسْجِدًا يَبْتَغِي بِهِ وَجْهَ اللَّهِ بَنَى اللَّهُ لَهُ مِثْلَهُ فِي الْجَنَّةِ.

“Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, duke synuar arritjen e kënaqësisë

Sarajevo, 2010.

16. Transmetoi: Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibni Maxhe dhe Ahmed.

së Tij, Allahu do t'ia ndërtojë një të ngjashme në Xhenet.”<sup>17</sup>

Këto hadithe, sipas ekspertëve të fushës, janë autentike (sahih), ndonëse nuk duhet të merren dhe të kuptohen fjalë për fjalë, sepse i Dërguari i Allahut (a.s.), në këtë mënyrë ka inkurajuar besimtarët për të ndërtuar dhe mirëmbajtur xhamitë, të cilat janë kandil ndriçues të Islamit dhe treguesit që në vendet ku janë ndërtuar, aty ka myslimanë. Madhësia e xhamisë nuk është aq e rëndësishme sa qëllimi (nijeti). Të gjitha hadithet që flasin për vlerën e (ndërtimit) të xhamive shprehen: “Kush ndërton një xhami në emër të Allahut”, ose: “për hir të kënaqësisë së Allahut”, theksojnë rëndësinë e qëllimit dhe sinqeritetit në ndërtimin e xhamive. Xhamitë, pra, historikisht gjithnjë janë ndërtuar dhe mirëmbajtur ekskluzivisht për hir të Allahut dhe afirmimit të fesë së Tij të ndritshme, lartësimit të Fjalës së Allahut (xh.sh.) - përkushtimit të sinqertë ndaj dinit-Islam.

Në disa hadithe, i Dërguari i Allahut (a.s.), flet për rëndësinë e kryerjes së namazit në xhemat, në xhami, sepse xhamitë janë, mbi të gjitha, vendet ku bëhet sexhde, d.m.th. me përlësi ul ballin në tokë, në namaze të përbashkëta, me qëllim për të madhëruar Allahun e Lartësuar dhe për të arritur kënaqësinë e Tij. Në këtë drejtim, përmenden disa hadithe:

17. Transmetoi: Nesaiu, Ibni Maxhe dhe Ahmed.

عن أبي هريرة رضي الله عنه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: ((مَنْ تَطَهَّرَ فِي بَيْتِهِ، ثُمَّ مَشَى إِلَى بَيْتٍ مِنْ بُيُوتِ اللَّهِ، لِيَقْضِيَ فَرِيضَةً مِنْ فَرَائِضِ اللَّهِ، كَانَتْ خُطْوَاتُهُ: إِحْدَاهُمَا تُحِطُّ خَطِيئَةً، وَالْأُخْرَى تَرْفَعُ دَرَجَةً))

“Kush pastrohet në shtëpinë e tij dhe pastaj shkon në një nga xhamitë për të kryer një farz prej farzeve të Allahut, me një hap që bën in falet mëkati e me tjetrin hap ngrihet më lart në Xhenet.”<sup>18</sup>

Për më tepër, “Kur ai kryen faljen e namazit, engjëjt vazhdojnë të kërkojnë bekimet e Allahut dhe faljen për të, sa kohë që ai është në vendin e tij të faljes, dhe vazhdojnë duke u lutur: ‘O Allah, dburo bekimet e Tua mbi të, Ji i mëshirshëm dhe i dashur me të’ dhe njeriu qubet në falje, sa kohë që ai pret për namazin.”<sup>19</sup>

Me një rast tjetër, Resulullahu ka thënë:

عن أبي هريرة رضي الله عنه أن النبي قال: “مَنْ عَادَ إِلَى الْمَسْجِدِ أَوْ رَاحَ، أَعَدَّ اللَّهُ لَهُ فِي الْجَنَّةِ نُزُلًا كُلَّمَا غَدَا أَوْ رَاحَ” مُتَّفَقٌ عَلَيْهِ

“Sa herë që dikush shkon në xhami - në mëngjes ose në mbrëmje - Allahu i përgatit atij një vend në Xhenet, pa marrë parasysh sa herë shkon në mëngjes dhe sa në mbrëmje.”<sup>20</sup>

Se vlera e faljes së namazit me xhemat ka rëndësi të veçantë, më së miri e ilustron ky hadith i Profetit:

عن ابن عمر رضي الله عنهما أن الرسول صلى الله عليه وسلم قال: “صَلَاةُ الْجَمَاعَةِ أَفْضَلُ مِنْ صَلَاةِ الْفَدَى بِسَبْعٍ وَعِشْرِينَ دَرَجَةً”

“Namazi i kryer bashkërisht (me

xhemat) është njëzeteshtatë herë më i vlefshëm se ai i kryer individualisht.”<sup>21</sup>

رُوي عن أبي هريرة - رضي الله عنه - أن رسول الله - صلى الله عليه وسلم - قال: (سَبْعَةٌ يُظِلُّهُمُ اللَّهُ فِي ظِلِّهِ يَوْمَ لَا ظِلَّ إِلَّا ظِلُّهُ: إِمَامٌ عَادِلٌ وَشَابٌّ نَشَأَ فِي عِبَادَةِ اللَّهِ تَعَالَى وَرَجُلٌ ذَكَرَ اللَّهَ خَالِيًا فَفَاضَتْ عَيْنَاهُ وَرَجُلٌ كَانَ قَلْبُهُ مُعَلَّقًا فِي الْمَسْجِدِ، صحيح ابن حبان

Transmeton Ebu Hurejreja (r.a.) se Profeti (a.s.) ka thënë: “Shtatë lloje njerëzish do të jenë nën hijen e Allahut atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij: një udhëbeqës i drejtë, një i ri i cili që herët i përkeushtohet ibadetit ndaj Allahut, një njeri që e kujton Allahun në vetmi dhe nga dashuria për Të sytë i qajnë me lot, një person zemra e të cilit është e lidhur vazhdimisht me xhami...”<sup>22</sup>

Mesazhi i këtyre haditheve është mjaft i qartë: IDërguari i Allahut (a.s.), u përpoq të zhvillonte te pasuesit e tij dashurinë për xhaminë, që është një vend ku myslimanët tubohen pesë herë në ditë, e në veçanti ditën e xhuma, e akoma më shumë gjatë ditëve të Bajrameve. Qëllimi i të gjitha porosive islame është që njeriu të jetë aty për të bërë ibadet, ta madhërojë Allahun (xh.sh.), aty të mësojë për fenë dhe edukatën islame. Të gjitha shqetësimet që has njeriu në jetë janë rezultat i veprimtarisë njerëzore që nuk është në përputhje me urdhrin e Zotit dhe ligjet që Ai ka caktuar. Rregullat dhe dispozitat islame janë renditur në mënyrë që një person, nëse i kryen ato

18. Transmetoi Muslimi.

19. Transmeton Buhariu.

20. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

21. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

22. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

rregullisht dhe në mënyrë korrekte, të sigurojë paqe shpirtërore, stabilitet dhe kënaqësi të brendshme. Islami ofron një koncept të tillë të jetës ku njeriu, duke jetuar në përputhje me parimet islame, konfirmon veten si një person i shëndetshëm, i edukuar dhe i ekuilibruar, i stolitur me virtyte të larta morale.

Sikur t'i referohemi Xhamisë së Profetit (*Mesxhid'un-Nebeu*), do të vërejmë se ajo, përtej kryerjes së misionit të saj për ibadet Allahut të Lartësuar, mbase edhe për shkak se ishte e ngjitur me shtëpinë e Profetit (a.s.) dhe gjendej në një pozitë ku myslimanët mund të tuboheshin lehtësisht, përveç se ishte qendra kryesore administrative e shtetit, kur e kërkonte nevoja luante rol edhe si qendër ku trajtoheshin çështje me karakter social, shoqëror, politik, juridik, ushtarak e financiar. Ajo ka luajtur edhe rolin e mexhlise-tubimeve, sepse aty debatoheshin çështje me rëndësi të veçantë, sikundër edhe të thesarit shtetëror (bejt'ul-mal), rezidencë e shtabit ushtarak, e nga një herë edhe të spitalit për të plagosurit në luftë. Në një pjesë anësore të saj, kanë gjetur strehim edhe nevojtarët dhe të pastrehët.<sup>23</sup> Aty Profeti (a.s.) tubonte zekatin dhe sadakatë për ta ndihmuar shtetin e sapothemeluar. Xhamia, gjithsesi, luante edhe rolin e shkollës

---

23. Grup autorësh, Islami nëpërmjet haditheve, pjesa 2, Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë, Stamboll, 2017.

për t'i arsimuar e edukuar besimtarët sipas mësimëve dhe udhëzimeve islame.

Sikurse kuptohet, i Dërguari i Allahut (a.s.) ka folur në mënyrë shumë afirmative për namazin në xhemat me qëllim që të inkurajojë myslimanët që të mblidhen pesë herë në ditë, të shohin njëri-tjetrin, të kenë një efekt pozitiv të njëri-tjetri, të heqin atë që është negative në sjellje të kolektivit dhe për të inkurajuar atë që është e bukur dhe pozitive.

Duke falur namazin, posaçërisht në xhami me xhemat, njeriu vazhdimisht freskon dhe forcon marrëdhëniet me Krijuesin e tij. Dispozitat e tjera islame, të tilla si agjërimi, zekati, haxhi, institucioni i dhikrit (përkujtimi dhe lavdërimi i vazhdueshëm i Allahut), duatë-lutjet (adresimi i drejtpërdrejtë dhe i përlur ndaj Krijuesit) kanë një qëllim unik e ai është formimi i një personaliteti të shëndetshëm dhe të ekuilibruar, i cili do të jetë i vetëdijshëm për detyrën e tij në jetë dhe që nuk do ta lejojë atë të bëhet skllav (i varur) i pasioneve të shfrenuara ose i ndonjë vesi që shqetëson shëndetin dhe jetën e njeriut.

Të theksojmë edhe një fakt që haset në literaturën e hadithit, ku thuhet se sahabiu i famshëm Abdullah bin Mes'udi (r.a.), duke përshkruar qëndrimin e sahabëve ndaj namazit në xhami (xhemat), ka thënë:

وَمَا يَتَخَلَّفُ عَنِ الصَّلَاةِ إِلَّا مُنَافِقٌ قَدْ عَلِمَ  
نِفَاقَهُ، أَوْ مَرِيضٌ، إِنْ كَانَ الْمَرِيضُ لَيَمِشِي بَيْنَ  
رُجُلَيْنِ حَتَّى يَأْتِيَ الصَّلَاةَ

“Nga namazi (me xhemat) nga ne ka munguar vetëm hipokriti, hipokrizia e të cilit ka qenë e njohur, ose, i sëmuri, madje edhe i sëmuri do të vinte në namaz me ndihmën e dy personave që e mbanin për kerabësh!”<sup>24</sup>

Deklarata e këtij sahabiu, shumë i dashur për të Dërguarin e Allahut (xh. sh.), është shumë e rëndësishme, sepse pasqyron qëndrimin e gjeneratës më të mirë të myslimanëve - sahabëve ndaj faljes së namazit në xhami. Ky sahabi fisnik paralajmëron se mosfalja e namazeve dhe shmangia e xhematit është një formë hipokrizie (nifak praktik). Ky është një paralajmërim i qartë për myslimanët që të mos i lejojnë vetes një sjellje të tillë, sepse moskryerja e namazit me xhemat, në të vërtetë, do të shpjerë drejt një qëndrimi hipokrit dhe me pasoja negative, që rezultojnë prej tij: anomali të ndryshme dhe fenomene devijuese në shoqëri, e keqe kjo nga e cila askush nuk do të jetë i qetë. Kjo zaten edhe është arsyeja pse i Dërguari i Allahut (a.s.) foli me kaq zell për xhaminë dhe lutjet në xhemat, duke u përpjekur të ndërtojë vetëdijen te besimtarët për atë që posaçërisht e do Allahu i Madhërishëm, sepse përmes lutjeve dhe xhematit kursehen e ruhen individi dhe bashkësia.

24. Transmeton Muslimi në “Sahihun” e tij.

Nuk duhet harruar edhe një element tjetër shumë me rëndësi. As’habët e Profetit (a.s.) e mbase edhe shumë myslimanë ndër shekuj, siç u tha më sipër, namazit me xhemat në xhami i kanë kushtuar vëmendje të veçantë, madje aq sa gjurmët e pjesëve të trupit të cilat kanë prekur tokën në sexhde, Allahu i përmend në Kur’an:

سِيمَاهُمْ فِي وُجُوهِهِمْ مِنْ أَثَرِ السُّجُودِ

“...Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes...”<sup>25</sup>

Ndërkaq, nga hadithet e Resulullahut vërejmë se Allahu (xh. sh.) garanton se zjarri i Xhehenemit nuk i djeg ato pjesë të trupit që kanë rënë në sexhde për Allahun e Lartësuar.

## Elementet përbërëse të xhamisë

Në trojet shqiptare ekzistojnë kryesisht dy lloje xhamish:<sup>26</sup>

**a-** Xhamitë e mëdha, me kupolë të dukshme, ndryshe quhen edhe sulltanore dhe paraqesin vlera më të mëdha arkitekturore se sa lloji i dytë.

**b-** Xhamitë paksa më të vogla, pa kupolë, me tavan a çati druri dhe me kënde (rëndom katërqoshëse).

Nëse e vështrojmë xhaminë nga aspekti arkitektonik, do të vërejmë

25. Kur’an: El-Feth, 29.

26. Një shqyrtim analitik më të zgjeruar e gjeni te Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë, 1984. Shih, gjithashtu S. Kudra, *Dzamije Sarajeva*, bot. “El-Kalem”, Mexhlisi i Bashkësisë Islame të Sarajevës, Sarajevë, 1426/ 2006.



se ajo përbëhet nga *salla e madhe* për faljen e namazit, që është edhe pjesa qendrore e saj. Në murin ballor, i cili ndryshe quhet edhe muri i Kibles, është edhe *mibrabi*, i cili është një thellim gjysmëharkor, dhe ky është vendi ku imami i prin xhematit në namaz. Nga ana e djathtë e sallës (e xhamisë), është edhe *minberi*, prej nga hatibi-ligjëruesi mban predikimin javor ose edhe ndonjë tjetër. Në të shumtën e rasteve, minberi ka shtatë a më shumë shkallë, ku zakonisht ligjëruesi ligjëron nga shkalla e shtatë. Ndërkaq, nga ana e majtë e sallës qendrore, në të shumtën e rasteve, në këndin e murit ballor dhe atij në të majtë është edhe *qyrsia* (ar. *kursijj*), vend i veçantë prej nga imami mban vazi-nasihatin ose kurdo që e ndjenë të nevojshme t’iu drejtohet të pranishmëve me ndonjë këshillë, njoftim, informim e të ngjashme.

Shumë xhami sulltanore kanë edhe portikun që është pjesa e përparme para hyrjes në xhami, e cila në parim është në shërbim të xhematit para se të futen në sallën qendrore, sikundër “mafili i xhamisë” është pjesa e sipërme, që shërben për t’u falur.

Pjesë tjetër mjaft e rëndësishme është edhe *minarja* ose kulla e veçantë që shërben për thirrjen e ezanit. Ka minare prej guri ose druri. Minarja ka edhe *sherefë* (ballkone të vogla) një, dy ose edhe tri sosh, varësisht nga tipi i xhamisë. Disa xhami minaren e kanë të rrumbullakët, por ka edhe

nga ato që e kanë katërkëndëshe.

Sipas arkitekturës, xhamitë sulltanore të ndërtuara gjatë periudhës osmane, kanë një kupolë më të madhe (kupola qendrore) dhe disa kupola të tjera më të vogla, që ia shtojnë shumë bukurinë xhamisë dhe e bëjnë madhështore. Në të vërtetë, karakteristikat e xhamisë, krahas funksionalitetit të tyre dhe bukurisë-stilistikës, ato kanë qenë tepër të kujdesshme edhe se si do të jetë akustika e zërit, sepse ky ka qenë element me shumë rëndësi gjatë funksionimit të xhamisë.

Një çështje tjetër, me shumë rëndësi ka qenë ajo që xhamitë monumentale, mbi portën kryesore-hyrëse kanë pasur mbishkrimin, i cili ka përmbajtur: qëllimin e ndërtimit të xhamisë, personin (autoritetin) i cili e ka ndërtuar, kujt ia ka dedikuar dhe vitin e ndërtimit. Edhe sot, xhamitë e vjetra, në përgjithësi, e ruajnë atë mbishkrim, i cili është me rëndësi të jashtëzakonshme, dhe prej nga në mënyrë të saktë njihet historiku i xhamisë, ndonëse, për fat të keq, ka edhe të tilla xhami në të cilat nuk është ruajtur mbishkrimi i saj ose edhe është dëmtuar.

Xhamitë e mëdha, monumentale, në brendësinë e tyre kanë dekorime shumë të bukura ku dominojnë figurat e botës bimore, të bëra me shumë shije, cilësi dhe finesë. Në disa sosh ka edhe shkrime stilistike të emrit të Allahut, të Profetit, as’habëve të tij, e edhe ndonjë ajet kur’anor.

Nga xhamitë sulltanore të tipit me kupolë në Kosovë, të cilat kanë vlera të mëdha arkitektonike dhe artistike, duhet të përmendim: Xhaminë e Sinan Pashës në Prizren (1615), Xhaminë e Bajraklisë në Pejë, Xhaminë e Hadim Agës në Gjakovë (1595), etj.<sup>27</sup> Në Prishtinë është Xhamia e Madhe ndërtuar 8 vjet pas rënies së Stambollit (1461), ndërkaq xhamia e Çarshisë (ose e Gurit) në zemër të Prishtinës është xhami sulltanore unike për faktin se minaren e saj, madje edhe majën, e ka të ndërtuar tërësisht prej guri, e që është shumë e rrallë në këto anë.

Për nga përbërja dhe stili i ndërtimit, meriton të përmendet edhe xhamia Muradie në Vlorë (1542), xhamia e Iljaz bej Mirahorit në Korçë.<sup>28</sup> Tirana ka pasur disa xhami monumentale të këtij tipi (me kupolë) e ajo e Haxhi Et'hem beut e zbukuron aq shumë kryeqytetin, pasi është një ndërtim me vlera të veçanta arkitektonike dhe e zbukuruar me piktura dhe dekore. Ajo ka një hajat të gjerë me çati të mbajtur mbi shumë shtylla guri. Kjo xhami mund të radhitet fare lehtë në grupin e monumenteve më të bukura të besimit islam, jo vetëm të

Shqipërisë, por edhe të Ballkanit.<sup>29</sup> Edhe në Maqedoni ka disa xhami të tilla të cilat konsiderohen perla të vërteta të arkitekturës islame.

Xhamitë në të kaluarën kryesisht janë mirëmbajtur nga institucioni i vakëfit, ose nga donacionet e bamirësve, ose edhe nga donacionet fetare. Sot, në shumë shtete të botës mirëmbahen nga organet shtetërore, nga qeveritë e shteteve të cilat kujdesen për to. Në rastin tonë, për (ri)ndërtimin dhe mirëmbajtjen e xhamive kujdeset popullata-besimtarët.

### Si duhet të sillemi në një xhami

E përmendëm edhe më herët se kur ndodhemi në xhami, në të vërtetë ne jemi mysafirë të Allahut të Gjithëmëshirshëm, sepse xhamia është “*Bejtullah - shtëpia e Allahut*”, prandaj, besimtari duhet të sillet me kujdes maksimal, duke i kushtuar vëmendje hyrjes, sjelljes në të, veprimeve brenda saj, si dhe daljes nga ajo!

Myslimani kur do që të hyjë në xhami është e parapëlqyeshme të hyjë me këmbë të djathtë, e kur të dalë nga ajo të dalë me këmbë të majtë. Ndërkaq, qëndrimi në xhami

27. Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë, 1984. Duke i përshkruar këto objekte islame, konsulli i Austrisë në Shkodër, J. Muller, në vitin 1838 ndër të tjera shkruan: “*Xhamia në qendër të Gjakovës mund të konkurronte lirisht me xhamitë e Stambollit*.”

28. Po aty, f. 418.

29. Në Kosovë, për nga numri i xhamive në shek. XIX-të, vinin qyteti i Prizrenit me 30 xhami, Peja 16, Prishtina me 13 xhami dhe 5 mesxhide të vogla pa minare, Gjakova me 11, Mitrovica me 4, Vushtrria me 3, Gjlani me 2, etj. Po aty, f. 422.

duhet shfrytëzuar maksimalisht për ibadet, lexim të Kur'anit, istigfar, lutje, I'tikaf, dëgjim vazi-nasihate, ligjërime e të tjera veprime të kësaj natyre, ashtu siç na ka mësuar i Dashuri i Allahut. Ja se si e këshillonte të birin, Ebu Derda: "O biri im, xhamia duhet të jetë shtëpia jote, sepse unë kam dëgjuar Profetin (a.s.) duke thënë: "*Xhamitë janë shtëpitë e njerëzve të devotshëm* (mutteki), *kështu që ai i cili e ka xhaminë si shtëpinë e tij, Allahu i garanton atij mëshirë dhe kalim të sigurt mbi Urën e Siratit.*"<sup>30</sup>

Në xhami duhet të qëndrojmë me devotshmëri, me qetësi, me përulësi, jo me mendjemadhësi, jo me arrogancë, mundohemi sa më shumë të përmendim Allahun (xh. sh.) dhe të respektojmë besimtarët që janë aty. Natyrisht, aty mund edhe të flasim, sidomos për çështje me interes për fenë, ose edhe këshillime reciproke të dobishme, por jo fjalë të kota, ose Zot na ruaj, fyese, të padobishme, përgojime, ofendime, mashtrime...! Profeti (a.s.), kur kishte ndonjë çështje me rëndësi, e bisedonte me shokët e tij në xhami. Në Kur'an, Allahu (xh. sh.) ka thënë:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ الَّذِينَ هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَائِعُونَ وَالَّذِينَ هُمْ عَنِ اللَّغْوِ مُعْرِضُونَ.

**"Vërtet që besimtarët kanë shpëtuar. Ata të cilët në namazet e tyre janë të përulur. Dhe ata, të cilët i shmangen të kotës (qoftë fjalë a punë)."**<sup>31</sup>

30. Transmeton Taberani.

31. Kur'an: El-Mu'minun, 1-3.

Kurrsesi nuk lejohet të flitet ose të bisedohet në xhami ditën e xhuma gjatë kohës kur hatibi është duke mbajtur hytben, madje as t'i thuhet "mos fol" atij që pëshpërit ose bën shamatë. Prandaj, në të tilla raste duhet të kemi kujdes, në veçanti të mos e ngremë zërin gjatë kohës që dikush falet ose është duke lexuar Kur'an. Madje, as Kur'an nuk pëlqehet që të lexojnë njëkohësisht disa veta me zë të lartë, sepse e pengojnë njëri-tjetrin dhe i shqetësojnë të tjerët.

Sa kohë që jemi në xhami nuk lejohet të bëjmë ndonjë shitblerje, sado të vogël, sepse ai është vend adhurimi e jo tregtie. Nuk është aspak edukative që brenda xhamisë të mbështetesh me shpinë në mur, duke ia kthyer shpinën kibles, e duke i shtrirë këmbët. Aty dinjiteti dhe edukata njerëzore duhet të jenë në nivelin më të lartë të mundshëm.

Xhamitë, qofshin të mëhershme ose edhe bashkëkohore, duhet të ruhen të pastra dhe të mirëmbahen sa më mirë që të jetë e mundur.

Vlerë kulmore islame është pastërtia, prandaj, ajo duhet të ruhet si brenda ashtu edhe jashtë xhamisë. Fundja, për pastërtinë e xhamisë të gjithë besimtarët-xhemati i asaj xhamie janë përgjegjës. Nëse ne myslimanët jemi dukshëm të kujdesshëm për pastërtinë e shtëpive tona, atëherë xhamia ka akoma më shumë përparësi! Aishja (r.a.) tregon se: "*Profeti ka urdhëruar të ndërtohen*

*xhami ndër mjedise të tjera arabe, të mbahen pastër dhe të parfumohen me aromë të këndshme.*<sup>32</sup>

### Xhamitë-shkolla

Para se të themi dy fjalë për shkatërrimin e xhamive gjatë luftës së fundit në Kosovë, nuk mundemi të mos përmendim sado kalimthi edhe shndërrimin e xhamive në shkolla publike, si e vetmja zgjidhje për të vazhduar arsimimin e bijve dhe bijave të këtij populli. Gjatë periudhës 1989-99, për shkak se “soldateska”<sup>33</sup> serbe i kishte dëbuar nxënësit nga shkollat publike, të gjitha xhamitë e Kosovës dhe objektet e tjera ndihmëse të tyre, Bashkësia Islame i vuri në dispozicion të arsimit shqip, kështu që xhamitë qenë shndërruar në mësonjëtoje. Ani pse në kushte të vështira, megjithatë mësimi u zhvillua në xhami e nuk u ndërpre. Kështu që, gjatë kësaj periudhe (1989-99), pjesa dërmuese e xhamive të Kosovës, krahas ibadetit që aso kohe kryhej në to, ato njëkohësisht shërbenin edhe për të kryer misionin e arsimit dhe të edukimit të disa gjeneratave, të cilëve me të padrejtë iu mohua ndjekja e mësimin në shkollat publike. Mësimi nëpër xhami gjatë viteve 1992-1999 është mbajtur në: Dragash, Ferizaj, Istog, Gjakovë, Obiliq, Mitrovicë, Pejë,

32. Transmeton Ebu Davudi.

33. Forcat ushtarake e policore. Shënim i Redaksisë.

Prishtinë, Prizren, Rahovec, Viti e gjetiu.<sup>34</sup> Autori i nderuar, i cituar në këtë fusnotë, ish-pedagog imi në Medrese kur isha nxënës, këtë shkrim të tijin e përfundon kështu:

*“...Populli i Kosovës, sidomos nxënësit dhe mësimdhënësit e asaj kohe, do ta kujtojnë përherë, me respektin e pietetin më të lartë, këtë kontribut të jashtëzakonshëm të Bashkësisë Islame të Kosovës, në kohët më të vështira për popullin shqiptar në Kosovë.”*<sup>35</sup>

### Shkatërrimi i xhamive dhe i objekteve tjera islame

Në vendin tonë, pavarësisht gjendjes ekonomike, politike a

34. Më gjerësisht: Bajram Shatri, “Kontributi i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të saj në mbijetesën e arsimit shqip në Kosovë në periudhën e viteve 1990- 1999” te “Edukata Islame” nr. 117 , Prishtinë, f. 203- 219. Në këtë shkrim, autori ndër të tjera përmend edhe kontributin e Medresesë së Mesme “Alauddin” të Prishtinës, ku thotë:

*“...Me rastin e dëbimit të studentëve nga konviktet në vitin 1989, solidariteti i popullatës së Prishtinës ishte shumë i lartë. Këtu prapë duhet veçuar Medreseja ‘Alauddin’ e Prishtinës, përgjegjësit e së cilës i strebuan studentët e shumtë, të cilët kishin ngelur rrugëve, duke u siguruar strehim, ushqim dhe përkujdesje prindërore.*

*Medreseja u ofroi ndihmë të pakursyer shumë institucioneve arsimore e shkencore të Kosovës, si Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Senatit të Universitetit të Prishtinës, Institutit Albanologjik, Institutit të Historisë, Ministrisë së Arsimit, Bashkimit të Pavarur të Sindikatave të Kosovës, partive politike, etj...”*

35. Si në fusnotën e mësipërme, faqe 217.

sociale, ndërtimit të xhamive gjithnjë i është kushtuar kujdes meritohet. Deri në prag të luftës së fundit (1998-99), në Kosovë kanë funksionuar përafërsisht 560 sosh.

Çështje e vërteta, forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe në mënyrë sistematike shkatërruan tërësisht ose pjesërisht, ose dogjën ose shkatërruan mbi 218 xhami dhe objekte të tjera të trashëgimisë islame. Nuk ka asnjë komunë në Kosovë që të mos ketë objekte islame të shkatërruara. U shkatërruan, gjithashtu, 86 minare, 117 mihrabe, 120 minbere, 114 kupola, mbi 560 arabeska origjinale e autoktone të artistëve shqiptarë, u dogjën ose u vodhën mbi 12.000 dorëshkrime, një numër i konsideruar Mus'hafe të xhamive. Ndër këto objekte të dëmtuara, disa prej tyre kanë qenë objekte me rëndësi historike dhe të shpallura të mbrojtura nga shteti. Disa sosh kanë qenë perla të trashëgimisë materiale islame, me arkitekturë të papërsëritur. Dogjën dhe shkatërruan xhaminë "Ramadanije" në Prishtinë, xhaminë e Zallit në Mitrovicë, xhaminë Qendrore (Bajrakli) dhe atë të Kuqe në Pejë, xhaminë e Hadim Agës në Gjakovë, xhaminë kryesore në Vushtrri, së cilës edhe gurët e mureve ia kishin larguar nga vendi, xhaminë në Mitrovicë dhe shumë objekte të tjera të kësaj kategorie. Edhe djegia, dëmtimi e shkatërrimi i secilës xhami është histori më vete.<sup>36</sup>

36. Lidhur me shkatërrimet e xhamive dhe

Organet kompetente të Bashkësisë Islame të Kosovës, falë ndihmës së të Madhit Zot mbi të gjitha, falë përkrahjes dhe ndihmës materiale të donatorëve nga lindja dhe perëndimi, dhe falë përkrahjes së pa rezervë të besimtarëve tanë të nderuar, ia kanë dalë që pjesën dërmuese të këtyre objekteve t'i rindërtojnë dhe në to sot sërish të përmendet emri i Allahut dhe t'i bëhet ibadet Fuqplotit. Është për të ardhur keq që edhe 22 vite pas mbarimit të luftës, xhamia në Mitrovicë, për shkaqe thjesht politike, akoma nuk është rindërtuar, ndonëse jo rrallëherë Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës i është premtuar nga ana e kompetentëve ndërkombëtarë se do të ndihmojnë dhe do të ofrojnë siguri për ta rindërtuar.

Vlen të theksohet se shkatërrimin e shtëpive të Allahut kryesisht e bëjnë kriminelët, mizorët, tiranët, mendje-sëmurët. Shikuar historikisht, gjithmonë ka pasur mendje të sëmura që kanë mësyre shkatërrimin e xhamive, siç është i mirënjohur rasti i Ebrehasë, i cili kishte marrë disa elefantë dhe kishte mësyre prishjen e Qabes, ose, rasti i bizantinëve, të cilët kishin mësyre shkatërrimin e "El-Aksas". Po ashtu

---

objekteve të tjera islame, sidomos gjatë 1998-99, më gjerësisht: Sabri Bajgora, *Barbaria serbe ndaj monumenteve islame në Kosovë*, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2000.

kanë vepruar edhe serbët-çetnikët në Kosovë. Mirëpo, edhe Qabeja, edhe El-Aksaja edhe xhamitë tona sot krenare madhërojnë Allahun dhe në to Atij njerëzit i bëjnë ibadet, ndërkaq kriminelët ku janë sot?!!! Sigurisht, nuk janë në mesin e të gjallëve, ama, edhe nëse i kanë ikur dënimit në këtë botë, në Ahiret sigurisht që do ta marrin atë që kanë merituar.

### Si përfundim

Që nga koha e Profetit (a.s.) dhe e gjeneratave të para të myslimanëve e deri në ditët tona, ndërtimit të xhamive/mesxhideve i është kushtuar rëndësi në mbarë botën islame dhe më gjerë, prandaj myslimanët brez pas brezi e kanë stolitur faqen e dheut me xhami të mrekullueshme, shumë prej tyre edhe monumentale, me karakteristika të larmishme artistike dhe arkitektonike. Në qendrat e qyteteve, vendet më pikante kanë qenë të rezervuara për xhami, duke treguar kujdes për bukurinë e tyre në aspektin ornamental dhe arkitekturor.

Xhamitë janë simbole të lirisë sonë. Me shekuj, ato na kanë liruar dhe kanë ruajtur një ndjenjë të rëndësishme lirie në ne. Ne kemi qenë të lirë dhe dinjitarë në histori aq sa kemi hyrë në xhami dhe i kemi bërë sexhde të Vetmit Zot. Gjithashtu, xhamitë janë vende që ruajnë të gjitha vlerat, traditat, autoritetet tona, na i freskojnë kujtimet tona. Xhamitë, gjithashtu, na lidhin me të gjitha

gjeneratat e mëparshme, me njerëz të nderuar, me vakëflënës, imamë, hafëzë, myezinë dhe luftëtarë.

E thamë edhe më sipër se rëndësia dhe vlera e xhamive është shumëdimensionale, dhe se myslimanët e kanë përdorur edhe si shkollë, si vend për t'u edukuar, sepse myslimanët aty shkojnë për t'u bashkuar e për t'u afruar, e jo për t'u hidhëruar e për t'u përçarë. Xhamia, gjithsesi, është shkolla e parë e myslimanëve, është vendi në të cilin merren bazat e edukatës islame, djepi në të cilin ushqehet dashuria për dituri dhe kulturë.

Nga xhamitë kanë dalë dijetarët dhe imamët e mëdhenj, kolosët e dijeve islame. Në xhami janë diskutuar, debatuar dhe shpjeguar dituritë e ndryshme islame, shkencore dhe shoqërore. Edhe në xhamitë tona është ligjëruar në gjuhën e popullit, edhe atëherë kur ka qenë shumë vështirë të flitej shqip. Imamët tanë kanë qenë kategoria e vetme e inteligjencies shqiptare që kanë pasur guximin intelektual për të mbajtur ligjërimi në shqip.

Mbi të gjitha dhe para se gjithash, xhamitë janë vende ku madhërohet Allahu (xh.sh.), ku i bëhet sexhde, i drejtohen lutjet, dhe vendi ku shprehet dhe dëshmohet takvallëku ynë-devotshmëri jonë për Allahun (xh.sh.)

لَمَسْجِدٍ أُسَسَ عَلَى التَّقْوَىٰ مِنْ أَوَّلِ يَوْمٍ  
أَحَقُّ أَنْ تَقُومَ فِيهِ...

“...Një xhami, e cila që prej

**ditës së parë është themeluar në respekt dhe devotshmëri ndaj Allahut, është më e drejtë të falësh në të...**<sup>37</sup>

Profeti (a.s.) në xhami i priste dhe takohej me delegacione të fiseve të ndryshme të cilët vinin në Medine, aty takohej me as'habët e tij, i këshillonte, i edukonte e i arsimonte, e në rast nevoje e përdorte edhe si gjykatore për të zgjidhur problemet e ndryshme jetësore mes njerëzve. Prandaj, me shumë të drejtë mund të konstatojmë se xhamia ka qenë institucion shumë funksional, ndërkaq roli i saj ka qenë madhështor.

Xhamitë janë simboli i Islamit, treguesi i bashkimit dhe unitetit të myslimanëve, shenja e ekzistencës dhe mbizotërimit të tyre në një zonë të caktuar. Këtë e tregojnë qartë direktivat dhe porositë që Profeti (a.s.) jepte kur përcillte ndonjë ushtri apo njësi: *“Nëse atje shihni ndonjë mesxhid ose dëgjoni ezanin, mos e sulmoni*

37. Kur'an: Et-Teubeh, 108.

*askënd* (nga popullata vendore)!”<sup>38</sup>

Prandaj, le t'i ruajmë xhamitë tona. Raporti dhe marrëdhënia jonë ndaj xhamive kryesisht do të përcaktojë gjendjen dhe pozicionin tonë. Ne duhet gjithnjë ta kujtojmë hadithin e Profetit (a.s.) se *“Nga veprat dobiprurëse, sevapi i të cilave nuk ndërpritet edhe pas vdekjes janë: ... ndërtimi i një xhamie...”*<sup>39</sup> - kishte thënë Profeti (a.s.).

E lusim Allahun e Gjithëmëshirshëm që t'i pranojë ibadetet dhe adhurimet tona.

Lusim Allahun që t'i mëshirojë të vdekurit tanë, t'i shëroj të sëmurët tanë, kurse fëmijëve tanë t'u japë selamet.

Lutemi, O Zot i Gjithëpushtetshëm, që xhamitë tona të jenë dëshmitare për ne dhe familjet tona dhe jo kundër nesh!

Amin, ja rabbel-alemine!

---

38. Transmetojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

39. Transmeton Ibni Maxheh.

### Burimet e shfrytëzuara:

*Kur'ani i Madhërisbëm*, përktheu Prof. Hasan I. Nahi, botim i përkthyesit, Prishtinë, 1988.

*Kur'ani Fisnik*, përktheu H. Sherif Ahmeti, botoi: “Kompleksi i Mbretit Fehd për shtypjen e Kur'anit Fisnik”, Medinë, pa v. b.

*Shpjegimi i kuptimeve të Kur'anit të lartë në gjuhën shqipe*, përkthyer nga një grup përkthyesish pranë Darusselam, Shtëpia botuese dhe shpërndarëse “Darusselam”, Rijad, 2000.

*Kur'an Ćasni*, përkthyer nga hfz. Muhamed Pandža dhe Džemaluddin Čaushević, bot. “Stvarnost”, Zagreb, 1969.

El-Hafidh Imaduddin ibni Kethir Ed-Dimeshkij, Muhtesar Tefsir ibni Kethir, Daru l Kur'ani l Kerim, përkatitur dhe redaktuar nga Muhamed Ali Es-Sabuni, Bejrut, pa v.b.

Sejjid Kutub, Fi Dhilali l Kur'an, Darush-Shuruk, Bejrut, 1973.

Imam Muslimi, *Sahibi Muslim bi sherh En-Nevevi*, Shtypshkronja “Misrije”, Kajro, pa v.b.

El-Karnshavi, Abdul-Xhelil. *Dirasat fi 'l Sheriati 'l islamije*, botime të Universitetit të Benghazit, Benghazi, Libi, pa v.b..

El-Kasani, Imam Alaud-din, *Bedâ'us-sanâi' fi tertîbîsh-sherâi'*, botim i tretë, botoi “Dar el-ihja al- Turath El-Arabi” dhe “Muesese et-Tarih El-Arabi”, Bejrut, 2000.

- Nerkez Smailagić, *Leksikon Islama*, “Svetlost”, Sarajevo, 1990, f. 137.

- John L. Esposito, *Fjalor i Oksfordit për Islam*, “Logos-A”, Shkup, 2017.

- Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, pjs. 2, “Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë”, Stamboll, 2017.

- Safvet Halilovic, *Sira - životopis posljednjeg Allahovog Poslanika*, *El-Kalem*, Sarajevo, 2010.

- Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë, 1984.

- S. Kudra, *Dzamije Sarajeva*, bot. “El-Kalem”, Mexhlisi i Bashkësisë Islame të Sarajevës, Sarajevë, 1426/ 2006.

David Macaulay, *Xhamia*, pa vend dhe vit botimi.

Vexhdi, Muhamed Ferid. *El-Islamu fi asri-l-ilm'*, botoi “Daru-l-kitab el-arabij”, Bejrut, 1967.

- Bajram Shatri, *Kontributi i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve të saj në mbijetesën e arsimit shqip në Kosovë në periudhën e viteve 1990- 1999* tek “Edukata Islame” nr. 117 , Prishtinë.



## Mrekullia e Kur'anit Famëlartë në dritën e njohurive të reja shkencore

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi  
Gjakovë

### Abstrakt

*Para 14 shekujve, Kur'ani Famëmadh, i shpallur nga Allahu i Madhërishtëm nëpërmjet të Dërguarit, Muhamedit a.s., i cili jetoi në Gadishullin Arabik në kohën kur arabët, për të njehsuar kohën, përdornin kalendarin hënor, u drejtobet në gjubën që ata kuptonin:*

**“Ai e bëri diellin shndritës, e hënën dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. Allahu nuk krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton.”**

*Allahu i Gjithëdijshtëm, në diturinë e Tij të përhershme, e ka ditur se do të vijë koha kur shkencëtarët do t'i zbulojnë këto fakte dhe atëherë do të kuptojnë se Kur'ani është prijatar i shkencës, ndërsa Muhamedi (a.s.) është vula e profetëve të Tij.*

*Prandaj saktësia dhe vërtetësia e Kur'anit Famëmadh është garantuar nga Allahu i Gjithëdijshtëm për çdo vend, për çdo kohë, epokë dhe brez:*

**“Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!”**

**P**ara 14 shekujve, Kur'ani Famëmadh, i shpallur nga Allahu i Madhërishtëm nëpërmjet të Dërguarit, Muhamedit a.s., i cili jetoi në Gadishullin Arabik në kohën kur arabët, për të njehsuar kohën, përdornin kalendarin hënor, u drejtohet në gjuhën që ata kuptonin:

**“Ai e bëri diellin shndritës, e hënën dritë dhe asaj (hënës) ia caktoi fazat, që ta dini numrin e viteve dhe llogarinë. Allahu nuk krijoi këtë për tjetër, pos me qëllim të caktuar Ai ia sqaron argumentet një populli që kupton.”<sup>1</sup>**

Periudha Siderike (Rotullimi i Hënës në raport me yje) Sinodike.

Muaji hënor T 27.321661 ditë=655.71986 29.53059 ditë

Dita tokësore është 23h, 56min. 4,0906s = 86164,0906s pra 24h = 86400s.

Viti hënor përbëhet prej dymbëdhjetë muajve, ku muaji përkufizohet si kohë e një revolucioni të Hënës në orbitën e saj rreth Tokës. Paraqitjen e kësaj orbite e hasim në Kur'anin Fisnik:

**“Ai është që krijoi natën dhe ditën, diellin e hënën dhe secili prej tyre noton në orbitë.”<sup>2</sup>**

Këtu është parashtruar një fakt shkencor. Ky fakt është ekzistimi i orbitave të Tokës, Diellit dhe Hënës!

Pra, në Kur'anin Famëmadh është vendosur një koncept i ri 14 shekuj para se këtë ta zbulojë shkenca bashkëkohore.

1. Junus, 5.

2. El-Enbija, 33.

## **Relacioni i ri në sistemin Tokë-Hënë**

Gjatësia e orbitës së Hënës “L” dhe kohës “t” e një dite të Tokës janë në korrelacion me ajetin kur'anor, i cili konstanten universale të shpejtësisë së ndonjë ndodhie kozmike e përshkruan si vijon:

**“Ai është që udhëheq çështjen (e të gjitha krijesave) prej qiellit në tokë, pastaj ajo (çështja) ngrihet tek Ai në një ditë që sipas llogarisë suaj është sa njëmijë vjet.”<sup>3</sup>**

Shprehja e Kur'anit Fisnik, “sipas llogarisë suaj”, nuk lë vend për asnjë dyshim se është fjala për vitin hënor. Ajeti fillon me paraqitjen e një ndodhie kozmike, krijues i së cilës është Allahu, i Cili e udhëheq atë. Kjo ndodhi udhëton kaq shpejt nëpër tërë Gjithësinë, mes qiejve dhe Tokës, saqë për një ditë kalon një distancë në hapësirë, ekuivalente me distancën që Hëna kalon për një mijë vjet hënor. Pyetja e cila parashtrohet është: Cila është ajo ndodhi kozmike dhe me ç'shpejtësi lëviz sipas njësimi kur'anor?

Ajeti i Kur'anit Fisnik, i cituar më lart, kuptohet mbi bazën e matjeve vijuese: Distanca, në të cilën një ndodhi kozmike e kalon në vakum vetëm për një ditë siderike, është e barabartë me largësinë e 12.000 rrotullimeve të Hënës rreth Tokës.

$$C \times t = 12\,000 \times L$$

Ku “C” është shpejtësia e

3. Es-Sexhde, 5.

ndodhisë kozmike, “t” është intervali kohor i një dite mesatare yjore, e përcaktuar si kohë e një rrotullimi të Tokës rreth boshtit të vet në raport me yjet, pra 23h. 56min. 4s = 86164.0906s.

“L” është distanca inerciale, të cilën Hëna e kalon në korrelacion rreth Tokës për një muaj siderik, gjegjësisht “L” është e tërë gjatësia e orbitës së Hënës në lëvizjen e saj gjeocentrike, pa interferencën e lëvizjes së saj spirale që shkaktohet me revolucionin e Tokës rreth Diellit. Kjo është gjatësia e orbitës hënore, nga e cila, në vlerën e matjes, është mënjeluar efekti i fushës së gravitetit të Diellit.

Le të jetë “V” shpejtësia orbitale mesatare e matur e Hënës e nxjerrë nga rrezja mesatare “R” e orbitës së saj, e matur nga Toka gjatë kohës së lëvizjeve të saj heliocentrike.

Kjo vlerë është shënuar në të gjithë librat e astronomisë.

Le të jetë “ $\alpha$ ” këndi të cilin sistemi Tokë-Hënë e kalon rreth Diellit në një periudhë prej një muaji siderik, 27.321 661 ditë. Këndin “ $\alpha$ ” mund ta njehsojmë nëse marrim në shqyrtim periudhën e një revolucioni heliocentrik (një vit ose 365.25 636 ditë) të sistemit Tokë-Hënë. Llogaritja jep këtë vlerë të shpejtësisë C:

$$C=12\ 000 \times 3682.67 \times 0.89157 \times 655.71986/86164.0906$$

$$C=299792.5 \text{ km/s}$$

Nëse përqendrohemi në vlerën

internacionale të shpejtësisë së dritës  $C=299792.5 \text{ km/s}$ , do të vërejmë përputhshmëri të jashtëzakonshme. Kështu arrijmë në përfundimin se ndodhia kozmike, e përmendur në ajetin kur’anor të cituar më lart, është identike me dritën, dhe të gjitha ndodhitë e ngjashme kozmike, siç janë të gjitha llojet e valëve elektromagnetike, që përhapen ndërmjet qiejve dhe Tokës, pastaj valët e pritshme të gravitetit në tërë Gjithësinë, si dhe të gjitha grimcat, si, për shembull, neutronet, të cilat udhëtojnë në vakum, kanë këtë shpejtësi maksimale.

Këtu është interesant të përmendet edhe ajeti kur’anor, i cili sinjalizon të njëjtën relativitet në sistemin Tokë-Hënë, ku Allahu i Madhërishtëm thotë:

**“Ata kërkojnë prej teje t’ua ngutësh dënimin, po Allahu nuk e thyen premtimin e Vet, pse një ditë te Zoti yt, është sa njëmijë vjet, si llogaritni ju.”<sup>4</sup>**

Kështu që të dy barazimet relativiste kur’anore tregojnë se vlera e fituar C është konstantë absolute. Nuk ekziston asnjë argument shkencor që tregon se vlera C mund të ndryshohet në kohë.

Pra, shpjegimi i ri relativist i këtij relacioni kur’anor jep vlerën  $C=299792.5 \text{ km/s}$ , gjë që është në pajtim të plotë dhe mahnitës me vlerat e pranuar internacionale. Ky rezultat mahnitës tregon njësinë e 4. El-Haxhxh, 47.

botës fizike, vlerën speciale të teorisë së relativitetit dhe njëherazi vërteton autenticitetin e Kur'anit Famëmadh - prijatarin e shkencës.

Është interesant të gjendet relacioni i ri astronomik mes rradisit të orbitës hënore  $L$  dhe kohës  $t$  të një dite tokësore në bazë të shpjegimit të ri relativist të ajeteve kur'anore, të cilat paralajmërojnë shpejtësinë më të madhe universale identike me shpejtësinë  $C$  të dritës në vakum.

Këtu shprehet gjithashtu uniteti në kompleksin e fenomeneve të cilat, po t'i shikojmë, na duken sikur nuk kanë asgjë të përbashkët.

Kaptina "Et-Tarik" fillon me një betim të jashtëzakonshëm:

**"Pasha qiellin dhe yllin trokitës. E ku e di ti se çka është tariku-trokitësi? Ai është ylli që shpon (errësirën me dritë)"...**<sup>5</sup>

Në fjalorin e gjuhës arabe fjala *tarik* tregon atë që troket, pulson, farkon, bën zhurmë.

Nexhm - paraqet yllin.

Thakib tregon atë që shpon, depërton, shkrepin, shkëlqen, vezullon.

Pra, Allahu i Madhërishëm betohet në yllin (nexhm), i cili prodhon impulse të ngjashme me trokitje (tarik) dhe, njëkohësisht, dërgon vezullime të jashtëzakonshme të dritës, radio valë, rreze (gama) dhe X (thakib)! Është e njohur si depërtojnë dhe sa janë depërtuese rrezet gama, rrezet

5. Et-Tarik, 1-3.

X, radiovalët dhe drita.

Cili është ky yll që ka këto cilësi?

Këto cilësi astronomët ua përshkruajnë vetëm yjeve neutronikë. Yjet neutronikë kanë dendësi dhe shpejtësi rrotulluese jashtëzakonisht të mëdha, nga një rrotullim në disa sekonda e deri te një rrotullim në 1.56 milisekonda. Këta yje quhen pulsorë<sup>6</sup>. Nga dy polet magnetike të pulsorëve dalin grimca të shumta. Këto grimca prodhojnë rreze të fuqishme drite, radiovalë, rreze X dhe gama.

Kjo rrjedhë e fuqishme e pret qiellin si drita në fanar. Tek yjet pulsorë boshti magnetik nuk përputhet me boshtin rotator. Çdo herë që kjo rrymë (qoftë e dritës, radiovalë, rreze gama ose X) qëllon Tokën, dëgjohet pulsimi preciz i zhurmës, pulsim ky që është i ngjashëm me trokitje (tarik) ose të rrahura të një ore të fuqishme qiellore, të cilat i ndjek një zhurmë depërtuese.

Nëse me anë të internetit lidhemi me njërin nga observatorët (këtë trokitje të yllit neutronik e kanë incizuar me anë të radioteleskopëve të mëdhenj) do të befasonemi edhe vetë me përputshmërinë e habitshme ndërmjet ajeteve të cituara kur'anore dhe veprimt të pulsorëve!

Sikur ylli ynë, Dielli, në ndonjë mënyrë të çuditshme, do të arrinte dendësinë e një ylli neutronik që ka diametër 10 km, atëherë shpejtësia

6. Yje shumë të vegjël, me dendësi dhe energji të lartë kur shpërbëhen.

rrotulluese e Diellit do të rritej 5 miliardë herë, gjegjësisht Dielli do të rrotullohej 2.000 herë në sekondë.

Pulsori më energjik është zbuluar në mjegullnajën Gaforroide në Yjësinë e Demit. Ai rrotullohet 30 herë në sekondë dhe është tejet i magnetizuar. Për këtë arsye ai vepron si stacion energjetik qiellor, rrezatimi i të cilit transmeton energji të mjaftueshme dhe bën që e tërë mjegullnaja Gaforroide të ndriçojë gati gjithë hapësirën spektrale.

Më të afërt janë radiopulsorët. Kështu, pulsori PSR 1937+21 rrotullohet mbi 360 herë në sekondë!

Supozohet se këto fenomene të emetimit të dritës depërtuese ose radiovezullimet shkaktojnë rënie të përhershme të materieve nga ylli fqinj, dhe ngjan me trokitjen me gishtërinj në globin rrotullues, duke ia ruajtur kështu shpejtësinë e rrotullimit!

Në shpjegimin e tij, Jusuf Ali, thotë se ekzistojnë kundërthënie të mëdha lidhur me atë se për çfarë flasin këto 3 ajete kur'anorë. Disa komentues mendojnë se këtu është fjala për Venusin ose Yllin Polar; të tjerë si ky janë planeti Saturn, ylli Sirius, grumbulli i hapur i yjeve Plejadë 5 ose yjet që bien.

Ai mendon gjithashtu se fjala më adekuate *tarik* duhet marrë në kuptimin yll, në kuptimin kolektiv dhe gjenerik, sepse yjet shndrisin për çdo natë në vit, dhe shkëlqimi i tyre depërton nëpër natën e errët.

Duhet theksuar se larmi mendimesh hasim edhe te komentues të tjerë.

Karakteristikë e objektit qiellor, të theksuar në ajetet 1-3 të kaptinën Et-Tarik, është:

1. troket (rrah, pulson, farkon),
2. është yll,
3. shpon, depërton, shkrepitin.

Asnjë nga planetët e Sistemit Diellor nuk i plotëson kriteret që janë përcaktuar në ajetin kur'anor, sepse:

Asnjëri nga planetët nuk prodhon pulsime të ngjashme me trokitjen.

As Venusi, as Ylli Polar, as Saturni nuk janë yje, por trupa të ftohtë qiellorë.

Asnjë nga planetët nuk ka rrezatim kaq të fuqishëm (qoftë në spektrin e dukshëm të dritës, qoftë në rajonin e emetimit të radiovalëve, rrezeve X dhe gama) që të jenë kaq interesantë.

Sa i përket Siriusit dhe Yllit Polar, ato janë yje që kanë brendi të njëjtë, ashtu si edhe miliarda yje të tjerë me ndriçim të madh.

As grumbulli i hapur i yjeve Plejadë nuk i plotëson këto kriterë, sepse është fjala vetëm për shumë yje të grupuar me pamje karakteristike, kështu që ne në qiell shohim “shkëlqimin e bashkuar” të tyre.

Ata, që në rastin tonë i quajmë “yje rënës”, nuk janë fare yje, por pjesë të vogla të materialit kozmik me madhësi të gurëve ranorë apo pak më të mëdhenj, të cilët, kur

arrijnë në atmosferën e Tokës, digjen për shkak të fërkimit me ajrin dhe shihen me një dritë intensive.

Ndërsa sa i përket qëndrimit të Jusuf Aliut, i cili thotë se tarik duhet shpjeguar me termin e përgjithshëm “yjësi”, ai nuk mund të pranohet, ngase shprehja kur’anore është jashtëzakonisht precize për të lejuar një improvizim të këtillë. Megjithatë, Allahu e di më së miri!

Në kaptinën Et Tarik (Ylli trokitës), Allahu i Madhërishtëm betohet:

“**Uessemaj dhatir-rexh’i**”, që në shqip përkthehet: “**Betohem në qiellin i cili rikthen.**”<sup>7</sup>

Siç shihet nga ajeti, Allahu i Plotfuqishëm betohet në qiellin që ka një cilësi tepër të rëndësishme, e kjo është aftësia e kthimit (rexh’un) ose e sjelljes së gjërave në drejtim të kundërt.

Ajeti nuk thotë “Betohem në qiellin me shi” (Ues-semaj dhatil matar) apo “Betohem në qiellin përplot me shi” (siç është përkthyer shqip). Nëse donte të thoshte kështu, Ai do ta theksonte, por jo. Shkakun mund ta kuptojmë tani, në periudhën moderne, kur shkenca ka përparuar dukshëm në fushën e njohurive mbi atmosferën e Tokës dhe rolit të saj në ruajtjen e jetës në Tokë.

Komentuesit e hershëm të Kur’anit e kanë shpjeguar këtë ajet, duke menduar se qielli e kthen shiun. Kështu, rexh’us-7. Et-Tarik, 11.

sema, për ata ka qenë shiu. Dhe kjo është absolutisht e vërtetë.

Njëri prej fenomeneve më të rëndësishme në jetën tonë është ajo që ne e quajmë cikël ujor, ose cikël hidrogeologjik. Është e njohur se nga masat ujore të hapura, siç janë detet dhe oqeanet, uji avullon nën ndikimin e nxehtësisë së diellit, dhe ngrihet në formën e avullit ujor në shtresat e ulëta të atmosferës, e cila është e njohur si troposfera.

Shtresa e troposferës është 13-15 km mbi nivelin e detit, por kjo distancë ndryshon varësisht nga zona klimatike. Allahu i Madhërishtëm i ka dhënë kësaj zone karakteristikën e ftohjes graduale. Duke u ngritur gjithnjë e më lart, ajo bëhet gjithnjë më e ftohtë, derisa temperatura të arrijë në -80°C. Kjo është e vetmja mënyrë me ndihmën e së cilës avulli i ujit, i ngritur nga sipërfaqet e deteve dhe oqeaneve, kondensohet dhe kthehet në Tokë.

Sikur kjo shtresë e atmosferës të mos e kishte vetinë e ftohjes, uji i cili do të avullohej do të humbiste që në momentin e avullimit.

Për këtë shkak, njëri prej aspekteve më fenomenale të planetit tonë është cikli (qarkullimi) i ujit. Uji është njëri nga elementet më të rëndësishëm që qielli i kthen Tokës.

Cikli ujor është tejet preciz dhe i balancuar bukur mes tokës dhe deteve. Shkalla e avullimit nga detet dhe oqeanet është më e madhe se ajo që sjellin reshjet, ndërsa në

Tokë është e kundërta, pra shkalla e avullimit nga masat kontinentale është më e vogël se reshjet që bien në të. Në këtë mënyrë fitimi dhe humbja e ujit është e balancuar për mrekulli. Ky cikël uJOR është njëra nga karakteristikat më të theksuara të planetit tonë, i cili njihet si planeti i kaltër i Sistemit Diellor, që është i pasur me sasi të mëdha uji.

Pra, tani e dimë shkaku përse Allahu i Madhërishëm betohet në qiellin që “kthen”, sepse e kemi kuptuar se në qiell ekziston një mburojë shumë-shtresore e Tokës. Këto shtresa (mburoja) të atmosferës i kthejnë në Tokë të gjitha format e dobishme të materies dhe energjisë. Kështu, qielli nuk e kthen vetëm shiun, por edhe gjëra të tjera. Mbi atmosferën është ozonosfera, pra shtresa e ozonit.

Kjo është shtresa në të cilën sasia e oksigjenit rritet edhe më tej. Kjo shtresë ndodhet në një lartësi prej 25 km mbi nivelin e detit. Allahu i Madhërishëm na dërgon rrezatimin, i cili vjen nga Dielli dhe nga kozmosi i jashtëm. Pa thithjen e rrezeve ultravjollcë, nuk do të kishte jetë në Tokë.

Kjo formë e shprehjes *rexb'a* është formë e kthimit të materieve të dëmshme në kozmosin e jashtëm. E dimë gjithashtu se këto dy shtresa, troposfera dhe ozonosfera, nuk kthejnë vetëm shiun në Tokë, por edhe lloje të ndryshme të energjisë dhe grimcave të forta, të cilat janë të

rëndësishme për banorët e planetit. Kthen po ashtu edhe valët e nxehta që lëshon Toka, edhe grimcat e forta, të cilat janë përgjegjëse për bardhësinë e ditës, në të cilën kënaqemi për shkak të reflektimit të madh të dritës së Diellit nga sipërfaqja e tyre e jashtme.

Mbi ozonosferën gjendet jonosfera - shtresa e jonizuar, e cila kthen në Tokë valët e emetuara radio-televizive dhe të telekomunikacionit. Si rezultat i reflektimit të radiovalëve, ne mund t'i dëgjojmë radiostacionet e hemisferës së kundërt.

Pa jonosferë nuk do të kishte radio, televizion dhe telekomunikacion. Mbi jonosferën gjenden të ashtuquajturit “Brezat e Van Allenit”; dy breza koncentrikë shumë të hollë në pole, shumë të përhapur në ekuator. Këto breza i shtyjnë grimcat kozmike, të cilat udhëtojnë me shpejtësi fantastike drejt Tokës, dhe janë rrezik vdekjeprurës për jetën në Tokë. Mbi Brezat e Van Allenit gjendet magnetosfera, e cila vepron gjithashtu si barrikadë mbrojtëse për jetën në Tokë, duke mënjanuar pjesën më të madhe të grimcave kozmike që udhëtojnë drejt nesh.

Prandaj fjala *rexb'* është vërtet e çuditshme, për shkak se vetëm me një fjalë, Kur'ani Famëmadh, përshkruan aftësinë e qiellit që planetit tonë i kthen format e dobishme të materies dhe energjisë, por që në kozmosin e jashtëm mënjanon format e dëmshme, duke

mbrojtur në këtë mënyrë jetën në Tokë. Kjo është arsyeja pse Allahu i Gjithëdijsëm, në diturinë dhe urtësinë e Tij të përhershme, e ka përdorur fjalën *rexh'* (kthim), e jo shi (meteor).

Në ajetin vijues të së njëjtës sure, Allahu i Madhërihëm betohet: **“Betohem në Tokën me plot çarje”**<sup>8</sup>

Ajetin e cituar të Kur'anit Famëmadh përkthyesit shqiptarë e kanë përshtatur si më poshtë:

H. Sherif Ahmeti: “Edhe tokën që çahet për bimë”.

Hasan ef. Nahi: “Edhe tokën që plasaritet për të mbirë bimët”.

Feti Mehdiu: “Edhe tokën që çahet e plasaritet (për të mbi)”.

Fjala kryesore në këtë ajet është *sade'*, që do të thotë çarje, plasaritje.

Menjëherë vërehet se në ajet nuk përmendet asnjë çarje e Tokës, nuk përmendet asnjë bimë dhe asnjë mugullim i bimës. Në fakt, ajeti është konstatim dhe paraqitje e fakteve lidhur me gjendjen ekzistuese të korës së Tokës.

Komentuesit e mëparshëm të Kur'anit këtë e kanë kuptuar vetëm si çarje-plasaritje e truallit për të mbirë bima. Kur hedhim farën në tokë, e më pastaj e ujisim, nga toka mbin bima e re me bukurinë e saj të përkryer, që ne kemi mbjellë. Aftësia e bimës që mugullon vetë është një çudi më vete.

Por, çarja-plasaritja e truallit për të mbirë bima është 8. Et-Tarik, 12.

vetëm një aspekt i kuptimit “të tokës me plot çarje-plasaritje”.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në kërkim të mineraleve, shkencëtarët u zhytën në fund të deteve dhe oqeaneve. Për habinë e tyre, ata konstatuan se thellësitë më të mëdha të oqeaneve nuk janë në qendër, siç është menduar më parë, por në periferi, ndërsa pjesët më të cekëta të oqeaneve dhe deteve janë në qendër. Hulumtimet e mëtejme kanë zbuluar se shtresa gurore e Tokës është e çarë në shumë vende dhe se ato të çara dhe plasaritje janë në të gjitha drejtimet: në drejtimin veri-jug dhe lindje-perëndim, janë me dhjetëra mijëra kilometra të gjata dhe 60-150 kilometra të thella në tërë trashësinë gurore të kores së Tokës. Kjo bën të mundur që magma nën litosferë të depërtojë deri në fund të deteve dhe oqeaneve. Nga këto plasaritje llava del në sipërfaqe, nga e cila ndërtohen ishuj në mes të detit, që quhen “Kodra Shkëmbore” mes-oqeanike. Maja më e lartë në Tokë është mali Everest, 8.848 m mbi nivelin e detit, por në fund të oqeaneve kemi ngritje të cilat arrijnë lartësinë mbi 11 km.

Pra, njëra nga karakteristikat e planetit tonë janë plasaritjet e tij.

Në këto plasaritje goditen pllakat kontinentale. Ato fërkohen mes tyre duke shkaktuar tërmete dhe shpërthimin e vullkaneve.

Nga këto shpërthime dalin sasi të mëdha shkëmbinjsh të tretur, që rrjedhin duke formuar kodra



shkëmbore mes-oqeanike. Sikur Toka të mos i kishte këto plasaritje, të cilat mundësojnë përcjelljen e nxehtësisë nga brendia për nga korja e Tokës, jeta në Tokë nuk do të ishte e mundur. Pra, Toka plasaritet për të zbërthyer farën e bimës; nga plasaritjet e saj del nafta, burimet termale, mineralet dhe vullkanet.

Njeriu mund të pyesë se si është e mundur që Profeti (a.s.) i ka ditur këto fakte shkencore, kur e dimë se asnjëherë nuk ka bërë hulumtime shkencore në dete dhe oqeanë. Për të gjitha këto e ka informuar Allahu i Madhërishtëm nëpërmjet frymëzimit hyjnor.

Allahu i Gjithëdijshtëm, në diturinë e Tij të përhershme, e ka ditur

se do të vijë koha kur shkencëtarët do t'i zbulojnë këto fakte dhe atëherë do të kuptojnë se Kur'ani është prijatar i shkencës, ndërsa Muhamedi (a.s.) është vula e profetëve të Tij.

Prandaj saktësia dhe vërtetësia e Kur'anit Famëmadh është garantuar nga Allahu i Gjithëdijshtëm për çdo vend, për çdo kohë, epokë dhe brez:

**“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?!”**<sup>9</sup>

---

9. Fussilet, 53.

## Vakëfi midis së shkuarës dhe së ardhmes

**Edison Hoti**  
**Drejtoria e Vakf-Investimeve**  
**Komuniteti Mysliman i Shqipërisë**

### Abstrakt

*Vakëfi luan një rol shumë të rëndësishëm në shoqëritë myslimane. Ai ka qenë burimi kryesor për shërbimet e ndryshme publike të ofruara për komunitetet besimtare por edhe më gjerë.*

*Tradicionalisht, krijimi i vakëfeve është ngulitur në kulturën e myslimanëve dhe është e përfshirë në të gjitha sferat e jetës. Vakëfi gjithashtu ka kontribuar në shërbim të njeriut në fusha të ndryshme të zhvillimit, siç ishin ndërtimi i objekteve të kultit, formimi i institucioneve arsimore, infrastrukturë, mjekësi, etj. Megjithatë, në kohët moderne, vakëfi ka parë një rol në rënie, pothuajse në të gjitha vendet myslimane. Fenomen i cili ngre një numër pyetjesh se çfarë faktorësh çuan në këtë rënie, duke theksuar kështu njëkohësisht arsyet e rënies së tij dhe nevojën për reformim.*

*Studimet konstatojnë se, transparenca me fondet është elementi kryesor në shtimin vakëfeve të reja. Është dinamika më jetësore e vakëfit. Nëse kjo mungon nuk mund të presim ndonjë rezultat domethënës, sado të mëdha qofshin përpjekjet.*

*Rizformulimi i mënyrës së menaxhimit të vakëfeve dhe hartimi i një rrjeti të integruar, që studion problemet që hasen në praktikën e kohëve moderne në të cilat jemi, është gjithashtu element kryesor në zhvillimin e vakëfeve.*

*Planifikimi dhe udhëzimi legjislativ i vakëfit, padyshim është dinamika kryesore që tregon perspektivën dhe horizontin e zhvillimit të vakëfit, në varësi të natyrës së tij dhe kushteve me të cilat përbëhet ai vakëf.*

1. “Vakëf” - Ruajtja e një pasurie dhe shpenzimi i përfitimeve të saj në rrugë të Allahut (xh.xh.).

*Studimi arrin në përfundimin se kur myslimanët përkushtohen më tepër në praktikat vakëfnore, duke ecuar me transparencë në organizimin e vakëfeve dhe fondeve që kanë të bëjnë me praktikat vakëfnore, njëkohësisht duke rritur interesimin në formimin e vakëfeve të reja, atëherë vërtetë mund të flasim për një ringjallje reale të praktikës së vakëfit. Vakëfi fiton vlerën e tij të munguar në shoqërinë myslimane, duke iu kthyer shërbimin e dubur atyre zërvare të cilët përfitojnë nga vakëfi, duke u bërë kështu një magnet tërheqës i Mëshirës së Zotit mes njerëzve.*

### Hyrje

Vakëfi është një akt financiar bamirësie i themeluar nga pasuri të paluajtshme ose edhe të luajtshme, por gjithmonë për të shpenzuar të ardhurat e tyre në përmbushje të nevojave publike apo familjare, bazuar në preferencat dhe kushtet e vendosura nga vakëflënësi<sup>2</sup>. Pasi prona është krijuar si një Vakëf, ajo kurrë nuk mund të jepet si dhuratë, të trashëgohet apo shitet. Ajo i takon Allahut (xh.sh.) dhe prona vakëf mbetet e paprekur. Vetëm të ardhurat e lindura kanalizohen për përfituesit e saj. Ka vetëm një rast në të cilin bëhet përjashtim ku lejohet *Istibdal*-i<sup>3</sup> i vakëfit. Ky vendim

merret nga autoritetet më të larta të menaxhimit të vakëfit, “*Mexhllis*-i”<sup>4</sup>.

Motivimi kryesor për një themelues vakëfi, për ta formuar atë, jepet qartë në Kur’an dhe Traditën Profetike. Në Kur’an, sure Al ‘Imran, thuhet: “**Kurrë nuk do ta arrini sinqeritetin e plotë me besim** (as kënaqësinë e lumtur në Xhenet) **derisa të mos e jepni më të dhembshmen (më të dashurën) e pasurisë suaj**. Çfarëdo që jepni (për Zotin), **Allahu atë e di**.”<sup>5</sup>. Në suren Bekare, “**të cilët besojnë në të fshehtën, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne**”<sup>6</sup>. Ose sipas nxitjes profetike, ku Profeti ynë (a.s.) urdhëron e thotë: “*Kur vdes personi, mirësitë e të*

---

2. “vakëflënësi” - personi i cili formon vakëf.

3. “Istibdal” i vakëfit- Istibdal është një fjalë arabe që rrjedh nga fjala “Bedel” që do të thotë të ndryshosh ose zëvendësosh. Në thelb, Istibdal do të thotë të shesësh atë që mungon ose një pronë vakëfi që ka humbur

---

të ardhurat e saj për të blerë atë që është më e mirë.

4. “Mexhllis” - është autoriteti më i lartë i menaxhimit të vakëfit.

5. Kur’an, Al ‘Imran, 3:92.

6. Kur’an, Bekare, 2:3.

*gjitha akteve të tij ndërpriten (bashkë me ndërprerjen e akteve), me përjashtim të sadakasë (lëmoshës, mirëbërësisë) që vazhdon të veprojë, të diturisë së lënë prej tij, nga e cila vazhdojnë të përfitojnë njerëzit, dhe të fëmijës së dobishëm, i cili lutet pas tij për të.”<sup>7</sup>* Dijetarët myslimanë kanë deklaruar se me sadakanë (lëmoshën, mirëbërësinë) që vazhdon të veprojë, e cila në terminologjinë përkatëse quhet sadakatu’l-xharije<sup>8</sup> (mirësi rrjedhëse), përgjithësisht bëhet fjalë për vakëfin.

Njëkohësisht besimtarët, aktin e formimit të vakëfit e shikojnë edhe si një lutje të fuqishme ndaj Zotit, duke pritur prej Tij furnizimin me begati e bereqet nga mirësitë e Tij në mënyrë të vazhdueshme, nga Ai i Cili është Pronari i mallit dhe i pasurisë.

Pra, formimi i vakëfit për themeluesin e tij është një mënyrë për të arritur devotshmërinë para Zotit.

Vakëfi ka luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e një qytetërimi të lulëzuar, që është i plotë në karakter, në moral dhe sjelljen racionale të njeriut. Ai krijoi një rilindje të plotë shkencore dhe kulturore. Është e pamohueshme që fondet e vakëfeve kanë kontribuar në zhvillimin e arsimit dhe lëvizjeve shkencore në Islam. Këto fonde kanë

qenë burimi kryesor për shkolla, qendra shkencore dhe biblioteka, të cilat shtruan rrugën për trajnimin e shumë shkencëtarëve, hulumtuesve, shpikësve dhe intelektualëve. Në të vërtetë, vakëfi është një nga faktorët kyç për prosperitetin shkencor dhe kulturor në qytetërimin islam. Ai është gjithashtu një nga shtyllat themelore për shumicën e institucioneve publike.

Vakëfi është gjithashtu një fushë konkurrence mes besimtarëve, drejtuesve, biznesmenëve, apo edhe individëve të thjeshtë për të formuar institucione vakëfnore në shërbim të besimtarëve dhe duke e kthyer atë në një burim të pashtershëm të sevapeve për ahiretin e vakëflënësve.

Një specifikë shumë e veçantë dhe e rëndësishme mbi formimin e vakëfeve, sidomos në ditët tona, është kontributi në ekuilibrin social që këto institucione vakëfnore formojnë. Duke vendosur një lidhje të natyrshme fetare me epiqendër kënaqësinë e Zotit, mes të pasurve dhe të varfërve arrihet që, nga shtresa e pasur e shoqërisë të ofrohet mëshirë dhe përkujdesje, ndërsa nga shtresa e varfër mes tyre të kthehet në mirënjohje dhe respekt. Kjo tematikë sigurisht kërkon një hapësirë dhe dedikim më të madh në trajtimin e saj, por ne këtu po mjaftohemi me kaq.

Në të kaluarën, shumë shokë të Profetit (a.s.) të tillë si Osmani, Talha, Zubejri, Aliu, Ibn Omeri,

7. Muslim, Uasijje, 14.

8. “Sadakatu’l-xharije” - ose mirësi rrjedhëse, e vazhdueshme, quhet lënie për pëlqim të Zotit, e një veprë që kryen shërbim të vazhdueshëm, të pandërprerë.

Abdullah bin Amr bin Asi dhe Halid Bin Uelidi (r.a.), etj., patën formuar vakëfet e tyre, praktikë e cila tregon dhe thekson më tej rëndësinë e vakëfit.

Procesi i vakëfeve vazhdoi deri në periudhën osmane, në të cilën institucioni i vakëfit njohu një institucionalizim të mirëfilltë në këtë fushë. Në këtë institucionalizim dhe edukatë vakëfnore viset shqiptare zinin një vend të veçantë, madje rasti ynë si Shqipëri është një shembull shumë domethënës në këtë fushë. Këtu përmendim një rast interesant që e kemi hasur në arkivat tona në KMSH gjatë punës. Quhej “vakfi i Meq Medines”, sot diku pranë konvikteve të inxhinierisë së ndërtimit në Tiranë. Pra vakëfi i Mekës dhe Medinës. Të ardhurat që merreshin nga ai vakëf, shkonin për këto dy vende të shenjta, Meken dhe Medinën. Me të vërtetë shumë mbresëlënëse kjo praktikë, e cila njëkohësisht tregon edhe qytetarinë e institucionalizimin që vakëfi kishte arritur në atë kohë në vendin tonë.

Megjithatë, në fillim të shekullit 20, roli i vakëfit në Shqipëri dhe pothuajse në të gjitha vendet Islame hyri në një periudhë rënieje drastike. Vendi ynë e ka kaluar këtë periudhë ndoshta në formën më të egër të mundshme. Aplikimi i sistemit komunist dhe ateist në Shqipëri bëri një çrrënjosje të pamëshirshme ndaj çdo gjëje fetare. Kulmi arriti në vitin 1967 ku sistemi famëkeq ndaloi

përfundimisht fenë, duke rrënuar objektet e kultit dhe sekuestruar të gjitha pronat vakëf të komuniteteve fetare. Edhe sot e kësaj dite, në më shumë se 30 vite demokraci, akoma fati i humbur i vakëfeve mbetet nëpër dyert e gjykatave me shumë dosje nëpër duar. Gjithsesi kjo histori famëkeqe që ka ndodhur, nuk duhet të nxisë pesimizmin, përkundrazi duhet t'i nxisë besimtarët e drejtuesit e tyre drejt formimit dhe ndërtimit të vakëfeve të reja.

Për të kuptuar vakëfin dhe rolin e tij në Islam, mjafton që ne të gërmojmë në historinë e vakëfeve në Botën Islame, nga ku do të fillojmë të kuptojmë edhe arsyet për rënien e vakëfit në ditët e sotme, e më pas për të kuptuar nevojën e tij për reformim.

### **Historia dhe roli i krijimi të vakëfit në Islam**

Në historinë islame mund të shohim imazhe të shkëlqyera dhe mësim të dobishme për statusin e vakëfit dhe ndikimin e tij në mbështetjen e zhvillimit të bashkësisë myslimane. Vakëfi zuri vend në kulturën e myslimanëve, u ngulit në të gjitha sferat e jetës dhe ka kontribuar në shërbimin e publikut në fusha zhvillimore nga me të ndryshmet. Vakëfi gjithashtu është bërë një burim financimi për myslimanët gjatë shekujve. Për shembull, për shkak të dhuratave të

mëdha vakëfnore të bëra nga Profeti (paqja qoftë mbi të) dhe shokët e tij, vakëfet mbulonin pothuajse të gjitha nevojat e jetës gjatë periudhës së hershme të civilizimit islam, duke përfshirë shëndetin, arsimin, infrastrukturën bazë, aktivitetet e biznesit dhe marrëdhëniet tregtare, krijimin e vendeve të punës, ofrimin e ushqimit për nevojtarët dhe bagëtinë, sigurimin e strehimit për të varfrit, mbështetjen e sektorëve bujqësorë dhe industrialë.

Koncepti i mirëfilltë i vakëfit teorik dhe praktik u formua gjatë jetës së Profetit (a.s.). Sa herë që Profeti (a.s.) identifikonte një nevojë në shoqërinë e tij, ai (a.s.) ose e përmbushte atë duke themeluar vakëf ose inkurajonte shokët e tij për ta përmbushur atë nëpërmjet krijimit të vakëfeve prej tyre. Kështu, myslimanët e dinin më së miri rëndësinë e vakëfit dhe e konkretizuan atë gjatë jetës së Profetit (a.s.), sepse Profeti vetë krijoi shumë vakëfe. Nevoja për solidaritet financiar dhe bashkëpunim shoqëror midis myslimanëve doli në periudhën e hershme të historisë islame, për shkak të shumë kërkesave dhe nevojave për “shtetin islam” të sapolindur. Profeti (a.s.) dhe shokët e tij punuan shumë për të gjetur burime të ardhurash për të përmbushur këto nevoja.

Myslimanët e mëparshëm nxituan në dhënien e më të mirës që patën dhe të zgjedhin bamirësinë më të mirë për ndërtimin e vendeve

adhurimore dhe institucioneve të tjera në shërbim të fesë e njeriut. Hz. Omeri (r.a.) pasi fitoi një pjesë toke në Hajber, erdhi te Profeti (a.s.) dhe pyeti se çfarë të bëjë me të. Profeti (a.s.) e këshilloi atë për ta bërë një “vakëf”. Në të vërtetë, pothuajse të gjithë sahabët e të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga sahabët e Bedrit, Muhaxhirët dhe Ensarët kanë lënë vakëfe nga ajo që ata fitonin. Epoka e kalifëve ishte epoka më e mirë islame pas epokës së Profetit (a.s.), ku njerëzit morën pjesë në aktivizimin e vakëfeve dhe bamirësive të ndryshme.

### **Vakëfi në ndërtimin e qytetërimit islam**

Vakëfi është një aspekt i rëndësishëm i historisë islame, një arritje e madhe për unitetin e umetit, një shprehje e thellë e mendimit dhe kulturës së myslimanëve. Është një lëvizje efektive e shoqërive islame dhe një fuqi e drejtpërdrejtë e tyre. Vakëfi është një nga aspektet më të rëndësishme të qytetërimit islam, është një themel që shpreh vullnetin e sensit të thellë mysliman dhe të solidaritetit me bashkësinë myslimane.

Në të vërtetë, rritja e vakëfeve në botën myslimane mund t'i atribuohet një numri faktorësh. Besimi i tyre dhe dëshira e fortë për bamirësi janë faktorë kyç që kanë çuar shumë njerëz që të bëjnë të paktën një pjesë

të pronës së tyre si një vakëf.

Studiuesit e qytetërimit islam janë befasuar nga efekti i madh që ka pasur vakëfi në jetën e myslimanëve, si në teori ashtu edhe në praktikë.

Një lexues i historisë islame do të zbulojë lehtë se vakëfi përfaqëson elementë të rëndësishëm në ndërtimin e shoqërisë dhe individit.

Vakëfi gjithashtu luajti një rol të madh në arritjet shkencore dhe kulturore të vendeve islame. Mund t'i përmendim disa nga këto arritje kryesore si më poshtë:

- Shpërndarja e njohurive, ndërtimi i shkollave, xhamive, bibliotekave publike, katedrave për të mësuar përmendësh Kur'anin e Shenjtë edhe duke paguar për shpenzimet e nxënësve.

- Formimi i laboratorëve astronomikë, laboratorëve të shkencës dhe spitaleve arsimore; për të mësuar mjekësinë, infermierinë dhe farmakologjinë.

- Ndërtimin e veprave publike në shërbim të njerëzve sipas nxitjes që Feja Islame bën, si ura, rrugë, çezma, puse uji, shtëpi për njerëzit në nevojë, etj.

- Vakëfi ka kontribuar gjithashtu në ruajtjen e parimeve të Islamit, avancimin e shoqërisë islame dhe përhapjen e Islamit.

- Parandalimin e prishjes morale të individit, familjes dhe mbarë shoqërisë në tërësi.

Vakëfi gjithashtu ndihmon në organizimin e jetës shoqërore

dhe ngre statusin e njerëzve të varfër, forcon të dobëtit, punëson të papunët dhe mbron jetën e nevojtarëve. Ai plotëson zgjerimin, përparimin dhe zhvillimin e umetit, duke mbështetur projekte në këto drejtime kuptimplote dhe mbi hulumtimet shkencore.

Megjithatë, pavarësisht rolit vendimtar që ka vakëfi, mund të themi se ka rreth tre shekuj që vakëfi ka humbur shkëlqimin e tij në botën myslimane dhe roli i vakëfit ka rënë ndjeshëm. Ne na duhet të shqyrtojmë arsyet e rënies së vakëfit dhe mënyrat për të reformuar dhe kthyer mbrapsht këtë rënie.

### **Arsyet e rënies në krijimit e vakëfeve të reja dhe ringritja po nga të njëjtat shkallë**

Është fakt që vakëfi ka një rënie të ndjeshme në kohën tonë. Kjo është e kuptueshme dhe e ndjeshme nga të gjithë, si nga ata që janë të angazhuar drejtpërsëdrejti me vakëfet, por edhe nga ata besimtarë prej të cilëve pritët të japin më shumë kontribut në drejtim të formimit të vakëfeve të reja.

Për fat të keq, roli i vakëfit është zbehur shumë nga shoqëria myslimane dhe sot, ne si shoqëri, jemi në nevojë urgjente të kësaj praktike.

Ndoshta dobësia jonë, ndoshta egërsia përçarëse e armiqve, ndoshta të dyja bashkë, këtë nuk mund ta

themi me siguri, por një gjë duket shumë qartë, që akoma vakëfet në botën islame janë në gjendje të mjerueshme. Pronat aktuale vakëf janë akoma pjesë e përtacisë, neglizhencës dhe joproduktivitetit në pothuajse të gjitha shoqëritë myslimane. Për më tepër, kjo bën që, si rrjedhojë, roli i vakëfit në shoqëritë myslimane të bjerë në mënyrë drastike.

Autoritetet studiuuese vakëfnore të kohëve të sotshme, njëzëri japin alarmin dhe deklarojnë se: “Ne duhet të ndryshojmë një çast e më parë një pjesë të kulturës negative që godet bashkësinë myslimane dhe të ringjallim konceptin vakëf përsëri në shoqërinë tonë.”

Në të gjitha studimet dhe hulumtimet që janë bërë nga ekspertë të ndryshëm, në lidhje me praktikën e vakëfit, është arritur në përfundimin se tre janë elementët kryesorë të cilët formojnë dinamikën e vakëfit.

**1.** Transparenca me fondet, është elementi i parë që ndikon në motivimin e besimtarëve në formimin e vakëfeve të reja. Nëse ky element mungon, sado e madhe qoftë përpjekja, nuk do të ketë ndonjë rezultat domethënës. Në qoftë se myslimanët kanë organizim të mirë, administratorë të vakëfeve (myteveli<sup>9</sup>, me terminologjinë

9. “Myteveli” - person përgjegjës, sipërmarrës mbi kujdesin dhe menaxhimin e vakëfit.

islame) me integritet e moral të lartë, atëherë do të shikojmë që donatorët do të jenë më dashamirës dhe kontribuues në dhurimin dhe formimin e vakëfeve të reja.

**2.** Riformulimi i mënyrës së menaxhimit të vakëfeve dhe hartimi i një rrjeti të integruar që të studiojë problemet që hasen në praktikën aktuale në të cilën gjendemi, është gjithashtu element kryesor në zhvillimin e vakëfeve. Duke lehtësuar ngërçet praktike të së shkuarës dhe duke nxitur praktika të reja në mënyrën e menaxhimit të vakëfeve, realisht mund të shpresojmë në rigjallërimin e praktikave të menaxhimit të vakëfeve. Menaxhimi i duhur dhe përkujdesja e vakëfeve mund të bëhet një burim vërtetë i madh i të ardhurave për myslimanët.

**3.** Planifikimi dhe udhëzimi legjislativ i vakëfit. Ky element i tretë është komplet një dinamikë e veçantë. Një dinamikë që ka të bëjë me perspektivën e vakëfit. Sa më shumë që e zhvillojmë këtë, aq më shumë kjo do të bëhet e ndjeshme ndaj progresit. Prandaj është e nevojshme të planifikojmë mënyrat e menaxhimit të vakëfit si dhe investimet e aseteve të tij, duke i dhënë hapësirën e duhur ekspertëve të fushave financiare, juridike dhe të njohjes së dinamikave të pronave. Përpjekjet për të rinovuar mekanizmat e investimeve vakëf ndihmojnë në



lulëzimin, zhvillimin, kthimin dhe rritjen e financimit nga vakëfet.

Sipas studiuesve në fushën e vakëfeve dhe financave islame, çdo përpjekje për të ringjallur vakëfet kërkon riformulim të konceptit menaxhues. Përveç kësaj, ringjallja e vakëfeve kërkon një rrjet të integruar të çështjeve shkencore teologjike dhe problemeve që hasen gjatë monitorimeve në terrenin praktik të vakëfit.

Përveç të gjithave, mënyra më e rëndësishme për t'u përballur me sfidën e rënies së vakëfit është përhapja e vetëdijes fetare në mesin e kombit, duke ringjallur ndjenjën fetare të solidaritetit. Ringjalljen e këshillave të jurisprudencës islame në mesin e besimtarëve, duke transmetuar rrugën e të qenët njerëz të mirë, të dobishëm për shoqërinë tonë, duke aplikuar shariatën në menaxhimin e vakëfeve dhe duke studiuar një plan efektiv ekonomik, që do të kujdeset për vakëfet e myslimanëve, e duke zbatuar format ekonomike më të volitshme për zhvillimin maksimal të tyre. Dhe, më në fund, të dyja palët, si vakëflënësi ashtu edhe menaxheri i vakëfit do të harmonizohen në zhvillimin maksimal të vakëfeve, duke formuar kështu modelin vakëf të ëndërruar mes nesh.

Në fund të fundit, a nuk vërtitet filozofia e vakëfit rreth formimit të një individi të mirë që është reformuar në vetvete,

në marrëdhënie me të tjerët, në lidhjet dhe aktivitetet e tij? Kështu, roli i vakëfit nuk është i kufizuar vetëm në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për individin apo nevojën e një grupi shoqëror, por edhe për vendosjen e lidhjeve të tyre përkatëse, duke vlerësuar marrëdhëniet e tyre dhe duke racionalizuar ndërveprimet midis tyre.

Përveç kësaj, vakëfi ofron një model të vazhdueshëm për dhënien dhe zhvillime të mëtejshme. Duke u kujdesur së pari për ekzistencën e institucioneve vakëf, më pas duke mbrojtur e investuar fondet e vakëfeve, pastaj duke bërë shpërndarjen e fitimit sipas kushteve të dhënies nga vakëflënësi e duke parë nevojat e komunitetit të besimtarëve dhe më së fundi promovimin e profesionistëve me sjellje dhe vlera etike profesionale, vakëfi rifiton dimensionet e tij në shoqërinë myslimane.

Vlen të përmendim këtu, në lidhje me tematikën tonë, që një shtysë shumë e madhe dhe efikase në formimin e vakëfeve nga biznesmenë myslimanë do të ishte edhe njohja e donacionit drejt komuniteteve fetare nga shteti si zbritje nga taksat e tyre. Praktikë e cila gjendet në disa shtete, islame ose joislame, por kjo lloj praktike shumë e vlefshme dhe shumë efikase rezulton akoma të jetë e panjohur në vendin tonë.

## Përfundim

Vakëfi është një akt unik i paraqitur nga Islami. Ai ka luajtur rol të rëndësishëm socio-ekonomik, kulturor dhe fetar gjatë gjithë historisë së qytetërimit islam. Në të kaluarën, mbledhja e një numri të madh të vakëfeve krijoi pasuri të madhe për komunitetin mysliman. Megjithatë, për shkak të arsyeve dhe ngjarjeve të ndryshme historike, roli i vakëfeve, si një mjet i dobishëm për zhvillimin socio-ekonomik, në përgjithësi është dëmtuar, është lënë pas dore dhe shpesh është harruar. Pa dyshim, siç u përmend edhe më lart, studiuesit mund të shohin se si vakëfi ka kontribuar në mirëqenien e njerëzve në fusha të ndryshme të zhvillimit, të tilla si arsimi, shëndetësia dhe shërbime të tjera. Por, sidoqoftë, në kohën e sotme, roli i vakëfit ka rënë ndjeshëm, dhe për këtë gjithsecili ka përgjegjësinë për të bërë më shumë në ringritjen e institucionit dhe kulturës vakëfnore.

Këtu përmendëm shkurt arsyet e rënies së vakëfit dhe nevojën tonë për ta reformuar atë. Komunizmi fillimisht dhe demokracia pa krye më pas, patën një ndikim rrënjësor

në dëmtimin e strukturës së vakëfit në vendin tonë edhe në shumicën e vendeve myslimane. Gjithashtu dhe menaxhimi i dobët i tyre çoi në rënien e vetë vakëfit. Kështu, ringjallja e vakëfeve kërkon që të gjithë ata të cilët mund të menaxhojnë vakëfet apo fondet, të forcojnë transparencën, të bëjnë riformulimin e menaxhimit të vakëfeve dhe një planifikim të mirëfilltë që ka të bëjë me perspektivën e vakëfit. Një rrjet të integruar praktik që monitoron çështjet dhe problemet që has vakëfi në epokën moderne.

## Shënim

Ky studim jep disa kontribute praktike mbi hulumtimin e praktikave të vakëfit, duke identifikuar faktorët që kanë kontribuar në rënien e vakëfit dhe mënyrat për ta ringritur atë, duke u nisur nga praktika e përditshmërisë me vakëfet.

Unë shpresoj që ky dorëshkrim të vlejë si një diskutim dhe nxitje, së pari për mua dhe kolegët e mi, të cilët merren në përditshmërinë e tyre me praktikën vakëfnore, por sigurisht edhe për këdo që është i interesuar për një këndvështrim modest mbi vakëfin.

# Bediuzzaman Said Nursi

## Mrekullia e kohës

### I

**Dorian Demetja**  
**Drejtoria e Kulturës**  
**Komuniteti Mysliman i Shqipërisë**

#### Hyrje

**B**ediuzzaman Said Nursi ishte dijetar i një kalibri të lartë me origjinë kurde, lindur më 1878 në Turqinë Lindore. Ai jetoi në dekadat e fundit të Perandorisë Osmane, përjetoi rrëzimin dhe copëtimin e saj pas Luftës së Parë Botërore, si dhe jetoi edhe 37 vjet pas formimit të Republikës Turke më 1923. Të qenët gjatë gjithë jetës dhe misionit të tij si një person me gradë të lartë shpirtërore, ishte rezultat i të vepruarit në përputhje me Kur'anin e Sunetin, si dhe të respektimit të arsyes e logjikës. Ai i qëndroi besnik kauzës së tij me aq fisnikëri, sa që nuk kërkonte asgjë tjetër, përveç

mundësisë për të plotësuar nevojat minimale për mbijetesë. Shumë botime dhe konferenca i janë kushtuar cilësive të dallueshme të Bediuzzamanit, si devotshmëria ndaj idealeve të larta, perceptimi i tij i thellë për botën e sotme, thjeshtësia, humanizmi gjithëpërfshirës, besnikëria ndaj shokëve të tij, dëlirësia, modestia, përulësia dhe mjaftueshmëria me pak.

Bediuzzaman Said Nursi gjatë gjithë jetës është ndeshur me sprova nga më të vështirat, kjo për arsye se ai u ballafaqua dhe u përpoq të ndeshet me anarkinë, e cila bazohej në mosbesim dhe ateizëm, duke e përkufizuar atë si problemin më domethënës që kishte nevojë të zgjidhej urgjentisht. Ai jetoi në

një kohë, kur një pjesë e mirë e njerëzimit ishte zhytur në ateizëm, për shkak të abuzimit me shkencën e filozofinë, dhe kur truri shpëlahej me komunizëm. Ai urrente mosbesimin, tiraninë dhe largimin nga feja, ndaj edhe luftoi fort kundër despotizmit. Ai thotë: *“Para meje është një zjarr i madh. Flakët e tij po arrijnë në kupë të qiellit. Në atë zjarr po më digjet fëmija im, besimi më ka marrë flakë. Po vrapoj që ta shuaj atë zjarr dhe të shpëtoj besimin. Dikush ma pengon këmbën në rrugë, ç’rëndeësi ka? Përballë këtij zjarri të madh, a ka vlerë kjo ngjarje e vogël?! Mendime të cinguar! Pikëpamje të ngushta!...”*<sup>1</sup>

Bediuzzamani analizoi tre faktorë madhorë që kishin të bënin me thelbin e problemeve të atëhershme, por që mbetën të tillë edhe në kohën tonë: Injoranca në sensin e indiferencës ndaj Zotit dhe Profetit, varfëria dhe përçarja shoqërore. Bediuzzaman ia kushtoi jetën luftës ndaj këtij virusi fatal. Në syrin e tij, shpresa e shpëtimit për umetin do të ishte e kotë, përderisa ideologjitë e rreme e të devijuara do të mbizotëronin dhe derisa shoqëria të mos ndriçohej me dritën e të mësuarit, dijes dhe mendimit sistematik. Ai i frymëzoi brezat e rinj me sihariqin e rilindjes dhe i udhëhoqi ata drejt shtigjeve

që të shpinin te mendimi islam. Ai gjithmonë i referohej dijes dhe aktivizimit të mendjes, punonte shumë për lindjen e një shoqërie të përsosur e të shëndoshë. Për arritjen e një ideali të tillë, Bediuzzamani mendonte se edukimi përbënte udhërrëfyesin kryesor, tek i cili do të përfshiheshin xhamitë, shkollat, garnizonet, rrugët, këndet e lojërave, madje edhe burgjet.

Bediuzzamani shkroi shumë libra, por në fokus ishin veprat e titulluara *“Risale-i Nur”* (Mesazhet e Dritës). Ato janë fryt i përpjekjeve serioze, të cilat shpjegojnë dhe i paraqesin njeriut të sotëm parimet bazë të besimit dhe të vërtetat e Kur’anit. Vetë Bediuzzamani në një ligjëratë u shpreh: *“Tani unë e shoh qartë se pjesa më e madhe e jetës sime është komanduar e drejtuar jashtë aftësisë së perceptimit tim, që do të nxirrte këto mesazhe për t’i shërbyer çështjes së Kur’anit, thua se e gjithë jeta ime si studiuës, të kishte kaluar në parapërgatitjen për këto shkrime, të cilat demonstrojnë mrekullinë e Kur’anit.”*<sup>2</sup>

Në shekujt e XIX-të dhe XX-të, sulmet ndaj themeleve të besimit të ndërmarra nga materialistët, ateistët e të tjerët, në emër të shkencës e progresit, e bënë Bediuzzamanin që të kuptonte nevojën urgjente e themelore, e cila konsistonte në

---

1. Dr. Ramazan Ballxhë, *Jeta dhe vepra e këshilltarit të shekullit Bediuzzaman Nursiut*, përktheu Abdykadir Haktanër, shtëpia botuese “Gelenek”, Stamboll 2003, f. 281.

---

2. Bediuzzaman Said Nursi, *Sözler - Fjalët, Nga Koleksioni i Risale-i Nurit*, Sözler Neşriyat. Shqipëroi nga arabishtja Jusuf Salkurti, İstanbul 2006, f. 4.

ruajtjen dhe forcimin e besimit. Metoda e tij analizon besimin e mosbesimin dhe demonstroi përmes argumenteve të qarta logjike se, duke ndjekur metodën e Kur'anit, jo vetëm që është e mundur t'i provosh në mënyrë të arsyeshme të gjitha të vërtetat e besimit, por demonstroi gjithashtu, se këto të vërteta kanë të vetmin shpjegim racional për ekzistencën, njeriun dhe universin. Me këtë metodë që zhvilloi, Bediuzzamani i shpjegoi të vërtetat e besimit me një gjuhë që mund të kuptohet nga njerëzit e të gjitha shtresave, duke paraqitur unitetin e mendjes, zemrës dhe ndjenjave. Kështu, duke ndërthurur teologjinë, misticizmin dhe shkencat pozitive, ai paraqiti një perspektivë krejt të re dhe synoi të eliminonte ndarjen e shkollës, medresesë dhe teqesë. Veprat e tij janë lexuar vazhdimisht me mjaft kujdes, me ndjenja të sigjerta vlerësimi dhe do të vazhdojnë të jenë të një rëndësie të veçantë sa më shumë që kalon koha.

Bediuzzamani besoi se burimi, shkaku i problemeve të njeriut në kohën e sotme me të cilat përballëj bota islame, do të mund të kurohej, në mënyrë të veçantë, vetëm nëpërmjet përtëritjes së besimit. Kështu, Bediuzzamani u ktheu shpinën politikave të kohës dhe ia kushtoi të gjithë përpjekjen e tij këtij qëllimi. Me njohjen e thellë të shkencave fetare dhe moderne, rruga e re për tek e vërteta, që Bediuzzamani hapi me

veprat e “Risale-i Nurit”, ishte aq e suksesshme në ruajtjen dhe forcimin e besimit, saqë ai u pranua nga shumë personalitete të ishte ripërtëritësi i fesë, premtuar nga Profeti Muhamed (a.s.) se do të vinte në çdo shekull në hadithin e mirënjohur: “*Pa dyshim që Allahu do t'i dërgojë këtij umeti në çdo fillim shekulli një muxhbedid, i cili do të ripërtërijë çështjet e fesë.*”<sup>3</sup>

### **JETËSHKRIMI I BEDIUZZAMAN SAID NURSI'së**

Said Nursiu lindi në vitin 1878 (1293 Rumi dhe 1295 Hixhri) në një familje të thjeshtë, në fshatin Nurs<sup>4</sup>, nënprefektura Hizan e qytetit Bitlis, një nga qytetet e hershëm të Anadollit. Duke qenë se kishte lindur në fshatin Nurs, ai thirrej Said Nursi, pra “Saidi nga fshati Nurs”. Kjo, sepse në atë kohë nuk kishte mbiemra dhe njerëzit përmendeshin ose me emrat e baballarëve ose në bazë të disa cilësive. Pas formimit të Republikës së Turqisë, atij i është dhënë mbiemri “Okur”, mbiemër ky që nuk është përdorur. Gjithashtu, duke qenë me origjinë kurde, ai është njohur edhe me llogarin Said-i Kurdi. Nënën e Saidit e quanin

3. Ebu Daud, Melahim 1, nr. 4291. E Saktëson Es-Sekhau në “El-Mekasid el-hasene”, nr. 149 dhe Albani në “Es-Silsiletu es-sahiha”, nr. 599; El-Hakim, “El-Mustedrek”, 4:522; El-Munau, “Fejdu'l-Kadir”, 2:281, nr. 1845.

4. Një fshat i përbërë prej 20 shtëpiash.

Nurije, kurse babanë, Mirza. Saidi ishte i katërti prej shtatë fëmijëve. Dy më të mëdhenjtë ishin vajza, Durrije dhe Hanëm, pastaj erdhi në jetë vëllai i tij më i madh, Abdullahu. Saidi u pasua edhe nga dy djem të tjerë, Mehmedi dhe Abdulmexhidi, si dhe në fund erdhi një vajzë në familjen e tyre që quhej Merxhan. Prindërit e Saidit ishin njerëz shumë të devotshëm dhe të virtytshëm. Babai i tij Mirza, vdiq në vitin 1920, kurse e ëma, Nurija, vdiq gjatë luftës së Parë Botërore dhe të dy gjenden të varrosur në fshatin Nurs. Në vitet e mëvonshme, Saidi Nursi, për ta, do të thoshte: *“Nga nëna ime mësova mëshirën dhe dbembshurinë, kurse nga babai im mësova rregullin dhe disiplinën.”*<sup>5</sup>

### PERIUDHA E SAIDIT TË VJETËR (1878-1918)

Është me rëndësi të theksohet se këtë emërtim e ka përdorur vetë Bediuzzamani në veprat e tij, duke e quajtur periudhën e parë të jetës “Saidi i Vjetër”. Periudhën e dytë të jetës së tij e ka emërtuar “Saidi i Ri”, ndërsa dhjetë vitet e fundit të jetës i ka quajtur “Saidi i Tretë”.

Ditët e fëmijërisë, deri në moshën 9 - vjeçare, Saidi i ka kaluar pranë familjes. Vëllai i tij, Abdullahu, ishte jashtë qytetit me studime. Kur

krahasonte vëllain me shokët e tjerë, Saidi shikonte se si studimet e kishin kompletuar atë me dituri dhe me disa cilësi të bukura. Epërsia e vëllait e vetëkuptueshme, zgjoi te Saidi një dëshirë të fortë dhe një zell të madh për studime. Për arsye se në fshat nuk kishte ndonjë medrese, ai mësimin e përgatiste vetë, për t’ia treguar vëllait që vinte një herë në javë në shtëpi, për të vizituar prindërit. Saidi i vogël ishte ambicioz e këmbëngulës deri në fund për të kryer detyrat. Ai i kapërcente me guxim pengesat e vështirësitë dhe karakterizohej nga një shpirt luftarak. Jo pak herë kapej me shokët e tij, po ashtu edhe me ata më të mëdhenj. Por kjo nuk buronte nga ndonjë e metë, por ngaqë shpirti i tij i madh, akoma nuk po gjente një rrugë dhe mënyrë për të shprehur vetveten. Le të shohim se si në vitet e mëvonshme Bediuzzamani e përshkruan veten e tij në këtë moshë: *“Kur isha dhjetë vjeç, kisha një krenari të madhe brenda vetes sime, gjë e cila ndonjëherë mori formën e mburrjes dhe të vetëlavdërimit. Megjithëse unë vetë nuk doja, merrja pamjen e dikujt që ndërmerrte ndonjë vepër të madhe dhe të ndonjë akti të madh heroizmi. Unë thosha me vete: Ti nuk vlen asnjë grosh, cila është arsyeja për këtë mburrje e vetëlavdërim të tepërt, veçanërisht kur ajo vinte te guximi?! Unë nuk e dija dhe çuditesha për këtë. Pastaj, para një ose dy muajsh (viti 1944), pyetja mori përgjigje: ‘Risale-i Nuri’ (vepra e tij Mesazhet e Dritës) po e bënte veten të ndihej para se të shkruhej: Megjithëse ti*

5. Bediuzzaman Said Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, shqipëroi Jusuf Salkurti, Sözlür Neşriyat, İstanbul 2010, f. 16.

*ishe një bërthamë si një asbkël e zakonshme druri, ti kishe një parandjenjë të atyre frutave të Parajsës, sikur ato të ishin në të vërtetë prona jote dhe mburreshe e lavdëroje veten tënde.”<sup>6</sup>*

Një herë, në një ditë dimri, pa në ëndërr Ditën e Kiametit dhe ringjalljen që po ndodhte. Saidi ndjeu një dëshirë për të vizituar profetin Muhamed (a.s.) Ndërsa ishte kureshtar dhe donte të dinte se si do të mund ta arrinte këtë, mendoj që të shkonte e të ulej pranë Urës së Siratit, sepse të gjithë do të kalonin sipër saj. Kur Profeti (a.s.) do të jetë duke kaluar, mendoj ai, unë do ta takoj dhe do t'i puth dorën. Prandaj, ai shkoi dhe u ul pranë Urës dhe atje u takua me të gjithë Profetët dhe ua puthi duart. Më në fund, profeti Muhamed (a.s.) erdhi. Saidi ia puthi dorën dhe kërkoi dituri prej tij. Profeti i tha: “Dituria e Kur’anit do të të jepet ty, me kusht që ti të mos u bësh pyetje asnjërit prej umetit tim”.

### **Në rrugën drejt ditorisë**

Zelli i madh që kishte Saidi për dituri, e shtyu atë të merrte leje nga i ati dhe të vazhdojë studimet në krahina të ndryshme të vendit. Në fillim, në vitin 1886 shkon në Medresenë e mësuesit Muhamed Emini. Prej aty shkon në Medresenë

e njohur të Hasan Veliut dhe pastaj në Medresenë Tag, në të cilat qëndron pak kohë. Saidi i kuptonte mësimet shumë shpejt, mirëpo mësuesit e tij nuk dëshironin që të kapërcente mësimet dhe kjo gjendje bëri që ai të ndryshojë shpesh mësuesit. Në kërkim të një medreseje të përshtatshme për veten, Saidi shkon në Bejazid të qytetit Erzurum, ku studimet e tij do të thelloheshin më tepër. Deri në këtë kohë, ai kishte studiuar rregullat e gramatikës dhe të sintaksës arabe. Në Bajezid, Saidi i kreu studimet te mësuesi Mehmet Xhelal Efendiu. Ai i mbaron aty studimet në vitin 1892 mbi themelet dhe përmbledhjet e shkencave të fesë për 3 muaj pa ndërprerje, ku nëpër medrese zgjasnin me periudha të gjata. Ishte zhytur aq shumë në mësim, saqë nuk merrej fare me jetën e përditshme. Mënyra e leximit të këtyre librave prej tij, është një rinovim për metodikën e medreseve, sepse në ato kohë, nxënësit i mësonin librat që i jepte shkolla fjalë për fjalë nga mësuesit, metodikë e cila zgjaste 15 vjet. Kurse metoda e Saidit ishte që brenda disa mësimëve, nxënësi të mësojë nga mësuesit çelësin e të gjithë librave, pastaj me punën e tij të plotësojë dijet e veta. Kështu, arsimi edhe do të ecë shpejt, edhe nxënësit do t'i shtohet besimi te vetja. Reforma metodike e Saidit që në moshën 14-vjeçare, do ta ndiqte atë për gjatë gjithë jetës. Kjo metodë e jashtëzakonshme e tij, do të

6. Nursi, *po aty*, f. 18-19; Bediuzzaman Said Nursi, *Emirdag Labikası-II, Risale-i Nur Külliyyatından (Lügatli, Kaynaklı, İndeksli)*, Söz BasımYayın, İstanbul 2012, f. 52.

përbënte hallkën e parë të zinxhirit të mirësive që do të hidhte themelet e një ideali të së ardhmes. Pasi mori diplomën në Medresenë e Mehmet Xhelal Efendiut, ai vazhdoi rrugën në kërkimin e mëtejshëm të diturisë. Saidi shkoi në qytetin Shirvan, ku studionte vëllai i tij, Abdullahu, i cili e pyeti Saidin se ku kishte qenë e çfarë kishte mësuar dhe, për të provuar diturinë e tij, i bëri pyetje të ndryshme. Abdullahu kur e provoi vëllain e vet, u çudit jashtëzakonisht shumë kur pa se në ç’nivel ishte ngjitur Saidi dhe, megjithëse para tetë muajsh ai kishte qenë nxënësi i tij, që nga ai çast e pranoi Saidin si mësuesin e vet.

### Marrja e epitetit “Bediuzzaman”

Po në vitin 1892, pasi qëndroi për një kohë të shkurtër pranë vëllait të tij Abdullahut, Saidi shkoi në qytetin Siirt. Aty hyri në Medresenë e mësuesit dhe dijetarit të njohur të zonës, Fet’hullahut. Ai, për çdo libër që e pyeste Saidin, përballej me të njëjtën përgjigje “e kam përfunduar”. Mësuesi mbeti i mahnitur dhe s’mund ta besonte se si ka mundësi që të mbarohen të gjitha këto libra për një kohë kaq të shkurtër. Me këtë rast, mësuesi i tha Saidit: “S’ka dyshim se ti zotëron një zgjuarsi gjeniale, por ta provojmë se si je në kujtesë. Ta shohim a do të mundesh të mbash mend me dy lexime disa

rreshta nga ‘Makamati Harije!’”<sup>7</sup>. Saidi me një të lexuar të një faqeje të librit, e mësonte atë përmendësh. Mësuesi Fet’hullah, duke shprehur habinë e tij tha: “Të gjenden të dyja bashkë, intelijenca me kujtesën, në një mënyrë tepër të zhvilluar tek një person i vetëm, është vërtetë e rrallë!”. Saidi gjatë qëndrimit në medresenë e tij, mësoi përmendësh librin “Xhem’ul-Xheuami”<sup>8</sup> për një javë, me dy orë punë në ditë. Pas kësaj, mësuesi Fet’hullah shkruan në arabisht këto fjalë mbi libër: “Të gjithë librin Xhem’ul-Xheuami e mësoi përmendësh brenda një jave.”

Kjo ngjarje dhe fama e tij u përhap shumë. Dijetari Fet’hullah njoftoi dijetarët më të shquar të zonës: “Në medresenë tonë ka ardhur një nxënës shumë i ri. Për çfarëdo që ta pyes, më jep përgjigje menjëherë. Është për t’u çuditur që në këtë moshë ka këtë logjikë dhe kujtesë!”. Pas kësaj, dijetarët vendosën ta thërrasin Saidin për ta provuar. Ata morën përgjigjet e të gjitha pyetjeve të tyre pa asnjë mëdyshje në çdo fushë të fesë. Saidi përgjigjej duke shikuar mësuesin e tij, sikur po i lexonte nga libri. Dijetarët u përballen me një të ri gjenial, të cilët e vlerësuan dhe e respektuan

7. Libër i shkruar me figura letrare nga poeti i famshëm Ali Hariri, i cili vdiq në vitin 665 hixhri.

8. Libër që përmban parimet e Fikhut, jurisprudencës së katër medh’hebeve të Islamit, shkruar nga dijetari shafi, Ibnu’l Subki.



jashtëzakonisht. Kështu, dijetarët i japin Saidit epitetin “Bediuzzaman” (Mrekullia e kohës). Por fillimisht këtë epitet ia ka dhënë mësuesi i tij, Fet’hullahu.

Ndërsa në një vepër të mëvonshme Saidi ka shkruar: “Unë tani e kuptoj se emri Bediuzzaman, i cili m’u dha para shumë viteve, megjithëse nuk isha i denjë për të, nuk ishte i imi askund. Më saktë, ai ishte një emër i ‘Risale-i Nurit’. Ai i ishte bashkëngjitur interpretuesit të dukshëm të ‘Risale-i Nurit’ përkohësisht si një besim, amanet.”<sup>9</sup>

### Rinia e Bediuzzamanit në Bitlis dhe Van

Kur Bediuzzamani shkoi në qytetin e Bitlisit, u miqësua shumë me prefektin e qytetit, Omer Pashain. Megjithëse në moshë të re, prefekti vuri re te Bediuzzamani një inteligjencë të jashtëzakonshme dhe virtyte shumë të bukura. Për këtë arsye, ai kërkoi prej Bediuzzamani të banojë në shtëpinë e tij dhe të merret me studime. Bediuzzamani qëndroi aty afërsisht 2 vjet dhe studioi shumë nga shkencat bashkëkohore, duke konstatuar njëkohësisht armët e armiqve që sulmojnë fenë me futjen e dyshimeve. Kështu, ai brenda 2 viteve mësoi përmendësh 40 libra, të cilat përbëheshin nga komentet e Kur’anit, librat e filozofisë islame, librat e shkencave të ndryshme,

9. Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, f. 45.

gramatikë, morfologji, logjikë, etj.

Bashkëshortja e Omer Pashës kishte vdekur dhe ai kishte gjashtë vajza. Në një vepër të mëvonshme, Bediuzzamani do të shprehet: “Kur isha rreth 20 vjeç, unë qëndrova për 2 vjet në banesën e prefektit të Bitlisit, Omer Pasha, me insistimin e tij dhe për shkak të respektit të tij për dijen. Ai kishte gjashtë vajza. Tre prej tyre ishin të vogla dhe tri të tjerat të mëdha. Megjithëse unë qëndrova në të njëjtën shtëpi me to për 2 vjet, nuk mund t’i dalloja dot nga njëra-tjetra tri të mëdhatë. Unë u jepja shumë pak vëmendje, si do të kishta mundur?! Një i ditur erdhi e qëndroi bashkë me mua si mysafir. Brenda dy ditëve i njohu ato, si dhe mundi t’i dallonte njëren nga tjetra. Ato ishin të gjitha të ngatërruara në syrin tim, dhe ai më pyeti: ‘Përse nuk i shikon ato?’ Unë iu përgjigja: ‘Ruajtja e dinjitetit të dijes nuk më lejon t’i shoh ato.’”<sup>10</sup>

Në të njëjtën periudhë, filloi të mësojë përmendësh Kur’anin, duke lexuar nga 40 faqe në ditë dhe duke mësuar pjesën më të madhe të tij, por pastaj e ndërpreu për dy arsye: E para, ishte se e quante mungesë respekti leximin e shpejtë të Kur’anit, dhe e dyta, ishte i mendimit se nevojë e domosdoshme është kuptimi dhe të vërtetat e Kur’anit, sesa mësimi përmendësh i tij. Për këto arsye u përqendrua te librat në fushat e fesë islame dhe të shkencave të tjera që përmendëm më sipër, që t’i përdorë ato si çelës për të vërtetat e Kur’anit

10. Nursi, *po aty*, f. 41; Nursi, *Emirdag Labikası-II*, f. 257.

Famëlartë, që iu bë udhërrëfyes e mësues i tij.

Kur në vitin 1897, Bediuzzamani mori një ftesë nga prefekti i Vanit, Hasan Pasha, lë Bitlisin për të shkuar në qytetin e Vanit. Saidi qëndroi aty duke studiuar e dhënë mësim në Medresenë Horhor, si dhe duke rendur mes fiseve të zonës si një pajtues dhe burrë feje. Ai punonte me klanet dhe grupimet e kohës, duke i shtyrë ata që t'i hidhnin pas armiqësitë që kishin mes tyre dhe të pajtoheshin e të gjenin paqe me njëri-tjetrin. Këta njerëz nuk kishin mundur t'i pajtonin në atë kohë as organet shtetërore. Kur ishte në Van, Saidi qëndroi në fillim me prefektin, Hasan Pashën. Kur ky u largua, në vend të tij si prefekt i Vanit erdhi Tahir Pashë Shkodrani<sup>11</sup>. Me dëshirën e prefektit, Bediuzzamani qëndroi për një kohë të gjatë në banesën e tij. Tahir Pasha ishte dashamirës i dijetarëve dhe ndiqte me pasion zhvillimet e reja në shkencat moderne, për këtë, kishte formuar edhe një bibliotekë të pasur. Me lajmet dhe të rejat e vazhdueshme që i sillte Tahir Pasha në lidhje me ngjarjet në Evropë, Saidi përfitoi shumë. Tahir Pasha ishte zyrtari i parë shtetëror që kuptoi talentin e madh dhe potencialin e Bediuzzamanit dhe vazhdoi ta

11. Tahir Pashë Shkodrani është me origjinë shqiptare, lindur në Podgoricë më 1847. Ai ka qenë prefekt në Musul (Irak), Van dhe Bitlis.

inkurajonte e ta mbështeste atë, deri kur ndërroi jetë më 1913.

Duke qëndruar në banesën e prefektit, Tahir Pashës, Bediuzzamani pati rastin të përzihej me zyrtarët e qeverisë dhe të fillojë të lexojë gazetatat e revistat që siguroheshin në zyrën e prefektit, veçanërisht artikujt që kishin të bënin me Islamit dhe botën islame. Një ditë, Tahir Pasha i tregoi një artikull, ku një sekretar britanik për kolonitë kishte thënë në një gazetë: "...Sa kohë që myslimanët kanë Kur'anin, ne jemi të paaftë dhe të pafuqishëm që t'i sundojmë. Ne, ose duhet ta marrim atë prej tyre, ose t'i bëjmë ata ta humbasin dashurinë ndaj tij." Kërcënimet e qarta të sekretarit kolonial britanik ndaj Kur'anit dhe botës islame, shkaktuan zemërim dhe një revolucion në idetë e Bediuzzamanit, i cili deklaroi: "*Unë do të provoj dhe do të demonstroj për botën se, Kur'ani është një diell i pavdeksbëm dhe i pashuar!*"<sup>12</sup>

Pasi fitoi njohuri të shumta për çështjet dhe problemet me të cilat përballej shoqëria osmane dhe bota islame në përgjithësi, ai kuptoi se forma tradicionale e teologjisë islame nuk mjaftonte për t'iu përgjigjur dyshimeve që ishin ngritur lidhur me Islamit, dhe se studimi i shkencave natyrore e shoqërore ishte i domosdoshëm. Prandaj, duke përfituar nga lehtësitë, ai filloi vetë studimin e

12. Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, f. 52.

tyre, duke shtuar edhe 50 libra të tjerë në memorien e tij, kryesisht në fushat e historisë, gjeografisë, matematikës, gjeologjisë, fizikës, kimisë, astronomisë dhe filozofisë. Studimi i shkencave të ndryshme nga Bediuzzamani, duhet të shihet në kontekstin e rritjes së influencës perëndimore ndaj Perandorinë Osmane në fundin e shekullit të '19 dhe në fillimin e shekullit të '20, si dhe të sulmeve që i bëheshin Kur'anit e Islamit në emër të shkencës e materializmit, si dhe filozofisë pozitiviste në veçanti. Ai studim, ndër të tjera, ishte me qëllim për t'iu përgjigjur sulmeve.

Në një vend në veprat e tij, Bediuzzamani thotë: *“Kur isha i ri, duke qëndruar në banesën e Tahir Pashait në Van, i cili vetë më pati caktuar një dhomë, çdo natë para se të flija, dy orë e gjysmë i kaloja duke përsëritur librat që kisha mësuar përmendësh. Në këtë kohë, kam ditur përmendësh 90 libra. Për tre muaj mbaroja përsëritjen, duke punuar nga tre orë në natë. Vëllezër, e falënderoj shumë Allahun e Madhëruar që më dhuroi këtë fuqi, që të përpiqem për mbrojtjen e diturisë, të cilat shërbejnë si shkallë për të arritur në të vërtetat e Kur'anit Famëlartë. Unë në këtë mënyrë, munda të shoh se çdo ajet i Kur'anit, ka kapluar gjithësinë, pastaj, duke më mjaftuar Kur'ani, nuk ishte e nevojshme që të lexoj ndonjë libër tjetër...”*<sup>13</sup>

13. Ballxhë, *po aty*, f. 71.

### Plani për ndërtimin e universitetit “Medresetu’z-Zehra”

Bediuzzamani dëshironte të realizonte rinovimin e medreseve, ku të mësoheshin si lëndët fetare, ashtu edhe ato shkencore. Themeli i kësaj metode, ishte të kombinonte shkencat fetare me shkencat moderne, me qëllimin që shkencat pozitive do të mbështesnin e forconin të vërtetat e fesë. Bediuzzamani, tashmë ndiqte këtë metodë kur u jepte mësim studentëve të tij. Ai e kishte vënë re se një sistem i tillë edukimi, ishte i domosdoshëm jo vetëm për të luftuar përhapjen e injorancës dhe prapambetjen e vendit, por gjithashtu, ishte edhe një zgjidhje për problemet e tjera sociale e politike. Për këtë, kishte në plan të ndërtonte një universitet me qendër në Bitlis dhe me dy filiale, njërin në Van dhe tjetrin në Dijerbakër. Atë do ta emëronte Medresetu’z-Zehra, e cila do të funksiononte në tri gjuhë, me arabishten dhe turqishten si gjuhë e detyruar dhe gjuhën kurde si gjuhë me zgjedhje.

Pasi bisedoi me prefektin e Vanit, Tahir Pashë Shkodranin, ai, në vitin 1907, u nis për në Stamboll, për të folur në lidhje me këtë plan, por edhe të tjera, me sultan Abdulhamidin e dytë. Nga ana tjetër, Tahir Pashai, i cili i kishte dalë gjithmonë në krah Saidit, i shkruan sultanit një letër, në të cilën flet gjerë e gjatë për vlerat e Bediuzzamanit

dhe mundësinë e ndihmesës. Gjatë rrugës, Bediuzzamani ndaloi në një medrese dhe kur mësuesi i saj e pyeti për udhëtimin, ai iu përgjigj: “Unë jam duke shëtitur Anadollin për të hetuar më afër gjendjen e atdheut. Po shkoj në Stamboll që të takohem personalisht me sulltanin, për t’i paraqitur mendimin tim që të vendosin nëpër shkollat publike mësimin fetar dhe nëpër medrese mësimin e shkencave. Në këtë mënyrë, ata që mbarojnë shkollën nuk bëhen të pafshe, dhe nxënësit e medreseve shpëtojnë nga fanatizmi.”<sup>14</sup> Pas takimit me sulltanin, Bediuzzamani jo vetëm që nuk mori asnjë përgjigje pozitive, por kaloi edhe peripeci të ndryshme.

Bediuzzamani bëri një figurë tërheqëse në Stamboll, e cila ra shumë në sy. Në derën e dhomës së tij, te hoteli i quajtur “Hani Shekerxhi”, ai vuri një tabelë në të cilën ishte shkruar: “Këtu të gjitha pyetjet marrin përgjigje, të gjitha problemet zgjidhen, por asnjë pyetje nuk bëhet”. Ndërkohë që dijetarët e lindjes ishin të mahnitur nga Saidi, me predikimet që jepte në xhaminë Fatih të Stambollit, ai u bë i pranueshëm edhe nga dijetarët e Stambollit, të cilët kur merrnin përgjigjet e pyetjeve të tyre, e vërtetonin edhe njëherë epitelin e tij “Bediuzzaman”.

Nga Egjipti erdhi një dijetar i madh që quhej Shejh Bahid dhe

14. Necmeddin Şahiner, *Bilinmeyen Tarafıyla Bediüzzaman Said Nursi*, Nesil Yayınları, İstanbul 2004, f. 76.

i drejtoi Said Nursisë vetëm një pyetje që të shohë largpamësinë e tij. E pyeti: “Ç’më thua për lirinë në qeverinë Osmane dhe cili është mendimi yt për Evropën?” Said Nursi i përgjigjet: “*Qeveria Osmane është shtatzënë me Evropën dhe Evropa është shtatzënë me Islamin. Do vijë një ditë dhe do të lindin.*”<sup>15</sup> Përballë kësaj përgjigjeje, Shejh Bahidi thotë: “Me këtë të riun nuk debatohet. Edhe unë jam i të njëjtit mendim. Një shprehje e tillë, e thënë shkurt dhe koncize, i përket vetëm një Bediuzzamani.” Ndërkohë Said Nursiu shkroi një libër në gjuhën arabe të titulluar “Muhakemat” (Argumente të arsyeshme), libër që njihet për nivelin e lartë të diturisë, si recetë për dijetarët. Këtë vepër, ai e përktheu vetë në vitin 1911 në gjuhën turke.

Në ditët kur Perandoria Osmane shpalli qeverinë parlamentare në vitin 1908, Bediuzzamani ishte aktiv në jetën publike dhe politike. Duke qenë se në këtë periudhë filluan shumë ngatërresa, drejtimi i popullit u orientua kundër vlerave shpirtërore dhe Islamit. Nëpërmjet ligjëratave dhe artikujve nëpër gazeta e revista, Bediuzzamani u mundua të ndalte rrymat që zhvilloheshin kundër drejtësisë islame. Ai ishte pro qeverisjes parlamentare dhe demokracisë, si dhe theksonte se kjo lloj mënyre e qeverisjes nuk bie ndesh me fenë. Despotizmi

15. Nursi, *Emirdag Lahikası-II*, f. 82.

dhe qeverisja absolute ishin mes shkaqeve më të mëdha të gjendjes së rëndë të Perandorisë Osmane, si dhe të botës islame. Ai thotë: “*Jam kundër çdo lloj despotizmi. Kudo që ta shoh atë, i gjuaj me shuplakë. Sipas meje, despotizmi më i keq është despotizmi i bërë diturisë. Unë jetoj pa bukë, pa liri nuk jetoj. Sa më shumë zhvillohet besimi, aq më shumë shkelqen liria. Ja, epoka e artë!*”<sup>16</sup>

Bediuzzamani do të ishte pionieri i lirisë, i qeverisjes kushtetuese dhe i fuqisë së ligjit gjatë gjithë jetës së tij. Këto opinione dhe diskutime në këtë drejtim, i ka përmbledhur me pyetje-përgjigje edhe te libri i tij “Münazarat” (Debatet). Duhet të vëmë theksin në atë se përfshirja e tij në të gjitha rastet, ishte gjithmonë me qëllimin për t’i shërbyer fesë, për të shfaqur parimet islame dhe për t’u dhënë orientim atyre që ishin me pushtet. Ai nuk u përfshi asnjëherë për hir të politikave, për fuqi, prestigj apo pozitë.

Në vitin 1911 mbylli udhëtimet e tij në krahinat lindore të Turqisë dhe u nis për në Damask të Sirisë. Në xhaminë Emevije mbajti hutben e xhumasë përpara mijëra besimtarëve, ku të pranishëm ishin edhe një numër i madh dijetarësh. Kjo hutbe u vlerësua shumë dhe u kthye më vonë në libër me titull “Hutbe-i Shamije” (Hutbeja e

Shamit), e cila u botua disa herë në arabisht e turqisht. Këtu, Said Nursiu foli kryesisht për problemet e botës islame dhe zgjidhjet e tyre. Ai e kishte konstatuar diagnozën e umetit, duke treguar ekzistencën e tri sëmundjeve: Injoranca, varfëria dhe përçarja, si dhe duke bërë të qartë mënyrën e luftimit të tyre me dituri, art dhe unitet. Për këtë arsye, nga njëra anë, ai përpiquej me gjithë fuqinë e tij për arsimimin e popullit, kurse nga ana tjetër, përpiquej të pengojë ata që mundohen të fusin përçarje në popull. Në këtë hutbe, ndër të tjera ai tha: “*Në të ardhmen kur arsyeja, shkencën dhe teknologjinë të kenë pushtet dhe të jenë me influencë, sigurisht që atëherë do të jetë koha kur Kur’ani do të fitojë epërsi, i cili përkon me provat e arsyeshme dhe e bën arsyen të konfirmojë shpalljet dhe vendimet e tij.*”<sup>17</sup>

Kur u kthye në Stamboll, Sulltan Mehmed Reshadi e fton Bediuzzamanin në një udhëtim për në Ballkan, si përfaqësues i krahinave lindore. Kur arriti në Shkup, atëherë kryeqendër e vilajetit të Kosovës, Bediuzzamani u rrethua nga dijetarët e Shkupit, të cilët i bënë pyetje të ndryshme. Në këtë rast, në Shkup u hodh themeli i një universiteti. Bediuzzamani i paraqiti Sulltan Reshadit nevojën për ngritjen e një universiteti edhe në Lindje, pasi

16. Bediuzzaman Said Nursi, *Mektubat, Risale-i Nur Külliyatından (Terimli, Lügatlı, Kaynaklı, İndeksli)*, Söz BasımYayın, İstanbul 2004, f. 19.

17. Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, f. 124; Bediuzzaman Said Nursi, *Hutbe-i Şamije, (Arapça Metin İlaveli)*, Yeni Asya Neşriyat, İstanbul 2016, f. 23.

atje ishte qendra e botës islame. Në këtë kohë, filluan luftërat ballkanike dhe projekti i universitetit të vilajetit të Kosovës (Shkup) u pezullua. Kështu që fondi i përcaktuar për të, iu dha Said Nursiut për hedhjen e themeleve të universitetit Medresetu'z-Zehra, sipas plan-projektit të tij. Bediuzzamani, më vonë, do të shprehej: *“Mendimin tim në lidhje me universitetin, fillimisht e mori parasysh vetë Sulltan Reshadi dhe premtoi se do të japë 20.000 monedha floriri. Si fillim mora 1000 monedha dhe menjëherë hodhëm themelet në Edremit, pranë liqenit të Vanit. Por, fatkeqësisht filloi Lufta e Parë Botërore dhe këjo (ndërtimi saj) u anulua.”*<sup>18</sup>

### **Bediuzzamani në Luftën e Parë Botërore**

Në vitin 1914 filloi Lufta e Parë Botërore dhe rusët sulmuan tokat osmane. Në këtë luftë, Bediuzzamanit si komandant, iu dha detyra e mbrojtjes së qyteteve Van, Bitlis dhe Mush, të cilat ishin në prag rënieje. Ai tregoi aftësi të jashtëzakonshme, të cilat u vlerësuan shumë kur u kthye në Stamboll, ku prefekti i Vanit, Tahsin beu, e dekoroi me medaljen e luftës në dokumentin e së cilës shkruhej: *“Shërbimet e kryera nga divizioni i Vanit, janë rezultat i përpjekjeve fizike dhe shpirtërore të Said Nursiut”*.

Megjithëse në luftë dhe fronte, Bediuzzamani nuk e lëshoi lapsin,

18. Ballxhë, *po aty*, f. 106.

si arma më e madhe për të luftuar mosdijen dhe, nëpërmjet nxënësit të tij Habibi, ia doli të shkruajë librin: *“Isharetu'l I'xhaz”* (Shenjat e mrekullive), një tefsir Kur'ani në gjuhën arabe. Ky libër u ribotua disa herë në Stamboll, Bejrut dhe Irak, duke u përkthyer edhe në turqisht.

Në vitin 1916, duke luftuar kundër rusëve dhe armenëve me një divizion të përbërë prej gati 4000 vullnetarësh, u vranë shumë nga nxënësit e tij. Edhe ai vetë u plagos në Bitlis dhe ra rob te rusët, të cilët e internuan atë në kampin e të burgosurve, në Kosturma të Rusisë. Edhe atje, ai vazhdoi me këshilla e mësimë përreth 2 vjet. Në pranverën e vitit 1918, Bediuzzamani gjeti një mënyrë për t'u arratisur në mes të konfuzionit e rrëmujës që pasoi revolucionin Bolshevik dhe, nëpërmjet Gjermanisë e Austrisë u kthye në Stamboll.

Përpara se të arratisesh, komandanti i përgjithshëm i rusëve Nikolla Nikollajaviç, vizitoi kampin me qëllim që të inspektonte të burgosurit. Ai gjeti një respekt nga të gjithë të burgosurit, por jo nga Bediuzzamani. Kur komandanti e pyeti se përse nuk e respektoi duke u ngritur në këmbë, atëherë Bediuzzamani iu përgjigj: *“Unë jam një dijetar mysliman. Unë kam besim në zemrën time. Ai që ka besim në zemrën e tij është më i lartë se sa ai që nuk ka besim. Në qoftë se unë do të isha ngritur në këmbë, do të isha treguar mosrespektues ndaj besimit tim. Unë nuk u ngrita për këtë*

arsye.”<sup>19</sup> Komandanti e ndjeu veten të fyer, duke treguar se kjo është fyerje edhe për ushtrinë e tij, kombin dhe Carin, dhe urdhëroi të ngrihet një gjykatë ushtarake për të dënuar Bediuzzamanin.

Me këtë urdhër, u ngrit gjykata ushtarake. Ndërkohë erdhën disa oficerë turq, gjermanë dhe austriakë, duke insistuar që Bediuzzamani t'i kërkonte falje komandantit rus, por ai u përgjigj: “Unë dësbijoj të udhëtoj për në botën e Ahiretit, te prania e të Dërguarit të Zotit, dhe më dubet të kem vetëm një pasaportë për në Ahiret. Unë nuk mund të veproj në kundërshtim me besimin tim.”<sup>20</sup> Asnjëri nuk mundi të hapë gojën përballë kësaj fjale dhe të gjithë prisnin rezultatin. Gjykata e përfundoi procesin gjyqësor me marrjen e vendimit për ekzekutim, për shkak të fyerjes së Carit dhe të ushtrisë ruse. Ndërkohë që Bediuzzamani mori abdes për të falur dy rekate namaz, u shfaq Nikolla Nikollajaviç. Ai i tha: “Më fall! Unë kujtova se veprimin tënd e bëre për të më fyer mua dhe mora masat ligjore kundra teje. Por tani unë e kuptoj se ti paske vepruar vetëm sipas besimit tënd dhe paske zbatuar atë çfarë urdhëron ai besim. Prandaj vendimi shfuqizohet. Ti meriton respekt për vendosmërinë dhe devocionin tënd. Unë të shqetësova ty, të lutem përsëri që të më falësh.”

19. Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, f. 176.

20. Nursi, *po aty*, f. 177.

## Vitet e Bediuzzamanit në Stamboll

Ardhja e tij në Stamboll, e gëzoi shumë popullin dhe veçanërisht njerëzit e dijes. Pa e njoftuar, Bediuzzamanin e bëjnë anëtar të shoqatës “Daru’l Hikmeti’l Islamiye”<sup>21</sup> në Bejazit, shoqatë që kishte në fokus mbrojtjen e myslimanëve dhe bashkimin rreth ligjit hyjnor. Kur e njoftojnë për këtë, ai pranon dhe shprehet: “Le të jetë shërbim ndaj vendit dhe popullit tim”.<sup>22</sup>

21. Shoqatë në rangun e akademisë islame, e varur nga Shejhulislami (Post që përfaqësonte organin zyrtar fetar në Perandorinë Osmane), e cila ka operuar gjatë viteve 1918-1922. Bediuzzamani qëndroi anëtar i shoqatës për katër vitet e ekzistencës së saj të shkurtër. Ajo u mbyll në nëntor të vitit 1922, kur Sulltanati u suprimua nga qeveria e Ankarasë. Në dokumentin e kësaj shoqate, vet Bediuzzamanin ndër të tjera ka thënë: “Unë kam qenë një anëtar i Daru’l Hikmeti’l Islamiye që kur ajo u themelua në fillim. Unë e humba diplomën që mora prej Muhammed Xhelal Efendiut kur isha një i burgosur lufte. Jam autori i shtatëmbëdhjetë veprave. Së pari, në arabisht, janë komenti Kur’anor “Isbaratul i’xhaq”, trajtesat mbi logjikën të quajtura “Talikat” dhe “Kıral i’xhaq”, dhe El-Hutbetu’sh Shamije. Unë kam shkruar vepra në turqisht si *Nokta*, *Shuaat*, *Sunubat*, *Munazarat*, *Mubakemat*, *Lemeat*, *Rumuz*, *Isbarat*, *Hutuva’i Sitte*, *Iki (mekteb-i) musibetin şebadetnamesi dhe Hakikat Çekirdekleri*. Shumica e veprave të mia janë shkruar si nxitje për orientimin e myslimanëve dhe për të zgjuar të pavëmendshmit. Ashtu siç flas Turqisht dhe Kurdisht, po ashtu unë lexoj e shkruaj Arabisht dhe Persisht.” (Nursi, *po aty*, f. 204-205).

22. *Bediüzzaman Said Nursi kimdir? (Uzun*

Gjatë viteve në Stamboll 1918-1922 të Bediuzzamanit, në Perandorinë Osmane 600 vjeçare po përjetoheshin shkatërrime e kapitullime njëri pas tjetrit dhe zemrat e besimtarëve po digjeshin nga hidhërimi. Nga njëra anë shtetet e perëndimit kishin marrë në dorë armët e shkencës dhe filozofisë, duke mos u njohur asnjë të drejtë myslimanëve, nga ana tjetër intelektualët myslimanë kishin kohë që psikologjikisht kishin humbur përballë perëndimit. Armiqtë e Islamit po bënë të pamundurën për t'i dhënë goditjen edhe më të ashpër, duke bërë vazhdimisht propagandë se shkak i rënies ishte feja.

Bediuzzamani nëpërmjet ligjëratave dhe veprave të veta, ka treguar shpesh se, ashtu si civilizimi modern, që nuk ishte produkt dhe pronë e krishterimit, as rënia dhe prapambetja nuk ishin pasojë e Islamit. Ai thotë: *“Unë nuk mund të mohoj se ndodhen disa virtyte në qytetërim, por ato nuk janë as pronë e krishterimit, as shpikje e Evropës, ato nuk janë as produkti i këtij shekulli; ato janë pronë e përbashkët, të prodhuara nga lidhja e mendjeve dhe e ideve, nga ligjet e feve të shpallura, nga nevoja e bashkëlindur e njerëzimit dhe veçanërisht nga ardhja e Islamit, si faktor i legjislacionit të zbritur Muhamedit (a.s.).”*<sup>23</sup>

Në marrëveshjet që u bënë me kapitullimin e ushtrisë osmane,

*Bijografi*), sorularlarisale.com, makale.

23. Nursi, *po aty*, f. 209.

edhe Stambolli, në vitin 1920, filloi të përjetojë ditët e pushtimit. Megjithëse rreziku i vdekjes ishte pothuajse i sigurt, Bediuzzamani nuk e braktisi qytetin dhe u përpoq ta kthejë popullin dhe parinë e vendit kundër politikës britanike. Në këto ditë, patriotizmin më të madh dhe ndikues, Bediuzzamani e ka bërë me shkrimin e librit të tij *“Hutuvat-i Sitte”* (Gjashtë hapat). Aty ai tregoi gjashtë rrugë nëpërmjet të cilave britanikët dhe grekët mbollën përçarje e grindje në mesin e myslimanëve. Me këtë libër dhe të tjerë të ngjashëm, ai mbrojti identitetin e fesë islame dhe arriti t'i vinte kundra britanikëve mendimet e popullit dhe të diturve, në një kohë kur Shejhu'l Islami ishte i detyruar të nxirrte fetva (vendim) në favor të pushtuesit. Madje, kësaj ai iu kundërvu dhe hodhi poshtë duke thënë: *“Në një vend ku fetvaja (vendimi) jepet nga përgjegjësit e saj nën diktat, është e mangët, duke qenë se nuk ka vullnet të lirë.”*<sup>24</sup> *“Ata që veprojnë kundra pushtimit armik nuk janë rebelë. Fetvaja dubet të shfuqizohet.”*<sup>25</sup>

### **Bediuzzamani në Kuvendin e Ankarasë**

Shërbimet e Bediuzzamanit ndaj popullit dhe atdheut u panë me admirim nga Ankaraja zyrtare dhe në vitin 1922 i dërgohet me telegram

24. Nursi, *Mektubat*, f. 19.

25. Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, f. 199.



një ftesë nga Mustafa Kemali, në veçanti, i cili ishte zgjedhur kryetar i Asamblesë së Madhe Nacionale, po ashtu edhe nga një grup deputetësh. Kjo ftesë u përsërit disa herë, derisa Bediuzzamani vendosi të shkojë. Pavarësisht pritjes së ngrohtë që iu bë atij, si dhe gëzimit të madh që shfaqej për triumfin e Islamit dhe të turqve mbi armiqtë e tyre, ai u shqetësua shumë kur gjeti një qëndrim të shkujdesur ndaj Islamit dhe detyrave fetare mes shumë deputetëve të asamblesë. Ishte fillimi i një epoke të re dhe pikërisht koha për të mobilizuar forcat për rilindjen e civilizimit islam, për ta bërë atë një qendër dhe burim mbështetës për botën islame. Por, ndryshe nga kjo, përveç indiferentizmit ndaj fesë, ai zbuloi se po propagandoheshin idetë ateiste. Ai e përshkruan kështu atë panoramë: *“Kur shkova në Ankara në vitin 1922, morali ishte i lartë si rezultat i fitores së ushtrisë së Islamit mbi grekët. Por unë pashë se një rrymë e urryer ateizmi po përpiqej pabesisht për të sabotuar, korrumpuar, helmuar e shkatërruar mendjet e tyre. Unë thashë, o Zot! Ky përbindësh synon të dëmtojë shtyllat e besimit.”*<sup>26</sup>

Me qëllim nxitjen e deputetëve që të kapeshin pas Islamit dhe të kryenin detyrat e tyre fetare në këtë kohë kritike, në janar të vitit 1923, ai botoi një deklaratë me dhjetë pika, të cilën ua shpërndau të gjithë deputetëve. Kjo nxitje e Bediuzzamanit pati një efekt të

26. Nursi, *po aty*, f. 236.

konsiderueshëm. Ajo e shtoi në 60 numrin e deputetëve, të cilët filluan ta kryejnë namazin në mënyrë të rregullt, derisa ambientin që përdorej për xhami e kërkuan të ishte më i madh. Megjithatë, ai mesazh tërhoqi një reagim jo të mirë të kryetarit të asamblesë, Mustafa Kemal Pashës. Një ditë, në prani të një numri të madh deputetësh në asamble, Mustafa Kemali i foli me zemërim Bediuzzamanit:

“Ne të thirrëm këtu se kemi nevojë për hoxhallarë heronj si ti, që të përfitojmë nga mendimet e tua, por ti erdhe këtu dhe nise menjëherë të shkruash rreth namazeve, duke shkaktuar konflikte mes nesh.” Bediuzzamani e kundërshtoi këtë me pak fjalë, pastaj i revoltuar, duke ia drejtuar dy gishtat, i tha: *“Pasha! Pasha! E vërteta më e lartë në Islam, pas besimit, është namazi (detyrimi për kryerjen e pesë kohëve të namazit). Ata që nuk i kryejnë namazet janë tradhtarë dhe opinionet e gjykimit e tyre kundërshtohen.”*<sup>27</sup> Mustafa Kemali e përmbajti zemërimin dhe për të përfituar prej influencës së tij i ofroi një post e rrogë të mirë, si dhe disa përfitime të tjera, por Bediuzzamani, duke kuptuar qëllimin e tij, si dhe për t’i orientuar përpjekjet e tij drejt “Saidit të Ri”, nuk pranoi dhe në verën e vitit 1923 shkoi në qytetin e Vanit.

27. *Bediuzzaman Said Nursi kimdir? (Uzun Biyografi)*, po aty.

## PERIUDHA E “SAIDIT TË RI” (1923-1950)

Periudha e dytë kryesore e jetës së tij, ajo e “Saidit të Ri”, filloi me themelimin e Republikës së Turqisë dhe me ardhjen në fuqi të regjimit të ri. Gjatë kësaj periudhe, ai do t’i nënshtrohet viteve të gjata të mërgimit, persekutimit dhe burgimit nga administrata e Republikës, të cilën ai e kundërshtoi me forcë, por që nuk i nxori asnjëherë armë. Siç e kërkuan kushtet dhe rrethanat e kohës, luftërat e “Saidit të Vjetër” përballë sulmeve të ndryshme për çështjen e Islamit, ishin shumë aktive, si në sferën publike, ashtu edhe në fushën e politikave. Ai, duke u tërhequr nga kjo jetë, u përqendrua te përpjekjet për të shpëtuar e forcuar besimin në Zot, si dhe tek të vërtetat e besimit, të cilat në atë kohë ishin nën kërcënim.

Bediuzzamani nuk i kushtoi shumë vëmendje periudhës së tij të hershme, duke u orientuar tashmë në studim, adhurim e meditim, si dhe përkushtimit për mësimin e nxënësve të tij. Gjatë kësaj kohe, në fillim ai pati brenda vetes një trazirë, pastaj një ndryshim të brendshëm. Deri në atë kohë, Bediuzzamani ishte thëlluar në dituritë filozofike, sepse ai i mendonte ato si mjet për progres shpirtëror e ndriçim, si dhe ishte i mendimit se ato dituri mund të përdreshin për të “përforcuar” Islamin. Pastaj, ai zbuloi se ato ia

kishin turbulluar shpirtin dhe kishin qenë pengesë për përparimin e tij shpirtëror. Sikur disa shkreptima të perceptimit, rinisën procesin e zgjimit të tij shpirtëror. Ai e përshkruan kështu erën e këtij ndryshimi: *“Errësira shpirtërore që buronte nga shkencat e filozofisë, e zhytën shpirtin tim në univers, duke ia zënë frymën. Cilëndo rrugë që shikoja për të kërkuar dritë, pashë se nuk mund të gjeja dritë në ato çështje, unë nuk mund të merrja frymë...”*<sup>28</sup>

Krizat shpirtërore të Bediuzzamanit e shtynë atë të tërhiqej prej shoqërimit të njerëzve dhe të kërkonte vetminë në vende larg banimit. Në këtë gjendje, atij i erdhën në ndihmë vepra “Futuhu’l Gajb” e Abdul Kadir Gjejanit dhe vepra “Mektubat” e Shejh Ahmed Sihrindi, Imam Rabbanit. Ai thotë: *“Fillova të mendoja shumë. Cilin nga ata të dy të ndjek?! A të ec pas këtij, apo të ec pas atij?! Unë mbeta në një gjendje të çuditshme, sepse te secili nga ata kishte veçori të ndryshme që më tërhiqnin. Vetëm njëri nuk ishte i mjaftueshëm për mua. Asnjë prej figurave të mëdha, të tillë si Imam Gazali, Mevlana Xhelaleddin Rumi dhe Imam Rabbani, nuk iu përgjigjën të gjitha nevojave të mia. Ndërsa isha kështu i ngatërruar, iu shfaq zemrës sime, nga mëshira e Zotit (xh.sh.), se fillimi i këtyre rrugëve të ndryshme dhe burimi i këtyre rrjedhave, si dhe dielli i këtyre planetëve është Kur’ani Fisnik. Atëherë këmba e vetme e vërtetë, gjendet veçse në*  
28. Nursi, *po aty*, f. 218.

*Kur'an. Prandaj, Kur'ani është udhëzuesi më i lartë dhe mësuesi më i shenjtë. Kështu, unë e shtrëngova fort me dy duart e mija dhe u kapa pas tij.*<sup>29</sup> Sigurisht që ky transformim nuk buroi nga një ndryshim rrënjësor në mendimet dhe pikëpamjet e tij. Ai vetë deklaroi se kjo lidhet me rrugën dhe metodën që do të ndjekë më vonë në shërbim të Islamit.

Rruga e “Saidit të Ri” do të ishte edhe rruga e veprave të “Risale-i Nurit”. Ishte pikërisht kjo periudhë, që Bediuzzamani frymëzohej prej Kur’anit që të shkruajë koleksionin “Risale-i Nur” (Mesazhet e Dritës), i cili shpjegon dhe shtjellon në një mënyrë të veçantë mësimet e Kur’anit, lidhur me besimin në Zot dhe të vërtetat e besimit, me një metodë efektive për t’ia parashtruar njeriut të sotëm. Vepra e parë që “Saidi i Ri” shkroi në këtë drejtim, ishte një koleksion prej dymbëdhjetë broshurash në gjuhën arabe, të cilën e përfundoi në vitin 1924. Ai vetë i bashkoi këto broshura në një libër dhe e titulloi “Methnevi-i Nuriye” (Përmbledhja e Dritës), të cilën ai e përshkroi si një lloj bërthame të “Risale-i Nurit” apo farishtë, ndërsa “Risale-i Nurin”, si kopshtin e saj.

Pas 2 viteve në Van, në të cilën kaloi një jetë të tërhequr në malin Ereğ, në vitin 1925, nis një kryengritje kurde me në krye shejh Saidin. Disa kryetarë të fiseve nga Bitlisi, Vani, Mushi, etj., shkuan te Bediuzzamani

29. Nursi, *po aty*, 221.

me mendimin se ai do t’i përkrahte ata kundër shtetit. Bediuzzamani u tha: “*A jeni të mendimit që ta shtyni vëllain të mbysë vëllain e vet?! A mos keni barruar se për shumë shekuj populli turk ka mbajtur flamurin e fesë islame dhe në rrugën e fesë ka dhënë qindra mijëra, ndoshta miliona shëhidë, si dhe ka rritur miliona dijetarë?! Kështu që, nuk i ngrihet shpatë nipave të këtyre sakrifikesve të fesë islame, pra, unë nuk i ngre shpatë popullit turk.*”<sup>30</sup>

Megjithëse Bediuzzamani nuk mori pjesë në këtë revoltë, ai u gjykua me pjesëmarrësit e tjerë. Pas hetimeve të thella ai u shpall i pafajshëm, megjithatë u internua në rrethin Burdur. Përsëri armiqtë e fshehtë të tij hapën lajme se Said Nursiu nuk po ndalet dhe po predikon haptazi. Me qëllim për ta izoluar nga jeta jashtë dhe për t’i ngushtuar ndikimin në popull, në vitin 1927, autoritetet e dërguan atë në një fshat të vogël që quhej Barlla, në rrethin e Ispartës.

### Jeta e Bediuzzamanit në Barlla

Në të vërtetë, viti 1925, ishte fillimi i njëzet e pesë viteve të një despotizmi absolut, i cili i gjeti njerëzit e Anadollit të çliruar nga armiqtë e jashtëm që kishin pushtuar tokën, dhe me formimin e qeverisë së re. Qëllimi i qeverisë së re në Ankara, ishte që ta kthente Turqinë në një shtet me model perëndimor,

30. Ballxhë, *po aty*, f. 139.

dhe për këtë, duhej të çrrënjoste krejtësisht mënyrën e saj të jetës, bashkë me çdo gjë tjetër që e bënë atë që ishte, dhe t'i impononte një mënyrë jete të huaj. Sigurisht që kjo do të bëhej nëpërmjet forcës dhe despotizmit.

Barlla, në të cilën u internua Said Nursiu, ishte një fshat i shkretë dhe vend i largët, ku atëherë mund të shkohej në këmbë ose me varkë. Rruga do të vinte për Barlla në vitet e mëvonshme, ashtu siç do të vinte telefoni dhe elektriciteti. Banorët e Barllës përbëheshin më së shumti nga mosha e thyer, sepse shumë të rinj ishin larguar nëpër qytetet e mëdha për arsye ekonomike. Autoritetet në Ankara i frikësonin njerëzit e zonës, duke përhapur thashetheme dhe shpifje të ndryshme ndaj Bediuzzamanit. Ata u përpoqën t'i mbanin njerëzit larg tij, duke i lejuar Bediuzzamanit vetëm vizitorë të rrallë. Ata e ndiqnin dhe e shqetësonin atë në mënyrë të vazhdueshme. Mirëpo, autoritetet në Ankara, nuk do ta dinin se, në internimin e padrejtë të Bediuzzamanit në Barlla, ata po i shërbenin pikërisht çështjes së cilës donin të shfarosnin. Këto masa shtypëse, po u shërbenin thjesht qëllimeve të urtësisë së Zotit, sepse këtu Bediuzzamani shkroi pjesën më të madhe të 130 pjesëve të “Risale-i Nurit”. Pikërisht në Barlla, ai shkroi në fillim broshurën “Haşir Risalesi”

(Broshura e ringjalljes), pastaj të plotë kryeveprat “Sözler” (Fjalët) dhe “Mektubat” (Letrat), si dhe pjesën më të madhe të kryeveprës “Lem’alar” (Shkreptimat). Kështu, nëpërmjet këtyre veprave filloi lufta e heshtur e Bediuzzamanit kundra forcave ateiste.

Bediuzzamani qëndroi në Barlla 8 vjet. Ai qëndroi në një shtëpi të vogël, ku poshtë saj ishte një çezmë dhe pranë një rrap i lartë. Në degët e rrapit, Bediuzzamani kishte ndërtuar një kasolle, të cilën e përdorte në stinën e verës dhe të pranverës për adhurim, lutje e meditim. Gjithashtu, ai e kalonte kohën në lëndinat, pyjet dhe malet e Barllas, duke shkruar veprat e “Risale-i Nurit”, si dhe duke i korrigjuar ato, të shumuara me laps nga nxënësit e tij të zellshëm dhe fshatarët e rrethit të Ispartës. Ai pa u demoralizuar, pa u lodhur, mes ndëshkimeve të rrepta, duke shpenzuar të gjithë fuqinë e tij dhe duke braktisur dëshirat e veta, u përpoq për realizimin e idealit në shkrimin e “Risale-i Nurit”. Ai thotë: *“Nderi dhe lartësia e fesë islame nuk më lejon t’i përulem askujt përveç Allahut. Për të shpëtuar besimin e popullit mysliman, sakrifikova botën dhe jetën time. Hallall i qoftë! Madje edhe zullumqarët nuk i mallkoj fare, sepse përballë këtyre vuajtjeve, fitova shumë nxënës. Nuk e di numrin, por shpresoj se disa milionë njerëz e kanë shpëtuar besimin e tyre...”*<sup>31</sup>

31. Ballxhë, *po aty*, f. 281.

## Koha në Isparta

Në vitin 1934, qeveria mendoi ta dërgojë Bediuzzamanin në Isparta, në mënyrë që ta ketë më shumë nën mbikëqyrje. Atje, edhe para portës së shtëpisë së tij, edhe rreth e rrotull saj, qëndronin vazhdimisht policët. Shpesh nxënësit e tij nuk mund t'i afroreshin Bediuzzamanit, sepse ai mbahej nën një mbikëqyrje të rreptë. Për një kohë, vetëm një nxënës, i quajtur Mehmet Gülërmak, u lejua të qëndronte me të për ta ndihmuar në nevojat të ndryshme. Ai ishte edhe "Postieri i Nurit", duke mbledhur e shpërndarë "Risale-i Nurin", ashtu siç kërkohej. Në Isparta, Bediuzzamani shkroi pjesën tjetër të kryeveprës "Lem'alar" (Shkreptimat), dhe i gjithë "Risale-i Nuri" tashmë numëronte 130 pjesët e tij të plotësuara.

Bediuzzamani e deshi provincën e Ispartës si qendrën prej së cilës rrezatoi "Risale-i Nurin" nëpërmjet nxënësve të tij. Ai, kohë më vonë, ua shprehu këtë gjë disave prej nxënësve: "*Për shkakun tuaj unë e dua Ispartën dhe fshatrat përreth, së bashku me të gjithë gurët dhe dheun e saj. Unë madje, mund të them se, nëse autoritetet e Ispartës do të më dënonin me burg, ndërkohë që një provincë tjetër do të më jepte pajësinë, unë përsëri do të zgjidhja Ispartën...*"<sup>32</sup> Në qytetin e Ispartës ndodheshin disa prej nxënësve më të afërt të Bediuzzamanit, të tillë si Husrevi dhe Re'fe Beu. Ata qëndruan me të aq sa

32. Nursi, *po aty*, f. 303.

mundën, duke vepruar si shkruesit e tij dhe duke shumëuar kopje të "Risale-i Nurit".

Mes kujtimeve të Re'fe Beut gjatë kësaj kohe përmenden: "Husrevi dhe unë shkruanim kopjet e 'Risale-i Nurit'. Mësuesi (Bediuzzamani) rrinte në dhomën sipër. Papritmas dera hapej dhe ne shihnim mësuesin duke hyrë me një tabaka dhe dy gota çaji. Ne viheshim në pozitë të vështirë dhe ngriheshim menjëherë në këmbë, duke dashur ta merrnim tabakanë prej tij. Por ai ngrinte dorën e tij dhe thoshte: 'Jo jo, unë duhet t'ju shërbej juve.' O Zot i Madh, dhe ai shtoi 'duhet'. Çfarë modestie! Çfarë fisnikërie! Unë kurrë nuk kam parë një modesti dhe një fisnikëri të tillë ndokund... Ne studionim e shkruanim të vërtetat e Kur'anit dhe përfitonim shumë. Për t'ia treguar këtë atij, një ditë ne i thamë: Çfarë do të kishim bërë ne o mësues, në qoftë se nuk do t'ju kishim gjetur juve?! Dhe përsëri me atë modestinë e madhe ai na u përgjigj: 'Çdo të kisha bërë unë, në qoftë se nuk do t'ju kisha gjetur juve?! Nëse ju jeni të lumtur një herë për atë që më gjetët, unë duhet të jem një mijë herë i lumtur që ju gjeta juve...'"

Në periudhën prej 9 muajsh që qëndroi në Isparta, u shkruan tre broshura: "**Ihtiyarlar Risalesi**" (Broshura për të moshuarit), "**İktisat Risalesi**" (Broshura rreth kursimit) dhe "**Hastalar Risalesi**" (Broshura për të sëmurët).

## Burgu i Eskishehirit

Nopranët e kuptuan se Bediuzzamanin nuk mund ta ndalonin me internime dhe izolime, prandaj vendosën të provojnë rrugët e asgjësimit të tij. Në maj të vitit 1935, disa nxënës të Bediuzzamanit u morën prej shtëpive dhe vendeve të tyre të punës dhe u mbajtën nën arrest. Dy ditë më vonë, vetë Bediuzzamani dhe një grup tjetër i nxënësve u arrestuan për t'u dërguar së bashku në burgun e qytetit Eskishehir. Në fakt, urdhri ishte të zbankonin Bediuzzamanin dhe 31 nxënësit e tij në ndonjë vend të veçuar gjatë rrugës dhe t'i pushkatonin. Por, oficerit përgjegjës, Ruhi Beut, i erdhi keq dhe nuk e zbatoi urdhrin. Për shkak të mosbindjes ai u përjashtua nga ushtria. Në burgun e Eskishehirit erdhën edhe nxënës të tjerë, të arrestuar në vende të tjera dhe numri total i tyre në burg shkoi në 120. Bediuzzamanin e mbyllën fillimisht në një birucë, kurse nxënësit e tij i vendosën në një qeli.

Megjithëse kushtet ishin skandaloze, ku mungonin nevojat më themelore, Bediuzzamani dhe nxënësit e tij këtë burg e quajtën “Medresetu’l Jusufije” (Shkolla e Jusufit)<sup>33</sup>, dhe e kthyen atë në një vend mësimi dhe udhëzimi për të burgosurit e tjerë. Shumë të burgosur më pas, të cilësuar edhe si vrasës të

33. Krahasuar me historinë e profetit Jusuf (a.s.), si model i të burgosurve.

tërbuar, do të dilnin nga burgu si atdhedashës të mirë. Në 11 muajt e burgut, Bediuzzamani vazhdoi të shkruante, duke përfunduar edhe pesë broshura të tjera gjatë kohës që ndodhej atje. Këto broshura ishin nga kryevepra “Lem’alar” (Shkreptimat), konkretisht Shkreptimat e 28, 29 dhe 30, si dhe Rrezet e para dhe e dyta nga kryevepra tjetër e tij, e quajtur “Şualar” (Rrezet). Ai i shkroi ato duke ua diktuar nxënësve nga kujtesa e tij. Njëkohësisht, ai burg filloi të kthehet edhe në xhami, sepse namazet e lutjet atje kryheshin rregullisht dhe i gjithë Kur’ani lexohej disa herë në ditë.

Ndërkohë, gjykimi i Bediuzzamanit së bashku me nxënësit e tij, vazhdonte në arrest me burg. Akuzat ishin të ndryshme dhe përfshinin shkeljen e parimeve të shekullarizimit dhe nenit 163 të Kodit Civil, që midis të tjerave, ishin akuzat për formimin e një tarikati, shfrytëzimi i fesë për qëllime politike, me idenë e reaksionit politik dhe organizimi i një grupi të fshehtë, i cili do të ishte i dëmshëm për sigurinë publike. Gjykata ishte nën presion nga ministri i brendshëm për të dënuar Bediuzzamanin. Kështu, kjo ishte një çështje jete a vdekje për të dhe për nxënësit e tij. Megjithatë Bediuzzamani do ta mbronte vetveten në gjykatë denjësisht, pavarësisht se fjalët e tij mbrojtëse do të ishin kryesisht për të mbrojtur “Risale-i Nurin”.

Në shkrimet e tij, Bediuzzamani kishte nisur një lëvizje pozitive, pa shkelur në pamje të jashtme ligjet e reja. Dhe ai qe në gjendje ta provonte këtë për gjykatën. Kështu, pavarësisht presionit që i bëhej gjykatës, ajo e shfajësoi atë nga të gjitha akuzave, përveç njëres, asaj që lidhej me një broshurë të shkurtër, e cila shpjegonte ajetet e Kur'anit lidhur me veshjen islame. Për këtë, Bediuzzamani u dënua me 11 muaj burgim dhe me detyrim lejeqëndrimi në qytetin e Kastamonut. 15 nxënësit e tij u dënuan me nga 6 muaj burg secili, ndërsa të tjerët morën pafajësinë.

### Vitet në Kastamonu

Bediuzzamani u lirua nga burgu i Eskishehirit në mars të vitit 1936, pasi kreu 11 muaj dënim dhe u dërgua në Kastamonu. Në Kastamonu ai qëndroi shtatë vite e gjysmë. Tre muajt e tij të parë në Kastamonu, Bediuzzamani qëndroi “si një mysafir” në rajonin e policisë. Në vijim të kësaj, ai u lëviz për te një shtëpi e lëshuar me qira përballë policisë. Lëvizjet e tij këtu ishin më të kufizuara se sa në Barlla dhe përndjekja vazhdonte. “*Kaderi i Zotit kërkon që tani unë të shërbej këtu.*”<sup>34</sup>, - tha Bediuzzamani dhe vazhdoi të shkruajë shtojca të tjera për “Risale-i Nurin”, duke përfunduar njërën

34. *Bediuzzaman Said Nursi kimdir? (Uzun Biyografi)*, po aty.

prej broshurave më të rëndësishme të tij, të titulluar “El-Ajetu'l Kubra” (Argumenti i Madh). Gjithashtu, këtu u shkruan Rrezja e tretë deri në të nëntën nga kryevepra e tij “Şualar” (Rrezet), të cilat u përhapën nga nxënësit e Bediuzzamanit dhe u dërguan në qytete e fshatra prej postierëve të “Risale-i Nurit”.

“Risale-i Nuri” filloi të kishte lexues të shumtë mes nxënësve të shkollës në Kastamonu. Bediuzzamani e përmend këtë në disa letra, duke shprehur kënaqësinë e tij të madhe se një numër i konsiderueshëm prej pjesëve të “Risale-i Nurit” u shkruan nga fëmijët, gratë dhe të moshuarit. Ai tërhoqi nxënës të rinj dhe Kastamonu fitoi emrin “Isparta e dytë”, si një qendër prej të cilës u përhap “Risale-i Nuri”. Gjatë javëve të tij të para në Kastamonu, Bediuzzamani tërhoqi të parin e atyre që do të ishte më i afërti i nxënësve të tij këtu, që e thërrisnin çajxhi Emin. Ai ishte në internim njësoj si Bediuzzamani. Prej nxënësve të tjerë të afërm të Bediuzzamanit në qytetin e Kastamonut ishte Mehmet Fejziu, i cili kishte një kulturë arsimore. Këta të dy, e ndihmonin vazhdimisht, me sa kishin mundësi Bediuzzamanin, duke i siguruar nevojat e tij të përditshme dhe Mehmet Fejziu, veçanërisht, duke vepruar si shkruesi i tij dhe ndihmës i “Risale-i Nurit”.

Bediuzzamani mbajti korrespondencë të vazhdueshme

me nxënësit e tij në Isparta e gjetkë nëpërmjet letrave, dhe këto letra u mbledhën bashkë për të formuar veprën “Kastamonu Lahikası” (Letrat e Kastamonut). Lartësia e madhe e Kastamonut i bënte dimrat shumë të ftohtë. Në disa letra Bediuzzamani përmend të ftohtin e ashpër me sëmundjet që ai vuante. Ai ishte goditur me dhembjen kronike të mesit të kryqeve dhe reumatizmin, përveç këtyre, Bediuzzamani u helmua në disa raste nëpërmjet helmit që i futej fshehurazi në ushqim apo fruta. Çajxhi Emini ka pohuar se Bediuzzamani vuajti kriza të rënda sëmundjeje si rrjedhojë e helmimit. Gjithsej në jetën e tij, ai u helmua 19 herë, kurse 28 vite të jetës i kaloi në internim dhe burgje të ndryshme të vendit. Bediuzzamani, pavarësisht se u sprovua shumë, duke vuajtur madje edhe nga mundime e siklete të tjera, shprehet: “*Unë i shpreh falënderime të pafundme Krijuesit tim, i Cili më ka dhuruar besimin, ilaçin më të shenjtë për çdo sëmundje, si dhe mjekimin e nënshtimit ndaj vendimit të Zotit, i cili vjen nga besimi në Kaderin Hyjnor. Ai më ka dhënë durim të plotë dhe më ka mundësuar të jem falënderues.*”<sup>35</sup>

Ka të ngjarë që në vitin 1940, Asije Hanëm, bashkëshortja e drejtorit të burgut të Kastamonut, sollë një xhybe 100 - vjeçare të trashëguar brez pas brezi, domethënë mantelin e veshur nga Meulana

Halid Bagdadi<sup>36</sup>, për t’ia dhuruar Bediuzzamanit. Duke ditur se ai nuk do ta pranonte atë si dhuratë<sup>37</sup>, ajo u konsultua me nxënësin e tij Mehmet Fejziun dhe vendosën që t’ia paraqesin xhyben si një “amanet”. Sidoqoftë, Bediuzzamani e pranoi atë me gatishmërinë më të madhe sikur të merrte pronën e tij. Bediuzzamani përmend në një letër se kur kishte marrë diplomën e përfundimit të studimeve në moshën 14 - vjeçare, ai kishte qenë shumë i ri për ta veshur mantelin dhe çallmën e dijetarit. Tani 56 vite më vonë, Meulana Halidi e kishte veshur atë me xhyben e tij personale mbi 100 vite distancë.

### Burgu i Denizli’së

Si Bediuzzamani edhe nxënësit e tij në Kastamonu, po ashtu edhe nxënësit e “Risale-i Nurit” në rajonin e Ispartës, si dhe në vendet e tjera, ishin nën presion të vazhdueshëm prej autoriteteve. Ky presion shtohet me kalimin e kohës, duke përfunduar me arrestimet e mëdha dhe me gjyqet e Denizlisë, si dhe me burgosjen në vitin 1943-

36. Meulana Halid Bagdadi është muxheddidi (ripërtëritësi i çështjeve të fesë) i pranuar i shekullit 19, i cili ka ndërruar jetë më 1827. Ndikimet e tij të shumta janë shtrirë qysh nga Azia e Mesme deri në Ballkan, nga Afrika e Veriut deri në Lindjen e Largët.

37. Bediuzzamani gjatë gjithë jetës së tij nuk ka pranuar kurrë zekat, sadaka apo dhuratë prej dikujt.

35. Nursi, *po aty*, f. 322.



1944. Në disa raste para kësaj, kopjet e “Risale-i Nurit” rrëmbeheshin pas kontrolleve, nxënësit arrestoheshin, pastaj merrnin pafajësinë dhe kopjet e “Risale-i Nurit” riktheheshin. Qëllimi kryesor i autoriteteve ishte të thyenin solidaritetin e nxënësve të “Risale-i Nurit”, duke mbjellë përçarje mes tyre, t’i frikësonin dhe t’i largonin prej shërbimit të tij. Ishte një përpjekje serioze dhe e planifikuar për të ndalur përhapjen e “Risale-i Nurit” nga ana e forcave brenda qeverisë, që punonin për çështjen e pafesisë.

Akuzat për burgosjen e Bediuzzamanit dhe nxënësve të tij do të ishin pak a shumë të njëjta. Ato akuza përfshinin krijimin e një tarikati, formimin e një shoqërie politike, kundërshtimin e reformave dhe shfrytëzimin e ndjenjave fetare në një mënyrë që do të shkelte sigurinë publike. Në vitin 1943 Bediuzzamanin, së bashku me 126 nxënësit e tij, i dërguan në burgun e Denizlisë, ku qëndruan për 9 muaj. Në qoftë se kushtet kishin qenë të këqija në burgun e Eskishehirit, në Denizli ato ishin akoma më të vështira. Bediuzzamani ka thënë se ai vuajti gjatë një dite në Denizli, shqetësimin e mundimin që kishte vuajtur për një muaj në Eskishehir. Ai u mbajt në izolim i vetmuar në kushte të tmerrshme, në një qeli të vogël, pa ajër, të lagësht e të errët. Ai përsëri u helmua në disa raste. Kurse nxënësit e tij u vendosën në një qeli

së bashku me të dënuarit me vdekje, me qëllim për t’u vrarë prej tyre. Qelia e Bediuzzamanit kishte një dritare të vogël me pamje nga oborri i ushtrimeve fizike i të burgosurve afatgjatë. Kështu, meqenëse Bediuzzamani ishte në një izolim të plotë dhe nxënësit e tij ishin të gjithë të burgosurit, që e kishin të ndaluar të flisnin apo të komunikonin me të, sepse dënoheshin me rrahje, ai u hidhte atyre nga kjo dritare, por edhe nga korridori, shënime, letra dhe pjesë që i shkruante. Ato shumë shpesh shkruheshin në copëza letre të mbështjella brenda kutive të shkrepëses. Ato letra kopjoheshin dhe dërgoheshin në mënyrë të fshehtë jashtë burgut, të cilat më pas shumoheshin nga nxënësit e “Risale-i Nurit” dhe përhapeshin në qytete të tjera.

Meqenëse ishte realisht “Risale-i Nuri” ai që ishte në proces gjyqësor, si fjala mbrojtëse e Bediuzzamanit, po ashtu edhe fjala mbrojtëse e nxënësve të tij, ishin në mbrojtje të “Risale-i Nurit”. Si përfundim, edhe këto akuza rezultuan me një fitore për të drejtën. E vërteta triumfoi mbi të gënjeshtërtën dhe “Risale-i Nuri” triumfoi mbi armiqtë e tij. Në fillim u përgatit raporti pozitiv nga komiteti i ekspertëve në Ankara dhe pastaj u shpall pafajësia. Gjithashtu, ajo u bë shkak që shumë zyrtarë, por edhe të tjerë, të lexonin disa pjesë nga “Risale-i Nuri”, i cili dha rezultate të favorshme. Raporti pohoi se 90%

e “Risale-i Nurit” përbëhej nga shpjegime shkencore e të thella për të vërtetat e besimit, dhe se këto pjesë nuk largoheshin aspak nga rruga e diturisë dhe e parimeve të fesë. Nuk ndodhej asgjë në këto vepra që sugjeronte se feja po shfrytëzohej, apo po formohej një organizatë, apo se ndodhej një lëvizje që do të prishte qetësinë e rendin publik. Në vitin 1944, duke u mbështetur kryesisht mbi forcën e raportit të komitetit të ekspertëve, gjykata shpalli vendimin e saj unanimit për pafajësinë e të gjithë të burgosurve dhe lirim të menjëhershëm të tyre.

Një faktor që ka kontribuar për pafajësinë e tyre, ishte gjithashtu ndryshimi i jashtëzakonshëm që u shkaktua në shumicën e të burgosurve të tjerë, nëpërmjet influencës së Bediuzzamanit dhe nxënësve të tij. E njëjta pati ndodhur deri diku në Eskishehir, por në burgun e Denizlisë, madje edhe kriminelët më të pandreqshëm, mësuan se si t'i kryenin namazet dhe si të lexonin Kur'anin, si dhe disa mësuan të ndihmonin nxënësit e “Risale-i Nurit” në shkrimin e kopjeve të tij. Kur ky përmirësim në sjellje nga të burgosurit u konstatua nga autoritetet e burgut, ata i lejuan kopjet të shumoheshin e shpërndaheshin pa kufizim. Ato iu dërguan gjithashtu Apelit dhe departamenteve përkatëse në Ankara, si mbrojtje e “Risale-i Nurit” dhe ishin instrumente për të siguruar

pafajësinë e tyre. Këtu u shkruan veprat: “Frutat e besimit”, si dhe nga kryevepra “Şualar” (Rrezet) u shkrua e 12 dhe 13-ta.

### Jeta në Emirdag

Kur Bediuzzamani dhe nxënësit e tij dolën nga gjykata, banorët e Denizlisë i përshëndetën ata me brohoritje, gëzim e hare. Brenda një ose dy ditësh, të gjithë nxënësit u shpërndanë dhe u rikthyen në qytetet e fshatrat e tyre. Pasi doli nga burgu, Bediuzzamani lëvizi te një dhomë në katin e sipërm të hotelit Shehir. Ai qëndroi aty për një muaj e gjysmë. Sapo u vendos, një numër i madh njerëzish nisën ta vizitonin, megjithëse ai ishte nën mbikëqyrje të vazhdueshme. Ata të cilët e vizitonin ndiqeshin dhe emrat e tyre regjistroheshin. Kështu, pavarësisht faktit se kishte marrë pafajësinë nga gjykata e Denizlisë dhe “Risale-i Nuri” kishte dalë i pastër, mbikëqyrja nën të cilën ai mbahej ishte më e rreptë se më parë dhe keqtrajtimet ishin më të ashpra.

Qeveria kishte urdhëruar që Bediuzzamani të vendosej në Emirdag. Kështu, Bediuzzamani arriti në këtë qytet të vogël provincial, i ngritur në një vend të lartë, në fund të gushtit 1944. Ai do të ishte vendi, ku do të qëndronte për shtatë vite të tjera, deri në tetor të vitit 1951, me shkëputjen e 20 muajve në burgun e Afjonit, nga janari i vitit 1948 deri

në shtator të vitit 1949. Shtëpia që u gjet për Bediuzzamanin ishte në qendër të qytetit, në një rrugë me shumë lëvizje, afër rajonit të policisë dhe të godinave të bashkisë. Me rojet e caktuara vazhdimisht te dera e shtëpisë së tij, ishte shumë e vështirë të shkoje tek ai për vizitë. Ai u helmua këtu tri herë, nga të cilat vuajti shumë, por vullneti i Zotit deshi që ai të shërohej dhe të vazhdonte me veprën “Risale-i Nur”. Ishte helmimi që e bëri atë të shkruante letrën e tij të parë nga Emirdagu për nxënësit e tij në Isparta, të cilët ai i deshi shumë, duke treguar ndër të tjera se ishin vetëm duatë e lutjet e tyre që e kishin shpëtuar atë nga “sëmundja e rëndë” prej së cilës ai kishte vuajtur. Këto letra do të vazhdonin në vijimësi korrespondencën mes tyre dhe më vonë do të përmbliidhen në librin “Emirdag Lahikasi”.

Ashtu si në çdo vend që ai dërgohej, Bediuzzamani tërhoqi nxënës që i shërbyen atij me besnikëri, duke sakrifikuar pa ngurrim veten, pronat apo pozitat e tyre për të dhe për “Risale-i Nurin”. Në Emirdag ishte familja Çalishkan ajo që mori përsipër ta ndihmonte dhe të kujdesej për nevojat e kërkesat e tij. Pastaj, edhe familjarët e tyre ndihmuan për t’ia plotësuar kërkesat personale, si dërgimin e ushqimit, të cilin gjithmonë ai e paguante, si dhe bënin gjithçka që ishte e domosdoshme që puna e “Risale-i Nurit” të vazhdonte. Në vitin 1946,

dy prej makinave shumëfishuese që kishin ardhur për herë të parë në Turqi, u blenë nga nxënësit e tij, duke u vendosur njëra në Isparta dhe tjetra në Inebollu. Tashmë kopjet e “Risale-i Nurit” ishin të përhapura në një shkallë shumë më të gjerë se sa më parë. Kjo e rriti shumë përhapjen e këtyre veprave, për më tepër, nuk kishte më pengesë në aspektin ligjor për botimin, qarkullimin dhe shpërndarjen e lirë të “Risale-i Nurit”.

Librat e “Risale-i Nurit” që u shumëfishuan me këto makina nga nxënësit e tij ishin: “Shkopi i Musait”, “Dhulfikari”, “Lamba Ndriçuese”, “Vula ratifikuese e së padukshmes”, “Prijsi i rinisë” dhe “Fjalët e Vogla”. Përveç këtyre librave, ishin edhe me mijëra kopje të pjesëve të tjera të “Risale-i Nurit” dhe letra të shumta, që Bediuzzamani ua shkroi nxënësve të tij rreth çështjeve të ndryshme. Në të njëjtën kohë, shkrimi i tyre me dorë dhe i pjesëve të tjera të “Risale-i Nurit”, si dhe letrat e Bediuzzamanit vazhdonin me ritëm të plotë.

Për më tepër, në këtë kohë, “Risale-i Nuri” dalëngadalë filloi të shpërndahej drejt botës islame. Kjo ndodhi, kur pas vitit 1947 u bë e mundur që “Risale-i Nuri” të shoqëronte haxhijtë në haxh. Kopjet e disave prej librave u dërguan në el-Ez’her të Egjiptit, në Damask dhe në Medine. Disa iu dhanë një dijetari fetar prej Kashmiri, i cili ra dakord që t’i përcillte ato te dijetarët indianë.

Gjithashtu, Salahuddin Çelebi në Inebollu, të cilin Bediuzzamani e quajti Abdurrahman Salahuddin, filloi të vendoste lidhje me disa misionarë amerikanë dhe për disa muaj u lexoi atyre veprat “Asay-ı Musa” (Shkopi i Musait), dhe “Dhulfikar”, duke jua bërë njëkohësisht dhuratë ato kopje.

Bediuzzamani vepronte gjithmonë me dashamirësi ndaj fëmijëve që mblidheshin rreth tij kur dilte, duke thënë se ata ishin nxënësit e ardhshëm të “Risale-i Nurit”. Ai tërhoqi pas vetes njerëz të çdo klase. Ai do t’u thoshte barinjve, punëtorëve, fermerëve ose këdo që takonte: *“Puna që ju bëni është një shërbim i madh për të tjerët. Për sa kohë që ju të kryeni pesë namazet e detyruara çdo ditë, e gjithë puna juaj do të shërbejë si adhurim që do t’ju sjellë dobi e përfitim në Ahiret.”*<sup>38</sup> Thirtja dhe interesimi i madh që Bediuzzamani u kushtoi këtyre njerëzve pati efekt të konsiderueshëm, sepse shumë prej atyre fëmijëve, u bënë në të ardhmen nxënësit e “Risale-i Nurit” dhe i shërbyen çështjes së fesë e të Kur’anit. Në Emirdag, ndershmëria dhe drejtësia e dyqanxhinjve, tregtarëve dhe zejtarëve u bënë të mirënjohura. Madje edhe një polic i veshur civil, i dërguar për të spiunuar Bediuzzamanin në vitin 1947, e vërejti këtë duke blerë gjalpë, kur pa dyqanxhiun ta peshonte letrën veç. Në fjalët e tij tha: “Ishte Bediuzzamani që e bëri Emirdagun kështu!”

38. Nursi, *po aty*, f. 449.

## Burgu i Afjonit

Përhapja e shpejtë e “Risale-i Nurit” për tre vite e gjysmë, nga viti 1944 deri në fillim të vitit 1948, nxiti autoritetet të marrin parasysh seriozitetin e situatës, si dhe armiqhtë e fesë të shtonin presionin ndaj Bediuzzamanit dhe nxënësve të tij. Aty rreth fundit të vitit 1947, presidenti i kohës Ismet Inonu vizitoi qytetin e Afjonit dhe mbajti një fjalim, në vijim të të cilit presioni dhe sulmet ndaj Bediuzzamanit u shtuan. Pas kësaj, policia lëvizi kundra nxënësve të “Risale-i Nurit” në provincat e Ispartës, Kastamonus, Konjas dhe në shumë të tjera. Shtëpitë kërkoheshin e bastiseshin, si dhe hetimet vazhdonin. Në të njëjtën kohë, Bediuzzamani iu nënshtrua një sërë bastisjesh krejtësisht të paligjshme, sulmesh dhe bezdisjesh. Gjatë kërkimeve në shtëpinë e Bediuzzamanit ata nuk gjetën asgjë, por morën Kur’anin e tij dhe disa fletë të shkruara në arabisht.

Dy policë u urdhëruan që ta çonin Bediuzzamanin te rajoni i policisë. Duke dështuar për ta zemëruar atë nëpërmjet bastisjes së shtëpisë së tij, ata u përpoqën përsëri të provokonin një incident, duke u orvatur ta bënin Bediuzzamanin gazin e botës, duke u përprjekur me forcë t’ia hiqnin çallmën dhe ta detyronin atë të vinte një kapele në publik, gjatë marrjes për të bërë raportimin e tij. Ata përsëri dështuan. Bediuzzamani që e dalloj

këtë komplot, por edhe të tjera për shfarosjen e tij dhe të nxënësve të vet, tregoi një durim të madh, dhe në letrat që u dërgoi nxënësve, i paralajmëroi që të mos bien në lojën e tyre. Ai thotë: *“Jam gati të sakrifikoj 1000 herë jetën time, dinjitetin dhe nderin tim, për sigurinë e këtij kombi dhe për qetësinë në këtë botë dhe lumturinë në botën tjetër, veçanërisht për fëmijët e pafajshëm, për të ngratët dhe të moshuarit, për të sëmurët dhe të varfrit.”*<sup>39</sup>

Megjithëse komplotet dhe përpjekjet e tyre nuk dhanë rezultat, ata po me të njëjtat akuza menduan burgosjen e tretë dhe më të keqe, në një shkallë më të gjerë për Bediuzzamanin dhe nxënësit e tij. Kështu, Bediuzzamani dhe nxënësit e “Risale-i Nurit” hynë në shkollën e tyre të tretë të Jusufit (a.s.), Medrese-i Jusufije, më 23 janar 1948. Është e qartë se burgosja e Bediuzzamani dhe dënimi i nxënësve të tij, ishin një përfundim i ditur me kohë. Pas marrjes së pafajësisë prej gjykatës në Denizli, armiqtë e tyre ishin të vendosur që t’i nxirrnin ata fajtorë me çdo kusht, ndonëse kjo do të thoshte “mos respekt ndaj tri gjykatave më të mëdha, shpërfillje ndaj nderit e drejtësisë së tyre, madje, fyerje ndaj tyre”, sepse akuzat ishin të njëjta.

Pas procedurave paraprake, seancat e gjyqit filluan gati katër muaj pas arrestimit të tyre dhe vazhduan për gjashtë muaj e gjysmë.

39. *Bediuzzaman Said Nursi kimdir? (Uzun Biyografi)*, po aty.

30 prej nxënësve u gjykuan në gjendje të lirë, kurse Bediuzzamani dhe 19 nxënës u gjykuan nën arrest. Komiteti i ekspertëve i ngritur për Bediuzzamanin, iu nënshtrua presionit nga qeveria dhe parashtroi dy çështje kryesore, të cilat prokurori i përdori kundra tij, ndonëse vetëm para tre viteve ekspertët e kishin nxjerrë të pafajshëm “Risale-i Nurin”. Ata vetë i hodhën poshtë akuzat e formimit të një tarikati, të organizimit të një shoqërie politike dhe të prishjes së rendit publik, dhe i përqendruan kundërshtitë e tyre, mbi trajtesën “Rrezja e pestë”, si dhe qenien e tij mendjemadh e mburravec, nëpërmjet së cilës ai synonte të ndërtonte, me anë të dëshirës së mirë të nxënësve ndaj tij, një pozitë fuqie e prestigji personal, akuza që Bediuzzamani me argumente i përshkroi si të padrejta, të pasakta dhe të pajustificueshme.

Me të gjitha vonesat dhe zvarritjet, gjykata përfundimisht e shpalli vendimin e saj më 6 nëntor 1948, duke shpërfillur të gjitha dëshmitë dhe duke shpallur Bediuzzamanin fajtor në bazë të nenit 163 të Kodit Penal në drejtime të ndryshme si “shfrytëzimin e ndjenjave fetare dhe nxitjen e njerëzve kundra qeverisë”. Ajo gjykatë e dënoi Bediuzzamanin me 2 vite dënim me punë të detyrueshme, dënim i cili u shkurtua në 20 muaj për shkak të moshës së tij, ndërsa nxënësit e tij u dënuan me burg

për disa kohë që varionte nga pak ditë deri në 18 muaj; shumica e tyre qëndruan atje 6 muaj.

Bediuzzamani u vendos në një qeli me 70 persona, e cila kishte 24 dritare dhe ku shumica e xhamave ishin të thyera. I sëmurë dhe me ethe, ai u la krejtësisht i vetmuar në këtë dhomë, me rryma ajri e me temperaturë nën zero, pa sobë apo mjet ngrohjeje. Duke qenë më shumë se 70 vjeç, i ngrirë nga i ftohti, i dobësuar nga mungesa e ushqimit, në disa raste duke qenë në prag të vdekjes (3 herë nga helmimi), i lënë pa kujdesin e nevojshëm, duke vuajtur mjerimin që është e vështirë të imagjinohet, Bediuzzamani vazhdoi të shkruante për orientimin e nxënësve të tij dhe atë të burgosurve të tjerë. Ai i kalonte netët në falje, lutje e shqyrtim, duke përpiluar fjalën e tij mbrojtëse dhe të nxënësve, me qëllim që të bëjë të njohur realitetin e çështjes, si dhe për të mbrojtur “Risale-i Nurin” kundra këtij sulmi të fundit.

Gjatë këtyre 20 muajve, Bediuzzamani u shkroi disa letra kryesisht të shkurtra, nxënësve të tij në burg për çështje të ndryshme. Brendia më e rëndësishme e atyre letrave ishte nxitja që u bënte

nxënësve që ta shohin burgosjen e tyre pozitivisht, nën dritën e urtësisë hyjnore si një sprovë e testim, i cili paraqet mundësi të reja për t’i shërbyer Kur’anit nëpërmjet “Risale-i Nurit”. Bediuzzamani shkroi këtu broshurën “El-Huxh-xhetuz’zehra” (Rrezja 15). Më pas, për t’i dhënë zhurme e shqetësim, Bediuzzamani u detyrua forcërisht të lëvizë te turma dhe zhurma e krahut të pestë të burgut, ndonëse ajo lëvizje më vonë doli të ishte mëshirë. Të burgosurit filluan të konkurronin me njëri-tjetrin se kush do ta ndihmonte më shumë Bediuzzamanin, dhe shumë prej tyre filluan të kryenin pesë namazet e detyruara.

Pas shumë peripevice mes shkallëve të gjykatave, sidomos insistimit të prokurorit për dënimin e tij, 20 muajt kaluan dhe Bediuzzamani u lirua. Dhe përfundimisht, duke u mbështetur në raportin e një grupi ekspertësh nga drejtoria e çështjeve fetare, në qershor të vitit 1956, gjykata e Afjonit e shpalli të pafajshëm “Risale-i Nurin” dhe urdhëroi që të gjitha kopjet e konfiskuara t’u ktheheshin pronarëve të tyre.

...vazhdon në numrin e ardhshëm

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Alparslan Açıkgenç, *Said Nursi*, İslam Ansiklopedisi, TDV, V. 35.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, Sözlere Neşriyat, shqipëroi Jusuf Salkurti, İstanbul 2010.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Sözler - Fjalët, Nga Koleksioni i Risale-i Nurit*, Sözlere Neşriyat, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti, İstanbul 2006.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Mektubat, Risale-i Nur Külliyyatından (Terimli, Lügatli, Kaynaklı, İndeksli)*, Söz BasımYayın, İstanbul 2004.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Şualar, Risale-i Nur Külliyyatından*, Şahdamar Yayınları, İstanbul 2007.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Lem'alar, Risale-i Nur Külliyyatından*, Yeni Asya Neşriyat, Germany, 1994.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Emirdağ Lahikası, Risale-i Nur Külliyyatından (Lügatli, Kaynaklı, İndeksli)*, Söz BasımYayın, İstanbul 2012.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Hutbe-i Şamiye, (Arapça Metin İlaveli)*, Yeni Asya Neşriyat, İstanbul 2016.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Sikke-i Tasdik-i Gaybi, Risale-i Nur Külliyyatından*, Söz BasımYayın, İstanbul 2000.
- Bediüzzaman Said Nursi'nin Kronolojik Hayatı*, Risale-i Nur Araştırmaları Platformu, bediuzzaman-said-nursinin-kronolojik-hayati.pdf
- Bediüzzaman Said Nursi kimdir? (Uzun Biyografi)*, sorularlarisale.com, makale.
- Necmeddin Şahiner, *Bilinmeyen Taraflarıyla Bediüzzaman Said Nursi*, Nesil Yayınları, İstanbul 1994.
- Niyazi Beki (Dr.), *Kur'an İlimleri ve Tefsir Açısından Bediüzzaman Said Nursi'nin Eserleri*, Timaş Yayınları İstanbul, 1999.
- Ramazan Ballxhë (Dr.), *Jeta dhe vepra e këshilltarit të shekullit Bediüzzaman Nursiut*, shtëpia botuese "Gelenek", përktheu Abdylkadir Haktanër, Stamboll 2003.
- Suat Yıdırım (Prof. Dr.), *Risale-i Nurun Kur'an tefsirindeki yeri*, risalehaber.com, makale.
- Tubanur Tarhan & Ayşenur Osmanoglu, *Bir Kitap Bediüzzaman Said Nursi: Entelektüel Biyografisi*, DergiPark Akademik, İktisat sayısı, Yıl 2017, Sayı: 3.
- Thomas Michel (Prof. Dr.), *Bediüzzamane göre Müslümanlık-Hristiyanlık Münasebetleri*, Etkileşim Yayınları, İstanbul 2006.

## Gjumi si argument

Blerim Lazimi

### Abstrakt

Nga argumentet e besimit, që Allahu i sjell dhe ia numëron njeriut në tekstin e Fjalës së Tij të Lartë, është edhe gjumi. Meqë gjumi është përmendur në Kur'an si argument (nën bijen e termit "ajet"), atëherë besimtari dhe kushdo tjetër, pa mospërfillje e indiferencë, mund të nxjerrë mësimet e dubura, shumë të rëndësishme për jetën. Në këtë kontekst është mjaft i qartë Allahu në Kur'an: **"Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë mushkonjë a diçka edhe më e imët se ajo. Për sa u përket atyre që besuan, ata e dinë se ai (shembull) është i vërtetë nga Zoti i tyre, ndërsa ata të cilët mohuan do të thonë: "Ç'deshi Allahu me këtë si shembull?" Ai me të humb shumë, e po me të udhëzon në rrugën e drejtë shumë, po me përjashtim të atyre që janë jashtë rrugës, Ai me të nuk humb tjetër."**<sup>1</sup> Ndërsa, Bediuzaman Said Nursi, falë urtësisë së dhuruar nga Krijuesi, na orienton si ta lexojmë krijimin e Allahut dhe si t'i drejtëkuptojmë ajetet e Kur'anit. Si një mësues i shkëlqyer, Bediuzamani na shpjegon në formën e një parimi se çdo gjë e krijuar nga Allahu shfaqet në tri fytyra. Njëra nga fytyrat shikon dhe të përcjell tek Emrat e Bukur Hyjnorë. Tjetra fytyrë të fton në zbulimin e së vërtetës së përjetësisë. Dhe fytyra e tretë, e cila shikon me sytë e nefsit (ego-s), të shoqëron në përkohshmërinë, pasigurinë, dyzimet dhe tekat e jetës tokësore. Ashtu si për çdo krijesë të Allahut, ky parim i Bediuzamanit na mëson se nëpërmjet dritës kur'anore t'ia shikojmë edhe "gjumit" tri fytyrat. Dhe, më tej, të lexojmë në to mesazhin e besimit në Allahun dhe në Ahiret (Botën Tjetër). Kjo është metodika e të kuptuarit të gjubës së krijimit, me të cilën na udhëzon Allahu që në ajetin e parë të shpallur nga Kur'ani **"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)!"**<sup>2</sup>

---

1. Kur'an (2/26), f. 34, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

2. Kur'an (96/1), f. 722, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.



**D**uke lexuar Kur'anin, herë pas here të shfaqen ajete-argumente, të cilët të informojnë apo të nxisin të kërkosh për fenomene natyrore dhe veprimtari jetësore që lidhen drejtpërdrejt me vetë njeriun si krijesë. Diku, me një stil të shtruar kur'anor shpjegimi, njeriu mëson një e nga një fazat e ngjizjes së tij si krijesë në barkun e nënës (Kur'an, 23/15). Diku tjetër rrufeshëm, sa hap e mbyll sytë, i rrëfëhet jeta (Kur'an, 80/17-22). Diku tjetër, Allahu ia kujton njeriut procese jetësore si rritjen, lëvizjen, frymëmarrjen, të dëgjuarit, të shikuarit, të menduarit, të ushqyerit, plakjen, mundimet e jetës, e, ndër to, edhe gjumin. **“Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën dhe ditën, edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon.”**<sup>3</sup> Siç lexohet në këtë ajet kur'anor , gjendja e gjumit cilësohet në gradën e argumentit (me termin “ajet”), njëlloj si qiejt e toka, si errësira e drita, si nata dhe dita, si malet dhe uji, si kafshët dhe bimët, etj. Në Kur'an gjejmë të flitet drejtpërdrejt për gjumin në afro 9 vende.

### **Përkufizimi shkencor që shkon kokulur te burimi i dijes, Kur'ani**

**Gjumi përkufizohet shkencërisht si një gjendje e natyrshme pushimi**

3. Kur'an (30/23), f. 464, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

**dhe e përsëritshme për trupin e gjallesave.** Gjumi karakterizohet si një prehje trupore dhe mendore, domethënë shoqërohet me zvogëlim të aktivitetit lëvizor të trupit dhe rënie të reagimit ndaj ngacmimeve të jashtme. Edhe pse konsiderohet si pushim, gjatë gjumit në organizëm zhvillohen procese mjaft të ndërlikuara dhe intensive. Për shembull, vlerësohet se disa qeliza në tru arrijnë një aktivitet 5 deri në 10 herë më të lartë se në gjendjen zgjuar. Gjithashtu, gjatë gjumit ndodhin dy procese bio-kimikë shumë të rëndësishëm, të kundërt në dukje, por bashkë-plotësues perfektë në funksion: bie në nivele të ulëta katabolizmi (shkatërrimi i qelizave) dhe rritet në nivele të larta anabolizmi (ripërtëritja e qelizave). Te njeriu, gjumi ndikohet nga faktorë të ndryshëm hormonalë (melatonina, kortizoli), që më së shumti lidhen me ciklin ditë-natë (dritë-errësirë). Me ardhjen e natës (errësirës), truri rrit prodhimin e hormonit melatoninë. Kjo sjell gjendjen e gjumit për organizmin. Me ardhjen e ditës, pra me ekspozimin e trupit ndaj dritës, truri “jep komandën” dhe ndalon prodhimin e melatoninës. Tamam si një mekanizëm “rele”, kjo sjell zgjimin. Prandaj, **një gjumë në kohën e duhur, në sasinë e duhur, i rehatshëm dhe i qetë, konsiderohet i domosdoshëm biologjikisht për një jetë të shëndetshme.** Këtë e kuptojmë

më mirë kur vuajmë pagjumësinë dhe pasojat e saj. Mungesa e gjumit dëmton rëndë raportin katabolizëm-anabolizëm, shkakton çrregullime shëndetësore në organizëm, prodhon sëmundje, apati, shpërqendrim, mungesë efektshmërie në punë, depresion, shkurt një jetë plot telashe. Këto informacione sipërfaqësore që përmendëm, tregojnë se **gjumi ka funksion ripërtëritës të trupit dhe të trurit, gjë që i ka detyruar studiuesit ta përkufizojnë gjumin si pushim trupor, prehje mendore, si gjendje e natyrshme e domosdoshme qetësuese, çlodhëse dhe ripërtëritëse.**

A nuk e gjejmë edhe në Kur'an, afro 14 shekuj më parë, të njëjtin përkufizim për gjumin, madje të përsëritur në dy ajete? **“E ai është që natën ua bëri petk, gjumin pushim e ditën e bëri për gjallërim.”**<sup>4</sup> **“Dhe gjumin tuaj ua bëmë për pushim. Dhe natën ua bëmë mbulesë (si rrobat). Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim.”**<sup>5</sup> Është interesant të vihet në dukje se në suret 25, 30 dhe 78, bashkëngjitur me karakterizimin e gjumit si pushim dhe çlodhje, lexojmë për natën si petk gjumëndjellës dhe për ditën që sjell zgjimin dhe gjallërimin. Ja pra, si

na ka treguar Allahu, përmes Fjalës së Tij, që gjendja e gjumit te njeriu është e lidhur ngushtësisht dhe përcaktohet nga cikli astronomik tokësor natë-ditë. Ky është një prej ligjeve të Allahut, që për njeriun konsiderohet si natyrshmëri. Edhe Lajmëtari i Allahut, Muhamedi (a.s), me këtë përkufizim kur'anor i drejtohej me lutje Allahut Krijues *“O Ti që e bëre natën mbulesë! O Ti që e bëre ditën për gjallërim! O Ti që e bëre gjumin për pushim!”*<sup>6</sup>

Gjithashtu për efektin qetësues, ripërtëritës në energji dhe freskues të gjumit, Allahu na informon edhe kur përshkruan në Kur'an ngjarje të rëndësishme që shoqërojnë herë pas here jetën e shoqërive. Në Luftën e Bedrit, ndër të tjera përmendet edhe gjumi (i shkurtër) si faktor ndikues, qetësues e siguries psiko-fizik: **“Dhe kur Ai ju kaploi me një kotje (gjumë) që ishte siguri për ju nga ana e Tij, ju lëshoi shi nga qielli për t'ju pastruar me të, largoi prej jush të shtimet e shejtanit, e që të fuqizojë bindjen në zemrat tuaja dhe t'ju përforcojë me të (me shi) këmbët tuaja.”**<sup>7</sup> Edhe në Luftën e Uhudit përmendet e njëjta gjë: **“Mandej, pas asaj tronditjeje të rëndë, Ai u lëshoi sa për qetësim, një kotje (gjumë të lehtë) që i kaploi një grup prej jush, kurse një grup**

4. Kur'an (25/47), f. 417, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

5. Kur'an (78/9-11), f. 690, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

6. “Xheushen el-Kebijr”, porta 67.

7. Kur'an (8/11), f. 214, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

**e kishte preokupuar vetëm çështja e vetvetes...<sup>8</sup>** Ndërsa në ndodhinë e Djelmoshave të Shpellës (Kur'an, 17/9-26) gjumi ishte i gjatë në kohë. Shpella ishte e mbyllur dhe kishte errësirë të plotë, pa kuptuar fare as lindjen e perëndimin e diellit, as ditën e as natën, si “komanduese” të prodhimit të hormonit melatoninë.

Duke vrojtuar enigmën e plotë të këtyre ajeteve që flasin për gjumin, mësojmë se përkufizimi shkencor shkon pikë për pikë me deklarin kur'anor. Edhe një herë studimet shkencore dëshmojnë vërtetësinë e Kur'anit dhe zbërthejnë në detaje ligjet e Allahut Krijues, të Gjithëditur e Urtësiplotë. Me të drejtë i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), në agim të ditës falënderonte Allahun “Lavdi Allahut që ka krijuar gjumin dhe zgjimin!”

“Dyjajaja dhe të gjitha gjërat kanë tri fytyra”, - shkruan Bediuzaman Said Nursi te “Mektubat” (Letrat). Pastaj shpjegon:

“Fytyra e parë: Shikon tek Emrat e Bukur Hyjnorë dhe është pasqyra e tyre. Vdekja, ndarja dhe mos ekzistenca nuk mund të ndërhyjnë në këtë fytyrë. Përkundrazi, në të ka ripërtëritje dhe rifreskim.

Fytyra e dytë: Shikon tek Ahireti dhe vështron te Bota e përjetshmërisë. Ajo është si një tokë e lërueshme. Në këtë fytyrë piqen fruta të qëndrueshëm. Kjo fytyrë i shërben

qëndrueshmërisë dhe i bën gjërat e përkohshme gjëra të përhershme. Gjithashtu, në këtë fytyrë, nuk ka vdekje e zhdukje, por manifestime të jetës dhe të përjetshmërisë.

Fytyra e tretë: Shikon te qeniet e përkohshme, domethënë shikon tek ne. Ajo është e dashura e qenieve të përkohshme dhe e atyre që ndjekin tekat e nefsit të tyre. Ajo është vend tregtie për të vetëdijshmit, është fushë provimi e testimi për ata të cilët janë ngarkuar me detyra...<sup>9</sup>”

### **Cilësitë e Larta të Allahut (fytyra e parë)**

Një tjetër fakt, që e “ngre” gjendjen e gjumit në gradën e argumentit, është përmendja e tij në “Ajetin Kursijj”, i cili konsiderohet si ajeti më i madh i Kur'anit. **“Allahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikëqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotje, as gjumë. Gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij. E di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen. Nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar. Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshijnë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave nuk i vjen rëndë. Ai është më i larti, më i madhi.”<sup>10</sup>**

8. Kur'an (3/154), f. 101, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

9. “Mektubat” (Letrat), Said Nursi, faqe 437.

10. Kur'an (2/255), f. 71, përkthim me

Me të vërtetë njeriu është formësuar në një organizëm që funksionon mrekullueshëm, por, njëkohësisht, ai paraqet një qenie të paplotë (të mangët) dhe nevojtare. Njeriu lind, rritet, jeton, vdes... Ka uri dhe etje, ndaj i nevojitet ushqim e pije. Ai lëviz, punon, mendon dhe ndjen lodhje, ndaj i nevojitet energji. Ai gëzon, emocionohet, por edhe hidhërohet, apo inatoset. Ka dëshira, pasione e ëndrra, por ka edhe zhgënjime, ankthe e depresion. Këto mangësi (paplotësi) e bëjnë domosdoshmërisht njeriun qenie nevojtare, jo ndaj sendeve apo proceseve natyrore, por ndaj Garantuesit të zgjidhjes së nevojave, ndaj Krijuesit të çdo gjëje dhe të shkaqeve, ndaj Allahut që është i Lartësuar, i Pastër nga çdo e metë. Është më së paku pakujdesi dhe paradoksale të mendosh se njeriu, si qenie inteligjente, t'i adresojë nevojat te gjëra jointeligjente si oksigjeni, uji, ushqimet, gjumi, etj., etj. Një mendjeshkurtësi e tillë është njëlloj si të thuash se kompjuteri ka nevojë për programe, apo energji elektrike, duke mohuar tërësisht njeriun që e ka prodhuar dhe e vë në punë atë, apo edhe që projekton e harton programet kompjuterike, apo e ushqen me energjinë elektrike kompjuterin.

Njeriu ka nevojë për gjumë, madje më shumë edhe se për ujë e

---

komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

ushqime. Shkencërisht njeriu mund të jetojë afro 70 ditë pa u ushqyer, por nuk mund të jetojë më shumë se 11 ditë pa gjumë. Ky fakt pasqyrohet saktë edhe në renditjen e argumenteve në formulimin e ajetit 23 (Kur'an, 30/23), ku më parë përmendet gjumi dhe më pas të mirat, begatitë e Allahut. **“Nga argumentet e Tij është edhe gjumi juaj natën dhe ditën, edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon.”**<sup>11</sup> Pikërisht kjo nevojë periodike për gjumë ia kujton e ia rikujton për çdo ditë njeriut që ta njohë vetveten si të paplotë e nevojtar dhe të mendojë e besojë se është Allahu, i Vetmi, Shkaktuesi i gjithçkaje dhe Përcaktuesi, është i Gjallë dhe Mbikqyrësi i Përvetshëm, është Sunduesi i qiejve dhe tokës, Ai është më i Larti, më i Madhi. Për ta arritur këtë njohje të Allahut, me të drejtë, në përditshmërinë e myslimanit, këshillohet të lexohet 8 herë përgjatë ditë-natës “Ajeti Kursij”. Ndërsa i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), në lutjet e tij, duke kërkuar mëshirë dhe mbrojtje nga zjarri i Xhehenemit, ndër të tjera, i drejtohej Allahut me emrin “O Mbikëqyrës i pafjetur!” (“Ja Rekijbu la jenam!”)<sup>12</sup>. Prandaj edhe gjumi, në syrin e besimtarit, është një provë që

11. Kur'an (30/23), f. 464, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

12. “Xheushen el-Kebijr”, porta 32

të udhëzon në njohjen dhe lartësimin e Allahut, një shenjë që dëshmon Cilësitë e Larta dhe Emrat e Bukur të Allahut.

### Gjumi, zgjimi dhe ... Ringjallja (fytyra e dytë)

Cikli gjumë-zgjim shërbehet në Kur'an edhe për të argumentuar një çështje shumë të rëndësishme të besimit, Ringjalljen. Janë dy ajete në Kur'an, në të cilat Allahu zbulon për ne diçka nga fshehtësitë e gjumit, zgjimit, vdekjes dhe ringjalljes. **“Ai është që ju merr shpirtat (ju vë në gjumë) natën dhe e di çka vepruat ditën, pastaj ju ngjall-zgjon në të (ditën) deri në afatin e caktuar (vdekje). Pastaj do të ktheheni e do t’ju njoftojë me atë që keni pas vepruar.”**<sup>13</sup> **“Allahu i merr shpirtat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur. E, atij që i është caktuar vdekja, e mban (nuk e kthen), e atë tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon (të kthehet) deri në afatin e caktuar. Vërtet, në këto ka argumente për një popull që mendon.”**<sup>14</sup>

Së pari, Allahu na sjell në

vëmendje modelin (shembullin), për të kuptuar bindshëm funksionimin e një ligji edhe në realitete të tjera. “Ndonjëherë ndodh në Kur'an , me qëllim që të ngulisë në zemër veprat e mrekullueshme që Ai do t’i kryejë në Ahiret dhe, me qëllim që të përgatisë mendjen për t’i pranuar ato, Allahu i Plotfuqishëm përmend vepra të mrekullueshme që Ai i kryen në këtë botë, si një lloj përgatitjeje. Ose, Ai, ndonjëherë, përmend veprat e mrekullueshme që do t’i kryejë në të ardhmen dhe në Ahiret, në një mënyrë të tillë që ne bindemi me ato përmes analogjisë me vepra të ngjashme, të cilat ne i shikojmë në këtë botë...”<sup>15</sup> Domethënë, përballë mohimit të ringjalljes, Allahu na kujton ciklin gjumë-zgjim, si një përvojë e përditshme, për të qartësuar thjeshtë realitetin e pritshëm vdekje-ringjallje. Edhe termat (në arabisht) e përdorur tërthorazi për “gjumin” në dy ajetet janë të njëjtë (në analogji me vdekjen). “Njeriu, i cili krijohet çdo natë në gjumin, që është një lloj vëllai i vogël i vdekjes dhe i cili çdo mëngjes hap sytë në këtë botë sikur të ringjallej, do të thotë se i vëzhgon çdo ditë shenjat e kiametit dhe ringjalljes.”<sup>16</sup> Të njëjtën metodë argumentimi nëpërmjet modelit (shembullit), për çështjen e ringjalljes, Kur’ani na e

13. Kur'an (6/ 60), f. 169, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

14. Kur'an (39/ 42), f. 531, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

15. Përmbledhja Risale-i Nur, Fjala e Dhjetë, “Ringjallja dhe Bota tjetër”, f. 145, Bediuzzaman Said Nursi, Sozler.

16. “Udhërrëfyesi i një muslimani - Besimi”, f. 215, Prizmi, Tiranë 2008.

ofron edhe kur përmend gjallërimin e tokës së thatë e të shkretë pas shiut.

Së dyti, edhe nga pikëpamja shkencore vlerësohet se organizmi ynë vazhdimisht është në proceset “vdekje-prodhim” të qelizave, që janë njësisia jetësore bazë e ndërtimit dhe funksionimit të trupit. Në trupin e njeriut ka me dhjetëra trilion qeliza. Pranohet që çdo minutë vdesin rreth 300 milion prej këtyre qelizave. Në qoftë se organizmi i trupit nuk do t’i zëvendësonte në mënyrë të vazhdueshme ato, të gjitha qelizat e trupit do të vdisnin për 230 ditë. Kurse gjendja e gjumit është intervali kohor kur minimizohet vdekja e qelizave (katabolizmi) dhe maksimalizohet prodhimi i qelizave të reja (anabolizmi). Domethënë, gjatë gjumit raporti vdekje-riprodhim shkon në favor të jetës, në një farë mënyre, në favor të besimit në ringjallje. Me të drejtë, falë njohjes shpirtërore (*irfan*), dijetari i shekullit të kaluar Hamdi Jazër (1878 – 1942), në komentin e ajetit 60 (Kur’an, 6/60), për fragmentin “**dhe ju ngjall-zgjon në të** (ditën)”, bën një vlerësim bindës: “Allahu jua kompenson dhe rinovon në gjumë, pa e ditur ju, pjesët e trupit që ju janë dëmtuar, ose që ju kanë vdekur dhe, duke jua kthyer përsëri në mëngjes vetëdijen dhe aftësinë njohëse, që jua pati marrë, ju ringjall dhe ju zgjon me jetën tuaj materiale e shpirtërore të mëparshme. Vetëm atëherë ju i dalloni ditën dhe natën, i njihni veten dhe arritjet tuaja

sikur të mos i kishit humbur fare, sikur në mes të mos kishte ndodhur asnjë ndërprerje. Të dyja jetët materiale-shpirtërore që ka njeriu ndodhen çdo ditë e çdo natë, madje, çdo çast, në një “ringjallje” të tillë materiale-shpirtërore. Edhe nëse shumë njerëz e pranojnë këtë si një ringjallje në kuptim të figurshëm, po qe se çështja shihet seriozisht me një sy shkencor, del në shesh se kjo është një ringjallje me kuptimin e vërtetë të fjalës.”<sup>17</sup> Pra, ky rigjenerim i vazhdueshëm i qelizave të vdekura, ky rigjenerim i përditshëm i organizmit (që tashmë e pohon edhe shkenca), i kujton herë pas here njeriut të pavëmendshëm e të pakujdesshëm se, ashtu si Krijuesi e krijoi së pari, me të njëjtën lehtësi do ta rikrijojë, do ta ringjallë atë edhe pas vdekjes. Eja në vete o njeri, ktheja shpinën mosbesimit, apo dyshimit dhe beso sinqerisht në Allahun, i Cili sjell krijim pas krijimi dhe në Ringjalljen që do të vijë! Me këtë besim, i Dërguari Fisnik i Allahut, Muhamedi (a.s.), për çdo mëngjes e mbrëmje përkujtonte Allahun. Ai (a.s.) kur zgjohej nga gjumi falënderonte: “*Lavdërimi i përket Allahut që na ringjall pas vdekjes! Dhe kthimi ynë është tek Ai!*” dhe më tej vazhdonte “*Lavdi Allahut që ka krijuar gjumin dhe zgjimin! Lavdi Allahut që më ringjall mua të shëndosbë dhe të përkyer! Dëshmoj se Allahu i ringjall të vdekurit dhe se Ai ka mundësi për çdo gjë!*”<sup>18</sup>

17. “Udhërrëfyeti i një muslimani - Besimi”, f. 214, Prizmi, Tiranë 2008.

18. “Fikhus Sunneh”, Sejid Sabik, f. 721-723,

Me këto lutje dhe përkujtime duhet ta nisë ditën edhe myslimani, për të dëshmuar besimin në Allahun dhe besnikërinë në rrugën e të Dërguarit Muhamed (a.s.).

“Namazi është më i dobishëm se gjumi!”

“Namazi është më i dobishëm se gjumi!”

Gjumi përmendet edhe në një nga simbolet dalluese të jetës së përditshme të një myslimani, tek ezani, i cili jo rastësisht është frymëzim gjatë një ëndrre të përsëritur (pra, një fazë të gjumit). Kjo thirrje është pjesë e ezanit vetëm për namazin e sabahut (agimit të ditës). Siç dihet, ezani është thirrja për në namaz. Ai lajmëron përfundimin e vlefshmërisë së një vakti (intervali kohor) faljeje dhe fillimin e vaktit tjetër. Ezani i sabahut thirret në kohën që tregon përfundimin e natës (errësirës së plotë) dhe fillimin e muzgut të mëngjesit (agimit).

Nevoja për gjumë është e ndryshme në mosha të ndryshme dhe në organizma të ndryshëm. Zakonisht, nevoja për gjumë te njeriu vjen duke u zvogëluar me rritjen e moshës. Gjithsesi, qoftë sipas ajeteve të Kur’anit, qoftë sipas shkencës, cikli gjumë-zgjim përcaktohet sipas ciklit astronomik natë-ditë. Në këtë ligjshmëri të natyrshme, që ndërlihd një fenomen astronomik me një proces biologjik, përfundimi i natës (errësirës së plotë) duhet të sjellë “mekanikisht”

AIITC, Tiranë, 2005 dhe “Libri i lutjeve”, F. Gylen, f. 11, Prizmi, Tiranë, 2006.

zgjimin, domethënë përfundimin e gjumit. Jeta e një myslimani të devotshëm, që zbaton me përpikëri Kur’anin dhe praktikën profetike, është e rregulluar në harmoni të plotë me këtë natyrshmëri (*fitreh*). Përveç ditëve kur agjëron apo namazeve të veçanta që mund të falë gjatë pjesës së fundit të natës, myslimani e fillon regjimin e tij ditor me zgjimin që me shfaqjen e agimit dhe vazhdon më tej me faljen e namazit të sabahut, duke pritur ditën e re me adhurim, përkujtim e lavdërim ndaj Allahut, Zotit të errësirës dhe dritës. Pastaj, lindja e diellit, dita e re, e fton myslimanin e rigjeneruar me energji fizike, mendore dhe shpirtërore, në angazhimet e jetës personale, familjare e shoqërore. Në këtë këndvështrim, këshillohet dhe këmbëngulet fetarisht që fëmijët që në vegjëli të mësohen dhe edukohen me të fjeturit herët në mbrëmje, që gjumi të jetë i mjaftueshëm kur të zgjohen në mëngjes herët. Ndërsa përvoja popullore në edukimin e të rinjve e ka materializuar dobinë e këtij organizimi të jetës ditore, kur përkufizon “Kismetet ndahen herët në mëngjes”. Prandaj, o njeri, dëgjoje me respekt dhe përgjigju zërit të minareve: “Namazi është më i dobishëm se gjumi!” Shqitju shtratit joshës, koha biologjike e gjumit skadoi, boll fjete, lidhu me Allahun e Gjallë dhe Mbikëqyrës të përjetshëm, merr prej Tij mbrojtjen, sigurinë, paqen, dritën dhe begatitë e ditës. Përndryshe, një gjumë jashtë kësaj harmonie dhe natyrshmërie, një gjumë

i gjatë, i tepruar, apo i çekuilibruar në kohë (shumë të rinj e fillojnë gjumin në orët e vona të natës, apo edhe në agim të ditës), krijon dëme dhe probleme të pariparueshme shëndetësore, psikologjike dhe sociale për individin. Kjo është shfaqje e “fytyrës së tretë” të gjumit, ku njeriu ndjek tekat e nefsit dhe bëhet pre e përkohshmërisë. Një brez i ri i përgjumur, apo një shoqëri e përgjumur nuk ka energjitë e duhura për ta gjallëruar ditën, për rrjedhojë nuk mund të përparojë. Një shoqëri e tillë, pa kuptuar, zhytet në apati, indiferentizëm dhe në rrënim shpirtëror e material. Duke bërë këtë bilanc ndërmjet dobive dhe dëmeve, çdo individ me mendje të kthjellët duhet të shprehë mirënjohjen ndaj Krijuesit të Gjithëditur që e bëri namazin si një detyrë disiplinuese të jetës, për të përfituar më të mirën prej saj.

“Namazi është më i mirë se gjumi!” Në këtë pjesë të ezanit gjendet edhe një lloj finese në të shprehurit. Në fakt, i gjithë ezani është një thirrje e përsosur, edhe kuptimore, edhe letrare, edhe si formë komunikimi me njerëzit. “Këto melodi qiellore që nisin me sinjalet prej drite të agimit të parë dhe vazhdojnë gjer në kohën e rënies për të fjetur, u ofrojnë zemrave besimtare gotë pas gotë eliksir muzikor dhe, kështu, intermexo kënaqësie përjetohen, një pas një, gjatë një dite të tërë...”<sup>19</sup> “Namazi është më

19. “Udhërrëfytyesi i një muslimani – Adhurimi”, f. 90, Prizmi, Tiranë, 2010.

i mirë se gjumi!” Kjo sentencë jehon me esencën e Islamit, të formuluar në qindra ajete kur’anore, që e nxisin njeriun të kërkojë më të mirën, të punojë më të dobishmen, të arrijë virtytet më të larta, të vlerësojë më të bukurën, etj. Me një komunikim etik, kjo pjesë e ezanit të sabahut, duket sikur e vlerëson gjumin në sytë e njeriut si një dukuri të mirë, të përsosur, të nevojshme dhe të dobishme, prandaj Allahu e bëri si argument të besimit. Por tani që ka filluar muzgu i mëngjesit, më i dobishëm, më i vlefshëm për robin e Zotit është zgjimi dhe adhurimi (namazi), është ngritja fizike dhe shpirtërore (miraxhi), është puna e mirë. Prandaj besimtari, pa luhatje, duhet të zgjedhë më të dobishmen, më të mirën, që Allahu ta shpërblejë me gradat më të larta në përjetësi. **“Atëherë, Allahun lartësojeni kur të vijë mbrëmja dhe kur të agojë mëngjesi.”**<sup>20</sup>

“Namazi është më i mirë se gjumi!

Allahu është më i madhi!

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”

*“Të përgjigjem Allahu im, të përgjigjem, nën urdhrin Tënd të erdha! E mira është në dorën Tënde, prej Teje vjen dhe tek Ti kthehet!”*<sup>21</sup>

20. Kur’an (30/17), f. 464, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, Sherif Ahmeti, 1992.

21. “Libri i lutjeve”, F. Gylen, f. 9, Prizmi, Tiranë, 2006



## “Prodhimi i fëmijëve” Perspektiva biologjike, ekonomike, psikologjike, sociale dhe islame

Skënder Mustafi  
Jusuf Zimeri

### Abstrakt

*Shoqëria njerëzore po përballet me një rrjedhë të zhvillimeve të reja mjekësore, të cilat kanë zënë rrënjë në shoqërinë moderne dekadën e kaluar, por që tani kanë marrë hov në zhvillim. Ndër më të diskutuarat dhe më kontradiktoret nga ato është ajo e “nënës barrëmbajtëse” ose “nënës zëvendësuese<sup>1</sup>”. Është fjala për mbjelljen e vezores së fekunduar te një nënë e cila mban barrën e shtatzënisë në këmbim të të mirave materiale ose si një akt human e vullnetar për të gëzuar të tjerët me fëmijë. Kjo çështje është e diskutueshme në nivel shoqëror, etiko-moral, së drejtës dhe ekonomik. Gjithashtu është vlerësuar dhe klasifikuar edhe sipas parimeve të ndryshme fetare<sup>2dhe3</sup>.*

*Ky hulumtim merr për bazë kryesisht burimet dytësore të informacioneve, që është literatura dhe hulumtimet e dorës së parë, si dhe publikimet e përvojave të nënave barrëmbajtëse. Nga këto dy lloj faktesh bëhet një analizë shkencore dhe arriben konkluzione në të pesta perspektivat.*

*Nga hulumtimi mund të shihet qartë se kemi të bëjmë me një trend të ri në shoqërinë moderne, i cili tanimë ka marr hapat e parë dhe është duke u zhvilluar me hov të madh. Tanimë kanë zënë fill format e para të modeleve të biznesit ku ka filluar formimi i formave*

1. Ky togfjalësh është një lloj përshtatje nga gjuhët e tjera si anglishtja dhe gjermanishtja, por që autorët e këtij hulumtimi si më të përshtatshëm në pikëpamje shkencore në gjuhën shqipe pranojnë togfjalëshin “nëna barrëmbajtëse” dhe këtë term shfrytëzojnë përgjatë gjithë këtij punimi

2. Lones, Mark E. (2016) “A Christian Ethical Perspective on Surrogacy, Bioethics in Faith and Practice”: (2016)2:1, 5:21-33. DOI: 10.15385/jbfp.2016.2.1.5

3. Lustenberger, Sibylle (2020). DNA Tests, mamzerut, and the Bureaucracies of Transnational Surrogacy. Judaism in Motion: 81-116. DOI: 10.1007/978-3-030-55104-9\_3

*të para të ndërlidhjes së konsumatorëve me prodhueset dhe ndërmjetësuesit. Gjithashtu kuptohet se shtresa e pasur dhe së fundi shtresa e mesme shoqërore janë konsumues, ndërsa ajo e varfër është prodhuese. Së fundmi, nëpërmjet hulumtimit mund të shihen edhe pasojat e para në nivel psikologjik të nënave barrëmbajtëse dhe atë social të grupeve të ndryshme shoqërore. Me fjalë të tjera, zhvillimi i termit të familjes ka kaluar edhe një hap më para. Dubet theksuar gjithashtu se hulumtimi nuk merr parasysh vlerësimet etiko-morale për shkak të përmasave dhe kornizave hulumtuese. Megjithatë është bërë hulumtim dhe vlerësim në bazë të parimeve islame, meqë jurisprudenca islame ndalon rolin e nënës barrëmbajtëse dhe shumicën e llojeve të fekondimeve artificiale.*

## Hyrje

**K**y shkrim është rezultat i hulumtimit të literaturës, rasteve të studimit dhe materialeve që kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me aspektet mjekësore, ekonomike, psikologjike, sociale e islame të fekondimit artificial dhe rolit të nënave barrëmbajtëse.

Hulumtimi jo rastësisht trajton katër aspekte dhe Islamin si vlerësues të aktit modern të “prodhimit të fëmijëve”. Që të katër aspektet sa janë të lidhura aq edhe janë të varura mes tyre. Secili nga aspektet ndikon njëri-tjetrin dhe në fund, të gjithë së bashku, ndikojnë në paraqitjen, pranimin dhe përhapjen e rolit të nënave barrëmbajtëse në grupet e veçanta shoqërore, në veçanti, dhe në shoqërinë globale në përgjithësi. Qëllimisht është lënë jashtë trajtimit pikëpamja etiko-morale edhe pse

është një ndër elementet bazë për vendimmarrje. Kjo pikëpamje kërkon një hulumtim më vete dhe tejkalon kornizat e këtij studimi.

Sensibilizimi dhe të menduarit serioz rreth këtij trendi dhe pasojat për individët e shoqërinë është më se i domosdoshëm në shoqërinë tonë. Mund të themi se çështja është alarmante në nivel ndërkombëtar (kuptohet nëse ky alarm pranohet në nivel etiko-moral ose refuzohet si i tillë) dhe ka nevojë për trajtim në gjuhën shqipe, pasi edhe vendet e zhvilluara evropiane, që kanë ndikim shumë të madh në jetët tona, kanë filluar të mendojnë në mënyrë serioze për të lejuar zhvillimin e industrisë së mbjelljes së fëmijëve<sup>4</sup> dhe me këtë

4. Esser, Anna. (2021). Ist das Verbot der Leihmutterchaft in Deutschland noch haltbar?. Revista Shkencore: Schriften zum Bio-, Gesundheits- und Medizinrecht: 44/2021. doi.

edhe lejimin e paraqitjen e rolit të punëmarrësve si nëna barrëmbajtëse. Vende të tilla të cilat akoma e kanë të ndaluar marrjen e rolit të nënës barrëmbajtëse janë Gjermania, Zvicra, Austria, Franca, e disa vende të tjera evropiane<sup>5</sup>.

### **Prodhimi i fëmijëve: pikëpamja biologjike**

Në pikëpamjen mjekësore janë të njohura disa forma të mbjelljes së farës së mashkullit te vezorja e femrës. Thujse të gjitha shtetet e botës kanë ligje përmes të cilave pozicionohen lidhur me këtë ndërhyrje mjekësore. Qëndrimet ndryshojnë nga vendi në vend, edhe atë nga të lejuarit e tërësishëm, në të lejuarit me kushte e deri tek të ndaluarit e tërësishëm të fekondimit artificial. Madje edhe besimet e mëdha botërore kanë marrë qëndrimet e tyre lidhur me këtë çështje (poshtëshënimet 2, 3 dhe 20).

Një ndër format speciale të mbjelljes së farës është edhe ajo e “huazimit të nënës”. Kjo formë ka filluar të përhapet pothuajse që një dekadë, por që së fundi ka marrë

përmasa të mëdha dhe po arrin fazën e pjekjes së një forme të kulturës së shoqërisë moderne. Kështu që në procesin e “prodhimit të fëmijëve” në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të përfshirë një ose dy femra dhe një mashkull. Studiuesja Helena Ragone<sup>6</sup> në librin e saj të fundit shtjellon forma të ndryshme të bashkëveprimit mes kërkuesve për t’u bërë prind dhe nënave barrëmbajtëse. Në pikëpamje mjekësore janë dy forma kryesore:

1. *Kërkesa me farë të mashkullit dhe vezore të femrës, të cilët dëshirojnë të bëhen prindër.* Në këtë rast mashkulli, i cili dëshiron të bëhet baba, me farën e vet fekondon vezoren e femrës, e cila dëshiron të bëhet nënë, dhe kjo vezore mbillet te nëna barrëmbajtëse. I gjithë procesi ndodh në një proces artificial mjekësor.

2. *Kërkesa me farë të mashkullit që dëshiron të bëhet baba.* Në këtë rast mashkulli, i cili dëshiron të bëhet baba, fekondon vezoren e femrës barrëmbajtëse, por që nuk dëshiron të bëhet nënë (refuzohet fëmija në pikëpamje psiko-sociale dhe juridike nga nëna shtatzënë e që në këtë proces të kontraktuar njihet si nënë barrëmbajtëse).

Në pikëpamjen biologjike-mjekësore, nëna zëvendësuese, gjenetikisht, nuk ka asgjë të përbashkët me fëmijën që mban, vetëm nëse bëhet fjalë për formën e dytë të fekondimit e

org/10.5771/9783748924456

5. Surrogate.com (2021). Intended parents: What are the International Surrogacy laws by country? <https://surrogate.com/intended-parents/surrogacy-laws-and-legal-information/what-are-the-international-surrogacy-laws-by-country/information/what-are-the-international-surrogacy-laws-by-country/>. Së fundi vizituar më 28. Shtator 2021.

6. Ragone, Helena (2019). Surrogate Motherhood: Conception In The Heart. Sh.b. Routledge. Faqe 215.

që rregullohet në formë juridike dhe vlerësohet me norma etiko-morale e sociale. Në këtë rast një vezore e një femre tjetër, e cila është fekunduar me farën e një mashkulli vendoset në trupin e nënës barrë mbajtëse<sup>7</sup> dhe ajo e mban atë që nga ngjizja e deri te lindja. I gjithë procesi i ngjizjes, rritjes, bashkëjetesës mes nënës e fëmijës dhe lindjes rrjedh në mënyrë natyrale, ashtu si te nënat normale.

### **Fëmijë sipas dëshirës dhe aftësisë për të paguar: Pikëpamja ekonomike**

Dekadën e fundit, bazuar në zhvillimet mjekësore dhe ligjoro-etike, nuk është e patjetërsueshme lindja e fëmijëve, ne kemi nevojë vetëm për internet dhe mund t'i porosisim si çdo produkt tjetër. I gjithë procesi i porosisë, me të mirat dhe të metat e veta, mund të zhvillohet në internet<sup>8</sup>. Nga pikëpamja ekonomike, ky akt mjekësor është bërë një biznes i vërtetë mbi të cilin janë duke u ngritur konglomerate ndërkombëtare.

7. Walkowiak, Anne (2021). Leihmutterchaft: Wie sie funktioniert und welche (rechtlichen) Hürdenes gibt. GoFeminin.de GmbH. URL: <https://www.gofeminin.de/kinderwunsch/leihmutterchaft-s4024336.html>. Së fundi vizituar më 28. Shtator 2021.

8. Eichenberg, Christiane&Küsel, Cornelia (2019). Kinderwunsch und Internet. Psychotherapeut 2019 · 64:134–142. DOI: <https://doi.org/10.1007/s00278-019-0333-5>

Shkak i një zhvillimi të tillë ekonomik ndërkombëtar është sepse tanimë në prodhimin e fëmijëve nuk është e përfshirë vetëm shtresa e pasur shoqërore, por edhe ajo e mesme.

Duke marrë parasysh vende të ndryshme, si Ukraina dhe Rusia, që kanë të lejuar jo vetëm aktin mjekësor, por edhe të gjitha rrjedhat e tjera financiare, kuptohet se kemi të bëjmë me një zhvillim të një biznesi ndërkombëtar. Konsumatorët mund të jenë si nga vendet që e lejojnë rolin e nënës barrëmbajtëse ashtu edhe nga ato që e lejojnë me kushte ose e ndalojnë tërësisht. “Sjellja” e fëmijëve në vendet që ndalojnë një akt të tillë është rregulluar duke shfrytëzuar ‘vrimat’ ligjore kombëtare, siç është adoptimi. Të gjitha këto çështje janë të lidhura drejtpërdrejt me kërkesën dhe ofertën. Në këtë rast kemi të përfshirë pjesëmarrës të ndryshëm në kërkimin dhe ofrimin e produktit dhe shërbimeve.

Fillimisht kemi të bëjmë me produktin, i cili është fëmija. Më pas kemi femrën dhe mashkullin, ose femrën/mashkullin të cilët duan të bëhen prindër, e që janë konsumatorët. Nëna barrëmbajtëse është prodhuesja e produktit<sup>9</sup>. Përveç konsumatorëve dhe prodhueses në

9. Gauriat, Valérie&Sans, Sabine (2020). Leihmutterchaft: ein Kind auf Bestellung – Ausbeutung oder Segen?. EuroNew. URL: <https://de.euronews.com/2020/09/25/leihmutterchaft-ein-kind-auf-bestellung-ausbeutung-oder-segen>. Së fundi vizituar më 28. Shtator 2021.

këtë lloj biznesi janë të përfshirë edhe ndërmjetësues të tjerë, të cilët janë të domosdoshëm ose të kërkuar dhe të pozicionuar sipas përcaktimeve juridike. Si të përfshirë të domosdoshëm janë mjekët, të cilët bëjnë fekondimin artificial të vezores dhe mbjelljen e tij te nëna barrëmbajtëse. Ndërsa duke marrë parasysh strukturën ekonomike të kërkesës (niveлин e investimit) dhe gjendjen e ofertës (gjendjen ekonomike të nënës prodhuese) si kushte të kërkuara paraqiten qëndrimi në ambiente të paracaktuara për jetesë dhe lindje, konsumi sipas kushteve të paracaktuara dhe të kontraktuara si dhe llojet e tjera të sigurimeve. Nga ky zhvillim është hapur gjithashtu edhe fushë biznesi për ndërmarrjet e sigurimeve dhe risigurimeve, që mbulojnë periudhën e paralindjes dhe të lindjes, si dhe bankat që kreditojnë planifikimin familjar dhe mbështesin konsumatorët, pra personat të cilët investojnë të bëhen prindër.

Kombinimet më të përhapura, për sa i përket mbjelljes, shitjes/dhurimit së farës dhe shitjes/dhurimit së vezores, janë:

*Kërkesa me farë të mashkullit dhe vezore të femrës, të cilët dua fëmijë.* Këtu kemi të bëjmë me farën nga mashkulli, i cili dëshiron të bëhet baba, me vezoren e femrës, e cila dëshiron të bëhet nënë dhe nënën barrëmbajtëse. Që do të thotë, vezorja e femrës së parë fekondohet me farën e mashkullit dhe mbillet te nëna barrëmbajtëse.

*Kërkesa me farë të mashkullit të tretë në përfshirje të mashkullit, i cili dëshiron të bëhet baba me vezoren e femrës që dëshiron të bëhet nënë.* Në këtë rast kemi të bëjmë me farën e personit të tretë, vezoren e femrës, e cila dëshiron të bëhet nënë dhe nënën barrëmbajtëse. Roli i babait të mashkullit konsumator rregullohet në formë juridike pasi përfshirja biologjike në prodhim mungon tërësisht. Do të thotë babai juridik nuk ka lidhje gjenetike me fëmijën.

*Kërkesa me farë të mashkullit që dëshiron të bëhet baba dhe vezore të femrës së tretë.* Në këtë rast mashkulli, i cili dëshiron të bëhet baba, me farën e tij fekondon vezoren e një femre të tretë, që mbillet te nëna barrëmbajtëse. Roli i femrës që dëshiron të bëhet nënë rregullohet në formë juridike për shkak të mungesës së lidhjes biologjike me fëmijën.

*Kërkesa me farë të mashkullit të tretë dhe vezoren e femrës së tretë.* Në këtë rast mashkulli dhe femra, të cilët dëshirojnë të bëhen prindër, nuk janë të përfshirë në asnjë formë apo mënyrë biologjike me fëmijën. Roli i të dy kërkuesve për t'u bërë prindër rregullohet përmes formave juridike për shkak të mungesës së lidhjes gjenetike me fëmijën.

*Kërkesa me farë të mashkullit të tretë dhe vezoren e femrës që dëshiron të bëhet nënë.* Në këtë rast konsumatore është vetëm një femër e cila dëshiron të bëhet nënë dhe fëmija është vetëm i saj. Në pikëpamje juridike fëmija është i pababa dhe të gjitha të drejtat e prindit

janë të rezervuara nga nëna. Nënës gjithashtu juridikisht i sigurohet roli i prindit të vetëm.

*Kërkesa me farën e mashkullit që dëshiron të bëhet baba me vezoren e femrës së tretë.* Në këtë rast konsumator është vetëm mashkulli i cili dëshiron të bëhet baba dhe fëmija është vetëm i tiji. Në pikëpamje juridike fëmija është i panënë dhe çfarëdo lloji i ndërlidhjes me nënën shitëse/dhuruese të vezores ose nënës barrëmbajtëse është rregulluar/shkëputur juridikisht.


*Kërkesa me farë të mashkullit që dëshiron*

*të bëhet baba me vezoren e nënës barrëmbajtëse.*

Në këtë rast procesi i fekondimit ndodh në formë artificiale-mjekësore dhe në pikëpamje biologjike fëmija ka nënë dhe baba. Sidoqoftë, mashkulli është kërkuesi dhe konsumatori andaj dhe në formë juridike është prindi i vetëm, që do të thotë se fëmija është i panënë. Në këtë formë të prodhimit të fëmijës, nëna e cila është “dhuruese” e vezores (pikëpamje ekonomike) dhe barrëmbajtëse, mohon fëmijën si qenie biologjike dhe pohon atë vetëm si prodhim ekonomik.

**Figura dhe tabela:**

Modelet e bizneseve dhe mbajtësit e roleve të përfshirë në prodhimin e fëmijëve.



|                  |   |
|------------------|---|
| <b>Situata 1</b> | Kërkesa kontraktton me një institucion mjekësor, i cili ofron të gjitha shërbimet mjekësore. Institucioni kontraktton nënat barrëmbajtëse dhe i mban ato deri në lindje. E gjithë jeta e tyre gjatë shtatzënisë kalon brenda strukturave të institucionit dhe nën kontrollin e tyre.                                |
| <b>Situata 2</b> | Kërkesa kontraktton një institucion mjekësor, i cili ofron shërbimet e fekondimit, mbjelljes dhe mbikëqyrjes. Institucioni kontraktton nënat barrëmbajtëse. Nënata barrëmbajtëse jetojnë jetën e shtatzënisë në ambientet e dedikuara, që janë pjesë e institucionit ose janë të kontraktuara nga një palë e tretë. |
| <b>Situata 3</b> | Kërkesa kontraktton një institucion mjekësor, i cili ofron shërbimet e fekondimit, mbjelljes dhe kontrollit. Nënata barrëmbajtëse janë të lejuara të jetojnë në shtëpitë e tyre, por i gjithë procesi i kontrollit kryhet nga institucioni kontraktues.   |
| <b>Situata 4</b> | Kërkesa kontraktton nënën barrëmbajtëse. Palët marrin shërbimet e fekondimit dhe mbjelljes nga institucione mjekësore. Nëna barrëmbajtëse është e lirë të jetojë në shtëpi dhe të kryejë kontrollin mjekësor sipas vlerësimeve “të lira”.   |

Të gjitha kombinimet e trajtuara më sipër kërkojnë strategji të ndryshme biznesi, përfshirje të ndërmjetësve të ndryshëm dhe forma specifike financimi për udhëheqjen e proceseve. Sidoqoftë, të gjitha format e bashkëpunimit mes konsumatorëve, prodhuesve dhe ndërmjetësve rregullohen përmes kontratave specifike. Andaj, ashtu si në llojet e tjera të biznesit, edhe këtu kemi të bëjmë me një proces të mirëfilltë të prodhimit, ofrimit dhe konsumit të shërbimeve që janë të lidhura ngushtë me investimet, shpenzimet dhe shpërndarjen e fitimeve. Gjithashtu, kemi të bëjmë me një zinxhir të mirëfilltë të kombinimit të produktit dhe shërbimeve, ku kërkesa dhe oferta kontraktajnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthorë. Prandaj, edhe kërkesa e fëmijëve është e njëjtë si e një produkti të zakonshëm “me specifika të caktuara”, ku çmimi ndryshon në varësi të kushteve të kërkesës dhe karakteristikave të ofertës dhe prodhimit të produktit.

Meqë kemi oferta nga vende të ndryshme të botës, që ndryshojnë në nivelin e tyre ekonomik kemi të bëjmë me oferta me çmime të ndryshme të prodhimit (masiv), duke filluar nga 36,000 euro investime nga konsumatori për prodhim të një fëmije në Gjeorgji e deri në mbi 200,000 euro për prodhim të një fëmije në ShBA. Një biznes vërtet

i leverdishëm, i cili vetëm në ShBA, në vitin 2020 nga angazhimi i nënave barrëmbajtëse ka prodhuar rreth 2.2 miliardë euro e që sipas Global Market Insights Inc. pritet që në vitin 2027 të prodhojë rreth 27 miliardë euro<sup>10</sup>.

Bizneset e këtij lloji, gjithashtu deklarojnë se strukturat politike duhet të rregullojnë ligje që lejojnë teknologjitë si KRISBA (Tochylovski cit. tek Gauriat & Sans<sup>11</sup>) që mundësojnë përcaktimin e vetive të ndryshme të fëmijëve, ku ndër to është edhe përcaktimi i ngjyrës së syve. Kjo do të kishte ndikim të madh në zhvillimin e biznesit dhe rritjen e prodhimtarisë.

### **Fëmija është i imi: Pikëpamja psikologjike**

Siç edhe theksuam në pjesën e parë, duke filluar që pas mbjelljes së vezores e deri pas lindjes, jeta e nënës barrëmbajtëse, në pikëpamje

---

10. Cision US Inc. (2021). Surrogacy Market Revenue to Cross USD 33.5B by 2027: Global Market Insights Inc. URL: <https://www.prnewswire.com/news-releases/surrogacy-market-revenue-to-cross-usd-33-5b-by-2027-global-market-insights-inc-301308588.html>. Së fundi vizituar më 28. Shtator 2021.

11. Gauriat, Valérie & Sans, Sabine (2020). Leihmutterchaft: ein Kind auf Bestellung – Ausbeutung oder Segen?. EuroNew. URL: <https://de.euronews.com/2020/09/25/leihmutterchaft-ein-kind-auf-bestellung-ausbeutung-oder-segen>. Së fundi vizituar më 28. Shtator 2021.

biologjie-fiziologjike, është e njëjtë si e asaj normale. I gjithë procesi fillon me një nevojë financiare edhe pse kemi studime që hulumtojnë arsyet dhe gjendjen psikologjike të femrave që marrin rolin e nënave barrëmbajtëse. Në njërin nga këto studime i realizuar nga Elly Teman<sup>12</sup> është vënë për bazë vlerësimi psikologjik se nëna “normale” është e prirë që në bazë “natyrore” të lidhet me fëmijën që bart gjatë shtatzënisë dhe e lind atë. Autorja, madje, në bazë të kësaj “natyre” dhe “normaliteti” analizon pikat e sjelljes “njerëzore” që devijojnë te këto nëna që fëmijën e shohin vetëm si produkt dhe të huaj.

Sidoqoftë, në dokumentarët që portretizojnë nënat barrëmbajtëse, shkak i vetëm i marrjes së një roli të tillë paraqitet gjendja e dobët ekonomike dhe leverdia financiare ku me rëndësi të madhe është arritja e të mirave materiale. Në këtë mënyrë, meqë qëllimi është arritja e të mirave financiare, i gjithë procesi shihet si një rrjedhë ekonomike dhe burim financiar. Andaj, sipas shumë nënave barrëmbajtëse që janë shprehur publikisht lidhur me rolin e tyre, emocionet në këtë rast janë të papranueshme ose të panevojshme.

12. Teman, Elly (2008). The social construction of surrogacy research: An anthropological critique of the psychosocial scholarship on surrogate motherhood. *Social Science & Medicine* 67 (2008) 1104–1112. DOI: <https://doi.org/10.1016/j.socscimed.2008.05.026>

Në këtë gjendje dhe me këtë qëndrim, pohimi i nënave barrëmbajtëse është në mënyrë të prerë se fëmija u përket atyre që kanë bërë kërkesën.

Por cila është gjendja e vërtetë psikologjike e nënave barrëmbajtëse?

Hoda e të tjerët<sup>13</sup> në studimin e tyre të kualifikuar kanë arritur në përfundimin se të gjitha fazat e shtatzënisë së nënës barrëmbajtëse janë të ndikuara me prekje emocionale që janë përcjellë me komplikime të ndryshme psikologjike. Gjendjen e rëndë psikologjike e përshkruajnë edhe shumë nëna nëpër materiale multimediale. Në studimin të kualifikuar dhe sasior të vitit 2018 të realizuar nga Lamba e të tjerët<sup>14</sup> janë intervistuar 50 nëna barrëmbajtëse dhe 69 nëna normale gjatë dhe pas shtatzënisë së tyre. Hulumtimi ka treguar se 37% deri në 38% e nënave barrëmbajtëse janë ndjerë mbi mesataren në gjendje depresioni gjatë dhe pas lindjes. Një hulumtim tjetër që flet për lidhjen emocionale

13. Ahmari Tehran, Hoda/Tashi, Shohreh/Mehran, Nahid/Eskandari, Narges & Tehrani, Tahmineh Dadkhah (2014). Emotional experiences in surrogate mothers: A qualitative study. *Revista shkencore Iran J ReprodMed*. 2014 Jul; 12(7): 471–480. Publikuar te National Center for Biotechnology Information.

14. Lamba, N/Jadva, V/Kadam, K/Golombok, S (2018). The psychological well-being and prenatal bonding of gestational surrogates. *Revista shkencore: Human Reproduction*, Volume 33, Issue 4, April 2018, Pages 646–653, <https://doi.org/10.1093/humrep/dey048>



dhe depresioneve pas lindjes së nënave barrëmbajtëse është bërë nga Taebi e të tjerët në vitin 2020<sup>15</sup>. Në këtë hulumtim janë përfshirë 17 nëna barrëmbajtëse të cilat flasin për ndjenjat e tyre emocionale gjatë edhe pas lindjes. Autorët gjithashtu vënë në pah edhe komplikimet shëndetësore të ndërlidhura me ato psikologjike të këtyre nënave.

Ndikim të madh në gjendjen psikologjike të nënave barrëmbajtëse ka edhe vendimmarrja e konsumatorëve dhe reagimi i tyre gjatë dhe pas lindjes së fëmijës. Në rast të ndryshimit të mendimit të konsumatorëve me mosdashje të fëmijës gjatë shtatzënisë së nënave barrëmbajtëse, kjo e fundit është e detyruar ta abortojë atë. Në rast mos pajtimi me një vendim të tillë, atëherë u kërkohet kthimi i mjeteve të konsumuara financiare gjë që destabilizon psikikën e nënave barrëmbajtëse. Ndikim gjithashtu në rritjen e gjendjes së depresionit te nënat barrëmbajtëse ka edhe në rast të lënies së fëmijës pas lindjes nga ana prindërve investitorë. Në raste

---

15. Taebi, Mahboubeh/Alavi, Negin Masoudi/Ahmadi/Seyed Mehdi Ahmadi (2020). The Experiences of Surrogate Mothers: A Qualitative Study. Department of Midwifery and Reproductive Health, Nursing and Midwifery Care Research Center, Isfahan University of Medical Sciences, Isfahan Fertility and Infertility Center, Isfahan, Trauma Nursing Research Center, Kashan University of Medical Sciences, Kashan, Iran.

të tilla fëmija dërgohet nëpër shtëpi jetimësh dhe nuk i takon nënës barrëmbajtëse, sepse ajo nuk ka asnjë të drejtë juridike për ta mbajtur atë<sup>16</sup>.

Së fundi duhet theksuar se të gjitha nënat barrëmbajtëse janë të lidhura në mënyrë emocionale me fëmijën që bartin<sup>17</sup>. Studimet e ndryshme shpalosin se lidhjet emocionale me fëmijën, ose barrën si të tillë, shfaqen në forma të ndryshme. Nënat barrëmbajtëse vetvetiu ndikohen në nivel emocional me vetë rastin e barrëmbajtjes, por edhe krijojnë lidhje të forta emocionale me fëmijën që bartin. Lidhja emocionale me fëmijën shfaqet në forma të ndryshme edhe atë duke shfaqur rolin e vet si një rol të shenjtë, i cili u mundëson të tjerëve krijimin e një familjeje ose edhe përmes zhvillimit të llojeve të ndryshme të depresioneve. Zhvillimi i depresioneve në raste të tilla është i lidhur ngushtë me pamundësinë

---

16. Gauriat, Valérie&Sans, Sabine (2020). Leihmutterchaft: ein Kind auf Bestellung – Ausbeutung oder Segen?. EuroNew. URL: <https://de.euronews.com/2020/09/25/leihmutterchaft-ein-kind-auf-bestellung-ausbeutung-oder-segen>. Së fundi vizituar më 28. Shtator 2021.

17. Walsh, Theodora (2017). The pregnant avatar: seeing one-self in c-sections, surrogates, and sonograms. *Afterimage*. 2017;44(5):20-23. URL: <https://www.proquest.com/scholarly-journals/pregnant-avatar-seeing-one-self-c-sections/docview/1901200920/se-2?accountid=151164>. Së fundi vizituar më 04. Tetor 2021.

e kanalizimit, rregullimit dhe klasifikimit të emocioneve kundrejt fëmijës së lindur dhe ‘të dhënë/shitur’. Padyshim këtu ka ndikim të madh edhe lloji i kontraktimit për barrëmbajtje i cili shpeshherë i pamundëson nënës barrëmbajtëse madje as edhe ta shohë fëmijën.

### **Shoqëri e dalë nga epruveta: Pikëpamja sociale**

Shpjegimi i konceptit ‘familje’ është zhvilluar shumë dhe ka ndryshuar rrënjësisht në dyzet vitet e fundit<sup>18</sup>. Sot në shoqëritë e ndryshme botërore, përveç strukturave tradicionale të familjeve, posaçërisht me miratimin e ligjeve mbi bashkimet e lira të personave me gjini të njëjtë në formë martesë, kemi forma të reja të strukturave familjare. Natyrisht që në pikëpamje të shpjegimit të strukturave familjare duhet dalluar bashkimi nën kurorë, martesa, me familjen. Përkundër të gjitha këtyre ndryshimeve, në strukturimin e familjeve dhe të shpjeguarit të tyre, elementi më i rëndësishëm dhe kryesor, përmes të cilit zë themelet familja, është fëmija.

Dekadën e fundit ligjësimi i rolit të nënës barrëmbajtëse ka

mundësuar që të paraqiten forma të reja të strukturave familjare. Ndër to janë edhe strukturat familjare ku fëmija ka një prind të vetëm qoftë ai babai ose nëna, fëmija ka dy persona të gjinisë së njëjtë në rolin e prindit, qofshin ata meshkuj ose femra. Në këtë rast jo vetëm që kemi të bëjmë me struktura të reja familjare, por edhe me forma të reja të zhvillimit të proceseve edukuese të fëmijëve, ku fëmija privohet nga nëna dhe roli i saj, ose nga babai dhe roli i tij. Në këtë mënyrë riformohet institucioni familje dhe rishpjegohet jo vetëm struktura, por edhe vlerat e tij. Duke ditur se në këtë institucion femra ka një vlerë të madhe (Balfourzit. tek Abu-Rabia<sup>19</sup>) dhe rol të rëndësishëm, përmes këtyre ndryshimeve bëhet rishpjegimi dhe rivlerësimi edhe i rolit të saj. Përveç roleve të deritanishme të nënës, siç është ai biologjik dhe social, i shtohet edhe roli i mbajtjes së fëmijës për të tjerët<sup>20</sup>.

*Roli i mbajtjes së fëmijës*<sup>21</sup> është i lidhur ngushtë me shpjegimin e natyrës së re të nënës dhe me përcaktimin e koncepteve bio-

18. Imrie, Susan & Golombok, Susan (2020). Impact of New Family Formson Parenting and Child Development. Annual Review of Developmental Psychology. 2020; 2:295-316: DOI: <https://doi.org/10.1146/annurev-devpsych-070220-122704>

19. Abu-Rabia, Aref (2013). Infertility and Surrogacy in Islamic Society: Socio-Cultural, Psychological, Ethical, and Religious Dilemmas. The Open Psychology Journal, 2013, 6, 54-60.

20. Fraire, Manuela&Roudinesco, Élisabeth (2019). Welches Morgen für die Leihmutterchaft? Feministische Studien. 2019 / 05 Vol. 37; Iss. 1. DOI: 10.1515/fs-2019-0009

21. Nëna barrëmbajtëse.

psikologjike për të mundësuar largimin dhe refuzimin e fëmijës përmes adoptimit psiko-social në nivel personal. Largimi nga fëmija i është mundësuar edhe mashkullit (prind biologjik) i cili është dhurues i farës e që në të vërtetë refuzon rolin e prindit. Këto largime kontribuojnë në zhvillimin e kornizave të reja të zhvillimit psiko-social të fëmijës. Roudesco këtë gjendje, ndër zhvillimet e tjera, e identifikon si problem dhe fushë e cila kërkon edhe më tej hulumtime shkencore.

Në anën tjetër *rolit social* lidhet ngushtë në përgjithësi me meshkujt dhe në veçanti me femrat që dëshirojnë të bëhen prindër. Në këtë rast tejkalohen roli dhe niveli i adaptimit në rolin dhe nivelin e “përvetësimit” të fëmijës. Fëmija, përkundër gjendjes dhe fakteve biologjike është (përvetësim) i prindërve (dëshirues dhe financës së “prodhimit” të tij). Në nivel psikologjik, kjo gjendje lë shumë pyetje të hapura si në zhvillimin biologjik të fëmijës (në rast të paraqitjeve të sëmundjeve gjenetike) ashtu edhe në atë psikologjik (në rast të lindjes së nevojës psikologjike për njohje të nënës biologjike-barrëmbajtëse/dhuruese të vezores dhe babait biologjik farë-dhurues).

Kjo formë e re e konstruktit familjar në mënyrë teknike largon nënën dhe *rolin e saj biologjik* nga qendra e strukturës familjare dhe në vend të saj e vë riprodhimin

mjekësor, rregullimin ligjor dhe procesin ekonomik si një kombinim normal. Në këtë mënyrë kemi të bëjmë me struktura të reja shoqërore dhe forca të reja, të cilat, në mënyrë jo-biologjike, mbajnë elementet e saja të lidhur mes tyre.

### **Ai krijon çfarë Të dojtë: Pikëpamja islame**

Sipas konceptit islam në tërësi, qenia *Njeri* konsiderohet si qenia më e nderuar nga Krijuesi absolut, i cili në librin e Tij thotë: “**Ne i kemi nderuar bijtë e Ademit**”<sup>22</sup>, e në kornizat e këtij nderi dhe respekti që Krijuesi i dha qenies njeri është edhe ruajtja e linjës së gjakut dhe ruajtja e linjës dhe sigurisë familjare. Kjo ruajtje dhe siguri familjare arrihet vetëm duke siguruar raporte të shëndosha familjare dhe përgjegjësi morale e ligjore për anëtarët e shoqërisë në përgjithësi. Pikërisht për këtë Islami ligjësoi dhe shenjtëroi kontratën e martesës mes mashkullit dhe femrës, si qeliza e parë prej ku fillon formimi i familjes së shëndoshë dhe lidhjet e tyre mes njëri-tjetrit, dhe në anën tjetër ndaloi tradhtinë pikërisht për të mos humbur linjat e gjakut, ndërprerjen e linjave farefisnore, humbjen e nderit dhe humbjen e ndjenjave dhe emocioneve njerëzore<sup>23</sup>.

---

22. El-Isra', 17/70.

23. Departamenti për Fetva Jordan,

Islami në parim këmbëngul në natyrshmërinë e njeriut, e cila në rastin konkret arrihet përmes marrëdhënieve të rëndomta dhe të natyrshme seksuale, kurse të gjitha metodat e tjera i konsideron metoda artificiale. Te dijetarët myslimanë metoda e fekondimit seksual artificial te kafshët njihet që nga shekulli XIV, kur ata bënëin fekondimin seksual te kuajt për të ruajtur apo riprodhuar racën e pastër të kuajve arab<sup>24</sup>.

Në këtë proces në aspektin teorik kishin sinjalizuar edhe filozofët myslimanë, si Ibn Sina (Avicena)<sup>25</sup> pastaj Farabiu<sup>26</sup>, etj., se

---

Vendimi nr. 5 rreth dispozitës së sheriatit në fekondimin artificial, i nxjerrë më 24. korrik 1984, Aman, Jordan.

24. Nexhar, Jasir Abdulhamid Xhadullah, profesor i së drejtës krahasuese në Fakultetin e sheriatit në Deaakahlje- Egjipt, në veprën: "Telkihi es-sinaij min mendhuri el-fiklhi el-islamij, dirasetun fikhijetun mukarene (Fekondimi artificial nga optika e së drejtës islame, studim juridik krahasues), f. 374 - 375 - Studjuesi Isa Emize, El-haml, irthuhu ue ahkamuhu ue sueruhu el-muasire bejne esh-sheriatu uel-kanun (Shtatzënia, trashëgimia, dispozitat dhe mënyrat e shtatzënisë mes sheriatit islam dhe ligjit pozitiv), f. 110.

25. Ibni Sina është: Ebu Alij El-Husejn ibn Abdullah ibn Hasan ibn Alij Ibni Sina El-Belhij, i njohur në perëndim me emrin Avicena. Bota perëndimore e njohu me llogarin "mbreti i mjekëve", kurse në mesjetë njihet me emrin "babai i mjekësisë moderne". Ka shkruar rreth 20 vepra në lëmi të ndryshme shkencore, por përqendrimi i tij ishte në mjekësi dhe filozofi.

26. Muhamed El Farabi ka lindur në vitin 874 në Turkistan dhe ka vdekur në Damask. Ekzistojnë polemika të shumta rreth

procesi i fekondimit seksual është i mundur edhe në forma të tjera artificiale. Këtë më së miri e sqaron Ibn Halduni në *Mukadimen* e tij, duke u bazuar në studimet e Ibn Sinas dhe Farabiu<sup>27</sup>.

Eksperimentin e fekondimit artificial në bazë teorive të mëparshme e provoi prifti italian Lazarte Espaltri në vitin 1780 te një qen dhe doli i suksesshëm.

Mirëpo, me përparimin e shkencës së mjekësisë në kohët bashkëkohore, e veçanërisht pas suksesit të lindjes së foshnjës së parë, Luiza Braun, më 25 korrik 1979, e cila u quajt "foshnja e epruvetës"<sup>28</sup>, kjo çështje mori përmasa të mëdha në shoqërinë njerëzore saqë në vitin 1984, në klubin e fëmijëve të fertilizuar (IVF), ishin rreth 1000 fëmijë, prej tyre 56 binjakë, 8 trinjakë dhe 2 katërnjakë. Mirëpo pas këtij procesi, që gjithnjë e më shumë po merr përmasa botërore, ka edhe reaksione të ndryshme, sepse te fëmijët filluan të paraqiten (shfaqen) edhe probleme gjenetike e etike. Këtë

---

identitetit të tij se ishte turk apo pers, por me rëndësi është se ai jetoi dhe u edukua në Bagdad. Ishte filozof i madh, matematicien dhe muzikolog i njohur. U mor shumë edhe me shkencat e mjekësisë.

27. Abdurrahman ibn Haldun, Mukadimetu ibni Haldun 1/452, botim El-kutub el-Ilmije, Kajro.

28. Abazi, I. /Bislimi, T. /Ebibi, F. /Zimeri, J. (1996). E drejta familjare në Islam. Mexhlisit Shura të Bashkësisë Islame në R. Maqedonisë. Shkup.

e vuri në spikamë edhe shkencëtari e fiziologu Edwards, i cili ishte pionieri i IVF duke thënë: “Ekziston një nevojë e domosdoshme për të krijuar një kornizë etike dhe morale në këtë fushë”.<sup>29</sup>

S’do mend se ndaj këtij suksesi shkencor të arritur në kohën bashkëkohore as qendrat dhe akademitë islame nuk mund të qëndronin indiferente pa dhënë shpjegime për pikëpamjet e tyre. Kësaj çështje me shumë seriozitet iu rrek Kolegjiumi i Fetfave në Xhedda, Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam, Departamenti i Fetvasë në Kajro dhe institucione e tjera të rëndësishme në botën shkencore islame.

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam, në konferencën e saj të tretë të mbajtur në Aman të Jordanisë prej 16-11 tetor të vitit 1986, konferencë që debatoi edhe për fekdimit artificial, pas debatit, shqyrtimit, analizës së fakteve, konsultimit të mendimit të dijetarëve-fukahave, të mjekëve, sociologëve dhe profesionistëve të tjerë të fushave shkencore të ndërlihdura, solli vendimin nr. 16 (4-3)<sup>30</sup> në të cilin shpjegohen mundësitë

29. Elbar, Muhamed Ali (2016). Et-telkihu es-sinaj ue etfalu el-enabib. Botuar në revistën ‘El-Mexhmeu el-fikhij’ 2016:2.

30. Resolutions and Recommendations of the council of the Islamic Fiqh Academy 1985 - 2000 (2000): Resolution No. 16 (4 - 3). Islamic Development Bank. First Edition 1421 H. Faqe. 28 - 29.

e fekdimit artificial, të cilat u ndanë në shtatë mënyra. Dy prej tyre i quajti metoda të brendshme, kurse pesë të tjera i quajti metoda të jashtme:

**1. Metoda e parë:** Kur spermatozoidi merret nga burri dhe bashkohet me vezoren e një femre që nuk është bashkëshortja e tij legjitime, e pastaj vendoset në mitrën e bashkëshortes së tij.

**2. Metoda e dytë:** Kur spermatozoidi merret nga një burrë që nuk është bashkëshort i gruas dhe bashkohet me vezoren e bashkëshortes, e më pas të mbillen në mitrën e bashkëshortes nga e cila është marrë vezorja.

**3. Metoda e tretë:** Kur spermatozoidi merret nga bashkëshorti dhe bashkohet me vezoren e bashkëshortes të bëhet fekdimi artificial i jashtëm, e pastaj të vendohen në mitrën e një femra tjetër, e cila vullnetarisht ka shpreh dëshirën të jetë shtatzënë.

**4. Metoda e katërt:** Të bëhet fekdimi artificial i jashtëm, duke marrë spermatozoidin nga një mashkull i jashtëm (burrë tjetër) dhe vezorja nga femër tjetër dhe të vendosen në mitrën e bashkëshortes

**5. Metoda e pestë:** Fekondimi seksual i jashtëm të bëhet mes spermatozoidit të bashkëshortit dhe vezores së bashkëshortes e pastaj të mbillet në mitrën e bashkëshortes tjetër me të cilën është në kurorë (pra në mitrën e ortakes) nëse burri ka dy

bashkëshorte. Në këtë rast gjithnjë duhet pasur parasysh miratimi i gruas së parë. Pas fekondimit artificial, femra që mbetet shtatzënë me vezoren e gruas tjetër të burrit të vet, pra të ortakes, konsiderohet nënë e foshnjës prej gjiri, sepse foshnja nga organizmi i saj ka përfituar shumë më shumë se sa fëmija që vetëm e thithë qumështin e ndonjë gruaje. Këtij fëmije ndaj kësaj nëne prej gjiri i ndalohet çdo gjë, ashtu siç i ndalohen ndaj nënës së vërtetë (martesa me të, martesa me bijën e saj, etj.)

**6. Metoda e gjashtë:** Merret spermatozoidi i bashkëshortit dhe vezorja e bashkëshortes, vendosen në epruvetë e pastaj prej epruvetës vendosen apo mbillen në mitrën e bashkëshortes nga e cila është nxjerrë vezorja.

**7. Metoda e shtatë:** Merret spermatozoidi i bashkëshortit dhe mbillet ose futet në mitrën e bashkëshortes së tij përmes fekondimit të brendshëm artificial. Këtë lloj mjekimi sheriatit Islam e lejon, paraprakisht kushtëzon që të vërtetohet se a ka nevojë femra për një mjekim të tillë apo jo.

Akademia e Fikhut Islam në vendimin e lartpërmendur ka ndaluar pesë metodat e para me ndalesë të rreptë për shkak se me të gjitha ato metoda bëhet përzierja e prejardhjes dhe humbet familja si institucion i rëndësishëm për qenien njeri dhe për mbarë shoqërinë. Në anën tjetër disa

dijetarë kanë lejuar metodën e pestë, sepse realisht ekziston mundësia e ruajtjes së familjes dhe obligimeve që pasojnë pas lindjes, siç janë respekti, trashëgimia, etj. Ndërsa dy format e fundit dijetarët myslimanë i lejuan, por gjithnjë duke i dhënë prioritet natyrshmërisë për krijimin e fëmijëve që janë marrëdhëniet seksuale të natyrshme. Rastet e tjera jashtë natyrshmërisë konsiderohen raste aksidentale dhe trajtohen vetëm në kuadër të standardeve të kurimit të tyre për të realizuar dëshirat e tyre.

Gjatë gjithë këtij procesi të fekondimit artificial, sipas konceptit islam duhet të merren parasysh edhe disa faktorë të tjerë të jashtëm të cilët nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimin por që kanë ndikim në dispozitën juridike islame të procesit. Në vazhdim do të përmendim disa prej tyre si:

1. Në asnjë mënyrë nuk lejohet zhveshja e trupit të femrës islame në prezencën e personit me të cilin i lejohet martesa (d.m.th. që i lejohet të ketë marrëdhënie seksuale me të).

2. Në rast se femra ka nevojë urgjente për t'u shëruar nga ndonjë sëmurje, apo, në raste se ka ndonjë çrregullim të jashtëzakonshëm në organizmin e saj, Sheriatit Islam i justifikon situata të tilla, ndërsa femrës që lëngon prej sëmundjeve të tilla ia lejon zhveshjen e trupit të vet para burrit të huaj, natyrisht, me qëllim mjekimi ose shërimi. Në këtë rast, zhveshja e trupit të saj

kushtëzohet me masë të caktuar, gjegjësisht, me zhveshjen e asaj pjese të trupit që e imponon nevoja për shërim.

3. Meqë Sheriati Islam e lejon zhveshjen me arsye të trupit të femrës në prezencë të personit me të cilin i lejohet martesë, atëherë në këto raste, pra gjatë mjekimit, duhet që mjeku të jetë femër myslimane. Por, nëse nuk ka mjekë myslimane, atëherë fillimisht duhet të kërkohet mjekë jomyslimane, e nëse edhe kjo mungon, atëherë duhet të kërkohet mjeku i sinqertë mysliman. Nëse edhe ky mungon atëherë mundet të kërkohet mjekë jomyslimane, e nëse edhe kjo mungon, atëherë mund të jetë mjek jomysliman, porse me kusht që mjeku dhe pacientja të mos vetmohen. Pra në atë rast prezent duhet të jetë edhe bashkëshorti, por, nëse mungon ai, atëherë pacienten duhet ta shoqërojë ndonjë femër tjetër.

4. Femrës së martuar, që nuk mundet të ngelet shtatzënë, por që ajo dhe bashkëshorti i saj dëshirojnë që të kenë fëmijë, Sheriati Islam ia lejon mjekimin - fekondimin artificial, mirëpo vetëm sipas atyre metodave të cilat i lejon Sheriati Islam.<sup>31</sup>

---

31. E gjithë kjo që u theksua këtu është një përfundim që rrodhi nga debati i Akademisë Botërore të Fikhut Islam në vitin 1986, vendime këto që u sollën me unanimitet me përjashtim të njërit anëtar të akademisë, i cili abstenoj.

Duke marrë parasysh faktet e shpalosura më sipër kuptohet në mënyrë të qartë që (se) sipas parimeve islame ndalohet roli i nënës barrëmbajtëse dhe të gjitha format e ndërveprimit social dhe të biznesit që lidhen me këtë proces. Në këtë mënyrë i jepet rëndësi dhe përparësi natyrshmërisë së institucionit të familjes dhe rolit të saj në shoqëri.

### Konkluzion

Shoqëria njerëzore po përballet me një rrjedhë të zhvillimeve të reja sociale, etiko-morale, e ekonomike të përcjella nga shpërndarja gjithnjë e më shumë e rolit të nënave barrëmbajtëse. Ky rol ka ndikuar në paraqitjen e strukturave të reja familjare si dhe rolit të ri të nënave. Roli i nënave barrëmbajtëse përcillet me kritika nga ana e ekspertëve, por edhe me pasoja të rënda psikologjike për vetë femrat që marrin një rol të tillë.

Hulumtimi vë në pah faktin që kohëve të fundit kemi të bëjmë me një trend të ri biznesi, i cili fëmijët i sheh si një lloj prodhimi. Paraqitja e llojeve të ndryshme të sigurimeve dhe formave financiare që kreditojnë planifikimin familjar janë duke ndikuar dukshëm në rritjen e këtij lloji të biznesit i cili pritet që në pesë vitet e ardhshme të prodhojë dhjetë herë më shumë të ardhura financiare. Gjithashtu gjigantët në treg janë duke bërë gjithnjë e më

shumë presion për të arritur liri sa më të mëdha ligjore të cilat lejojnë “prodhim e fëmijëve” sipas dëshirës së prindërve. Natyrisht që potenciali për keqpërdorime dhe zhvillim të formave të palejuara biznesi është i lartë. Zhvillime të tilla kanë ndikuar edhe në paraqitjen e fërkimeve të mendimeve dhe qëndrimeve të kodeve etiko-morale të grupeve të

ndryshme shoqërore dhe besimeve fetare. Në këtë pikëpamje, Islami ka theksuar në mënyrë të qartë qëndrimin e bazuar në fakte shkencore islame, ku dukshëm i jep përparësi institutit të familjes dhe rrjedhave të zhvillimeve të pastra të strukturave shoqërore, duke ndaluar në mënyrë të padiskutueshme rolin e nënës barrëmbajtëse.

### Bibliografia

Abazi, I. /Bislimi, T. /Ebibi, F. /Zimeri, J. (1996). E drejta familjare në Islam. Mexhlisit Shura të Bashkësisë Islame në R. Maqedonisë. Shkup.

Deppenbusch, Marion & Schultze-Mosgau, Askan (2019). Leihmutterchaft. Në: Diedrich, Klaus et. al. (redaktues): Reproduktionsmedizin. Berlin/ Heidelberg: Springer.

Imrie, Susan & Golombok, Susan (2020). Impact of New Family Forms on Parenting and Child Development. Annual Review of Developmental Psychology. 2020;2:295-316: DOI: <https://doi.org/10.1146/annurev-devpsych-070220-122704>

Ragone, Helena (2019). Surrogate Motherhood: Conception In The Heart. Sh.b. Routledge.

Schramm, Edward & Wermke, Michael (2018). Leihmutterchaft und Familie: Impulse aus Recht, Theologie und Medizin. Botoi: Springer-VerlagGmbH. Redaktor: Edward Schramm dhe Michael Wermke, Rechtswissenschaftliche Fakultät Friedrich-Schiller-Universität Jena, Jena, Gjermani.

Taebi, Mahboubeh/Alavi, Negin Masoudi/Ahmadi/Seyed Mehdi Ahmadi (2020). The Experiences of Surrogate Mothers: A Qualitative Study. Department of Midwifery and Reproductive Health, Nursing and Midwifery Care Research Center, Isfahan University of Medical Sciences, Isfahan Fertility and Infertility Center, Isfahan, Trauma Nursing Research Center, Kashan University of Medical Sciences, Kashan, Iran.



## Sfidat me të cilat përballen familjet myslimane në shoqërinë bashkëkohore

Msc. Ledian Cikalleshi

### Abstrakt

*Në periudhën moderne dhe post-moderne bashkëkohore familja myslimane përballlet me mjaft sfida, të cilat ia vështirësojnë jetesën e fesë me këshillat klasike, duke e kthyer jetesën si myslimanë në një sfidë. Zhvillimi i teknologjisë, shkencës dhe ndryshimit të kushteve të jetesës në krahasim me 50 apo 100 vite me parë, madje edhe të 10 viteve më parë, vazhdimisht ngre pikëpyetje dhe diskutime se si duhet të jetë qëndrimi i Islamit dhe si do përshtatemi me kushtet e reja, pa cenuar principet e fesë. Në familje sfida kryesore mbetet formimi i saj, që nga gjetja e bashkëshortit dhe bashkëshortes, martesë, mbajtja e mbulesës nëpër shkollë, vende pune dhe institucione, edukimi fetar nëpër shkollë, shkollat me edukim të përzierë djem dhe vajza, televizioni dhe edukimi i fëmijëve, ushqimet hallall dhe konsumimi i produkteve sipas kritereve islame, komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale, etj. Këto janë disa nga sfidat, me të cilat përballlet një familje myslimane për të ruajtur besimin dhe balancat e fesë. Për këto probleme janë dhënë disa zgjidhje apo fetva, por që mbeten të pamjaftueshme për të zgjidhur problemet, pasi dinamizmi i jetës post-moderne bën që disa fenomene të mos njihen që në fillim për pasojat negative që mund të përmbajnë. Synimi i këtij studimi është të identifikojë dhe të hedhë dritë mbi këto sfida, me të cilat përballlet familja myslimane në shoqërinë bashkëkohore, në botë në përgjithësi dhe në Shqipëri në veçanti.*

**Fjalët kyçe:** *modernizmi, teknologjia, familja, edukimi fetar, ushqimi hallall, mbulesa.*

## **HYRJE**

Familja myslimane tradicionale konsiderohet një strukturë komplekse ekonomike, sociale, shpirtërore, etike, morale, riprodiktive, edukative; me role, funksione e marrëdhënie personale e kolektive të rregulluara brenda brezave, me kohezion e solidaritet familjar, me hierarki, autoritet të pakontestueshëm dhe disiplinë të fortë. Megjithëse Kur'ani nuk rekomandon ndonjë lloj të veçantë të organizimit familjar, nuk ka dyshim se struktura tradicionale e familjes myslimane aktualisht ka qenë më afër llojit të zgjeruar sesa asaj bërthamë. Kjo me siguri është rezultat i vazhdimësisë, e jo rezultat i ndonjë risie nga myslimanët. Nëse ka ngjarë që organizimi familjar në shoqërinë myslimane e ka pranuar, apo më mirë e ka vazhduar këtë formë të zgjeruar, nuk ekziston ndonjë klauzolë që atij t'i jep japë një miratim apo mospëlqim universal. Mirëpo, pavarësisht se a ishte gjerësia e strukturës së familjes myslimane funksion i vazhdimësisë historike apo i kushteve të tjera shoqërore, Islami, në dukje, e pranoi këtë formë dhe nuk mori ndonjë qëndrim tjetër për të, ndryshe nga qëndrimi i tij për aspekte të tjera të ndryshme të familjes.<sup>1</sup>

---

1. Emine A. VEZAJ, "Familja e zgjeruar dhe sfidat bashkëkohore", <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=125>,

Tranzicioni që ka ndodhur në shoqërinë tonë, me kushtet e rrethanat e reja të krijuara në të gjitha segmentet e jetës ekonomike e shoqërore, me presionet e vrazhda transformuese të realitetit, ka bërë që familja si formacion themelor, të pësojë në strukturë, në përbërje, në koncept dhe në funksione, duke krijuar fizionomi, tipologji, funksione, moral e (pa)përgjegjësi të tjera brenda familjes.

Sfidat me të cilat përballet familja myslimane janë të pranishme edhe në Shqipëri, ndonëse njihet si një hapësirë më tradicionale ose më pak e modernizuar, krahasuar me Evropën Perëndimore. Ndryshimet rrënjësore të sistemit, specifkisht rrënimi i sistemit komunist, ka prodhuar ndryshime edhe në sferën e strukturës familjare.

Fokusi i studimit është familja myslimane e përballur me sfidat globale dhe rajonale, në përpjekje për të ruajtur vlerat fetare islame dhe përpjekjet e saj për të qenë në koherencë me këto vlera. Sfida bazë mbetet gjetja e një zgjidhjeje fetare (me fetva) dhe dinamizmi i jetës, i cili vazhdimisht prodhon problematika të reja, që kërkojnë zgjidhje.

## **SFIDAT E FAMILJES MYSLIMANE**

Në kushtet që jetojnë dhe rrethohen familjet myslimane, (29.02.2020).

sidoqoftë, ndikimi nga modernizmi dhe problematikat që ai mbart janë të pashmangshme. Në tërësi kjo është një krizë globale dhe të gjithë ndikohen nga pasojat e saj. Epoka e globalizimit ka bërë që kriza dhe pasojat e saj të ndjehet në çdo anë të globit, pasi prezenca e fenomeneve të përbashkëta e shkaktojnë dhe përcjellin krizën. Prezenca e teknologjisë, televizionit, telefonave inteligjentë dhe internetit, udhëtimi me makina, avionë, etj., është e pranishme pothuajse në çdo cep të globit. Myslimanët jetojnë kryesisht në Lindjen e Mesme, Afrikën veriore, Azinë Qendrore, pjesën ishullore si Indonezia, Malajzia, etj., në Ballkan dhe nëpërmjet emigrimit tashmë në çdo vend Perëndimor, deri në Australi.

Problemet familjare janë të vjetra, shënohen në çdo periudhë të historisë njerëzore, por sot me përmasa më të mëdha. Disa prej problemeve specifike, me të cilat përballet shoqëria globale dhe familjet myslimane, janë:

Shturja thellësisht e familjes së kohës sonë, mes të tjerash është pasojë e modernizmit dhe materializmit radikal.

Modernizmi ka sjellë jetesën e pavarur paramartesore, shtyrjen e martesës dhe bum në numrin e njerëzve në moshë.

Mediatizimi i seksualitetit dhe serialet e ndryshme plot intriga, tradhti bashkëshortore e dëmtojnë

rëndë familjen.

Zbehja e ndjenjave fetare është në proporcion të zhdrejtë me shëndetin e familjes, sa më shumë që dobësohet fetaria aq më tepër cenohet familja.<sup>2</sup>

Çdo rajon ka specifikat, problemet dhe sfidat e veta, me të cilat myslimanët përballen në ato zona. Ne nuk do të mund të analizojmë të gjitha problematikat dhe sfidat e familjeve myslimane, por do të përmendim disa fenomene të përbashkëta dhe do të përqendrohemi në problematikat konkrete të familjes myslimane që hasen në Ballkan dhe Shqipëri në veçanti.

## LIDHJET MARTESORE

Islami i jep rëndësi dhe shqetësohet për familjen, mbajtjen e saj të shëndoshë dhe të fortë, kështu themelet e saj janë të forta. Ajo përbëhet nga një bashkëshort dhe një bashkëshorte fisnike, ku fëmijët gjejnë një ambient të përshtatshëm dhe të dashur, në të cilin ata do të mësojnë edukatën dhe sjelljet e mira dhe do të rriten në një atmosferë të shëndoshë, me plot mundësi për të fituar dituri dhe edukatë, për t'u angazhuar në aktivitete shoqërore, intelektuale, shpirtërore dhe fizike.

---

2. Ali Pajaziti, "Familja e Shekullit XXI: Konteksti global, ballkanik dhe shqiptar", International Scientific Journal "Centrum", No. 8 – 2017, f. 50.

Duke u nisur nga roli që familja ka për edukimin e individit dhe shoqërisë, duhet që familja myslimane të ndërtohet mbi baza të shëndosha, e cila në krye të radhës qëndron besimi.

Profeti Muhamed (a.s.) sqaron se: “*Gruaja martohet për katër gjëra: për pasurinë e saj, për pozitën e saj shoqërore, për bukurinë e saj dhe për fenë e saj. Zgjidh pra gruan fetare që të kesh begati.*”<sup>3</sup>

Zgjedhja e një bashkëshorti apo bashkëshorteje fetare, në shoqërinë bashkëkohore, është bërë më e vështirë, qoftë në realitetin ballkanik, atë evropian, por edhe më gjerë. Nëse mendohet për Shqipërinë post-komuniste vështirësia është shumë më e madhe. Ambientet e shkollimit, të punës, në shoqëri nuk favorizojnë shfaqjen dhe praktikimin e besimit. Familja, që dikur ishte në ndihmë të gjetjes së një bashkëshorti apo bashkëshorteje mbi baza fetare, duke drejtpeshuar edhe aspektet sociale, tashmë është zbehur. Individualizimi dhe ndryshimi i dinamikave të shoqërisë ka bërë që të rinjtë të shkëputen nga ndikimi i familjes dhe daljes “jashtë mode” të martesës me mblesëri në zonat urbane.

Maksimizimi i individualizimit ka sjellë degradime të shumta familjare, nga relativizimi i kurorës, bashkëjetesa dhe shoqërimi pa kurorë, shtyrja e moshës së martesës dhe duke mos qenë të gatshëm për

3. Transmeton Buhariu, Kitabu en-nikah, 1835.

të marrë përgjegjësitë e martesës.

Në këto kushte është bërë e vështirë gjetja e një bashkëshorti/je mbi vlera fetare, por edhe ruajtja e martesës pasi është realizuar. Sot një problem madhor, që kërcënon shoqërinë në mbarë botën, është numri i madh i divorceve, i cili po rritet në nivele alarmante. Prandaj mbetet sfidë krijimi i një familje, por edhe ruajtja e saj, pasi realiteti i divorcit, fatkeqësisht, nuk përjashton familjet myslimane.

## **PUNËSIMI DHE MBAJTJA E SHAMISË**

Familja bashkëkohore, apo ajo e epokës së globalizimit, ka ndryshuar rrënjësisht. Rolet e anëtarëve dhe perceptimi për familjen, gjithashtu kanë ndryshuar. Format stereotipike si “burri fitues i bukës” dhe “gruaja kujdestare e shtëpisë dhe e fëmijëve” gjithnjë e më tepër po rrallohen; shumica e shtëpive kërkojnë të ardhura nga të dy bashkëshortët me qëllim të “mbijetesës”.<sup>4</sup>

Shpenzimet për të mbajtur familjen janë shtuar ndjeshëm për shkak të kushteve sociale dhe komoditeteve brenda familjes. Njëkohësisht janë shtuar edhe kostot për rritjen, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve. Blerja e një shtëpie/qiraja, blerja e një makine, orenditë shtëpiake, njëkohësisht edhe pagesa të ndryshme për të

4 Ali Pajaziti, artikull i cituar, f. 41

qenë në koherencë me pjesën tjetër të shoqërisë, si telefonat inteligjentë, interneti, televizioni, etj., kanë krijuar kosto shtesë për buxhetin familjar. Kjo ka bërë që të mos mjaftojë vetëm paga e burrit, por edhe gruaja të dalë për të kontribuar në ekonominë familjare.

Gruaja është sensibilizuar për të ndjekur një shkollim dhe të ketë një profesion ku të punojë jashtë shtëpisë, ndoshta edhe përkrah burrave të tjerë. Në fushën e arsimimit ka lindur sfida e mbajtjes së shamisë, pasi edhe presioni shoqëror është më i madh, por ka pasur raste kur shamia nuk është lejuar të mbahet nëpër ambientet shkollore dhe janë privuar nga shkollimi, nëse nuk e kanë hequr. Po kështu janë privuar nga punësimi nëpër institucionet publike dhe shtetërore për shkak të shamisë. Këtu janë vënë në dilemë për të mbajtur shaminë apo humbur vendin e punës.

Edhe meshkujt kanë si sfida punësimin, sidomos në vendet ku shërbehet alkoli. Të rinjtë, të cilët janë në kërkim të një pune të përkohshme si kamerier, apo vende të tjera që kanë të bëjnë me shërbimin e alkolit, që fetarisht është e ndaluar, janë në dilemë mes punësimit dhe mbajtjes së principeve fetare. Por edhe pasi diplomohen, përballen me sfida të tjera si punësimi nëpër banka dhe institucione, ku fetarisht përbën problem serioz.

## USHQIMET HALLALL

Feja Islame ua ka shpjeguar myslimanëve hallallin dhe haramin në ushqime. Ndaj, myslimanët janë të detyruar të shfrytëzojnë prodhimet hallall, e kanë të ndaluar përdorimin e prodhimeve haram dhe e kanë për detyrim t'u shmangen prodhimeve të dyshimta. Kur'ani Famëllartë thotë:

**“...do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat...”**<sup>5</sup>

Që një prodhim ushqimor të jetë hallall, të gjithë përbërësit e tij dhe çdo gjë që vjen në kontakt me të, gjatë procesit të prodhimit, duhet të jetë hallall dhe e pastër. Problematike paraqiten ushqimet e mëposhtme:

a) bonbonet, çokolatat dhe ëmbëlsirat e tjera. Në prodhimin e tyre përdoret alkoli, yndyra e derrit, xhelatina, e cila prodhohet prej eshtrave dhe prej mbeturinave të mishit në thertore, kurse është i pranishëm edhe përdorimi i suplementeve me prejardhje nga insektet;

b) buka dhe kulaçet (simitet). Në prodhimin e tyre përdoret yndyra e derrit, suplementet të dyshuara si kancerogjene, suplementet e prodhuara nga qimet e derrit dhe të njeriut;

c) disa pije joalkoolike po ashtu përmbajnë shkallë të caktuar të alkolit, i cili edhe pse i pranishëm, kurrë nuk deklarohet, kurse për ngjyrat dhe shijet e ndryshme kanë

5. El-A'raf, 7:157.

meritë suplementet e shumta;

d) mishi dhe përpunimet e mishit janë problem i veçantë.<sup>6</sup> Therja e kafshëve të lejuara fetarisht, duke thënë “Bismilah” ngrihet më së shumti si problematikë, por ka edhe disa edhe më problematike, të cilat lidhen me mënyrën e therjes si: goditja me elektrohok e kafshës para therjes e cila shkakton paralizim të përkohshëm të kafshës dhe pasi i hiqet koka të mos i zbrazet gjaku nga trupi i saj, rreziku i ngodhjes së kafshës nga godita e elektrohokut, që të dyja rastët e bëjnë mishin të pangrënshëm fetarisht.<sup>7</sup>

Blerja nga konsumatorët myslimanë e produkteve të mësipërme, brenda kornizës hallall, mbetet e vështirë. Kjo pasi në vendet me shumicë jo-myslimane apo me industri të pazhvilluar nuk prodhohen ushqime hallall. Alternativat janë të pakta dhe kushtojnë. Një pjesë e mirë e besimtarëve nuk dinë t’i dallojnë nëse janë hallall, duke u nisur nga përbërësit e tyre. Etiketat e certifikimit “Hallall” mungojnë. Prandaj ushqyerja me ushqime hallall mbetet sfidë për familjet myslimane.

## ARSIMIMI DHE EDUKIMI

Sipas Islamit, feja është një institucion hyjnor që e edukon

njeriun dhe një disiplinë që e bën atë një individ të përsosur. Gjithmonë ekziston një lidhje mes Krijuesit dhe krijesave dhe kjo lidhje është më e veçantë me njerëzit. Ngaqë njeriu jeton gjithmonë në shoqëri, feja e vazhdon aktivitetin e saj po mes njerëzve.

Përcjellja e besimit fetar, i cili është një realitet historik dhe ka arritur deri në ditët tona me anë të edukimit, është një çështje e rëndësishme. Feja, e cila zotëron një fuqi të madhe informimi dhe drejtimi në përgatitjen e njeriut për jetën, ka qenë në marrëdhënie të ngushtë me jetën e tij. Meqë feja i përfiton njeriut njohuri dhe veçori të pasura dhe të shumëllojshme, gjatë gjithë historisë asaj i është dhënë vend në arsim dhe nevoja për mbështetjen e saj është ndjerë kurdoherë. Arsimimi fetar, i cili është përgjegjës për edukimin e individit në pikëpamjen fetare, gjatë përgatitjes së tij për jetën nis nga bazat fetare dhe nga njohuritë teorike rreth tyre.<sup>8</sup>

Edukimi fetar realizohet fillimisht në familje, më pas në shkollë, universitet, shoqëri, kurse fetare, xhami, etj. Edukimi fetar nuk është i kufizuar me moshë, mirëpo baza mbetet familja dhe vitet e para në të cilat zhvillohet edukimi dhe karakteri i njeriut.

Sfida e shumë familjeve

---

6. Osman Kozliq, “Të jetojmë me hallall”, <https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=224> (29.02.2020)

7. Kur’ani, Maide 5:3.

---

8. Dr. Adil Kutlu, “Rëndësia e edukimit fetar”, <http://zaninalte.al/2018/12/rendesia-e-edukimit-fetar/> (01.03.2020)

muslimane mbetet edukimi fetar, mbi baza të shëndosha fetare, pedagogjike, morale dhe, më e rëndësishmja, në harmoni me shkencën, nevojat e kohës si dhe larg ekstremizmave. Edukimi fetar mbi bazat e mësipërme nuk është i lehtë dhe ka kosto.

Në Shqipëri arsimit fetar islam nuk zhvillohet nëpër institucione publike. E gjithë hierarkia e arsimit nga kopshti, arsimit parauniversitar, universitar fetar bëhet nëpërmjet institucioneve jo-publike. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë është përpjekur të shtrijë arsimin fetar nëpërmjet disa medreseve dhe Kolegjit Universitar Bedër, mirëpo arsimit dhe edukimit fetar në këto institucione u jepet një numri të kufizuar, në raport me numrin e popullsisë muslimane dhe nevojave në vend. Pamjaftueshmëria e tyre ka bërë që edukimi fetar të merret në formë të pakontrolluar, jo zyrtare dhe nga individë që nuk e kanë përgatitjen e duhur pedagogjike dhe fetare. Rrjedhimisht kjo sjell një mori problemesh, si pamjaftueshmërinë e edukimit dhe ekstremizmin fetar.

Një tjetër sfidë në arsim mbetet edukimi i përzierë, djem dhe vajza në një klasë, i cili për pjesën e të gjitha feve tradicionale në Shqipëri konsiderohet problematik. Në Shqipërinë post-komuniste të diskutosh këtë standard të arsimit, ku djem dhe vajza, janë në klasa ose shkolla të veçanta, duket shumë

larg. Në shkollat publike nuk ka një shkollë të tillë dhe nuk është temë diskutimi. Ndërsa në shkollat jo-publike si medresetë, në arsimin e mesëm, aplikohet si praktikë. Ndërsa në arsimin e lartë nuk aplikohet. Për shumë familje besimtare mbetet shqetësuese standardi edukativ dhe përzierja nëpër klasa në djem-vajza, pasi kjo ndikon në humbjen e vlerave fetare, të cilat përpiqen t'u japin në familje. Për këtë arsye, jo pak prindër nuk i kanë lejuar vajzat e tyre, të vazhdojnë studimet nga frika e shturjes morale dhe fetare.

### **MEDIA DHE RRJETET SOCIALE**

Teknologjia e telekomunikacionit hapi një faqe të re për mbarë njerëzimin në shekullin e kaluar. Fillimisht u shpik telefoni, radioja, televizioni duke vijuar më pas me kompjuterin, internetin, telefonat inteligjentë, etj. Veçoria e tyre është se përcjellin informacionin në kohë rekord në distanca të konsiderueshme gjatë komunikimit. Shpikja teknologjike, e cila ndikoi në përhapjen në masë të rrjeteve sociale, shtimin e varësisë, qëndrimin 24 orë online, është padyshim ajo e telefonave inteligjentë të gjeneratës së re.

Në konkluzionin e shumë studimeve është theksuar se, përdorimi i teknologjisë, rrjeteve sociale, ndikon jashtëzakonisht

shumë në jetën e njerëzve, në formimin e opinionëve të tyre, rënien pre e propagandës, madje në shumë raste deformon vlerat fetare dhe dëmton opinionin për të. Në këtë kontekst, shumë studiues tërheqin vëmendjen se teknologjia shton shpërdorimin (israf) e kohës, energjive dhe parave. Pavarësisht zhvillimeve pozitive ajo ka arritur në situatën ku dëmton vlerat morale dhe fetare.

Përdorimi i teknologjisë së telekomunikacionit solli një problem të madh për popullatën fetare të të gjitha besimeve. Problemi kryesor i shfaqur në to është transmetimi i pamjeve, filmimeve me përmbajtje lakuriqësie, erotizmi dhe pornografie. Megjithëse transmetimi i materialeve pornografike është sanksionuar dhe kufizuar me ligj për publikun e përgjithshëm, dikush që kërkon mund t'i arrijë ato lehtësisht. Ndërsa pamjet, figurat, fotot e njerëzve me përmbajtje lakuriqësie dhe erotike shfaqen lehtësisht, sidomos në komunikimet e rrjeteve sociale, fetarisht janë konsideruar të ndaluara (haram) dhe vlerësuar si gjynah. Mirëpo kontrollimi për mosshfaqjen, vetë-kontrolli për të mos i parë, ende është problem i pazgjidhur, duke bërë që besimtarët të hyjnë në gjynah.

Dëmi e kësaj pjese është i qartë për këdo, mirëpo vetë përdorimi i teknologjisë sjell probleme të tjera si humbja e kohës, angazhimi me

gjera të padobishme, varësia ndaj teknologjisë, humbja e vëmendjes, zbrazëtia e ndjenjave fetare dhe syfaqësia (rija), të cilat nuk hyjnë direkt në pjesën e haramit dhe të ketë një reaksion të menjëhershëm ndaj tyre.

Tashmë është konfirmuar zyrtarisht si shkak i divorcit nëpër gjykata, përdorimi dhe varësia nga rrjetet sociale. Nëpërmjet tyre ndodhin shumë fenomene negative si komunikimi me të panjohur, njohje dhe lidhje jashtë martesore, provokime, ngacmime, etj. Ende qëndron si koncept për përdorimin e teknologjisë se “nëse e përdor për qëllime të mira është e dobishme, nëse jo është e dëmshme”. Koha ka treguar se ky koncept nuk qëndron dot më mbi teknologjinë.

Familjet myslimane njëkohësisht janë të prekura, ekspozuara dhe vuajnë pasojat e përdorimit të medias, teknologjisë së komunikimit dhe të rrjeteve sociale. Sfidat e familjeve myslimane bashkëkohore është se nuk po gjejnë dot një zgjidhje për të minimizuar dëmet që sjell përdorimi i teknologjisë te fëmijët dhe moshat e reja.

## KONKLUZIONE

Procesi i shekullarizimit apo i dobësimit të ndikimit të fesë, ka ndikuar në dobësimin e lidhjeve familjare. Mungesa e pjetarëve të moshës së trëtë në familjen



bërthamë dhe tkurrja e familjes sjellin probleme që kanë të bëjnë me socializimin. Siç është shprehur një shkrimtar, kriza e “gjeneratës së i-phonave dhe smart-phonave” është edhe për shkak të mungesës së përrallave që mësoheshin në prehrin e më të vjetërve. Sot ka tendenca që disa funksione të familjes t’i kryejnë institucionet e reja: kopshti i fëmijëve, shkolla, konvikti, shtëpia e pleqve, shtëpitë e strehimit.

Studimet dhe kërkimet e shumta të bëra në botë për familjen, flasin për faktin se familja globalisht është në krizë, gjë që reflektohet edhe në

kontekstin tonë shqiptar. Familja e periudhës së globalizimit shkon drejt shpërbërjes, në të nuk ka vend për tre breza.

Si rezultat sjellin i këtyre zhvillimeve, sfida për familjet myslimane bashkëkohore në jetesën e fesë, praktikimin, ruajtjen nga shumë të ndaluara, ushqyerjen me ushqime hallall, edukimin dhe përdorimin e teknologjisë. Disa sfida janë vetëm për familjet myslimane, ndërsa disa të tjera mbeten globale dhe duhet bashkëpunim edhe me faktorë të tjerë për të gjetur zgjidhjen e duhur për to.

## Vdekja e bardhë: Ibn ‘Arabiu rreth sprovave e virtyteve të urisë dhe agjërimit

Atif Khalil<sup>1</sup>

Universiteti i Lethbridge, Kanada

### Abstrakt

*Ky artikull paraqet një analizë të trajtimit të agjërimit dhe urisë nga Ibn ‘Arabiu (vd. 1240) në krerët 106 e 107 të kryeveprës së tij El-Futuhatu ‘l-mekkejje (“Hapjet mekase”). Në shqyrtimin e kësaj pjese të shkurtër të tekstit enciklopedik, sprova nxjerr në pah domethënien e thellë teologjike të urisë dhe agjërimit, duke theksuar virtytet dhe takëmet e mundit shpirtëror në mendimin e mistikut andaluzian. Gjithashtu, bëhet përpjekje për t’i venduar disa ide të Ibn ‘Arabiut në kontekstin e gjerë të traditës sufiste të hershme, të cilën ai e trashëgoi.*

---

1. *Shënim i autorit:* Dëshiroj t’i shpreh mirënjohjen z. Eric Winkel, i cili ofroi ndihmesë të paçmueshme në deshifrimin e disa prej fragmenteve më delikate të *Futubat*, si dhe Hany T. Ibrahim, Peri Bearman e të tjerëve për komentet e tyre konstruktive në stadi të ndryshme të këtij artikulli.

Agjërimi është një ndër praktikat fetare më të përhapura në historinë e njerëzimit. I ndërmarrë si formë pendese, rit përgatitor para fillimit, metodë për të induktuar vizione dhe ëndrra vërtetësie, mjet për shmangien e katastrofave natyrore, shprehje pikëllimi ose falënderimi, apo thjesht si mekanizëm për të kontrolluar e shtruar pasionet, duke mpakur burimin e ushqyerjes së tyre, ai haset në thuajse çdo kulturë e shoqëri.<sup>2</sup> Ndërkohë që format e tij kanë dalluar ndjeshëm në hapësirë dhe kohë, në zemër të këtij rituali qëndron gjakimi për t'iu qasur botës së shpirttrave dhe, matanë saj, vetë Realitetit të mbramë, nëpërmjet një përjetimi të ndërgjegjshëm, me dëshirë dhe të vetë-imponuar, të urisë.<sup>3</sup>

Në Islam, agjërimi (*saum*) ndërmerret bashkërisht gjatë muajit të Ramazanit në një shkallë, e cila, në botën moderne, nuk e ka shoqen tek asnjëra bashkësi fetare.<sup>4</sup> **“Agjërimi ju është parashkruar”**, - deklaroi Kur’ani, - **“siç iu pat parashkruar atyre para jush, që të druheni”**

2. Të shihen Hastings 1908–28: 5: 759–71, në faqe 759. Cf. von Braun 2006; Russell 2005.

3. Etja luan rol të rëndësishëm në agjërimin islam, por ka forma agjërimi te kultura të tjera që e përjashtojnë të përmbajturit nga uji.

4. Rreth domethënies së këtij muaji në historinë, devotshmërinë dhe shpalljen islame, të shihen Goiten 1966; Nasr 1981: 214–15; Neuwirth 2004.

(2:183). Mirëpo, për shumë myslimanë të devotshëm, nënshtrimi i trupit ndaj urisë dhe etjes, nëpërmjet agjërimit, shkon goxha përtej muajit të shenjtë dhe zgjatet te ditët e këshilluara të ‘Arafatit, ‘Ashurasë, “netëve të bardha” (ditët 13, 14 e 15 të kalendarit hënor, të cilat përkojnë me hënën e plotë), gjashtë ditët e muajit Sheual pas Ramazanit, dhjetë ditët e para të muajit Dhul-hixhxe, ditën e parë të Muharremit, agjërimit të hënave dhe të enjteve, agjërimit çdo dy ditë (të quajtur “agjërimi i profetit Davud”) dhe, përtej këtyre, në cilëndo ditë të vitit, në të cilën mund të ndihesh i frymëzuar, me përjashtim të dy Bajrameve kur ndalohet haptas.<sup>5</sup>

Vlera që i njihet *saum*-it dëshmohej te shembulli i Profetit dhe shumë prej këshillave të tij. “*Gjithçka e ka një derë*”, - thoshte ai, - “*dhe dera e adburimit (‘ibade) është agjërimi.*”<sup>6</sup> Ai ka

5. Të cilave mund t’u shtojmë ditët e ndaluara të *tesbrik*-ut, datat 11, 12 e 13 Dhul-Hixhxe. Natyrisht, statusi i saktë i agjërimit në ditët e lartpërmendura ka qenë lëndë e njëfarë debati juridik. Rreth agjërimëve të këshilluara, të shihen El-Gazali 1998, 1: 407–10 (për përkthimin e librit të gjashtë, të shihet Fitzgerald 2018). Cf. Mahmud 2017. Te shi’at dymbëdhjetë-imami, agjërimi i ‘Ashurasë është tejet i papëlqyer. Rreth historisë së agjërimit të ‘Ashurasë, të shihet Bashear 2004 dhe Rizvi 2006.

6. Cituar në El-Mekki 1995, 2: 332.

thënë gjithashtu: “*Durimi është gjysma e besimit.*”, dhe “*Gjysma e durimit qëndron tek agjërimi.*”<sup>7</sup> Një herë, një shoqërues gromësiu pa takt në prani të tij dhe Profeti paralajmëroi: “*Më të ngopurit prej jush në dynja do të jenë më të uriturit në ahiret.*” Me të dëgjuar këtë, burri u përgjigj: “Pasha Zotin, qysh sot nuk do ta mbush barkun më.”<sup>8</sup> Aq proverbiale ishte përkorja e Profetit, sa që ‘Aisha (vd. 678), bashkëshortja e tij, ankohej: “Bidati i parë i futur pas vdekjes së të Dërguarit të Zotit qe ngopja (*shëb*).”<sup>9</sup> Kjo, jo për të thënë se ai ia mohonte vetes kënaqësitë e jetës, në të cilat, përkundrazi, shquante dhurata hyjnore, siç dëshmojnë tradita të shumta. Me fjalët e Valerie Hoffman, “qëndrimi tërësor i Hadithit është se myslimanët nuk duhet të jenë as tepër të kësobotshëm e as tepër të asobotshëm, porse të marrin, siç e shpreh një *hadith*, nga kjo botë dhe tjetra.”<sup>10</sup> Megjithatë, moderimi i Profetit anonte pa dyshim kah vetëpërmbajtja dhe pikërisht kjo prirje e tij drejt të përmbajturit u bë

7. Të cituar të dy në El-Suhrauerdi :2005 346.

8. El-Mekki 1995, 2: 325.

9. El-Mekki 1995, 2: 327.

10. Hoffman 1995: 467. Artikulli i Hoffmanit është përvijimi më i mirë i agjërimin në traditën mistike islame. Rreth agjërimin në shpirtshmërinë myslimane të hershme, të shihet Gramlich 1997: 222–49; për një analizë aktuale të shprehive ngrënëse të sufive të hershëm, të shihet Selamah-Qudsi 2019.

baza e theksit të vënë mbi *saum*-in dhe urinë në sufizëm, sidomos në mesin e asketëve të hershëm (*ex-zubhad*).

Ky artikull heton dy krerë të shkurtër nga *el-Futubatu l-mekkejje* e Ibn ‘Arabiut (vd. 1240) mbi sprovat dhe virtytet e të përmbajturit nga ushqimi dhe pirja, me titujt “Rreth njohurisë mbi urinë e kërkuar” (*Fi ma’rifetu l-xbu’ el-metlub*) dhe “Rreth lënies së urisë” (*Fi terk el-xbu’*), përkatësisht.<sup>11</sup> Ndërsa mistiku e shtjellon çështjen e agjërimin gjerësisht në kreun 71 mbi “fshehtësitë e agjërimin” (*esrar es-saum*), ne do të përqendrohemi kryesisht te dy krerët në shqyrtim, me ca ndërfitje në seksione të tjera të tekstit. Dy krerët e ngjeshur hyjnë te seksioni i gjerë i *Futubat*, i cili u kushtohet ndalesave në udhë, ku Ibn ‘Arabi u heton gjerë e gjatë themelet metafizike të etikës sufiste.

Ibn ‘Arabi u hap të parin nga dy krerët duke ravijëzuar katër vdekjet (*erba’a mentat*) që duhet të kalojë rrugëtuesi i përsheptshëm në udhën drejt Zotit,<sup>12</sup> çdonjëra nga të cilat është element i domosdoshëm në traditën sufiste të vdekjes (*ment*) së aluduar në hadithin e mirënjohur:

11. Ibn el-‘Arabi 1990, 13: 637–45. Ndonëse përkthimet e mëposhtme janë të miat, kam konsultuar lirisht përkthimin e Eric Winkel në versionin e tij para botimit (2016: 249–57).

12. Ibn el-‘Arabi 1990, 13: 637–38.

“*Vdis para se me vdekë!*”<sup>13</sup> Këto vdekje<sup>14</sup> përfshijnë “vdekjen e gjelbër” të veshjes së rrobave të arnuara si shenjë dorëheqjeje, shumë e ngjashme me “betimin e varfërisë” të gjendur mes murgjve të krishterë. Omer ibn el-Khattab (vd. 644), na thuhet, vishte një rrobë me trembëdhjetë arna.<sup>15</sup> Domethënia simbolike e kësaj ngjyre qëndron, sipas disa autoriteteve, te fuqia e saj për të sjellë në jetë një bukuri të brendshme thelbësore të shpirtit, të lirë nga nevoja për zbukurim të jashtëm.<sup>16</sup> Pastaj kemi “vdekjen e zezë” të durimit me *sabr* të fyerjeve dhe lëndimeve të të tjerëve (*tehammul el-edha*), pa kërkuar hakmarrje ose shpagim. Lëndimi (*edha*) që rrugëtuesi duron në gjendje *sabri* i ngjan asaj që vetë Zoti duron nga njerëzit, siç shpjegon Ibn ‘Arabiu në kreun mbi mekamin e

13. Të shihen pohimet e shkurtra mbi domethënien e kësaj tradite në sufizëm nga Ritter 601 ,193 :2003; dhe Schimmel :2011 320 ,135.

14. Llojet e vdekjeve të përmendura këtu janë shpjeguar më me hollësi nga Esh-Shernubi 2011: 57. Kjo vepër nga dijetari ez’herist i fillim-shekullit XX përbën komentim të një poeme sufiste të paraardhësit të tij të largët Shejkh Ebu l’-Abbas Ahmed esh-Shernubi (vd. 995/1585).

15. Ibn el-’Arabi 1990, 13: 637. Megjithatë, siç më njoftoi me humor një shejkh sufi egjiptian, në dritën e prirjeve aktuale të modës, “vdekja e gjelbër” duhet parë në kontekstin e duhur.

16. Esh-Shernubi 2011: 57. Nganjëherë ajo përmendet edhe si “vdekje e verdhë” (*el-ment el-esfer*).

sabrit.<sup>17</sup> Pastaj është “vdekja e kuqe” e kundërshtimit të dëshirave dhe prirjeve të ulëta të vetes (*mukhalafat en-nefs fi agradiha*), e hulumtuar shpesh në literaturën sufiste në kontekstin e mundit (*muxhabede*) dhe “përpjekjes (*xhibad*) së brendshme”.<sup>18</sup> Një thënie e ‘Aliut (vd. 661) e përshkruan “vdekjen e kuqe” si vdekje “nga shpata”<sup>19</sup>, e cila mund të përshkruhet në një kuptim më mistik si vdekje nga shpata që pikon gjak dhe pret tekat. Fundja, e kuqja është ngjyra e gjakut, forcës jetike që gjallëron e mban trupin, dhe në simbolikën perse të ngjyrave ajo lidhet nganjëherë me “faqe dhe vello nusërore”<sup>20</sup> e përtej kësaj, me dashurinë erotike, ndonëse shoqërimi me Erosin nuk mund të zgjatet tepër larg për shkak të natyrës jobeqare të shpirtshmërisë islame, e cila kombinonte shpesh shqitjen me jetën e martuar.<sup>21</sup> Më në fund kemi

17. Ibn el-’Arabi 1990: kr. CXXIV: “Dije - Zoti të dhashtë sukses - se Zoti i Tejlartësuar thotë: ‘**Ata që e lëndojnë** (ju’dhune) **Zotin dhe të Dërguarin e Tij**’ [Kur’an, 33:57], duke e bërë të qartë kësodore se Ai lëndohet. Ai quhet *Es-Sabur* në sajë të lëndimit të krijesave [që Ai duron].”

18. Esh-Shernubi 2011: 57–58.

19. Kjo traditë gjurmohet te dijetari shi’i i shekullit V/XI, esh-Shejkh el-Mufid (1995, 2: 372).

20. Schimmel 1992: 265.

21. Ndërsa zbatohet te devotshmëria e krishterë mesjetare, pohimi i Tor Andrae-it (1987: 52) se, në qoftë se beqaria është urdhëresa e parë e jetës mistike, agjërimi është i dyti, nuk vlen tek Islami. Kështu, për shembull, mund të lexojmë tek Ibn el-’Arabi (1971: 96) një rrëfim për një veli i cili,

“vdekjen e bardhë” (*el-ment el-ebjed*) të urisë (*xbu*), bardhësia e së cilës vjen, të paktën pjesërisht, nga çehrja e zbehtë ose humbja e “skuqjes jetike” të personit të privuar nga ushqimi dhe pija. Përshkrimi i “vdekjes së bardhë” nga ‘Aliu si vdekje nga murtaja (*ta’un*) duket se e përplotëson këtë vështrim, pasi murtaja sjell shpesh uri e mosushqim.<sup>22</sup> Të njohurit me traditën folklorike islame të mesjetës mund të kujtojnë gjithashtu historinë e Ademit, i cili agjëroi në pendim pas Rënies, në tri “ditë të bardha” të hënës së plotë, duke rifituar kështu bardhësinë e një toni lëkuror që ishte nxirë nga mosbindja.<sup>23</sup> Ndërsa nuk ka dëshmi për të sugjeruar se vetë Ibn ‘Arabi mbështetet te kjo traditë, të paktën në kuptimin e saj të fjalëpërfjalshëm, pa harruar se “racializimi shpirtëror” në këtë rrëfim pasqyron nënryma etnocentrike të caktuara në kulturën e Lindjes së Afërt shumë para Islamit që mungojnë tek Ibn ‘Arabi, ky tregim që nuk gjendet në burimet fetare mundet megjithatë të shihet simbolikisht si referim ndaj përndritjes së brendshme që sjell uria e vullnetshme. Kjo, sepse shpirti i pastruar nga një praktikë e tillë mund të thuhet se pasqyron rrëzëllimën e

22. Esh-Shejh el-Mufid 1995, 2: 372.

23. Es-Suhrauerdi 2005: 351.

dritës hyjnore – siç e pasqyron hëna diellin netëve të “ditëve të bardha” kur agjëroi Ademi – duke e lejuar kësodore njeriun që ta realizojë natyrën e vet teomorfike si *imago dei* mbi tokë. Lidhja e ngushtë e agjërimin me përndritjen e brendshme gjen konfirmim te vepra *Istilabat es-sufijje* e ‘Abdur-Rezzak Kashaniut (vd. 1330), ku ai shpjegon se uria e sufive quhet “vdekje e bardhë” sepse “zbardh të brendshmen dhe ndrit faqen e zemrës.”<sup>24</sup>

Borxhin e Ibn ‘Arabiut ndaj traditës së hershme e zbulon fakti se, në parashtrimin që i bën domosdoshmërisë së përshkimit të katër vdekjeve, ai gati me siguri mbështetet te *Risale* e Kushejriut (vd. 1072), doracak të cilin ai e studioi me vëmendje nën drejtimin e njërit prej mjeshtërve të tij, veliut Jusuf el-Kumi, dhe përmes së cilit hasi për së pari fjalorin teknik të sufive.<sup>25</sup> Çështje e vërteta, Ibn ‘Arabi ishte aq i përkushtuar ndaj studimit të kësaj vepre, kur ndodhej në Andaluzi, sa që mori mbiemrin e autorit të saj.<sup>26</sup> Në *Risale* gjejmë një

24. Kashani 1992: s.v. *el-ment el-ebjed*. Për një analizë krahasimtare të racizmit modern dhe paramodern, të shihet Ogunnaike 2016.

25. Raporti i Ibn ‘Arabiut me këtë mjeshtër ishte aq intim, sa që pas vdekjes së tij, ai thërriste shpirtin e mjeshtër për të kërkuar këshillë mbi një çështje shpirtërore. Të shihet Corbin 1969: 224.

26. Pra, atij iu dha mbiemri “el-Kushejri”, Addas 1993: 102. Për më tepër rreth përdorimit të *Risales* nga Ibn ‘Arabi, të

thënie të Hatim Asammit (vd. 852), myhib i të shquarit Shekik el-Balkhi (vd. 810), e cila regjistron atë që mund të jetë një ndër përshkrimet më të hershme të domosdoshmërive të jetës së përshpirtshme: “Kush dëshiron të ndjekë rrugën tonë”, - pohonte Hatimi, - “duhet të fitojë katër veçoritë e vdekjes (*erba’u kbisal min el-ment*): vdekjen e bardhë, që është uria; vdekjen e zezë, që është durimi i lëndimit nga të tjerët; vdekjen e kuqe, që është të vepruarit e sinqertë në kundërshtimin e tekave (*mukbalafat el-heua*’); dhe vdekjen e gjelbër, që është veshja e një rrobe me arna të qepura njëra përmbi tjetrën.”<sup>27</sup> Në rastin e posaçëm të Hatimit, impulsi fuqimisht asketik pas fjalëve të tij, emblematik për mënyrën e devotshmërisë së mëkuar në traditën e hershme, vinte me gjasa nga ndikimi i murshidit të tij Shekik, i cili ishte vetë murid i Ibrahim ibn Ed’hemit, me nam për heqjen dorë nga një mbretëri e tërë për të jetuar në lutje e varfëri (*feker*) dhe për kthimin në model të këtij virtyti për brezat e ardhshëm.<sup>28</sup> Nga Hatimi kemi një tjetër thënie, që pasqyron të njëjtat cilësi vetëmohuese, për të cilat Ibrahim u bë i mirënjohur: “Nuk kalon mëngjes”, - vërejtja ai, - “që Shejtani të mos më pyesë: ‘Çfarë do hash? Çfarë do mbathësh? Ku

do të rrosh?’ Unë i gjegjem: ‘Do ha vdekje, do mbath qefinin, do jetoj në varr.’”<sup>29</sup>

Ibn ‘Arabi atëherë i kthehet shpjegimit të qëllimit të *el-xhu’ el-metlub*, urisë së kërkuar. Ai pohon se ajo është uri e vullnetshme, nëpërmjet të cilës ndërtimi natyror i trupit mbahet në mënyrë që të mos i jepet më tepër se ç’i nevojitet absolutisht, duke mbetur ndërkaq i lirë nga të gjitha teprimet (*tekilil fudul et-tabb*). Gjithashtu, ajo lejon prehje nga lëvizjet për të plotësuar nevojat e zakonshme të trupit (*es-sukun ila el-haraketi ila el-baxhë*), duke lehtësuar kështu një qetësi të brendshme përmes një qetësimi të jashtëm. Më me rëndësi, përtej të gjitha këtyre, është realizimi i ose pjesëmarrja në *es-sifa es-samedanijje*, cilësinë e kryehershmërisë dhe përjetësisë së Zotit, dhe në përputhje me këtë, lirinë e Zotit nga dëshira dhe nevoja – të përmbajtur te emri hyjnor *es-Samed*.

Po ç’ka në menditë të Ibn ‘Arabiu këtu? Si lidhet agjërimi me samedanijjen (ose samedijjen) e Zotit? Për ta rrokur më mirë atë që nënkupton mistiku ynë, duhet t’i kthehemi trajtesës së shekullit X mbi rregullat e jetës së përshpirtshme, *Kitab el-Luma’* nga Ebu Nasr es-Serraxh (vd. 988). Në kreun e tij të shkurtër por depërtues mbi *saum-in*, ai e hap hulumtimin me

shihet Chodkiewicz 2009.

27. El-Kushejri 2002: 83 (seksioni mbi Ebu ‘Abdurr-Rahman Hatim ibn ‘Alwan).

28. Të shihet Khalil 2016.

29. El-Kushejri 2002: 82 (seksioni mbi Ebu ‘Abdurr-Rahman Hatim ibn ‘Alwan).

një komentim të thënies së shenjtë hyjnore (*hadith kudsî*): “Agjërimi është Imi dhe shpërblimi i tij Më përket Mua” (*es-saum li ue-ene exhzi bibi*). Në shpjegimin e tij, ai tërheq vëmendjen ndaj dy niveleve të kuptimit në këtë hadith kudsî.

Së pari, ngaqë agjërimi është i vetmi akt përkushtimor që përfshin të përmbajturit nga një veprim – ndryshe nga çdo formë tjetër veprimtarie fetare – ku agjëruenin e shënjon një lloj i veçantë sinqeriteti në atë se devotshmëria e tij mbetet krejtësisht e fshehur nga sytë e të tjerëve. Natyra e aktit përkushtimor, pra i jep bërësit të tij njëfarë mbrojtjeje nga hipokrizia, ngase nuk ka gjë për të treguar ose parë. Agjërimi “është Imi”, - shpjegon Serraxh, - sepse atë nuk e sheh kush, veç Zotit.

Së dyti, dhe me rëndësi të posaçme për diskutimin tonë, ngaqë agjërimi përfshin jo vetëm të përmbajturit nga një veprim, por edhe frenimin nga ajo që ushqen ndërtimin natyror të trupit, ai i lejon agjëruenin të marrë pjesë, sipas nivelit përkatës të ekzistencës, në pavarësinë e Zotit, në cilësinë e tij të *samedijje-s* dhe kësodore, paradoksisht, në transcendencën hyjnore (*tenzîh*). Kur heq dorë nga ushqimi e pija, me çka mposht dëshirën më bazike të trupit, agjërueni bëhet “si i hyjnishëm” duke marrë pjesë në lirinë e Zotit nga ushqimi material, sepse fundja Ai as nuk ha, as nuk pi. Ndaj, agjërimi është i vetmi akt që i lejon njeriut

përjetimin e dhe pjesëmarrjen në tjetërsinë e Zotit, në një natyrë e cila mbetet përjetësisht e cilësuar nga pavarësia e plotë.<sup>30</sup> Për më tepër, shpërblimi që Zoti ka përgatitur për agjërimin e tejkalon përfytyrimin njerëzor, sepse vetë ky akt i tejkalon veprimet dhe përfshin përvetësimin e një cilësie hyjnore, në këtë rast transcendencës përmes *samedijjes*. Veç kësaj, shpërblimi nuk ka cak, sepse duke qenë mosveprim, ky akt nuk ka kufi (të paktën në kuptimin e rëndomtë) dhe gjithashtu sepse *sa’imun* (agjëruenin) janë *sabirun* (durimtarë), dhe “**durimtarët do t’i marrin shpërblimet e tyre pa kufi**” (39:10)<sup>31</sup> – së këndejmi edhe mbyllja e *hadithit kudsî*, “dhe shpërblimi i tij Më takon Mua.”<sup>32</sup>

Fakti se Ibn ‘Arabiu zhvillon këtë linjë mendimi konfirmohet kur i kthehemi kreut 71 në *Futubat*. Aty, ai e bën haptas lidhjen e lartpërmendur dhe e shtjellon me hollësi spikatëse, në një mënyrë që na lejon ta çmojmë më mirë rëndësinë e plotë të fjalëve së Serraxhit. Na tregohet se, një herë, Profetit iu afrua një nga shoqëruenin

30. Es-Serraxh 2001: 151.

31. Raporti intim ndërmjet durimit e agjërimin i nënvizuar në hadithin e mësipërm u shtjellua gjerësisht në literaturën sufiste, sidomos në dritën e klasifikimeve bazë të durimit (*sabr*), si akt “vetëpërmbajtjeje” ose “tkurrjeje të egos” (*Habsu ‘n-nefs*). Të shihet, për shembull, Hujwiri 1992: 321–22.

32. Es-Serraxh 2001: 151–52. Të shihet edhe shpjegimi i kësaj tradite nga Hujwiri (1992: 320).



e tij për këshillë. “Përvishju agjërimit”, - iu gëgj ai, - “sepse ai nuk ka shëmbëllim (*la mithle lebu*)”<sup>33</sup>, ku fjalët e fundit kanë rëndësi kritike, sepse i bëjnë jehonë një fragmenti të shpalljes së cituar shpesh në diskutimet klasike rreth teologjisë islame. Të qenët e agjërimit unik mes akteve përkushtimore, debaton Ibn ‘Arabi, vjen jo vetëm pse ai kërkon lënie e një veprimi (*terke*), po sepse është analog me njëshmërinë e Zotit, ngase “asgjë nuk është si shëmbëllimi i Tij” (*lejse ke-mithlibi shej*) (42:11). Nëpërmjet *la mithle lebu* të agjërimit, deklaroi mistiku, agjëruesi shkrihet në *lejse ke-mithlibi shej* të Zotit, pra në *tenzib*-un hyjnor. Pohimi “agjërimit është Imi” tregon takimin unik mes rendit hyjnor dhe atij njerëzor, që ndodh përmes *saum*-it, ku vetë Zoti bëhet shpërblimi i agjëruesit, ose më saktë Zoti është *sa'im*-i. Siç pamë, kjo ndodh sepse *sa'im*-i merr ngjyrim nga atributi hyjnor i *samedanijje*-s ose emrit hyjnor *es-Samed*, duke hequr dorë nga atributi i tij, prej krijese, i ngrënies dhe pirjes. Megjithatë, transcendenca hyjnore, në të cilën merr pjesë njeriu, duhet cilësuar pasi është e kufizuar në natyrën e vet jo tërësore në shtrirje – prejse transcendenca absolute i përket vetëm Madhështisë Hyjnore – për shkak të detyrimit të njeriut (si nga natyra, ashtu edhe nga ligji fetar) që dikur ta ndërpresë agjërimitin, ndryshe nga Zoti, agjërimiti i të Cilit

33. Ibn el-'Arabi 1990, 9: 103, 104.

është i përhershëm, sepse Ai mbetet përgjithmonë i lirë nga dëshira.<sup>34</sup>

Prapëseprapë, raporti unik ndërmjet agjërimit njerëzor e samedanijjes hyjnore mbetet dhe theksohet sërish nga Ibn ‘Arabi kur tërheq vëmendjen ndaj një hadithi pak të njohur: “Mos thoni Ramadan sepse Ramadan është emër (*ism*) ndër emrat e Zotit të Tejlartësuar!”<sup>35</sup> Ndërsa zinxhiri i transmetimit të kësaj tradite – të cituar edhe nga Gazali<sup>36</sup> – iu nënshtrua njëfarë kritike nga dijetarët e Hadithit për shkak të dobësisë së njërës prej hallkave të tij, për Ibn ‘Arabiun atë e forcon një konfirmim i nënkuptuar i përmbajtjes së tij i ndodhur në shpallje: kur flet për Ramazanin, Kur’ani ose i vë parashtesën “muaji i” (si të *shebr ramadan*, 2:185), ose i referohet thjesht si “muaji” (2:185), por nuk e identifikon kurrë si vetëm Ramadan, dhe kjo është të paktën pjesërisht për të aluduar statusin e tij si emër hyjnor. Pra, emri dallohet nga muaji i emëruar sipas tij, sepse ky i fundit cilësohet gjithmonë me *shebr*. Për më tepër, si në rastin e *saum*-it, Ramazani “nuk ka shëmbëllim”, sepse është i vetmi muaj i kalendarit hënor i quajtur sipas një emri të Zotit. Ngase është muaji në të cilin vetëshpalosja e samedanijjes së Zotit ndodh kolektivisht në bashkësinë islame të agjëruesve, kuptimi i

34. Ibn el-'Arabi 1990, 9: 103.

35. Ibn el-'Arabi 1990, 9: 115.

36. El-Gazali 2008: 237.

emrit të tij është *samed*, duke bërë që përkthimi i “Ramadan” të jetë “muaji i samedanijes”. Me fjalë të tjera, vetëshpalosja e samedanijes së Zotit ndodh në plotësinë e saj në muajin sipas të cilit quhet. Ibn ‘Arabi ngulmon se të qenët e këtij muaji unik nuk vjen nga shenjtëria, sepse Rexhebi u përshkrua nga Profeti si sakral (*mubarrem-i shenjtë*).<sup>37</sup> Rasti unik i tij – përveç të qenët muaji i shpalljes – qëndron te qenia e tij i vetmi muaj i quajtur me një *ism* hyjnor, kuptimi i të cilit tërheq vëmendjen ndaj amshueshmërisë, pavarësisë dhe lirisë së Zotit nga dëshira.<sup>38</sup>

Duke iu kthyer kreut 106, Ibn ‘Arabi vazhdon e shpjegon se uria e kërkuar – vdekja e bardhë që përndrit zemrën – duhet të jetë krejtësisht

37. Ibn el-‘Arabi 1990, 9: 116. Për një analizë historike të domethënies së këtij muaji, të shihet Kister 1971.

38. Në traditën e mëvonshme shohim një zbatim kureshtar të këtij tejpveshtrimi te natyra e agjërimit në një debat në *fikh*. Sha’rani (vd. 1573) vëren në *el-Mijzan el-kubra* se mes atyre që anojnë kah vështrimi se përdorimi i misvakut lejohej gjatë agjërimit, njëri grup debatonte se, ngaqë agjërimi përfshin pjesëmarrjen në *sifa samedanije*, ai kërkon të mbeturit i lirë – si Zoti – nga papërsosuritë, të metat dhe papastërtitë njerëzore, si në përmasat shqisore, ashtu edhe ato shpirtërore të njeriut. Pra, ashtu sikurse duhet të përmbahet nga të folurit e pahijshëm, si thashethemet, shpifja e gënjeshttra, agjëruesi duhet të mundohet edhe të qëndrojë i lirë nga aroma të pakëndshme. Të shihet Esh-Sha’rani n.d., 2: 26.

e vullnetshme (*ikhtijari*) dhe e shtrënguar nga ligji fetar. Ajo nuk vlen për ata që nga ushqimi i privon domosdoshmëria, varfëria, ose sëmundja, ose ata me gjendje mistike dhe gufime hyjnore aq intensive saqë humbin aftësinë e të ngrënit e të pirit. Madje, ajo nuk vlen as për ata që ushqehen nga bota e padukshme në mënyrë të atillë që efektet e mëkimit mbinatyror shquhen te fuqitë e tyre trupore (*kuwe*), intelekti i shëndoshë (*sibhat el-’akl*) dhe ruajtja e sjelljes dhe trupit (*hifdh el-mizaxh*).<sup>39</sup> Sipas besimit islam, vetë Profeti e përjetoj një mëkim të tillë, për shkak të të cilit ua ndalonte ndjekësve të tij agjërimit aq gjatë sa ai, që të mos e dëmtonin veten nga dëshira për të ndjekur modelin e tij. Thënia e tij “*Zoti më jep ushqim dhe pije*” është e mirënjohur në traditën islame.<sup>40</sup> Në tekstet e hershme sufiste, mëtime të ngjashme bëhen edhe për evliatë, disa prej të cilëve thuhej se mund të ushqeheshin nga e padukshmja jo pse kishin ranje të barabarta me atë të Profetit, por sepse, si “trashëgues të profetëve”, kerametet e tyre ndiqnin mrekullitë e të dërguarve të Zotit.<sup>41</sup> Në një shënim autobiografik gjetiu, Ibn ‘Arabi pohon se pat përjetuar mëkim të ngjashëm, aq sa shenjat e tij u bënë të dukshme në mbushjen e

39. Ibn el-‘Arabi 1990, 13: 639.

40. Muslim, *Es-Sahih*, kitab es-saum, nr. 2426–30.

41. Cf. seksionet mbi agjërimit dhe urinë në Es-Serraxh 2001.

tij në trup.<sup>42</sup> Por, kjo nuk është vdekja e bardhë për të cilën flet Ibn ‘Arabiu, vlera e së cilës qëndron te “shijimi” i urisë nga agjëruesi. Merita e veçantë e urisë (*xhu*) këtu vlen vetëm për ata që i kanë mjetet për të ngrënë e pirë (*sahib fa’ide*) por përmbahen ndërgjegjesisht dhe me dashje, pa u ushqyer as “nga lart” e as brenda kufijve të agjërimit ritual. Theksi që Ibn ‘Arabiu duket se vë te vlera e përjetimit të urisë nuk mbitheksohet dot dhe mund të çmohet më mirë kur marrim parasysh se agjërimi sipëror në traditën islame është ai i Daudit, ngase e pengon trupin që të mësohet aq shumë me agjërimin sa të mos ndiejë më privim nga ushqimi e pija.

Përgjatë kreut, Ibn ‘Arabiu ngulmon se uria e kërkuar duhet ndjekur brenda kufijve të agjërimit ritual: “Nuk kemi rrugë drejt Zotit”, - pohon ai, - “veç asaj që është shpallur (*el-wexhb el-meshru*)”.<sup>43</sup> Po të kishte metodë urie më dobiprurëse për shpirtin njerëzor sesa *saum*-i, Zoti do ta kishte shpallur. Veç kësaj, shkelja e normave të agjërimit me akte heroike asketizmi përbën mungesë edukate ndaj Zotit (*su’ el-edeb*).<sup>44</sup> “Rrugëtuesi duhet të mos i kalojë kufijtë e vënë nga ligji”, -

42. Ibn el-‘Arabi 1990, 8: 345.

43. Ibn el-‘Arabi 1990, 13: 638.

44. Për një shqyrtim përfshirës të edebit tek Ibn ‘Arabiu, të shihet Gril 1993. Të shihet edhe Chittick 1989: 175. Për një përpilim aktual sprovash rreth edebit në sufizëm, të shihet Chiabotti et al. 2016.

deklaroi Ibn ‘Arabiu, - “që të jetë ndjekës, sepse lënia e një akti me bindje jep shpërblim më të madh se të vepruarit me risi (*ibtida*)”.<sup>45</sup> Kështu, nëse dikush dëshiron të ndjekë një uri frytdhënëse, ajo duhet ndërmarrë në *saum*-in e mirëfilltë. Duke komentuar mbi hadithin ndofta më të cituar në literaturën sufiste mbi agjërimin dhe urinë, “*Vërtet, Shejtani rrjedh nëpër birin e Ademin si gjaku, ndaj frenojani rrjedhën me uri dhe etje!*”, Ibn ‘Arabiu vëren se hem ulemaja, hem “robt e Zotit” (siç i quan ai realizuesit e përsosurisë njerëzore) pajtohen plotësisht se Profeti e kishte fjalën jo vetëm për urinë e agjërimit ritual, por edhe “pakësimin e sasisë së ushqimit në syfyr për vazhduesin [e agjërimit] dhe në iftar për mosvazhduesin”.<sup>46</sup> Por, nxitja e rrugëtuesve për mosngrënie jashtë agjërimit është tipar i “njerëzve të gabimit mes njerëzve të kësaj rruge” (*ehl ul-galat min ehl hadhibi et-tarijke*).

Vendi kryesor, që Ibn ‘Arabiu i cakton kufizimit të urisë si metodë shpirtërore tek agjërimi ritual, i jep atij mundësi për të kritikuar rrugëtues e madje udhëzues shpirtërorë që devijuan në këtë çështje. Ndër rastet që ai veçon, janë ata “që i bëjnë muridët e tyre të agjërojnë, vetëm për të ngrënë para perëndimit të diellit”, pra para se të hyjë koha e iftarit. Ky është “gabim nga ana e tyre dhe tregon mosdije

45. Ibn el-‘Arabi 1990, 13: 640.

46. Ibn el-‘Arabi 1990, 13: 640–41.

të rrugës së parashtruar nga Zoti (*tarik Allah*)". Nëse me këso strategji kanë synuar t'i kundërvihen egove (*mukbalefet en-nufus*), ata kanë pasur në dispozicion, - debaton ai, - mjete më të përputhshme me ligjin fetar. Nga pohimi i tij i shkurtër – një thirrje drejtuar lexuesit që të mos bjerë në grackë të ngjashme – është e paqartë përse ushtruesit e një praktike kaq jonormale do ta ndërmerrenin atë ndopak, ose cila mund të ketë qenë përligjja e tyre. Megjithatë, mbi çështjen mund të hidhet njëfarë drite nëse i kthehemi sërish *Luma'*-së së Serraxhit, ku, pas një skicimi të shkurtër të agjërimit dhe urisë, ai thekson disa nga variacionet e kësaj praktike mes bashkëkohësve dhe pararendësve të tij, si dhe disa prej debateve mbi këto praktika. Ndër shembujt e tij është ai i një burri që e ndërpriste agjërimitin para kohe, si mënyrë për të disiplinuar nefsin e tij. Arsyetimi i tij, - sqaron Serraxhi, - ishte se ai do t'i përjetonte mundimet e agjërimit pa kënaqësinë e plotësimit të tij dhe pa kënaqësinë e pritjes së një shpërblimi nga Zoti për përmbushjen e tij. Fragmenti në fjalë thotë:

Jam njoftuar se një banor i Uasitit agjëroi për shumë vjet, por e ndërpriste agjërimitin para perëndimit (*kable gburub esh-shems*), me përjashtim të muajit të Ramazanit. Disa e qortuan, sepse kjo nuk kishte bazë në dijen e shpallur, edhe pse agjërimi ishte vullnetar. Të tjerë e

lëvduan, sepse ai synonte të shtronte egon me uri pa nxjerrë kënaqësi prej agjërimit dhe pa shpërblimin që i ka premtuar Zoti agjëruesit - ai nuk nxirrte kënaqësi prej kësaj. Për mendimin tim, qortuesit kishin të drejtë, sepse ai synonte të agjëronte, kështu që plotësimin e agjërimit e kishte detyrim. Po të mos ketë synuar agjërimit, atëherë ka praktikuar përkorje ndaj ushqimit dhe për të tillin nuk mund të thuhet aspak se agjëronte. Suksesi është me Zotin.<sup>47</sup>

Fragmenti tregon se Serraxhi kishte pikëpamje të ngjashme mbi çështjen me mistikun tonë. Edhe mjeshtri i madh sufi, bashkëkohës i Ibn 'Arabiut, Shihab ed-Din Suhrauerdi (vd. 1234) dha mendimin e vet mbi debatin me një vëzhgim depërtues në *'Auarifu 'l-me'arif*, madje duke e specifikuar Serraxhin me emër: ndonëse ishte vetëprivuar nga kënaqësia e agjërimit, burri prapëseprapë mori kënaqësinë e lënies së tij, sepse ndërpreu një agjërimit që ishte afër plotësimit si metodë për të shtruar nefsin, por në mënyrë të atillë që një gëzim i hollë mbeti i pashmangshëm. Për Suhrauerdin, ngase një ëmbëlsi dhe ndjesi arritjeje ishte e pashmangshme, qoftë nëse e plotësonte agjërimitin apo e ndërpriste para mbarimit, do të kishte qenë më mirë për burrin që t'i mbante rregullat e ligjit fetar duke e çuar agjërimitin deri në fund.<sup>48</sup> Në

47. Es-Serraxh 2001: 155.

48 . ES-Suhrauerdi 2005: 350.

kontekstin e diskutimit, Ibn ‘Arabiu shton se, nëse nijeti i personit është kundërshtimi i nefsit në raport me ushqimin, ai duhet thjesht ta kundërshtojë, jashtë agjërimit, në çfarë ha. Dhe kjo mund të arrihet duke ngrënë ushqim hallall, të cilin nuk ia ka ënda natyrshëm, si mënyrë për të zbutur nefsën, dhe përtej kësaj, nxjerrjen e bekimeve të Zotit të fshehura në të.

Duhet sqaruar se, ndonëse Ibn ‘Arabiu thekson rëndësinë e ndjekjes së urisë me agjërim, nuk rrjedh se ai e këshillon ngopjen (*sheb*), aq më pak mbushjen e barkut, jashtë caqeve të agjërimit. Siç pohon ai në kreun 107 veçse pak rreshta të gjatë: “për robt e Zotit, lënia e urisë nuk është ngopje; porse dhënie haku nefsit në raport me ushqimin e tij, përmes të cilit Zoti ruan shëndetin e tij dhe drejtësishtësinë e formës së tij”.<sup>49</sup> Duke tërhequr vëmendjen ndaj rreziqeve të brendashkruara në ndjekjen e agjërimit dhe urisë në skaje, ai citon shembullin e Ebu Derdasë (vd. 652), i cili në vetëmohimin e tij përkorës shkoi deri aty sa nisi të neglizhonte nevojat e trupit dhe të

49. Ibn el-‘Arabi 1990, 9: 644.

familjes. Kur u njoftua për regjimin vetëfshikullues të shoqëruesit të tij, Profeti e paralajmëroi që të mbante masën: “*Ngrihu natën në namaz e fli, agjëro dhe bëj iftar, dhe jepja çdo zotëruesi të një haku hakun e vet.*” Por, siç u vërejt më lart, baraspesha e këshilluar nga Profeti anoi kah dorëheqja, saqë nuk do të ishte e pasaktë që rruga e tij të përshkruhej si ajo e një “asketizmi të matur”. Mbi të gjitha, për Ibn ‘Arabun, Profeti i shkurajonte ekstremet. Ndërsa metoda e tij shpirtërore rëndonte kah përkorja, ajo ishte përkorje që shmangte dëmtimin e trupit dhe shprehte thjeshtësi më tepër se gjithçka tjetër. Kjo duket se është ajo që mistiku ynë kishte në mendje kur fliste për vlerën e lënies së urisë, pra nevojën për jetë shpirtërore që kombinon përjetimin e urisë me dhënien e hakut trupit, që aspiruesi të mos fiksohet me vetëmohimin trupor ose të bjerë në asketizëm për hir të asketizmit.<sup>50</sup>

### Përktheu: Edin Q. Lohja

---

50. Rreth tejkallimit ose shkuarjes përtej kufizimeve të çdonjërit prej virtyteve, të shihet Abrahamov 2010. Të shihen edhe vëzhgimet e mia në Khalil 2018: 45–51.

## Referencat

Abrahamov, B. 2010. Abandoning the Station (*tark al-maqam*), as Reflecting Ibn al-'Arabi's Principle of Relativity. *Journal of the Muhyiddin Ibn Arabi Society* 47: 23–36.

Addas, C. 1993. *Quest for the Red Sulphur: The Life of Ibn 'Arabi*, tr. P. Kingsley. Cambridge: The Islamic Texts Society.

Andrae, T. 1987. *In the Garden of Myrtles: Studies in Early Islamic Mysticism*, tr. B. Sharpe. Albany: State Univ. of New York.

Bashear, S. 2004. *‘Ashura*, an Early Muslim Fast. In *Studies in Early Islamic Tradition*, ed. S. Bashear, 282–316. Jerusalem: The Max Schloessinger Memorial Foundation, The Hebrew Univ. of Jerusalem.

Braun, C. von. 2006. Fasting. *The Brill Dictionary of Religion*, ed. K. von Stuckrad, 2: 719–20. 4 vols. Leiden: Brill.

Chiabotti, F. et al., eds. 2016. *Ethics and Spirituality in Islam: Sufi adab*. Leiden: Brill.

Chittick, W. 1989. *The Sufi Path of Knowledge: Ibn al-'Arabi's Metaphysics of Imagination*. Albany: State Univ. of New York.

Chodkiewicz, M. 2009. *Mi'raj al-kalima*: From the *Risala Qushayriyya* to the *Futubat Makkiyya*. *Journal of the Muhyiddin Ibn Arabi Society* 45, <http://www.ibnarabisociety.org/articles/ibn-arabi-miraj-al-kalima.html> (orig. Fr. publ. in *Reason and Inspiration: Theology, Philosophy and Mysticism in Muslim Thought*, ed. T. Lawson. London: I.B. Tauris in association with the Institute of Ismaili Studies, 2005).

Corbin, H. 1969. *Creative Imagination in the Sufism of Ibn 'Arabi*, tr. R. Manheim. Princeton: Princeton Univ. Press.

al-Ghazali, Abu Hamid. 1998. *Ihya' 'ulum al-din*. 5 vols. Aleppo: Dar al-Wa'i.

———. 2008. *Al-Maqasad al-asna*. Cairo: Dar al-Salam.

———. 2018. *Kitab asrar al-zakat wa Kitab asrar al-siyam: The Mysteries of Charity and the Mysteries of Fasting. Book 5 and 6 of the Ihya' 'ulum al-din*, tr. M. A. Fitzgerald. Louisville, KY: Fons Vitae.

Goiten, S. D. 1966. Ramadan, the Muslim Month of Fasting. In *Studies in Islamic History and Institutions*, ed. S. D. Goiten, 90–110. Leiden: Brill.

Gramlich, R. 1997. *Weltverzicht: Grundlagen und Weisen islamischer Askese*. Veröffentlichungen der Orientalischen Kommission, vol. 43. Wiesbaden: Harrassowitz.

Gril, D. 1993. *Adab and Revelation or One of the Foundations of the Hermeneutics of Ibn 'Arabi*. In *Muhyiddin Ibn 'Arabi: A Commemorative Volume*,

ed. S. Hirtenstein and M. Tiernan, 228–63. Shaftesbury, Dorset: Element Books Ltd.

Hastings, J., ed. 1908–28. *Encyclopaedia of Religion and Ethics*. Vol. 5. New York: Charles Scribner's Sons.

Hoffman, V. J. 1995. Eating and Fasting for God in Sufi Tradition. *Journal of the American Academy of Religion* 63.3: 465–84.

Hujwiri. 1992. *The Kashf al-Mahjub: The Oldest Persian Treatise on Sufism*, tr. R. A. Nicholson. Repr. Lahore: Islamic Book Service.

Ibn al-'Arabi. 1971. *Sufis of Andalusia: The Ruh al-quds and al-Durrat al-fakhirah of Ibn 'Arabi*, tr. R. W. J. Austin. London: Allen and Unwin.

———. 1990. *Al-Futubat al-makkiyya*, ed. 'U. Yahya. 14 vols. Repr. Cairo: Al-Hay'a al-Misriyya al-'amma li-l-Kitab.

———. 2009. *On the Mysteries of Fasting from the Futubat al-Makkiyya (Meçan Revelations)*, tr. A. Bewley, ed. L. Bakhtiar. Chicago: Kazi Publications.

Kashani, 'Abd al-Razzaq. 1992. *Istilahat al-sufiyya*, ed. 'A. al-'Al Shahin. Cairo: Dar al-Manar.

Khalil, A. 2016. A Note on Interior Conversion in Early Sufism: Ibrahim b. Adham's Entry into the Way. *Journal of Sufi Studies* 5: 189–98.

———. 2018. The Dialectic of Gratitude in the Non-Dualism of Ibn al-'Arabi. *Journal of the Muhyiddin Ibn Arabi Society* 64: 28–51.

Kister, M. J. 1971. "Rajab is the Month of God": A Study in the Persistence of an Early Tradition. *Israel Oriental Studies* 1: 191–223; online at <http://www.kister.huji.ac.il>.

Mahmud, 'A. 2017. *Shahr Ramadan*. 8th printing. Cairo: Dar al-Ma'arif.

al-Makki, Abu Talib. 1995. *Qut al-qulub*, ed. S. N. Makarim. 2 vols. Beirut: Dar Sadir.

Nasr, S. H. 1981. *Islamic Life and Thought*. London: Allen and Unwin.

Neuwirth, A. 2004. Ramadan. In *Encyclopaedia of the Qur'an*, ed. J. D. McAuliffe, 4: 338–48. Leiden: Brill.

Ogunnaike, O. 2016. From Heathen to Sub-Human: A Genealogy of the Influence of the Decline of Religion on the Rise of Modern Racism. *Open Theology* 2: 785–803.

al-Qushayri, 'Abd al-Karim. 2002. *Risala*, ed. 'A. Mahmud and M. Sharif. Damascus: Dar al-Farfur.

Ritter, H. 2003. *The Ocean of the Soul: Man, the World and God in the Stories of Farid al-Din 'Attar*, tr. J. O'Kane with editorial assistance of B. Radtke. Leiden: Brill.

Rizvi, Sayyid Saeed Akhtar. 2006. Agjërimi i 'Ashures, shqip. Edin Q. Lohja. Londër.

- Russell, S. A. 2005. *Hunger: An Unnatural History*. New York: Basic Books.
- Salamah-Qudsi, A. 2019. The Spiritual Culture of Good: Eating Customs in Early Sufism. *Acta Orientalia Academiae Scientiarum Hungaricae* 72: 419–436.
- al-Sarraj, Abu Bakr. 2001. *Kitab al-Luma' fi al-tasawwuf*, ed. K. M. al-Hindawi. Beirut: Dar al- Kutub al-'Ilmiyya.
- Schimmel, A. 1992. *A Two-Colored Brocade: The Imagery of Persian Poetry*. Chapel Hill: Univ. of North Carolina Press.
- . 2011. *Mystical Dimensions of Islam*. Repr. Chapel Hill: Univ. of North Carolina Press.
- al-Sha'rani, 'Abd al-Wahhab. n.d. *Al-Mizān al-kubra'*. 2 vols. Cairo: Dar al-Fikr.
- al-Sharnubi, 'A. 2011. *Sharh Ta'yyat al-suluk ila malik al-muluk*. Beirut: al-Maktaba al-'Asriyya.
- al-Shayk al-Mufid. 1995. *Al-Irshad fi ma'rifeti buxhexhi Allah 'ala al-'ibad*. 2 vols. Beirut: Mu'assasat Al al-Bayt li-Ihja' et-Turath.
- al-Suhrawardi, Shihab al-Din. 2005. *'Awarif el-me'arif*, ed. 'A. Mahmud and M. al-Sharif. Cairo: Maktabat al-Iman.
- Winkel, E. 2016. *The Openings Revealed at Meça: The Inter-Actions, Journeys 13–14*. Las Vegas: The Futuhāt Project.



## Recencë romanit “Baladë muhaxhire” me autor Nimon Muçaj Drejt një kuptimi

Ma. sc. Refik Gërbeshi

### Abstrakt

*I shkruar për tri vite 2016-2019 i qaset me mjeshtri të rrallë periudhës Muhaxhire të viteve 1876 të periudhës së para Lidhjes së Prizrenit dhe asaj të viteve 1910, duke kthyer për afër gjysmë shekulli në kërkim të varrezave të të parëve. E veçanta e këtij romani është ngase ngjarjet, e personazhet i paraqet ashtu siç janë në realitet, pa fshehur elementin islam dhe ndikimin e hoxhës xhamisë dhe Islamit. Në detaje përsbkruben ato kohë të dëbimit të shqiptarëve me dhunë nga trojet e Prokuples, Nishit dhe Korshumlisë dhe përkujtimet e atyre ngjarjeve nëpër rrugët e Stambollit, Izmirit, Adanasë. Deri te dëshira për të gjetur të gjallë dikë nga të mbeturit në atdhe, sidomos nënën e verbër nga e cila e ndau llahtaria e Luftërave Ballkanike. Personazhi me identitet të përzier Elez Gërguri, një djalosh pa familje i quajtur Muhaxhiri, Arnauti, etj., i shoqëruar me shkrimin Osman me shkronja shqip të Alfabetëve të hoxhallarëve si Hoxha Hasan Tahsini, sikur na sinjalizon se shumë të vërteta fshihen në këto shkrime. Në këtë roman autori përmend figura të pushkës e penës, që është obligim i yni t'i ndriçojmë. Nën hijen e ngjarjes Muhaxhirije ecën nëpër kohët e vështira të migrimit të dhunshëm të shqiptarëve nga viset e Nishit të lashtë shqiptar drejt Lugjinës, Kosovës, Kumanovës e Shkupit deri në Stamboll, Izmir e Adana. Për të rikthyer në kujtesë identitetin, duke kërkuar varret e të parëve Ai vjen për të gjetur varrin dhe gjurmët e identitetit.*

## Në kërkim të Nënës

**N**jeriu si qenie e krijuar nga Zoti, secili me identitetin e vet, pavarësisht nga do të shkojë e çka do të përjetojë, gjithnjë do të rikujtojë kush është ai. Elezi personazhi kryesor i romanit kishte ardhur të kërktojë të ëmën dhe në “strajcë” së bashku me Kur’anin kishte dokumente e harta me emra vendbanimesh nëpër Vilajete të humbura në skaje të Perandorisë, për të cilat nuk shkruante historia. Me hartat e marra nga Stambolli kërkonte, por nuk e dinte as katundin Selishtë dhe vitin që ishin ndalur në Norçë apo Raincë. Nuk e dinte gjuhën në vendet ku ai kishte ecur si fëmijë.

Psikologët parashohin se kujtimi i gurgullimave e shijimi i kodrave e vendeve të fëmijërisë ringjall kujtesën por edhe shëron dhe mënjanon stresin. Por ky po kryente një amanet, një ndjenjë shpirtërore, duke kujtuar momente kur shoqërohej me të ëmën e moshuar e të verbër.

Nusja Tringë, tani një plakë e dobësuar, ishte e vetmja që kishte jetuar me Fatmen. “*Plaka kishte shpresë, se do ta gjente varrin e shoqes së dikurshme, sepse disa herë, jo vetëm që ia kishte hequr ferrat dhe barërat e këqija por edhe e kishte ujitur me kujdes.*”<sup>1</sup>

Ndërkohë po kërkonin nëpër

1. Nimon Muçaj, Baladë Muhaxhire, “Dituria Islame” Prishtinë, 2019, f. 9.

varreza. Ai e kujtonte se te varrezat e vjetra (që nuk dihej a ishin të vjetrat a po të reja) do të kishte lisa të mëdhenj bungu. Plaku Dash Coli nga Kurbalia rrëfente ngjarje trimash që kishin luftuar, si edhe tmerre masakrimesh ku gra e fëmije vriteshin e ata që kishin shpëtuar kishin marrë rrugë muhaxhirësh. Pleqtë thoshin, se shumë vite më përpara, në një mot të rëndë sall borë, aty ishte bërë kasaphane mbi njerëz. Këtë e dëshmon edhe historia.

## Duke kuptuar baladën

Fillimi e mbarimi i romanit me pasuesin: “Xhadeja e moçme Osmane” ndriçon se edhe në ato kohëra paska pasur xhade, ura, hamame e medrese, por me tu dobësuar e larguar ata, (Osmanlinjtë) mbesin varrezat e të përndjekurve, persekutuarve-muhaxhirëve, të cilat i mbulojnë varrezat e reja për t’i lënë në harresë ato të vjetrat. Këtë na qartëson Bacë Nimoni, të cilin e kujtojmë si personazh për filmat e viteve 1990 në Kosovë ku ai paraqet rrahjet, keqtrajtimet e vuajtjet ç’njerëzore që i shkaktonin ata që i përsërisnin masakrat mbi popullin tonë dhe kjo bënte përtëritje të varrezave.

Sidomos në këto kohë debatesh për kombin shqiptar.

Autori e përdor shumë mirë terminologjinë fetare si shprehjet

*Ibadet, Meit*, etj., por ceremonitë islame nuk janë “adete të vjetra” por adete islame dhe Islami nuk është adet i vjetër.

Varrezat që i quanin Osmane nuk kujdesej askush për to, mirëpo me mësimet që kishte për hartat gjente gjithandej varre të mbuluara me barishte të rrafshuara e pa asnjë emër. Ishin të periudhave të ndryshme historike. Roli i fesë islame për të qëndruar në identitet, ishte element kyç për dallimin nga fqinji gjakpirës e masakrues. “*Mos ua lëkundni eshtrat*”, - është një fjalë e vjetër, por lëkundja e eshtrave të atyre nga varrezat e moçme e të reja e edhe më të reja, ndriçon të vërtetën në kërkim të drejtësisë. Për këtë popull nuk ka nevojë për mëshirë, por për argumentim të së vërtetës dhe vetëm drejtësi apo korrigjim të padrejtësive që i janë bërë disa herë. Andaj amaneti i muhaxhirit duke dhënë frymën e fundit kujton se: “*Ismail Qemajli paska bërë një Shqipëri (Arbëni) pa Plavë e Guci, pa Ulçin e Çamëri, pa Shkup e Kumanovë, pa Manastir e Tetovë, pa Preshevë e Bujanoc...*” kurse “*Në Prishtinë piku gjaku që të mbijë përsëri.*” Agushi në momentet vdekjes kishte lënë amanet të ndërtohet një mejtep e medrese në Prizren, siç sqarohet te titulli “*Fryma ju sos*”.

### **Nëpër baladën Muhaxhirije**

Paragjykimi i Tringës si katolike për myslimanin, Elezin, ishte kush e

ka paguar dhe çfarë përfitimesh ka që po kërkon. Kishte prej banorëve të hershëm këtu agallarë pasanikë të mëdhenj Arnaut Omeroullu. Nga ana tjetër Tringa me Fatën, Bajram e Pashkë i bënin bashkë, Elezi e Sokoli si fëmijë luanin bashkë, Agushi e Ndou bashkë, sepse i bashkonte shqiptaria. Kurse Brankoja, fqinji provokonte Agushin se duhet të ikë për në Turqi...

Shumë masakra u kanë ndodhur shqiptarëve në festat fetare Bajram Ramazan, duke falë namazin e edhe në romanin “Baladë Muhaxhire” duke falur sabahun erdhën hordhitë karpatese dhe prenë e grinë. Qerimi luftonte fyt a fyt me armikun ku u angazhua edhe Fatimeja, të cilën e goditën me një shpatë në ballë dhe ia qorruan sytë. Ajo e mbante Elezin e vogël mbështjellë me pështjellak dhe ia mbylli gojën që të mos lëshonte zë, ngase ishin përzier me të vdekurit që të shpëtonin, e fëmija kishte parë tmerrin. Me Dash Colin kërkoi gurët e bardhë te varret për të identifikuar varrin e nënës së tij. Shkuan edhe te Molla e Gjakut, që e quanin edhe Molla e Kuqe, por pranë kësaj kishte shumë të vrarë e masakruar që nuk ndërronin identitet e ua prinin kokat. Që nga lashtësia romakët apo latinët kishin marrë “mademin” e këtyre anëve tregimi me koka njerëzish në kala e thurur me mite të rreme serbe, por është ndërtuar me koka shqiptarësh që u kishin mbetur kufomat mbi dhe.

Plaku Col Dashi i tregonte Elezit për ngjarjen, pa e ditur që ai si fëmijë i kishte parë me sy dhe kujtesa i kthjellohej kur shtohej tregimi se si Tringa kujdesej për të dhe e cila i kishte treguar shumë nga këto ngjarje, sidomos atë kur i kishte marrë goja nga të ftohtit atë ditë kur iu vranë babai, vëllai e motra dhe kishin kaluar natën në malin e mbuluar me borë. Dhe për ta shpëtuar e kishin futur në ujë të ftohtë. Derisa po i bënin trikat për shërim xha Abdyl Cena, ai foli dhe shprehu “sertllëkun”- e tij, kurse nuse Tringa e arsyetoi duke thënë: “Është muhaxhir nga Nishi.”

Tani ajo nuk e dinte se është ky por shikohej si ogurzi me pamjen jo të zakonshme të këtyre anëve. Flitej se plaku po kërkonte një të moshuar me emrin Fatime Gërguraj. Hoxha i kishte thënë se një grua me emrin Fatka ka jetuar në Rincë kështu thonë shënimet në xhami që nuk përputhen me arkivat e shtetit. Elezi shfletonte letrat nga arkivi, që së bashku me hoxhën ishin munduar t’i deshifrojnë, dhe Fata Gërguroviq plakë e vetmuar që nuk e kishte askënd e as ndonjë nishan. Jo vetëm Fate Qerimaj por edhe drunjtë e mëdhenj nuk janë as kodrat nuk janë si atëherë ashtu siç kanë qenë kur ata të pafetë, bashkë me rusët, shkretuan gjithë ato katunde andej në veri. Gjeti një njeri që mund të komunikonte sado pak në osmanisht e aty këtu ndonjë shprehje shqip.

“*Nuk kallxohen të gjitha ato tmerre. Nuk i rrokë kalemi e lëre më fjalë.*” Plaka nga Shkupi që dinte osmanisht ishte Tringa e cila erdhi, por që në shikimin e parë i shkaktoi Elezit rrëqethje trupi, saqë njëherë mendoi ta përqaftonte ngase ndjente mos është nëna e tij... kur kërkoi me llagapin Gërguraj prapë e orientuan te fshati Gurishtja por atje kishte qenë dhe i kishin thënë se është zhdukur ai vendbanim. Kërkonte një grua që nuk ia dinte as emrin mirë as gjuhën e saj. Kush je ti e nga vjen? “*Po kërkoi ndonjë njeri që e njeh këtë grua të cilën një shok i imi i medresesë e ka pas të veten. Jo nënës larg janë Gërgurajt me ditë e me net prej këtu matanë Prokuples e Nishit por një grua me emrin Fata apo Fatka Muhaxhira ishte Fata e Qerimit.*”

### “Prej Prokuple deri në Nish”

Elezit i rikujtohej se si gjyshi, duke dhënë shpirt kishte thënë: *Birë grurin po ta la amanet me e marrë te xhamia e madhe në Nish.*” Tha shehadetin dhe vdiq. Afër dy vite kishin qëndruar në kasolle me kashtë nëna thurte çorape e gjempera. Edhe rrëfimi i plakës Tringë i përshtatej në atë që kujtonte, por nuk e zbulonte veten kur ajo tregonte inserte nga jeta e Fatës, derisa po kërkonin ndër varre, e po i tregonte historinë e fëmijërisë së tij. Me tu strehuar në Rincë shkoi në shkollë serbe dhe tregoi talent por pati ngatërresa me disa fëmijë që e nënçmonin nënën

e verbër ... Edhe drejtori e kuptoi se ishte djali i luftëtarit të njohur Qerimit dhe e përjashtuan. Shkoi në Xhaminë e Preshevës ku mësoi nga Hoxha Kuran por edhe shkrim shqip me shkronja osmane. Nuk kishte alfabet shqip, por mësonte një alfabet që ishte përpiluar nga Hoxha Tahsin.

Tmerri i radhës i kishte ndarë nënë e birë dhe e ndjeu veten në xhami. Xhemati vijnë për ta falur sabahun dhe duke u kthjellë iu kujtua se gjatë namazit ndodhi masakra. Por kësaj radhe e mori muezini dhe e dërgoi në familjen e tij. Mori përsipër shpenzimet për djaloshin e talentuar Arnaut Muhaxhiri. Hoxhallarët e vizituan djalin pa familje dhe e regjistruan në medrese. Përdorej për punë të rënda fizike. Elezi në pazar takoi Agush Qarrin dhe Gjyla vajza e tij ia dha një shami. Mësonte te hoxhë Jonuzi. Hoxha vërejtë kulturën dhe talentin e tij dhe e regjistroi në shkollë të lartë, ku i vunë emrin Arnaut Muhaxhiri. Që të mos harronte vuajtjet e së kaluarës kërkoi ta mbante emrin e gjyshit dhe babait Qerim por e quanin Albani, Arnauti, Serbian, Bullgar, Muhaxher, etj. Në konviktin me studentë e quanin Elez. U tregonte historinë e tij të dhimbshme edhe shumë të tjerë kishin të tilla histori. Në medresenë e Marmarasë ishin plot të rinj pa familje dhe kombe të ndryshme në kohën e sulltan Hamitit, te Xhamia Sulltan Ahmet, e ndërtuar nga i biri

i Sylejmanit të Madhërisëm e nga duart e Arkitekt Sinanit me mjeshtri të rrallë, andaj edhe ia prenë duart që mos të ndërtonte më të tillë. Elezi kishte bërë 18 vjeç kur dëgjoji këngën e lypësit nëpër rrugët e Turqisë “*Prej Prokuple deri në Nish*”. Nuk dihej a qante a po këndonte. Të njëjtën kënge ia përktheu njëherë Dash Coli.

Kur shoku i medresesë lëndoi syrin, Elez muhaxhiri dha propozimin për t’i qitur qumësht gjiri. Por këtu iu kujtua nëna e verbër dhe qumështin që ia vënin në sy. I kishte dhënë bariu qumësht gjiri për sytë e saj. Hoxhallarët e kuptuan edhe më tepër talentin e tij dhe e dërguan në Fakultetin e Mjekësisë në Stamboll. Kur u kthye nga Haxhi kishte dëgjuar përsëri këngën “*Prej Prokuple deri në Nish*” dhe ia kishte sqaruar Agush Qarri. Elez Gërguri kishte kërkuar ta vizitonte memleqetin. “Jo,” - i thanë “*atje është kazaan si i Xhebenemit që i frikobet edhe Perandoria*”.

### **Përsëritje nostalgjish e takime shpirtërore**

Derisa ishte në Izmir të Turqisë kishte biseduar me xhaxha Agush Qarri për kodrën e kuqërremtë dhe lisat e mëdhenj bunge ku ishin të varrosur shehidët. “*Assesi nuk mund ta harronte babanë, i cili luftonte fyt a fyt me xhandarët e Krajlit.*”<sup>2</sup>

2. Nimon Muçaj, “Baladë Muhaxhirësh” - roman, Dituria Islame, Prishtinë 2019, f. 54.

Sikur i erdhi tingëllima e klithmave të së ëmës, derisa bishat Karpateve po ia verbonin sytë; ishte 6 apo shtatë vjeç. E ëma e kishte mbajtur mbështjellë nën pështjellak ngase bishat i vrisnin të gjithë. Por varrin e nënës si ta gjente? Në bisedë me plakën Tringë kuptoi se ajo ishte shoqja më e mirë e nënës; historia e saj si edhe e shumë familjeve nga Gërguraj, Selishta, Trepeza, Tërnavë, Gajtani, etj.

*“Osmanët ikën prej serbëve dhe rusëve nga fronti i Nishit”* - hoxha kishte treguar për ngjarjet e tmerrshme. Derisa te fqinjët e afërt flaka po dilte gjyshi kishte thënë: *“Ikeni se minuta është i gjatë, drejt gollakut. Unë po shkoj deri te Xhamia te hytbeja për ta marrë rrasën e gurit një shenjë e familjes dhe lisi trunq i gdhendur i fisit Kelmend.”*. Këto ishin historitë e gojëdhënave ngase askush nuk kishte e shkruar.

### Identiteti islam shqiptar

Hoxha Tahsini kishte thënë: *“Në doni të bëheni komb i qytetëruar, ashtu si kombet e tjera të Evropës, duhet të shkruajmë gjubën, të krijojmë letërsinë tonë kombëtare”*.<sup>3</sup>

Në historinë kombëtare përmenden mbi 30 gazeta shqiptare që dilnin që nga lidhja e Prizrenit e këndeje. Pas Luftës së Parë Botërore me gazetën “Shqipëria” të vitit 1918, e

cila botohej në diasporë saktësisht në Amerikë, revista “Reforma” dhe “Vullneti i popullit”; kjo e fundit i qasej publikimit të dhunës dhe represionit të myslimanëve në Jugosllavi dhe detyrimit për shpërngulje.

Gërshtetimi me elementin islam i mungon letërsisë shqipe edhe pse kjo e shoqëron që në hapat e parë të zhvillimit të saj. Romani në fjalë sikur u bashkëngjitet atyre kohëve dhe atyre shkrimeve, ngase pas tyre pasuan shkrime të “pastruara” nga elementi islam si dhe përkujtimi i vuajtjeve shekullore të popullit tonë. Peizazhi me ikje masive, djepa të thyer e të kthyer përmbys, fëmijë të shumtë të ngrirë e të vdekur, ku në pranverë u gjetën shumë kufoma të paprishura sikur të ishin në gjallë. Në kodër kishin mbetur shumë shehidë që i dolën zot vatanit, por shumë nga ata që u masakruan e u vranë mbetën mister i historisë dhe mbetën të panjohur për breza njerëzish. Historitë e tyre kishin mbetur vetëm gojëdhëna. Ndërkohë që shumica ishin drejtuar për në Stamboll, disa kishin mbetur nëpër tokë “mere” për të krijuar vatër të re

Shumë figura të rëndësishme të kulturës islame e kontribuues të shqiptarisë janë nga muhaxhirët. Mulla Sadri Prestreshi, Mulla Emin Statovci, Mulla Sherif Ahmeti e deri te Mulla Ademi, i cili ende gjallëronte përmes DVD-së me ligjëratë që po e dëgjoja, gjë të cilën e vijonte

3. Dr. Fahrush Rexhepi, Periodiku shqiptar islam-(Gjysma e parë e shekullit XX), Prishtinë, 2013, f. 68.

nipi, Naimi. Interesante të kthehem unë në gjendjen reale, në librarinë ku po punoj po dëgjoja një plak të vdekur qëmoti dhe, siç saktësoi nipi i tij, kjo ligjëratë mbahej diku në vitet '70 në Prishtinë.

Ligjëratë ishte e lidhur me hadithin e takimit të Muhamedit a.s. në lartësitë hyjnore gjatë natës së miraxhit. Edhe në roman ishte tendenca e takimit të Elezit me nënën e tij, gjyshin e tij të cilin e kishte parë ndërkohë që jepte shpirt.

Elezi kishte shkuar për specializim në Paris kthehet në Turqi tani në Adana në xhami; shpjegimi bëhet në vetën e parë sigurisht nga shënimet. Pasi përfundon Medresenë Sulltan Fatih shkon në Bukuresht e në Francë pas 3 vitesh me Merjemen diplomohen si profesorë specialistë. Derisa po kuronte një plakë të verbër i rikujtohej nëna sikur ta gjeja ku është për ta shëruar. Ëndërrimi i përsëritej me nënën e verbër dhe ngjarjen e këmishës së Jusufit a.s. lutej: "O Zot më ndihmo ta gjej!". Dëshira për të kërkuar Nënën i shtohet.

Ndërlidhja me elementin islam shkon edhe më tej përmes ritualit të Haxhit dhe përkujtimit të të afërmeve të tij. Por derisa personazhi po qëndronte në kodrën Uhud i shpjegohet për masakrën e Hamzës xhaxhait të Muhamedit a.s. Elezit i kujtohet edhe masakra ndaj familjes së tij. Me një ndërhyrje që nuk përket me Islamin ngase vajtimin nuk e ka

kërkuar Muhamedi a.s.

Në Arafat prapë i kujtohet nëna. Bën dua. Papritmas në frëngjisht bisedon me një haxhi dhe del se ishte shqiptar...

Takohet me Ibrahim Temon, Bej Dragën, Shahin Kolonjën, Ibrahim Efendiun e të tjerë që planifikonin të luftojnë, por ai sjell argument Sami Frashrin se duhet të lexojmë për të fituar; rruga e diturisë për Shqipërinë e lënë shkretë. Takimi me Agushin, i cili i thotë: "*Kaq dije ke bërë dhe nuk i hodhe në letër historitë e shqiptarëve*" e nxiti të hulumtojë por edhe të vijë në atdhe...

### Gjetja e varrit të Fatimes

Profesor Elezi në Adana, në konsullatën Franceze, e sugjerojnë të shkojë të marrë leje për qëndrim një muaj në serbi. Pasi kupton se ka qetësi shkon në konsullatën serbe dhe ia japin lejen. Kishte kërkuar në arkivat e shtetit në Nish Prokuple e Korshumli por i kishin thënë se nuk gjinden të dhëna për njerëz e fshatra të zhdukura. I kishin thënë se me dëshirën e tyre kishin shkuar në Turqi, por ai e dinte se shqiptarët i kishin larguar më dhunë. Disfata e Kumanovës në tetor 1912 përfundimi i Luftës Ballkanike, ishte data kur djaloshi ishte ndarë nga nëna dhe me tren, deri në Shkup, kishin arritur pa e ditur se ku po shkonin...

Në kërkim të varrit jo këtu po këtu. Bariu, që ishte shpëtimtari, duke

rrëfyer se si ka mbetur djali në ndonjë qerre të muhaxhirëve dhe plaka e verbër u strehua te ne. Dash Qarri tregonte për masakrën. Mbi 300 veta ishin vrarë e masakruar, e bariu i kishte varrosur, por të nesërmen nga bora i doli një nuse me beben djalin në pështjellak. Elezi i tregoi se “*Ai djali jam unë dhe po e kërkoj nënën*”. U nisën te varret ku ishte Tringa, por nuk do t’i tregonin asaj. Në fund të ditës gjetën varrin e bënë mihjen. Plaka Tringë solli një orë gjepi dhe unazë e çibuk dhe një letër. Hoxha e deshifroi duke thënë se është osmane me shkrim të Hoxha Tahsinit. E lexoi hoxha letrën dhe Tringa qante, duke treguar se si e humbi djalin. Hoxha dhe Dash Coli me metodën e gjilpërës me gjakun e Elezit në ashtin e Fatës, vërtetojnë trashëgiminë dhe i tha: “*Po kejo është nëna jote i paq gruan e femijët*”. Tringa kuptoi se Elezi qenka djali i Fatës e përqaftonte e i puthte duart. “*Më lumturove*”, - thoshte, - dhe shkoi në shtëpi solli një qyp

ku në brendi kishte një plis dhe një gurë. Tregoi se Fata kishte porositur qerepxhiun për ta merrte gurin në Xhaminë e Nishit. Dhe kur ia solli dha shpirt. E deshifruan se në gurë shkruhej “*La ilahe ila-llah Muhamed resulullah*” dhe kishte një zog dy krenar në mes. Ky ishte simboli i fisit Kelmend.

Tringa rrëfente: “*Fata e preku me gishta dhe e futi në qyp, ra shehadet dhe vdiq*”. I mbuluar me vaj e lot Elezi tha: “*E paska gjetur nëna e unë e kërkova në Xhaminë e Nishit nuk e gjeta*”. Pas kësaj u mërzit shumë fliste vet me vete “*Nënë s’kam mundë të bëj gjë për ty*”. Nga e qara e tepërt verbohet. Ngjarja mund të jetë në vitin 1928. Elezi përsëri nga Xhadeja Osmane kthehen në Adana e Stamboll dhe një mjek Sirian e kuron dhe shërohet. Preokupimi i muhaxhirëve mbetet Shqipëria e copëtuar dhe amaneti i bacës Agushit për Medresenë e Prizrenin, shpresë për t’i bërë ballë asimilimit.



## Vexhi Buharaja (1920-1987) “Mësues i Popullit”



### Abstrakt

*Vexhi Buharaja ishte një figurë e shquar në shumë fusha, një intelektual i veçantë në Shqipëri, atdhetar, njohës i dhjetë gjuhëve kryesore Lindore e Perëndimore.*

*Ai zotëronte në mënyrë të shkëlqyer gjuhët klasike të Lindjes islame: arabishten, persishten dhe osmanishten së bashku me turqishten e re. Zotëronte gjithashtu gjuhët kryesore të Perëndimit: anglishten, gjermanishten, frëngjishten dhe italishten. Pas vitit 1966, kur filloi punën në Institutin e Historisë si bashkëpunëtor shkencor, përvetësoi edhe rusishten.*

*Ky njeri i madh, poet, përkthyes, shkrimtar, historian, orientalist, studiues, hulumtues, u pranua në punë si mësues dhe u bëri ballë të gjitha vështirësive, meqenëse ishte një njeri i “padëshiruar” nga sistemi komunist. Në vitin 1965 e pranuan në Sektorin e Historisë së Mesjetës, pranë Institutit të Historisë në Tiranë. Vexhi Buharaja me punën e tij hulumtuese, kërkimore shkencore dha rezultate madhështore. Puna që bëri në Institutin e Historisë i zbuloi shumë fshehtësi Shqipërisë. Vexhi Buharaja me punën e tij këmbëngulëse, kërkimore, studiuese, hulumtuese, sistemuese, mblodhi, përktheu në shqip, transkriptoi rreth treqind mbishkrime turko-osmano-arabe, me vlerë të madhe.*

Vexhi Buharaja ishte një figurë e shquar në shumë fusha, një intelektual i veçantë në Shqipëri, atdhetar, dijetar, poet, përkthyes, shkrimtar, historian, studiues, hulumtues, njohës i dhjetë gjuhëve kryesore Lindore e Perëndimore.

Ai lindi më 12 maj 1920, në lagjen “Murat Çelepi” në Berat. Rrjedh prej një familje intelektuale, me trashëgimi të pasur fetare, kulturore dhe atdhetare. Babai i tij Ibrahim Efendiu, ishte hoxhë, myderriz, atdhetar, ashtu si edhe gjyshi i tij, Ismail Efendiu. Që të dy ishin burra që përmendeshin për dituri në Berat dhe anëmbanë Shqipërisë. Mësimet fillestare i kreu në vendlindje, në Berat. Pas kësaj vazhdoi studimet në Medresenë e Përgjithshme në Tiranë, ku u diplomua në vitin 1940 si një nga studentët më të dalluar. Menjëherë pas diplomimit, në moshën 20 vjeçare, u punësua në redaksinë e revistës “Kultura Islame”, e përmuajshme fetare, diturore, artistike, letrare, organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Tiranë. Në vitin 1944 u largua nga

Tirana për shkak të rrethanave të vështira të luftës dhe qëndroi në vendlindje, në Berat, te familja e tij.

Në vitin 1946, e burgosin duke e akuzuar se bënte propagandë kundër pushtetit komunist në Shqipëri. Pasi doli nga burgu, edhe pse ishte në liri, si ish i burgosur politik ende konsiderohej prej udhëheqësve të partisë si armik. U detyrua të bëjë punë të rënda fizike për të mbijetuar.

Vexhi Buharaja, ky njeri i rrallë, të gjitha vështirësive iu bëri ballë. Ky njeri i madh, poet, përkthyes, shkrimtar, historian, orientalist, studiues, hulumtues, u pranua në punë si mësues. Në vitin 1965 e pranuan në Sektorin e Historisë së Mesjetës, pranë Institutit të Historisë në Tiranë. Vexhi Buharaja me punën e tij hulumtuese, kërkimore shkencore dha rezultate madhështore. Puna që bëri në Institutin e Historisë i zbuloi shumë fshehtësi Shqipërisë. Vexhi Buharaja me punën e tij këmbëngulëse, kërkimore, studiuëse, hulumtuese, sistemuese, mblodhi, përktheu në shqip, transkriptoi rreth treqind mbishkrime turko-osmano-arabe, me vlerë të madhe. Duke u mbështetur në këtë material, ai ka shkruar studimin me titull: “Mbishkrimet turko-arabe në vendin tonë si dëshmi historike”, që datojnë nga shekulli XV deri në shekullin XX, të cilën e ka lexuar si kumtesë në Konferencën e Dytë Shkencore të Studimeve Albanologjike, që i zhvilloi punimet në Tiranë, më 12-



18 janar 1968. Ka realizuar një varg përkthimesh të tjera që i përkasin periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, siç janë aktet dhe memorandumet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, manifestin “Uyanalım” (Ujanallëm - Të zgjohemi) 1899, hartuar nga Dervish Hima, letërkëmbimin e tij me Dr. Ibrahim Temon, i përbërë prej 64 letrash, që përfshihet në vëllimin e tretë (1900-1908) “Rilindja Kombëtare Shqiptare”. Vexhi Buharaja, përveç dokumenteve historike, ka përkthyer nga gjuha turke e perse edhe vepra të tjera shkencore dhe letrare. Ka përkthyer veprat shkencore të Hoxha Hasan Tahsinit, rektori i parë i Universitetit të Stambollit, dramën “Besa” të Sami Frashërit, “Shahnamenë” e poetit të madh të Persisë, Firdeusit, përmbledhjen poetike “Tahajjulat” (Ëndërrimet) dhe “Katër stinët” të poetit Naim Frashëri. Këto vepra të përkthyer nga Vexhi Buharaja janë vlerësuar si perla në letërsinë artistike shqiptare. Ka përkthyer nga persishtja veprën “Gjylistani dhe Bostani” të poetit të madh persian, Saadi Shirazi (1203-1291), i krahasuar me Shekspirin, madje i mbiquajtur “Shekspiri i Lindjes”.

Prof. Eqrem Çabej kur e lexoi “Gjylistanin” vlerësoi jo vetëm tekstin e shqipëruar, por edhe studimin hyrës dhe fjalorin përkatës enciklopedik të përbërë prej 110 zërash që shoqërojnë veprën dhe

tha: “Mjaftonte vetëm studimi hyrës, shënimet sqaruese dhe fjalori enciklopedik që Vexhi Buharaja të meritonte një gradë shkencore.”

Përveç qindra përkthimeve të dokumenteve historike, përveç përkthimeve të kryeveprave letrare botërore dhe atyre shkencore, Vexhi Buharaja ka shkruar e botuar edhe punime, studime historike, filozofike, islamo-mistike si “Lufta e Qerbelasë”, “Haxhi”, etj., të cilat janë botuar në revistën “Zani i Naltë”, “Kultura Islame”, “Njeriu” gjatë viteve 1938-1944 etj... Ai zotëronte në mënyrë të shkëlqyer gjuhët klasike të Lindjes islame: arabishten, persishten dhe osmanishten së bashku me turqishten e re. Zotëronte gjithashtu gjuhët kryesore të Perëndimit: anglishten, gjermanishten, frëngjishten dhe italishten. Pas vitit 1966, kur filloi punën në Institutin e Historisë si bashkëpunëtor shkencor, përvetësoi edhe rusishten.

Në muajin maj të vitit 1975, Vexhi Buharaja, ky intelektual atdhetar, dijetar, njohës i dhjetë gjuhëve kryesore Lindore e Perëndimore, ky poet, shkrimtar, përkthyes, historian, studiues, hulumtues, u pushua nga puna, u dëbua nga Instituti i Historisë në Tiranë si njeri i “padëshirueshëm”. Ai që i pajisur me moralin islam, kështu që në punën e tij shkencore u shqua për vlerësime reale, të drejta, të sakta shkencërisht, pa politizimet e kërkuara. Të gjitha këto e bënë të

padëshirueshëm qëndrimin e tij në Institutin Historisë si bashkëpunëtor shkencor, megjithëse ai ishte i vetmi zotërues i dhjetë gjuhëve, megjithëse kishte një bagazh kulturor që të detyronte respekt, megjithëse kishte një përvojë dhjetëvjeçare në punën shkencore. Vexhiu pushohet nga puna duke iu përmendur vitet e burgut dhe internimet në kënetën e Maliqit, studimet në shkollën fetare dhe akuza se bënte propagandë fetare islame. Ai u tërhoq në vendlindjen e tij, në Berat, ku u zhyt në botën e vetmisë, të punës individuale e të punëve të thjeshta për të siguruar jetesën.

Ndërroi jetë në vendlindje, në Berat, më 5 korrik 1987, në moshën 67 vjeçare, por pas tri vitesh ai sikur u ringjall në kulturën shqiptare. Vexhi Buharaja, në gjithë krijimtarinë e tij, në radhë të parë mbeti poet. Në konkursin letrar që u shpall me 1 janar 1942, kur ishte 22 vjeçar, ai fitoi çmimin e parë me poezinë “Përpara Tomorit”.

Pas përmbysjes së diktaturës komuniste në Shqipëri, menjëherë, emri dhe vepra e Vexhi Buharasë

u përtëri dhe hyri në histori... Për jetën dhe veprën e Vexhi Buharasë studiues e historianë organizuan Sesione Shkencore në Berat e Tiranë. Më 20 dhjetor 1993 iu dha titulli “Mësues i Popullit” (pas vdekjes), kurse më 6 korrik 1994, Biblioteka e qytetit të Beratit mori emrin: Biblioteka “Vexhi Buharaja”. Në vitin 1995, historiani Ahmet Kondo, ish punonjës shkencor në Institutin e Historisë në Tiranë, shkroi një monografi me titull: “Vexhi Buharaja, njeriu, poeti, dijetari” (1920-1987), Tiranë, 2005, botuar nga Shtëpia botuese “EUGEN”. Në vitin 2008, në Tiranë, u botua libri me titull: “Vexhi Buharaja pa mite e mjegull” shkruar nga Yzedin Hima, me të cilën autori mbrojti me sukses gradën shkencore Master në fushën e studimeve letrare, pranë Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Tiranës.

Edhe medreseja e Beratit sot mban gjithashtu emrin e këtij kolosi letrash, “Vexhi Buharaja”.<sup>1</sup>

---

1. Për më tepër shih: Hima, Yzedin, “Vexhi Buharaja, pa mite dhe mjegull”, Tiranë, 2004.

## Pse duhet te jemi fetar II (vijon nga numri i kaluar)

### Abstrakt

*Kur-ani është një vepër e denjë për ç'do respekt. Kur-ani i ka njoftue njerëzsis tagrin e Zotit; ja shkoqitë qartaz njeriut marëdhanië që ka me Perëndin dhe ç'dubët të pres prej Tij. Kur-ani mbështiehtë krejt bazat morale e filozofike. Virtuti e vesi, e mira dhe e keqja, e vërteta dhe ngjyra e vërtetë e ç'do sendi është shpjegue në Kur-an...*

*Kur-ani është ai qi disa thërmija grindavecësh të bastardbuëm e të degjeneruem i lidhi ngushtë dhe i bashkojë në një tansi Kombëtare që kishte të bájë me fatin e botës. Themelet e urtis e të filozofis, drejtsija e barasija, janë shpjegue në Kur-an.*

*Kur-ani këshillon e porosit kursim dhe shpenxime me masë; Aj nxjerr në dritë njerin që ka humbë rrugën. Aj shpëton moralin. Kur-ani të mëtat dhe gabimet e njeriut i ndryshon dhe i këmben në vërtete të larta e të përsoruna.*

*Kanë qenë të marrë ata që Islamizëmës i kanë thanë fë barbare. Këta njerëz i kanë mbyllë sytë përpara Kur-anit, dhe s'kan dashtë të kuptojnë se si ky libër i naltë qysh prej shumë shekujsh po shkël e po resitë nga zemrat e njerëzvet veset e liga.*

### Pse nuk vjen tjetër Profet mbas Muhammedit?

**M**â naltë thamë se ardhja e profetëve njani mbas tjetrit kish për qëllim: të përmbushte të metat që ekzistonin, dhe të zgjanonte në mëndje të njerëzve, si mbas fuqis

mendore të tyre, një ato gjâna, të cilat i përshtateshin nevojave dhe rrethanave të kohës.

Shi, po për këtë qëllim, mbas Jesu Krishtit erdhi Muhammedi. Ay erdh të përmbushte të metat që ekzistonin, të zhdukte krejt një ato sende të pa nevojshme dhe të damshme.

Tashti le të kthehem në themë.

Pse nuk vjen tjetër profet mbas Muhammedit?... Të shumta, dhe të ndryshme janë përgjegjet që mund t'i epen kësaj pyetje; por unë po mjaftoj vetëm me dy:

I. Se Muhammedi kje dërgue Profet mbi gjithë botën, dhe

II. Se libri - ose ma mirë me thanë ligji - i Tij Hyjnuer i dërguem prej Zotit, mban të tana konditat që i përshtaten popujve dhe kohnave pa përjashtim. Kur-ani merr ndën mbrojtje dhe garanton të drejtat e të gjithë kombeve dhe të krejtë popujvet Musliman e jo Musliman.

Një orientalist Frang, Z. Sidion, tue folur për Kur-anin thotë: “Kur-ani është një vepër e denjë për ç’do respekt. Kur-ani i ka njoftue njerzís tagrin e Zotit; ja shkoqitë qartaz njeriut marëdhanië që ka me Perëndín dhe ç’duhet të pres prej Tij. Kur-ani mbështie krejt bazat morale e filozofike. Virtuti e vesi, e mira dhe e keqja, e vërteta dhe ngjyra e vërtetë e ç’do sendi është spjegue në Kur-an... “Kur-ani është aj qi disa thërmija grindvecësh të bastardhuëm e të degjeneruem i lidhi ngusht dhe i bashkoj në një tansi Kombëtare që kishte të bájë me fatin e botës. Themelet e urtís e të filosofis, drejtsija e barasija, janë spjegue në Kur-an.” “Kur-ani këshillon e porosit dhe spenxime me masë; Aj nxjerr në dritë njerin që ka humbë rrugën. Aj shpëton moralin. Kur-ani të mëtat dhe gabimet e njeriut i ndryshon dhe i këmben në

vërtyte të larta e të përsosuna.”

“Kanë qenë të marrë ata që Islamizmës i kanë thanë fé barbare. Këta njerëz i kanë mbyllë sytë përpara Kur-anit, dhe s’kan dasht të kuptojnë se si ky libër i naltë qysh prej shumë shekujsh po shkul e po resitë nga zemrat e njerzvet veset e liga.”

Një dijetar tjetër Angles John Davenport spjegon mendimet e Z. Gibbonit tue thanë: “Kur-ani është kodi i përgjithshëm i Muhammedanve, një kod fetar, shoqnor, civil, tregtar, militar, gjyqsor, e penal. Rregullon ç’do gjá; qysh prej ceremonive të fesë e deri tek ato të jetës së përditshme, qysh prej shpëtimit të shpirtit deri tek shëndeti i trupit, qysh prej të drejtave të të gjithëve, deri tek ato të ç’do individuali, qysh prej interesave të ç’do njeriu deri tek ato të shoqëris, qysh prej moralit deri në krime, e qysh prej dënimit këtu, deri tek ay në jetën tjetër.”

Prap Z. John Davenport thotë për Kur-anin: “Kur-ani pranohet pa kundërshtim që është standarti i gjuhës Arabe, dhe është mbushë plot me figura të shkëlqyera, dhe me metafora fort guximtare, sa do qi disa herë është i errët, jo i qartë për me u marrë vesh, përgjithësisht është i fuqishëm e sublim; kështu të vërtetojmë gjykimin e të famëshmit Goethe, i cili thotë: Kur-ani është një vepër, me pa kthjelltín a me premín e të cilit lexuesi pik së pari mërzitet,

mbasandaj thithet prej bukurive tërhjekse, dhe mâ në fund pa dashje, ja marrin zemrën dhe e bëjnë për vehte bukurit e shumta të Kur-anit.”

Kishim me përmendë këtu edhe shumë orjentalista kundërshtarë të tjerë, të cilët, para madhështis së Kur-anit, kanë kjen të detyruem me folë të drejtën. Ja, pra, për arsyeat e nalt parashtruara nuk vjen dhe as nuk është nevoja të vij tjetër profet mbas Muhammedit. Kur-ani i përshtatet ç’do kohe e Kombi.

### Personaliteti i Muhammedit

Myslimanët e kanë për detyrë morale, me mos kursye fjalët dhe lavdet mâ të ambla që mund të prodhojë penda e tyne, për Hazreti Muhammedin, por kurdoherë këta të jenë mbrenda kufinit të së vërtetës se p. sh., po i thamë hasha, H. Pejgamberit Zot, a djali i Zotit, kemi kalue, jo vetëm kufinin e të vërtetës, por kemi hy edhe mâ tutje... në shirq; estagfirull-llah; për H. Muhammedin. Prandaj unë këtu po marrë vetëm se ç’kanë thanë do kundërshtarë për të.

Të fillojmë pra qysh nga rinija tij. Sir William Muir thotë: “Gjithë autoritetet janë në një mejtim që Muhammedi, në djalëri kishte një sjellje modeste, dhe vetija të naltësuarat rallë ndër qytetasit e Meqes.”

Mr. Cyrlyle (Karlail) në librin e tij “Heronj si Profet Muhammedi dhe Islamizma” tue bâ fjalë për sjelljet e

Muhammedit në rinin e tij, thekson se, akoma kur që i vogël, ju dha titulli El-Emin që d.m.th. besniku<sup>1</sup>.

Në moshën 25 vjeç Muhammedi (A.S.) u martue me Hatixhen, e cila ish 40 vjeçe; dhe me të jetoj 25 vjet. Mbas vdekjes së Hatixhes Muhammedi bâni një jetë poligamije, me shumë gra dhe ky ka kjenë shkaku, qi shumë llapazana (na falni që e përdorëm këtë fjalë; por ç’të bëjsh!) të thonë se Muhammedi ka kjen qefli grash, dhe ka hupë dignitetin e tij me anë të poligamie. Le të ndëgjojmë pra, edhe për këtë se ç’farë thotë një orjentalist dhe kundërshtarë: “Lypset mbajtë mend se mâ të shumtat e martesavet që kontraktoj Muhammedi munden me u spjegue, së paku, aqë prej mëshirës së tij për gjendjen e dëshpërueme të grave në fjalë, sa dhe për arësylene të tjera. Martesat qenë gadi të gjitha me gra të veja, të cilat nuk qenë as të bukura, as të pasuna, por përkundrazi.”

Bossvorth Smith, tue përshkrue personalitetin e naltë të profetit t’Islamizmës, Muhammedit, thotë: “Në bariun e shkretinës, në tregëtarin e Sirisë, në banuesin e malit Hîra, në reformuesin pa as një pasanik, në t’arratusinin e Medines, në sundimtarin e pohuem, n’atë baraz me Khosroët (qisrat) e Persís dhe Heraklis e Greqis, na prap se

1. Vepra e Carlyle që përmendëm sipër është e përkthye edhe në gjuhën t’onë Shqip prej z. Beqir Çela.

prap mudn të dallojmë një njësi (unité). Nuk besoj se ndokush tjetër, rrethanat, ose gjendja e përjashtme e të cilit ndryshuën aqë shumë, ndryshoi vetë ma pak se profeti në të përballunit e tyne: ngjarjet kanë ndryshue, por esanca më duket të jet një soj.”

### Afetarizma

Mjerisht është bënë një zakon ndër të rritë t'onë, që në qoftë se i pyet të ç'farë besimi janë kanë, me t'u përgjegjë pa pikë turpi: “Afetar”, e ç'të duhet feja tash, sidomos në kët kohë.

- Po si mor, si s'të duhet feja në kët shekull, por a mund të rrojë njeriu pa fé në kto kohë?

- Si s'rron. Rusia me bolshevizëm, pa fé pa kurrgjâ, kanë me t'u përgjegjë.

- Hajde, hajde. Ja edhe një plagë tjetër “bolshevizëm; ti a din se bolshevizëm don të thotë zhgattrim?...”!

- Më len pra, të lutem të j'u shpjegoj pak konsekuencat e mnershme t'afetarizmit:

Afetarizëm = Dekadencia shpirtnore, morale e materiale e njeriut. Afetarizëm; sa fjalë e tmershme!!! Shumë të mbëdha e të damshme janë konsekuencat pra të afetarizmi. Afetari, shpresat kah të gjitha anët i ka të preme. Ay jeton si një kafshë në mes të shoqnis, pa ditur detyrët e tij që ka kundrejt

kolektivitetit; pa dijtun qëllimin e ardhjes së tij në këtë botë. E kush ja mëson atij këto a ... ligja morale!... po a ka ligjë morale pa pasur fé? (!) A ekziston ligjë morale pa besim? (!)... Jeta, për afetarin është një lodër ku dominon vetëm fuqija materiale.

- Jam i lumtur. Jam një menduës i lirë; dhe kjo liri i hodhi poshtë fenë dhe ç'do gja të mykun.

- Por; a ka menduës të lirë? Shko ke një tregtar meri një plaçkë të kushtueshme, dhe jepi mandej 2 leka, tue thanë: “Na shok, unë jam një menduës i lirë e prandej kaq bënë!”

Afetari jeton si një ... kafshë në mes të një fushës s'gjelbër, qi nuk shijon barin e njomë t'asaj fushe qi është nergut për të.

Dy janë shkaqet ma kryesore që e hudhin njerin n'afetarizëm: I- Ignoranca, dhe II- Mos zotnim i vetvetes. Si kur ç'do njeri t'i mposhte këta dy anmiq kaq të mbëdhenj, at'her në fjalorin t'në s'kishte me ekzistue këjo fjalë.

Duhet pohuar se, Intelektualët e sotshëm, ata që i thonë vetes afetar, të cilët nën maskën e intelektualitetit mshefin gjithë krimet e tyre morale e shoqnore, janë vetëm parasitë që rrojnë në krahë të botës. Intelektualët t'onë nuk dinë as barrën e randë që kanë dhe që randon mbi krahë të tyne. Mjafton për ta të këndojnë ndo një rromancë dashurie, kriminale dhe të jepen mbas qejfeve dhe epsheve shtazore. Të vishen mbasmodës, të pëlqehen prej vajzave të bukura, të



mbyllen nër kafene dhe të luajnë bixhos, të shkojnë natë për natë në për kinema... dhe ja u banë Intelektualë(!) Në qoftë se kjo don të thotë intelektualitet, na të gjithë mund të bähemi Intelektualë pa zor. Urdhno mor z. Afetar kët libër këndoje një herë! Ti pa pas as një ide mbi fet si flet kundër tyne?...

- Hê, hê, ç'po m'duhet; mue s'më intereson ajo. Unë vetëm due të kemë pare e të báj qejf.

- Pare! Mirë po feja s'të ndalon me qenë i pasun. Mjafton që pasunin t'a fitojsh me djersë, t'a keshë të pastër dhe t'a prishësh ku duhet.

Këta janë afetarët. Në qoftë se qëllimet e tyne s'mbarohen me anë miqsh, në qoftë se shpresat e tyne nuk j'u plotsohen at'herë ata bajnë atë që kanë bâ ma parë shokët e tij... mer një revolver dhe ja heq vehtes...

Mirë po kjo nuk ngjet edhe me

fetarin: Aj din qëllimin e ardhjes në këtë botë, din detyrët që ka kundrejt shoqnis, din... dhe... din... të gjitha ç'a i urdhnon feja dhe i ve në veprim. Në qoftë se qëllimet e tij nuk mbarohen ay ja le punën në dorë Zotit dhe nuk vret vehten.

Ja pra, pse duhet të jemi fetar. Dhe ja pse dijetarët ma të mdhaj të botës Descarti, Newtoni e tjerë janë kundra Afetarizmit.

Lexuesat të ndershëm të më falin për përdorimin e do fjalve jasht edukatës njerzore e fetare, si dhe pse, në disa vende kam dalë mjaft jashtë themës së marrun për subjekt.

Në numrin e ardhëm kemi me zhvillue: "Islamizma dhe qytetërimi" dhe "Bolshevizma dhe Islamizma".<sup>2</sup>

**Sabri Dardha**

---

2. Marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 8-9, viti 11, gusht-shtator 1936, f. 240-251.

## Abstracts in English

### Islamic Studies

#### **1. Social relations as seen from the prophetic tradition perspective Prof. Dr. Faredin Ebibi, Faculty of Islamic Sciences, Skopje**

*Interest in Sociology, which is a discipline of science that deals with social issues and the study of social phenomena, originates and stems from the continuous development of social life.*

*In order to create a family on a sound educational basis and understand the problems that married couples face in the formation phase followed by other issues such as; education of the children, the study of behavioural phenomena, religious manifestations, cultures of beliefs, ideas, social and ethnic classes where this process calls for self-awareness. In the same way that commitment and knowledge are required to manage these processes, knowledge of delicate segments is also needed.*

*Most social studies confirm the fact that man, by nature, is social and instinctively tends to integrate with other members of his kind. The circumstances constrain him to deal with people and cooperate with them, in order to achieve his interests and goals, as well as meet his needs and vice versa.*

*Sociology as a science deals with the study of social relations at the level of individuals, groups or institutions only from the point of view or from the aspect of achieving or fulfilling the interests of this world.*

*When it comes to Islamic law (shariah), it is a lot different, because it builds the connection of social relations of this world with the reward or punishment of the Hereafter, by establishing a series of controls and frameworks that contribute to the proper construction of these reports. Observance of these controls strengthens the ranks of believers and protects society from disruption and fragmentation. This text tries to take a look at the importance of good social relations or relations in Islam and the consequences as a result of not fulfilling one's duties.*

## **2. The mosque – The most deserving place for the worship of Allah the Almighty**

**Resul Rexhepi, Prishtinë**

*In Islam, mosques have a particularly prominent place. The name itself, which in Islamic sources and tradition is used as a synonym for a mosque, “Baytullah”, which means “House of Allah”, speaks volumes about the role and importance of the mosque in the lives of Muslim believers. The Muslim is closely associated with the mosque from his early childhood, when he goes to the mosque, to the mektep, for religious teachings and instructions, and to acquire the first knowledge of religion, morals, and etiquette. This connection should remain permanent, even when he grows as a personality, because Islam recommends to his followers to go to the mosque constantly every day throughout their lives to perform ibadah (worship) in congregation, due to the fact that prayers in congregation are far more valuable than those performed individually.*

*Also, the largest Muslim gatherings, such as the Friday and Eid prayers, are held in the mosque, and even some very important events in the life of Muslims are closely related to the mosque; that’s the place where Qur’an is recited, mawlid is performed, sermon-nasihah (lecture, advice) is preached, holy (blessed) nights and other Islamic holidays are observed etc. And when a Muslim dies, he is again associated with the mosque, because, mainly, in the harem of the mosque or in front of the mosque, the funeral prayer is performed, which is the dignified passage of man from this world. To sum it up, the Muslim organizes his life in such a way as to be in close contact with the mosque.*

*Therefore, it is rightly estimated that mosques are the largest Muslim shrines as well as the first and oldest Islamic classrooms and the most important cultural and educational centers.*

*This paper aims to remind esteemed readers about the importance and role of mosques and congregations in the life of Muslims, the elements that make up the mosque, our attitude towards them, etc.*

## **Quran and Science**

### **3. The miracle of the Holy Qur’an in the light of new scientific discoveries**

**Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi, Gjakovë**

*Fourteen centuries ago, the Glorious Qur’an, revealed by Allah Almighty through the Messenger, Muhammad (peace be upon him), who lived in the Arabian Peninsula at a time when the Arabs used the lunar calendar to count time, was addressed to them in a language they understood:*

**“He made the sun to shine, and the moon to shine, and to it (the**

moon) the stages, that you may know the number of years and the reckoning. Allah did not create this except for a specific purpose. He clarifies the revelations for a people who understand.” Yunus, 5.

*Allah, the All-Knowing, in His eternal knowledge, has known that the time will come when scientists will discover these facts and then realize that the Qur'an is the leader of science, while Muhammad (pbuh) is the seal of His prophets.*

*Therefore, Allah, the All-Knowing, for every place, guarantees the accuracy and truthfulness of the Glorious Qur'an for every time, era and generation:*

**“We will make it possible for them to see Our revelations in the horizons and in themselves until it becomes clear to them that it is the truth. Is it not enough that your Lord is Witness over all things?”** Fussilat, 53.

## Studies

### 4. Waqf between the past and future

#### Edison Hoti, Waqf headquarters, Muslim Community of Albania

*Waqf plays a very important role in Muslim societies. It has been the main source for the various public services provided to religious communities and beyond.*

*Traditionally, the creation of waqfs is embedded in the culture of Muslims and is included in all spheres of life. The Waqf has also contributed to human service in various fields of development; such as the construction of places of worship, the formation of educational institutions, infrastructure, medicine, etc. However, in modern times, waqf has seen a declining role, in almost all Muslim countries. Phenomenon, which raises a number of questions, related to the factors that led to this decline, thus emphasizing the reasons for its decline and at the same time the need for reform.*

*Studies show that transparency with funds is the main element in adding new endowments. This is the most vital dynamic of waqf. If this is lacking we can not expect any significant results, no matter how great the efforts.*

*The reformulation of the way of managing waqfs and the design of an integrated network, which studies the problems encountered in the practice of modern times in which we live, is also a key element in the development of waqfs.*

*The planning and legislative guidance of the waqf is undoubtedly the main dynamic that shows the perspective and horizon of the development of the waqf, depending on its nature and the conditions under which that waqf is composed.*

*The study concludes that when Muslims are more committed to waqf practices, moving transparently in the organization of waqfs and funds related to waqf practices, by increased*

*interest in forming new waqfs, then we can really talk about a real revival of the practice of waqf. The waqf gains its missing value in Muslim society, returning proper service to those voices who benefit from the waqf, thus becoming an attractive magnet of God's Mercy among people.*

## **5. Bediuzzaman Said Nursi, The wonder of the age I Dorian Demetja, Directorate of Culture, Albanian Muslim Community**

*Bediuzzaman Said Nursi was a high-caliber scholar of Kurdish origin, born in 1878 in Eastern Turkey. He lived in the last decades of the Ottoman Empire, experienced its collapse and disintegration after the First World War, and lived 37 years after the formation of the Turkish Republic in 1923. Being a person of high spirituality throughout his life and mission was as a result of acting in accordance with the Qur'an and Sunnah, as well as respecting reason and logic. He remained faithful to his cause with such nobility that he demanded nothing more than the opportunity to meet the minimum necessities of survival. Many publications and conferences have been devoted to Bediuzzaman's distinctive qualities; such as devotion to lofty ideals, his deep perception of the world today, simplicity, all-encompassing humanism, loyalty to his companions, chastity, modesty, humbleness and little self-sufficiency. .*

*Bediuzzaman Said Nursi has faced, throughout his life, the most difficult trials. This is because he confronted and tried to challenge anarchy, which was based on disbelief and atheism, defining it as the most significant problem that needed to be addressed urgently. He lived at a time when a good part of humanity was immersed in atheism, due to abuse of science and philosophy, and when the minds were brainwashed by communism. He hated disbelief, tyranny, and apostasy, so he fought hard against despotism. He says: "Before me is a great fire. Its flames are reaching the cup of heaven. In that fire my child is burning, my faith is on fire. I'm running to put out that fire and save the faith. Someone is blocking my foot in the street, what does it matter? In the face of this great fire, is this small event worth it?! Truncated thoughts! Narrow views ... "*

*Bediuzzaman analyzed three major factors that had to do with the essence of the problems of that time, but which remained the same in our time: Ignorance in the sense of indifference to God and the Prophet, poverty and social division. Bediuzzaman dedicated his life to the fight against this fatal virus. In his eye, the hope of salvation for the ummah would be in vain, as long as false and deviant ideologies would prevail and until society was enlightened with the light of systematic learning, knowledge and thought. He inspired the younger generations with the news of the rebirth and guided*

them to the paths that lead to Islamic thought. He always referred to knowledge and activation of the mind and worked hard for the birth of a perfect and healthy society. To achieve such an ideal, Bediüzzaman thought that education was the main guide, which would include mosques, schools, garrisons, streets, playgrounds, and even prisons.

Bediüzzaman wrote many books, but the focus was on works entitled "Risale-i Nur" (Messages of Light). They are the fruit of serious efforts, which explain and present to today's man the basic principles of faith and the truths of the Qur'an. Bediüzzaman himself said in a lecture: "Now I see clearly that most of my life has been commanded and directed beyond the capacity of my perception, which would produce these messages to serve the cause of the Qur'an, as if my whole life as a scholar had been spent in preparation for these writings, which demonstrate the miracle of the Qur'an."

In the nineteenth and twentieth centuries, the various attacks on the foundations of faith undertaken by materialists, atheists, and others, in the name of science and progress, made Bediüzzaman understand the urgent and fundamental need, which consisted of preserving and strengthening faith. His method analyses belief and disbelief and demonstrates through clear logical arguments that, by following the method of the Qur'an, not only it is possible to reasonably prove all the truths of faith, but also demonstrate that these truths hold the only rational explanation for existence: man and the universe. With the method he developed, Bediüzzaman explained the truths of the faith in a language that can be understood by people of all walks of life, presenting the unity of mind, heart and feelings. Thus, by combining theology, mysticism, and the positive sciences, he presented a whole new perspective and aimed to eliminate the division of school, madrasa, and tekke. His works have been consistently read with great care, with sincere feelings of appreciation, and will continue to be of particular importance as time goes on.

Bediüzzaman believed that the source or the cause of man's problems that the Islamic world was currently facing, could be cured, in particular, only through the renewal of the faith. Thus, Bediüzzaman turned his back on the politics of the time and devoted all his efforts to this goal. With a deep knowledge of the religious and modern sciences, the new path to truth that Bediüzzaman opened with the works of the Risale-i Nur was so successful in preserving and strengthening the faith that it was accepted by many personalities as the reviver of the religion as promised by the Prophet Muhammad (pbuh) that he would come in every century in the well-known hadith: "Surely Allah will send to this ummah at the beginning of every century a mujtabid who will renew the affairs of the religion."

## 6. Sleep as an argument/sign

**Blerim Lazimi**

*One of the signs of faith that Allah brings to man and counts in the text of His Most Exalted Word is “sleep.” Since sleep is mentioned in the Qur’an as an argument (under the shadow of the term “verse”), then the believer and anyone else, provided they show no disregard and indifference, can draw the right lessons, which are very important for life. In this context, Allah is quite clear in the Qur’an:*

**“Indeed, Allah does not hesitate to take any example – that of a mosquito or what is smaller than it. And those who have believed know that it is the truth from their Lord. But as for those who disbelieve, they say, “What did Allah intend by this as an example? He misleads many thereby and guides many thereby. And he misleads not except the defiantly disobedient. “ Qur’an (2/26)**

*On the other hand, Bediüzzaman Said Nursi, thanks to the wisdom bestowed by the Creator, guides us how to read Allah’s creation and how to understand the verses of the Qur’an. As an excellent teacher, Bediüzzaman explains to us in the form of a principle that everything created by Allah appears in three faces. One of the faces looks upon and conveys the Beautiful Divine Names. The other face invites you to discover the truth of eternity. And the third face, which looks with the eyes of the nafs (ego), accompanies you in the temporality, insecurity, duplicity, and whims of earthly life. As is the case with any creation of Allah, this principle of Bediüzzaman teaches us to look at the three faces of “sleep” through the light of the Qur’an and furthermore, to read in them the message of belief in Allah and the Hereafter. This is the method of understanding the language of creation, with which Allah guides us from the first verse revealed in the Qur’an, **“Read in the name of your Lord Who created (everything)!” Quran (96/1)***

## Psychology of Islam

### 7. “Producing children”, A biological, economical, psychological, social and islamic perspective

**Skënder Mustafi - Jusuf Zimeri, Skopje**

*Human society is facing a stream of new medical developments, which have taken root in modern society over the past decade, but which have now gained momentum in development. Among the most discussed and contradictory of them is that of the “pregnant mother” or “surrogate mother”. It is about implanting a fertilized ovary in a mother who carries the burden of pregnancy in exchange for material goods or as a humane and voluntary act to make others happy with children. This issue is controversial at the social, ethical, moral, legal*

and economic levels. It is also evaluated and classified according to various religious principles.

This research is mainly based on secondary sources of information, which is the literature and first-hand research, as well as publications of the experiences of expectant mothers. From these two types of facts a scientific analysis is made and conclusions are reached in all five perspectives.

From the research it can be clearly seen that we are dealing with a new trend in modern society, which has already taken the first steps and is developing with great impetus. The first forms of business models have already begun, where the formation of the first forms of customer interaction with manufacturers and intermediaries has begun. It is also understood that the rich and more recently the middle class are consumers, while the poor are the producers. Recently, through research, the first consequences at the psychological level of pregnant women can be felt as well as in the social aspect of different social groups. In other words, the development of the term family has gone one step further. It should also be noted that this research does not take into account ethical-moral assessments due to research dimensions and frameworks. However, research and evaluation has been done based on Islamic principles, as Islamic jurisprudence prohibits the role of the "pregnant/surrogate mother" and most types of artificial insemination.

## Sociology of Islam

### 8. The challenges of the Muslim family in the contemporary society Msc. Ledian Cikalleshi, Korça

In the modern and post-modern period, the Muslim family faces many challenges, which make it difficult for believers to live their religion by listening the typical advice, turning life as a Muslim into a challenge. The development of technology, science and the changing quality of life compared to 50 or 100 years ago or even 10 years ago, constantly raises questions and discussions about what the attitude of Islam should be and how will we adapt to the new circumstances without violating the principles of religion. The main challenge of the family remains its formation: starting with the finding of a husband or wife, marriage, keeping the hijab in schools, jobs and institutions, continuing with religious education in schools, schools with mixed education of boys and girls, television and education of children, halal food and consumption of products according to Islamic criteria, communication through social networks, etc. These are some of the challenges that a Muslim family faces in maintaining the faith and balance of the religion. Some solutions or fatwas have been given to these issues, but they remain insufficient to solve the problem. This is due to the dynamic of post-modern life that makes it hard for the negative consequences of some phenomena to be understood from the beginning. The aim of this study is to identify and shed light on these challenges that the Muslim family faces in contemporary society, all over the world and in Albania in particular.



## Translation

### 9. The White Death: Ibn 'Arabi about the trials and virtues of hunger and fasting

Atif Khalil, Lethbridge University, Canada

*This article presents an analysis of the treatment of fasting and hunger by Ibn 'Arabi (d. 1240) in chapters 106 and 107 of his masterpiece Al-Futuhatu'l-mekkiyye ("Meccan Openings"). In examining this short section of the encyclopedic text, the essay highlights the profound theological significance of hunger and fasting, emphasizing the virtues and fruits of spiritual toil in the thought of the Andalusian mystic. Attempts are also made to place some of Ibn 'Arabi's ideas in the broader context of the early Sufi tradition which he inherited.*

## Review

### 10. Review of the novel "Muhajireen Ballads" by Nimon Muçaj

Ma. sc. Refik Gërbeshi

*Written between 2016-2019, he approaches with rare mastery the Muhajireen period of 1876, the period before the League of Prizren and that of 1910, going back in time for nearly half a century in search of the cemetery of the first. The peculiarity of this novel is , that it presents the events and characters as they appear in reality, without hiding the Islamic element and the influence of the imam, the mosque and Islam. It describes in detail those times of forcible expulsion of Albanians from the lands of Prokuplje, Nis and Korshumli and the commemorations of those events in the streets of Istanbul, Izmir, Adana: down to the desire to find alive one of the survivors in the homeland, especially the blind mother from whom he was separated by the horror of the Balkan Wars. The character with mixed identity Elez Gërguri, a boy with no family, named Muhaxhiri, Arnauti, etc., accompanied by the Ottoman script with Albanian letters of the Alphabets of imams like Hoxha Hasan Tahsini, seems to signal that many truths are hidden in these writings. In this novel, the author mentions literary figures of rifles and pens, which it is our obligation to illuminate. Under the shadow of the event Muhaxhirije walks through the difficult times of violent migration of Albanians from the areas of ancient Albanian Nis to the Valley, Kosovo, Kumanovo and Skopje to Istanbul, Izmir and Adana. Trying to bring back memories of his identity by retrieving the graves of his ancestors, He comes to find the grave and the traces of identity.*

## Personality

### 11. Vexhi Buharaja (1920-1987)

*Vexhi Buharaja was a prominent figure in many fields, a special intellectual in Albania, a patriot, connoisseur of the ten main Eastern and Western languages.*

*He was fluent in the classical languages of the Islamic East: Arabic, Persian and Ottoman along with modern Turkish. He also spoke the major languages of the West: English, German, French and Italian. After 1966, when he started working at the Institute of History as a research associate, he also mastered Russian.*

*This great man, poet, translator, writer, historian, orientalist, scholar and researcher, was hired as a teacher and faced a lot of difficulties, as he was a man “unwanted” by the communist system. In 1965 he was admitted to the Sector of Medieval History, at the Institute of History in Tirana. Vexhi Buharaja with his research work, scientific study produced great results. The work he did at the Institute of History revealed many secrets to Albania. Due to Vexhi Buharaja’s persistent work, organized research and study, he was able to collect and translate into Albanian and also transcribe about three hundred Turkish-Ottoman-Arabic inscriptions, of great value.*

## Retrospective

### 12. Why we should be religious

*The Qur’an is a deed worthy of all respect. The Qur’an has informed man of the attribute of God; make clear to man the relationship he has with God and what to expect from Him. The Qur’an encompasses all moral and philosophical foundations. Virtue and vice, good and evil, truth and true color of everything is explained in the Qur’an...*

*The Qur’an is the one who tied some pieces of bastardized and degenerate quarrelsome people together and united them in a National unity that had to do with the fate of the world. The foundations of wisdom and philosophy, justice and equality, are explained in the Qur’an.*

*The Qur’an advises and envisions mass savings and expenses; It brings to light the man who has lost his way. It saves morale. The Qur’an changes man’s faults and mistakes and exchanges them for high and perfect virtues.*

*It was foolish to call Islam a barbaric religion. These people have closed their eyes to the Qur’an, and they did not want to understand how this lofty book has been eradicating evil vices from the hearts of people for many centuries.*



# Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.



REVISTË SHKENCORE DHE KULTURORE

# Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti X (XXIV) - Nr. 34 (187)

## Studime Islame

Prof. Dr. Faredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup  
Resul Rexhepi, Prishtinë

## Kur'ani dhe Shkenca

Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi, Gjakovë

## Studime

Edison Hoti, Drejtorja e Vakf-Investimeve, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë  
Dorian Demetja, Drejtorja e Kulturës, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë  
Blerim Lazimi

## Psikologji Islame

Skënder Mustafi & Jusuf Zimeri

## Sociologji Islame

Msc. Ledian Cikalleshi, Myfti i Korçës

## Përkthime

Atif Khalil, Universiteti i Lethbridge, Kanada

## Reçencë

Ma. sc. Refik Gërbeshi

## Personalitet

## Retrospektivë



Çmimi 300 lekë / 3 €